Approved For Release 2009/06/15 : CIA-RDP83-00418R001100040009-2

25X1

Page Denied

Approved For Release 2009/06/15 : CIA-RDP83-00418R001100040009-2

Approved For Release 2009/06/15 : CIA-RDP83-00418R001100040009-2

GAZETA ZYRTARE

E REPUBLIKËS POPULLORE TË SHQIPËRISË

18 Janar | Nr. 1 | 1955

PËRMBAJTJA

PJESA E I-rë

1) Dekret Nr. 1979 dt.10.I.1955 — Mbi një ndryshim me dekretin Nr. 1354 dt. 1/XI.1951 mbi krijimin e rezervave të punës. 2-2

2) Dekret Nr. 1978 dt.10.I.1955 — Për akordim dekoratash . . 2-15

3) Dekret Nr. 1982 dt.10.I.1955 — Për akordim dekoratash . . 15-18

PJESA E II-të

4) Urdhëresë e Qeverisë Nr. 1 dt. 12.I.1955 — Mbi sigurimin vullnetar të gjesë së gjallë. 18-24

5) Urdhëresë e Qeverisë Nr. 2 dt. 17.I.1955 — mbi çmimet, stimulacionet dhe normat e dorëzimit për disa bimë industriale dhe artikuj bujqësore dhe blektoralë. 24-28

6) Vendim i Këshillit Ministrave Nr. 13 datë 12.I.1955 Mbi ekonomitë ndihmëse . 28-30

7) Vendim i Këshillit Ministrave Nr. 14 datë 12.I.1955 — Mbi disa shtesa dhe ndryshime në rregulloren mbi sigurimin vullnetar të kulturave bujqësore t'aprovuar me vendimin e Këshillit të Ministrave të R.P.SH. Nr. 662 dt. 21.VIII.1950 30-31

8) Rregulla të Ministrisë Bujqësisë. — Mbi kanalet ujitëse dhe bonifikimet 31-36

NDRRIM EMËRI

1. Me vendimin Nr. 13, datë 25.V.1954 të Ministrisë së Punve të Mbrëndëshme, Baje Qeshja ndroi mbiemrin nga Qeshja në Lanaj.
2. Me vendim Nr. 26 datë 7,XII,1954 të Ministrisë Punve të Mbrënhëshme, Jonuz Gega ndroi mbiemrin nga Gega në Manka.

Approved For Release 2009/06/15 : CIA-RDP83-00418R001100040009-2

Approved For Release 2009/06/15 : CIA-RDP83-00418R001100040009-2

DEKRET

mbi një ndryshim në dekretin Nr. 1354 datë 1 nëntor 1951 mbi krijimin e rezervave të punës

Në mbështetje të nenit 58, pika 6. të Kushtetutës së Republikës Popullore të Shqipërisë:

ME PROPOZIMIN E QEVERISË
PRESIDIUMI I KUVENDIT POPULLOR
nxjerr këtë dekret:

DEKRET MBI NJË NDRYSHIM NË DEKRETIN NR. 1354 DATE 1 NENTOR 1951 MBI KRIJIMIN E REZEVAVE TË PUNËS.

Neni 1.—

Në nenin 3 të dekretit Nr. 1354 datë 1 Nëndor 1951 mbi "krijimin e rezervave të punës" shtohet parangrafi i tretë me këtë përmbajtje:

"Për t'u pranuar nxanësit në shkollat profesionale të më sipërme për minierat duhet të kenë mbushur moshën 16 vjeç dhe në kurset gjashtëmujore të kualifikimit për minierat të kenë mbushur të 18 vjetët".

Neni 2.—

Ky dekret hyn në fuqi që nga viti shkollor 1955-1956.

Tiranë, me 10-1-1955
Nr. i dekretit 1979

PËR PRESIDIUMIN E KUVENDIT POPULLOR
TË REPUBLIKËS POPULLORE TË SHQIPËRISË

SEKRETARI: Sami Baholli

ZAV. KRYETARI: Pilo Peristeri

DEKRET

për akordim dekoratash

Në mbështetje të nenit 58, pika 8, të kushtetutës së Republikës Popullore të Shqipërisë,

PRESIDIUMI I KUVENDIT POPULLOR
DEKORON:

I. NË MINISTRINË E NDËRTIMIT DHE KOMUNIKACIONIT
ME URDHËRIN E PUNËS TË KL. III-të

1) Jani Spiro Xhani, me këtë motivacion:
" Me zotësinë e tij si inxhinjer. ka ndihmuar në mobilizimin e kolektivit punonjës për realizimin dhe tejkalimin e planit të shtetit të vitit 1954 në parkun automobilistik të Shkondrës".

2) Xheladin Jakup Molovi
3) Haki Duraj Alija
4) Qamil Mustafa Ishmaku
5) Mustafa Naim Toska
6) Todi Sotir Kavaja

me këtë motivacion:
" Punëtorë të ndërgjegjëshëm dhe të palodhur në punë, janë mo-

Approved For Release 2009/06/15 : CIA-RDP83-00418R001100040009-2

Approved For Release 2009/06/15 : CIA-RDP83-00418R001100040009-2

bilizuar me të gjitha forcat e tyre për realizimin e planit të shtetit të vitit 1954 në parkun automobilistik të Shkodrës, dhe kanë treguar kujdes për mirëmbajtjen e automjetit, duke u bërë kështu shembëll dhe nxitës në punë për gjithë kolektivin punonjës".

7) Ligor Vasil Vako
8) Ymer Bafjar Mustafaj
9) Uran Mitrush Toska
10) Llambi Kozma Manari
11) Todi Vasil Janko

Me këtë motivacion:

"Punëtorë të ndërgjegjëshëm dhe të palodhur në punë. janë mobilizuar me të gjitha forcat e tyre për realizimin e planit të shtetit të vitit 1954, kanë tejkalulur normën e punës në një përqindje të konsiderushme dhe kanë treguar kujdes për ruajtjen e pasurisë së shtetit, duke u bërë kështu shembuil dhe nxitës në punë për gjithë kolektivin punonjës".

12) Ramazan Veli Vrapi
13) Neki Qamil Osmani
14) Thoma Qendro Kronidha

me këtë motivacion:

"Me zotësinë e tyre tekniko-administrative, kanë ndihmuar në mobilizimin e kolektivit punonjës të parkut automobilistik Tiranë për realizimin e planit të shtetit të vitit 1954, duke u bërë kështu shëmbull në punë edhe për punonjësit e tjetër".

ME MEDALJEN E PUNËS

1. Emin Etem Kastrati
2. Shefqet Cen Zakanjori
3. Ejell Shtjefen Arapi
4. Rifat Sajt Bakaili
6. Bim Tonin Toma
6. Sul Ymer Alibali
7. Xheladin Ymer Alibali
8. Shhaip Abaz Gradeci
9. Ali Halil Shllaku
10. Sabri Rakip Ademi
11. Zef Gjon Deda
12. Haxhi Brahim Muslija
13. Mitro Kristo Minovi
14. Lec Mark Shkreli
15. Mihal Kristo Shkondra
16. Ramadan Elez Elezi
17. Muhamet Murat Goxha
18. Rexhep Rustem Laçaj
19. Haki Seit Bacaj
20. Hamdi Dulo Hallumi
21. Teufik Sadik Tukaj
22. Grigor Todi Tusha
22. Zef Shtiefan Sheldija
24. Simon Ndoc Ndoci
25. Rexhep Hajdar Hallumi
26. Bahri Gani Dida
27. Shyqëri Sylyf Kurti
28. Kol Ndrek Pali
29. Fehtah Isuf Jusi
30. Jakup Smail Ismaili
31. Gjon Zef Toma
32. Izedin Alush Picoku

me këtë motivacion:

"Punëtorë të dalluar dhe të palodhur në punë. janë mobilizuar me të gjitha forcat e tyre për realizimin e planit të shtetit të vitit 1954, në parkun automobilistik të Shkodrës, duke u bërë kështu shembëll në punë edhe për punëtorët e tjerë".

33. Sejfullla Xhemal Deda
34. Ali Mehmet Meme
35. Koço Kristo Fundo
36. Pano Arsen Foniko
37. Arif Hysen Mortolli
38. Mehmet Selim Delvina
39. Foto Petro Qendro
40. Vangjel Sotir Budo
41. Odhise Filip Proko
42. Gaqo Ilio Duklasi
43. Thoma Grigor Pagoni
44. Kiço Kozma Karavello
45. Sotir Kosta Koçi
46. Hamdi Abaz Abazi

Approved For Release 2009/06/15 : CIA-RDP83-00418R001100040009-2

Approved For Release 2009/06/15 : CIA-RDP83-00418R001100040009-2

47. Jani Kosta Deda
48. Eftimi Kost Kosta
49. Spiro Llazi Mustaqe
50. Andrea Dhimitër Thamo
51. Hajredin Hasan Boshjaku
52. Kristo Pandeli Llupa
53. Sadik Shaban Shabani
54. Qako Thoma Çela
55. Sadik Bahri Vogli
56. Pellum Rahmi Kamberi
57. Sali Hysen Leka
58. Gaqo Petro Ceka
59. Lefter Kristo Xhupo
60. Haki Nezif Saraçi
61. Hiqmet Bido Bidas
62. Jorgo Mando Misha
63. Kristo Nikolla Shtrepi
64. Miftar Hajredin Zena
65. Avdyl Haxhi Hyka
66. Ramazan Shuaip Sevdaja
67. Hamdi Buto Kermi
68. Alaks Sarqiz Aksixhani
69. Jovan Andrea Gjole
70. Savo Murat Filipi
71. Durmish Shefki Shaqiri

me këtë motivacion:

"Punëtorë të dalluar dhe të palodhur në punë, janë mobilizuar me të gjitha forcat e tyre për realizimin e planit të shtetit të vitit 1954 në parkun automobilistik të Tiranës, duke u bërë kështu shembull në punë edhe për puntorët e tjerë".

72) Vangjel Llambi Verria
73) Reshat Ibrahim Pobrati
74) Marka Kosta Mata

me këtë motivacion:

"Punëtorë të dalluar dhe të palodhur në punë, janë mobilizuar me të gjitha forcat e tyre për realizimin e planit të shtetit të vitit 1954 kanë tejkaluar normën e punës dhe kanë treguar kujdes për ruajtjen e pasurisë socialiste, duke u bërë kështu shembull në punë edhe për punonjësit e tjerë".

75. Vath Shyqyri Gripshi
76. Reshit Veli Belba
77. Teodor Mihal Laçi
78. Abdyl Sali Jonuzi
79. Aleko Qendro Martiko
80. Aleko Janaq Qafiri
81. Muharrem Alush Gruda
82. Kozma Trifon Prifti
83. Çerçiz Nuri Islami
84. Tonin Gjon Pashku
85. Islam Beqir Meçe
86. Hizeir Imer Gora
87. Petrit Muharrem Tafruçi
88. Shaqir Hakik Ismaili
89. Kol Mark Gjergji
90. Sulejman Halil Begtashi
91. Muharem Tafil Rogani
92. Todi Rupi Naçi
93. Andon Aleks Papingu
94. Haxhi Ali Teliti
95. Lefter Miço Velço
96. Rexhep Xhemal Shehu
97. Sulejman Islam Meta
98. Simon Milo Kuçi
99. Safet Vesel Zorba
100. Xhaferr Shaban Dëshnica
101. Kajtas Mustafa Cela
102. Sulejman Mahmut Kosova
103. Islam Selman Tepshi
104. Koço Jorgji Afezolli
105. Shaban Xhaferr Bakiu
106. Demir Muharrem Taho
107. Myftar Selim Selimi
108. Ndue Kol Kola
109. Avdi Ismail Latifi
110. Bardhok Dod Gjoni

me këtë motivacion;

«Janë mobilizuar me të gjitha forcat e tyre për realizimin e planit të shtetit të vitit 1954 dhe e kanë tejkaluar në një përqindje të konsideruarshme kanë punuar me metoda sovjetike, kanë bërë kursime dhe kanë treguar kujdes për ruajtjen e pasurisë socialiste, duke u bërë kështu shembull në punë edhe për punonjësit e tjerë».

Approved For Release 2009/06/15 : CIA-RDP83-00418R001100040009-2

Approved For Release 2009/06/15 : CIA-RDP83-00418R001100040009-2

111) Gjergj Vangjel Pendavinji, me këtë motivacion:

«Është mobilizuar me të gjitha forcat dhe me zotësin e tij teknike-administrative ka ndihmuar kolektivin punonjës për realizimin e planit të shtetit të vitit 1954, duke u bërë kështu shembull në punë dhe për puntorët e tjerë».

112, Llazi Lili Miho
113. Abedin Ahmet Leskoviku
114. Hysen Ali Gjetani
115. Kristaq Todi Bogdani
116. Ibrahim Ismail Mata
117. Xhemal Hysen Shani
118. Xhevat Abil Çadra
119. Jonuz Islam Beshiri
120. Filip Terpo Tanaj
121. Koli Thoma Maksuli
122, Riza Ahmet Stafa
123. Sabah Muharem Rustemi
124. Enver Murat Hoxha
125. Musa Mahmut Metani
126. Mehdi Hajdar Shehu
127. Muharem Hajdar Salku
128. Halil Ismail Mata
129. Ali Mujo Berisha
130. Adem Tol Berisha
131. Nasuf Masllan Salku
132. Imer Mexhit Mija
133. Jorgji Stavri Cfilo
134. Andon Vasil Jorgji
135. Mustafa Selman Ximbraku
136, Damail Veli Mata
137. Ruse Mitro Mina
138. Gani Aziz Vuthl
139. Filip Terpo Nina
140. Risto Pavlo Marku
141. Qazim Mustafa Mija
142. Shaqir Xhaver Koçi
143. Xhemal Feta Çelmeta
144. Sadush Mahmut Halla
145. Tase Boris Nikolla
146. Trajko Jaqim Çfilo
147. Llukan Vasil Ballabani
148. Hasan Haxhi Kapllani
149. Malo Asllan Mezini
150. Andon Leonidha Gura
151, Tefik Rahib Arifi
152. Isuf Hajdar Kallushi
153. Rexhep Bajram Stajku
154. Osman Murat Baraku

me këtë motivacion:

«Punëtorë të dalluar dhe të palodhur në punë, janë mobilizuar me të gjitha forcat e tyre për realizimin e planit të shtetit të vitit 1954, në ndërmarjen «21 Dhjetor», kanë tejkaluar normën e punës në nji përqindje të konsiderushme dhe kanë treguar kujdes për ruajtjen e pasuris socialiste, duke u bërë kështu shëmbull në punë për gjithë kolektivin punonjës».

II. NË KOMITETIN E RINIS TË RRETHIT ELBASAN ME MEDALJEN E PUNËS

1) Llazar Vangjel Josifi, me këtë motivacion:

«Puntor i dalluar dhe i palodhur në punë, ka punuar me tri metoda sovjetike dhe ka tejkaluar normën ditore të punës në 130%, ka treguar kujdes për ruajtjen e pasurisë socialiste dhe ka bërë përpjekje për ngritjen e tij tekniko—profesionale, duke u bërë kështu shëmbull në punë edhe për punëtorët e tjerë».

2) Pandi Vasil Ala, me këtë motivacion:

»Punëtor i dalluar dhe i palodhur në punë, ka punuar me tri metoda sovjetike dhe ka tejkaluar normën ditore të punës në 125%, ka treguar kujdes për ruajtjen e pasurisë socialiste dhe ka bërë përpjeke për ngritjen e tij tekniko—profesionale, duke u bërë kështu shembull në punë edhe për punëtorët e tjerë».

3. Nikoll Filip Leci, me këtë motivacion:

«Punëtor i dalluar dhe i palodhur në punë, ka punuar me tri metoda

Approved For Release 2009/06/15 : CIA-RDP83-00418R001100040009-2

Approved For Release 2009/06/15 : CIA-RDP83-00418R001100040009-2

sovjetike dhe ka tejkaluar normën ditore të punës në 150%, ka treguar kujdes për ruajtjen e pasurisë socialiste dhe ka bërë përpjekje për ngritjen e tij tekniko—profesionale, duke u bërë kështu shembull në punë edhe për punëtorët e tjerë».

4. Mustafa Osman Turku, me këtë motivacion:

«Punëtor i dalluar dhe i palodhur në punë, ka punuar me tri metoda sovjetike dhe ka tejkaluar normën ditore të punës në 125%, ka treguar kujdes për ruajtjen e pasurisë socialiste dhe ka bërë përpjekje për ngritjen e tij tekniko—profesionale, duke u bërë kështu shembull në punë edhe për punëtorët e tjerë».

5. Musa Shaqir Balashi, me këtë motivacion:

«Punëtor i dalluar dhe i palodhur në punë, ka punuar me tri metoda sovjetike dhe ka tejkaluar normën ditore të punës në 128%. ka treguar kujdes për ruajtjen e pasurisë socialiste dhe ka bërë përpjekje për ngritjen e tij tekniko—profesionale, duke u bërë kështu shembull në punë edhe për punëtorët e tjerë».

6. Shefqet Hysen Sinani 7. Riza Ymer Belshaku

me këtë motivacion:

«Punëtorë të dalluar dhe të palodhur në punë, kanë punuar pa u lodhur për realizimin e planit të shtetit, kanë treguar kujdes për ruajtjen e pasurisë socialiste, dhe kanë bërë përpjekje për ngritjen e tyre tekniko—profesionale».

8. Mahmut Isuf Kurti, me këtë motivacion:

«Punëtor i dalluar dhe i palodhur në punë, ka tejkaluar normën ditore të punës në 169%, ka treguar kujdes për ruajtjen e pasurisë socialiste dhe ka bërë përpjekje për ngritjen e tij tekniko—profesionale duke u bërë kështu shembull në punë edhe për puntorët e tjerë».

9. Antoneta Dhimitër Pero, me këtë motivacion:

«Punëtore e dalluar dhe e palodhur në punë, ka tejkaluar normën ditore të punës në 170%, ka treguar kujdes për ruajtjen e pasurisë socialiste dhe ka bërë përpjekje për ngritjen e saj tekniko—profesionale, duke u bërë kështu shembull në punë edhe për punëtorët e tjerë».

10. Mereme Hajdar Tabaku, me këtë motivacion:

«Punëtore e dalluar dhe e palodhur në punë, ka tejkaluar normën ditore të punës në 120%, ka treguar kujdes për ruajtjen e pasurisë socialiste dhe ka bërë përpjekje për ngritjen a saj tekniko—profesionale, duke u bërë kështu shembull në punë edhe për puntorët e tjerë».

11. Zydi Shaban Dane, me këtë motivacion:

«Punëtor i dalluar dhe i palodhur në punë, ka tejkaluar normën ditore të punës në 143%, ka treguar kujdes për ruajtjen e pasurisë socialiste dhe ka bërë përpjekje për ngritjen e tij tekniko—profesionale, duke u bërë kështu shembull në punë edhe për puntorët e tjerë».

12. Mari Jani Panxhi, me këtë motivacion:

«Puntore e dalluar dhe e palodhur në punë, ka tejkaluar normën ditore të punës në 125%, ka treguar kujdes për ruajtjen e pasurisë socialiste dhe ka bërë përpjekje për ngritjen e saj tekniko—profesionale duke u bërë kështu shembull në punë edhe për punëtorët e tjerë».

13. Leonora Dhimitër Byku 14. Skënder Vangjel Tollumi

me këtë motivacion:

«Punëtorë të dalluar dhe të palodhur në punë, kanë punuar me me-

Approved For Release 2009/06/15 : CIA-RDP83-00418R001100040009-2

Approved For Release 2009/06/15 : CIA-RDP83-00418R001100040009-2

toda sovjetike dhe kanë tejkaluar normën ditore të punës në 140%, kanë treguar kujdes për ruajtjen e pasurisë socialiste dhe kanë bërë përpjekje për ngritjen e tyre tekniko–profesionale, duke u bërë kështu shembull në punë edhe për puntorët e tjerë».

15. Baki Kasem Pajova, me këtë motivacion:

«Punëtor i dalluar dhe i palodhur në punë, ka punuar me metoda sovjetike dhe ka tejkaluar normën ditore të punës në 150%, ka treguar kujdes për ruajtjen e pasurisë socialiste dhe ka bërë përpjekje për ngritjen e tij tekniko–profesionale, duke u bërë kështu shembull në punë dhe për punëtorët e tjerë».

16. Mina Mark Gugu

17. Xhemal Hasan Cacja

18. Preng Jorgji Toçi

me këtë motivacion:

«Puntorë të dalluar dhe të palodhur në punë, kanë punuar me metoda sovjetike dhe kanë tejkaluar normën ditore të punës në 190%, kanë treguar kujdes për ruajtjen e pasurisë socialiste dhe kanë bërë përpjekje për ngritjen e tyre tekniko–profesionale, duke u bërë kështu shembull në punë edhe për puntorët e tjerë».

19. Fadil Sefedin Doçi, me këtë motivacion:

«Punëtor i dalluar dhe i palodhur në punë, ka punuar me metoda sovjetike dhe ka tejkaluar normën ditore të punës në 144%, ka treguar kujdes për ruejtjen e pasurisë socialiste dhe ka bërë përpjekje për ngritjen e tij tekniko–profesionale, duke u bërë kështu shembëll në punë edhe për puntorët e tjerë».

20. Hydajet Hajdar Tabaku, me këtë motivacion:

«Punëtor i dalluar dhe i palodhur në punë, ka punuar me metoda sovjetike dhe ka tejkaluar normën ditore të punës në 170%, ka treguar kujdes për ruajtjen e pasurisë socialiste dhe ka bërë përpjekje për ngritjen e tij tekniko–profesionale, duke u bërë kështu shembull në punë edhe për puntorët e tjerë».

21. Kurt Hysen Nuredini, me këtë motivacion:

«Punëtor i dalluar dhe i palodhur në punë, ka punuar me metoda sovjetike dhe ka tejkaluar normën ditore të punës në 180%, ka treguar kujdes për ruajtjen e pasurisë socialiste dhe ka bërë përpjekje për ngritjen e tij tekniko–profesionale, duke u bërë kështu shembull në punë edhe për puntorët e tjerë».

III. NË KOMITETIN EKZEKUTIV TË K.P. TË QARKUT TË SHKODRËS ME MEDALJEN E PUNËS

1. Zef Prel Marashi
2. Bajram Dyl Kodra
3. Kol Pal Kola
4. Ramadan Rexhep Mani
5. Ali Adem Mani

me këtë motivacion:

«Punëtorë të dalluar dhe të palodhur në punë, kanë punuar me metoda sovjetike dhe kanë realizuar dhe tejkaluar normën e punës 130 deri 140%; kanë treguar kujdes për ruajtjen e materjalit dhe kanë bërë përpjekje për ngritjen e tyre tekniko–profesionale».

6. Sherif Smail Gruda
7) Hamdi Kapllan Begoviqi
8. Ragip Hamza Golemi

Approved For Release 2009/06/15 : CIA-RDP83-00418R001100040009-2

Approved For Release 2009/06/15 : CIA-RDP83-00418R001100040009-2

me këtë motivacion:

«Punëtorë të dalluar dhe të palodhur në punë, janë mobilizuar me të gjitha forcat e tyre për realizimin e planit të shtetit, kanë tejkaluar vazhdimisht normën e punës 150 deri 160%, kanë shfrytëzuar në maksimum automjetin dhe kanë treguar kujdes për mirëmbajtjen e tyre».

9. Halim Hysen Çeka
10. Selim Bajram Myftari
11. Tom Kol Mashaj
12. Jonuz Halil Fishta
13. Mati Lek Leci
14. Arif Halil Fishta
15. Cen Dan Rrjolli
16. Lan Selim Selimi

me këtë motivacion:

«Punëtorë të dalluar dhe të palodhur në punë, janë mobilizuar me të gjitha forcat e tyre për realizimin e planit të shtetit, kanë tejkaluar vazhdimisht normën e punës 160 deri 200%, dhe kanë treguar kujdes për ruajtjen e materjalit, duke u bërë kështu shembull në punë edhe për puntorët e tjerë».

17. Cin Mati Daija
18. Palok Shan Shani
19. Haki Riza Mani
20. Gani Buto Mandija
21. Pac Zef Mertini

me këtë motivacion:

«Punëtorë të dalluar dhe të palodhur në punë, kanë organizuar mirë punën në repartin e zdrukthëtarisë në N.L.N. Shkodër, kanë nxjerrë prodhim me kualitet të mirë, kanë realizuar dhe tejkaluar planin e shtetit në 130% dhe kanë perfeksionuar kuadro të reja».

22. Esma Elez Tuzi
23. Lirije Shyqyri Mani
24. Prende Ton Ceta
25. Shpresa Taip Shkodra

me këtë motivacion:

«Punëtorë të dalluar dhe të palodhur në punë, kanë punuar me metoda sovjetike, kanë tejkaluar normën e punës 130 deri 140% kanë nxjerrë prodhim me kualitet të mirë, dhe kanë bërë kursime në Landën e parë.

28. Qamil Tahir Kadija
29. Riza Dan Sulejmani
30. Sabri Osman Uruçi
31. Gjon Arif Bejtja

me këtë motivacion:

«Punëtorë të dalluar dhe të palodhur në punë, kanë punuar me metoda sovjetike, kanë tejkaluar normën e punës 130 deri 150%, kanë bërë kursime dhe kanë nxjerrë prodhime me kualitet të mirë, duke u bërë kështu shembull në punë edhe për puntorët e tjerë».

32. Binak Hysen Alija, me këtë motivacion:

«Ka organizuar dhe drejtuar mirë punën si përgjegjës i kantjerit të ndërtimit në Fushë–Arrës (Pukë). Ka mobilizuar gjithë kolektivin punonjës për realizimin e planit të shtetit dhe ka qenë gjithmonë në ballë të luftës për kapërcimin e vështirësive të ndërtimit, duke bërë kështu që plani i shtetit të realizohet para afatit.

IV. NE KOMITETIN EKZEKUTIV TË K.P. TË QARKUT KORÇËS ME URDHËRIN E PUNËS TË KL. I-rë

1. Kristo Naum Kono, me këtë motivacion:

«Ka punuar pa u lodhur dhe në mënyrë shembëllore, i është përgjigjur thirrjes të Partisë dhe të pushtetit për kompozimin dhe drejtimin e operetës

Approved For Release 2009/06/15 : CIA-RDP83-00418R001100040009-2

Approved For Release 2009/06/15 : CIA-RDP83-00418R001100040009-2

së parë Shqiptare «AGIMI», duke kontribuar kështu në ndërtimin e bazave të socializmit në vendin tonë».

ME URDHËRIN E PUNËS TË KL. II-të

1. Pandi Kristo Stilio
2. Mihal Gaqi Ciko

me këtë motivacion:

«Me aftësinë e tyre, janë treguar puntorë të palodhur në drejtimin nga ana e regjisë t'operetës së parë shqiptare «Agimi», duke kontribuar kështu në ndërtimin e socializmit në vendin tonë».

3. Vangjush Thimi Mio, me këtë motivacion:

«Është treguar punëtor i palodhur në pregatitjen e dekoreve, t'operetës së parë Shqiptare «AGIMI», duke kontribuar kështu në ndërtimin e bazave të socializmit në vendin tonë».

ME URDHËRIN E PUNËS TË KL. III-të

1. Vangjo Thodhor Vangjeli, me këtë motivacion:

«Është mobilizuar me të gjitha forcat e tij dhe është treguar punëtor i palodhur në punë si Drejtor i Shtëpisë së Kulturës, duke mobilizuar amatorët në nxjerrjen me sukses të Operetes së parë Shqiptare «AGIMI», duke kontribuar kështu në ndërtimin e bazave të socializmit në vendin tonë».

2. Marika Kosta Balashi, me këtë motivacion:

«Është mobilizuar me të gjitha forcat e saj dhe është treguar e palodhur në punë në interpretimin e rolit të Anës në operetën e parë Shqiptare «AGIMI», duke kontribuar kështu në ndërtimin e bazave të socializmit në vendin tonë»

3. Pandi Dhimitër Raidhi, me këtë motivacion:

«Është mobilizuar me të gjitha forcat e tija dhe është treguar i palodhur në punë, në interpretimin e rolit të Breshkut në operetën e parë Shqiptare «AGIMI», duke kontribuar kështu në ndërtimin e bazave të socializmit në vendin tonë».

4. Piro Kiço Suljoti, me këtë motivacion:

«Është mobilizuar me të gjitha forcat e tija dhe është treguar i palodhur në punë në interpretimin e rolit të Sokolit (Dublim) në operetën e parë Shqiptare «AGIMI», duke kontribuar kështu në ndërtimin e bazave të socializmit në vendin tonë».

5. Guri Simo Trebicka, me këtë motivacion:

«Është mobilizuar me të gjitha forcat e tija dhe është treguar i palodhur në punë si pjesëmarrës n'orkestër, në pregatitjen e operetës së parë Shqiptare «AGIMI«, duke kontribuar kështu në ndërtimin e bazave të socializmit në vendin tonë».

ME MEDALJEN E PUNËS

1. Gaqo Naun Jorganxhi
2. Ramazan Bogdani
3. Krisa Jorgji Kroji
4. Iro Andon Cico
5. Boris Viktor Plumbi
6. Miti Thanas Tuna
7. Raqi Dhionis Treska
8. Raqi Aristokli Palo
9. Vilermini Thanas Ravoniku
10. Vançi Kristo Pleqi
11. Andon Spiro Bitri

Approved For Release 2009/06/15 : CIA-RDP83-00418R001100040009-2

Approved For Release 2009/06/15 : CIA-RDP83-00418R001100040009-2

12. Dhimitra Stefan Xheka
13. Dhimitraq Niske Orgocka
14. Andrea Panci Majrani
15. Dhorka Perika Ndini
16. Pavlina Naum Bozhano
17. Andoneta Kozma Lubonja
18. Lefkodhe Naum Kane
19. Raqi Dhori Jankulla
20. Liza Josif Skrami
21. Dhimitra Thanas Mele
22. Misto Josif Grabocka
23. Andrea Guri Trebicka

me këtë motivacion:

«Janë mobilizuar me të gjitha forcat e tyre dhe janë treguar të palodhur në punë, në pregatitjen e operetës së parë Shqiptare «AGIMI».

24. Mehmet Telah Telah
25. Abaz Beqir Rrapo
26. Elmas Sulemen Sulejmani
27. Rexhep Sulejman Devolli

me këtë motivacion:

«Punëtorë të dalluar dhe të palodhur në punë, janë mobilizuar me të gjitha forcat e tyre për realizimin e planit të shtetit duke tejkaluar normën e punës në 130% dhe kanë treguar kujdes për ruajtjen e pasurisë socialiste, duke u bërë kështu shembull në punë edhe për puntorët e tjerë».

28. Gjike Thanas Gjika, me këtë motivacion:

«Është treguar punëtor i ndërgjegjëshëm dhe i palodhur në punë, është mobilizuar për realizimin e planit të shtetit, ka furnizuar mirë objektet dhe ka zbatuar drejt dhe në kohë urdhërat e eprorëve».

29. Shyqyri Maksut Kupe, me këtë motivacion:

«Punëtor i dalluar dhe i palodhur në punë, është mobilizuar për realizimin dhe tejkalimin e planit të shtetit dhe si stallier ka treguar kujdes për mirëmbajtjen dhe ushqimin e lopëve, duke u bërë kështu shembull në punë edhe për punëtorët e tjerë„.

30. Kristo Aleks Kristo
31. Miti Qirjas Rrapo

me këtë motivacion:

«Puntorë të dalluar dhe të palodhur në punë, janë mobilizuar me të gjitha forcat e tyre për realizimin e planit të shtetit duke tejkaluar normën e punës në 120% dhe kanë treguar kujdes për ruajtjen e pasurisë socialiste, duke u bërë kështu shembull në punë edhe për puntorët e tjerë„

32. Petraq Aleks Koço
33. Ferit Nuredin Topçiu
34. Thimi Mikali Boxhufi
35. Pandi Dhosi Sherko

me këtë motivacion:

«Punëtorë të dalluar dhe të palodhur në punë, janë mobilizuar me të gjitha forcat e tyre për realizimin dhe tejkalimin e planit të shtetit, kanë punuar me metoda sovjetike, kanë tajkaluar normën e punës në një përqindje të konsideruarshme dhe kanë treguar kujdes për ruajtjen e pasurisë socialiste».

36. Pandi Rapi Joti, me këtë motivacion:

«Panëtor i dalluar dhe i palodhur në punë, është mobilizuar me të gjitha forcat e tij për realizimin e planit të shtetit duke tejkaluar normën e punës në 125%, dhe ka treguar kujdes për ruajtjen e pasurisë socialiste, duke u bërë kështu shembull në punë edhe për puntorët e tjerë».

37. Kristaq Spiro Niço
38. Vangjel Lako Tasho

me këtë motivacion:

«Punëtorë të dalluar dhe të palodhur në punë, janë mobilizuar me të gjitha forcat e tyre për realizimin dhe tejkalimin e planit të shtetit duke tejkaluar normën e punës në 120% dhe kanë treguar kujdes për mirëmbajtjen e automjetit, duke u bërë kështu shembull në punë edhe për puntorët e tjerë».

Approved For Release 2009/06/15 : CIA-RDP83-00418R001100040009-2

Approved For Release 2009/06/15 : CIA-RDP83-00418R001100040009-2

39. Demir Hajredin Mustafa. me këtë motivacion:

»Punëtor i dalluar dhe i palodhur në punë, është mobilizuar me të gjitha forcat e tij për realizimin dhe tejkalimin e planit të shtetit duke tejkaluar normën e punës në 160% dhe ka treguar kujdes për mirëmbajtjen e automjetit, duke u bërë kështu shembull në punë edhe për puntorët e tjerë»,

40. Selim Didi Zavalani, me këtë motivacion:

«Punëtor i dalluar dhe i palodhur në punë, është mobilizuar me të gjitha forcat e tij për realizimin dhe tejkalimin e planit të shtetit, duke tejkaluar normën e punës në 200% dhe ka treguar kujdes për mirëmbajtjen e automjetit, duke u bërë kështu shembull në punë dhe për puntorët e tjerë».

42. Vangjel Petraq Maliqi, me këtë motivacion:

«Punëtor i dalluar dhe i pa lodhur në punë, është mobilizuar me të gjitha forcat e tij për realizimin dhe tejkalimin e planit të shtetit, ka tejkaluar normën e punës në një përqindje të konsideruarshme dhe ka treguar kujdes për ruajtjen e pasurisë socialiste».

43. Guri Vangjel Koti. me këtë motivacion;

«Punëtor i dalluar dhe i palodhur në punë, është mobilizuar me të gjitha forcat e tij për realizimin e planit të shtetit duke tejkaluar normën e punës në 146% dhe ka treguar kujdes për ruajtjen e pasurisë socialiste, duke u bërë kështu shembull në punë edhe për puntorët e tjerë».

44. Rrapi Sotir Tasi

45. Thanas Paskal Gjergo

me këtë motivacion:

«Puntorë të dalluar dhe të paladhur në punë, janë mobilizuar me të gjitha forcat e tyre për realizimin e planit të shtetit duke tejkaluar normën e punës në 115% dhe kanë treguar kujdes për ruajtjen e pasurisë socialiste, duke u bërë kështu shembull në punë edhe për puntorët e tjerë».

46. Stathi Llazi Zizi

47. Ilo Thanas Tasi

me këtë motivacion:

"Punëtorë të dalluar dhe të palodhur në punë, janë mobilizuar me të gjitha forcat e tyre për realizimin e planit të shtetit duke tejkaluar normën e punës në 110% dhe kanë treguar kujdes për ruajtjen e pasurisë socialiste, duke u berë kështu shembull në punë edhe për puntorët e tjerë».

48. Taqo Kostaq Borova, me këtë motivacion;

«Punëtor i palodhur në punë, është mobilizuar me të gjitha forcat për realizimin e planit të shtetit, si mekanik ka treguar kujdes për regullimin e automjeteve që të dalin sa më parë nga ofiçina në këtë mënyrë është bërë shembull në punë edhe për punëtorët e tjerë».

49. Niko Sotir Mitrollari. me këtë motivacion:

«Punëtor i dalluar dhe i palodhur në punë, është mobilizuar me të gjitha forcat e tij për realizimin e planit të shtetit duke tejkaluar normën e punës në 180% dhe ka treguar kujdes për ruajtjen e pasurisë socialiste, duke u bërë kështu shembull në punë edhe për puntorët e tjerë».

50. Koli Llazo Kapshtica, me këtë motivacion:

Është mobilizuar me të gjitha forcat për realizimin dhe tejkalimin e planit të shtetit, ka treguar kujdes në lidhje me organizimin dhe drejtimin e punës për sistemimin e lumit Devoll dhe ka zbatuar regullat dhe udhëzimet e drejtoris, duke u bërë kështu shembull në punë edhe për puntorët e tjerë».

51. Niko Kristo Gogo, me këtë motivacion:

«Është mobilizuar me të gjitha forcat për realizimin dhe tejkalimin e

Approved For Release 2009/06/15 : CIA-RDP83-00418R001100040009-2

Approved For Release 2009/06/15 : CIA-RDP83-00418R001100040009-2

planit të shtetit. si gjeometër ka organizuar dhe drejtuar mirë punën për sistemimin e Lumit Devoll dhe ka zbatuar regullat dhe udhëzimet e drejtoris, duke u bërë kështu shembull në punë edhe për puntorët e tjerë».

52. Zisi Kristo Note, me këtë motivacion:

«Është mobilizuar me të gjitha forcat për realizimin dhe tejkalimin e planit të shtetit,ka organizuar dhe drejtuar punën për ngritjen e godinave në Leskovik dhe ka zbatuar regullat dhe udhëzimet e drejtorisë, duke u bërë kështu shembull në punë edhe për puntorët e tjerë».

VI. NË KOMITETIN EKZEKUTIV TE K.P. TË QARKUT GJIROKASTËR ME MEDALJEN E PUNËS

1. Doko Çumani
2. Ali Cane Hysi
3. Lani Sotir Jani
4. Vasil Kristo Kamberi
5. Dalip Raiz Raizi

me këtë motivacion:

«Punëtorë të dalluar dhe të palodhur në punë, kanë realizuar dhe tejkaluar planin e shtetit në 170%. kanë bërë përpjekje për ngritjen e tyre tekniko-profesionale dhe kanë treguar kujdes për ruajtjen e pasurisë socialiste duke u bërë kështu shembull në punë edhe për punëtorët e tjerë»,

6. Kristo Pando Zingo
7. Thoma Nikolla Zisi

me këtë motivacion:

«Punëtorë të dalluar dhe të palodhur në punë, kanë punuar me metoda sovjetike, kanë realizuar dhe tejkaluar normën e punës në një përqindje të konsideruarshme dhe kanë nxjerrë punë me kualicet të mirë. Në këtë mënyrë jcnë bërë shembull në punë edhe për punëtorët e tjerë»,

8. Vuska Thoma Stathi, me këtë motivacion;

«Punëtor i dalluar dhe i palodhur në punë, është mobilizuar me të gjitha fuqit e tij për realizimin dhe tejkalimin e planit të shtetit, ka shfrytëzuar në maksimum automjetin dhe ka treguar kujdes për mirëmbajtjen, duke u bërë kështu shembull në punë edhe për punëtorët e tjerë».

9. Niko Thanas Zaro. me këtë motivacion:

«Punëtor i dalluar dhe i palodhur në punë, ka realizuar dhe tejkaluar vazhdimisht normën e punës në 120%, ka bërë kursime në karburant dhe ka treguar kujdes për mirëmbajtjen e automjetit, duke u bërë kështu shembull në punë edhe për punëtorët e tjerë».

10) Mehmet Shain Shaini
11) Vangjel Foto Gogo
12) Kiço Apostol Lula
13) Vangjel Theodhor Kerpo
14) Llambi Andrea Papa
15) Hezma Mustafa Qamili
16) Thoma Pando Kati
17) Foto Jani Loli

me këtë motivacion :

Puntorë të dalluar dhe të palodhur në punë, janë mobilizuar me të gjitha fuqitë e tyre për realizimin dhe tejkalimin e planit të shtetit duke tejkaluar normën e punës në një përqindje të konsideruarshme. Kanë bërë përpjekje për ngritjen e tyre tekniko-profesionale dhe kanë treguar kujdes për ruajtjen e pasurisë socialiste».

18) Peçi Thanas Petro, me këtë motivacion :

«Puntor i dalluar dhe i palodhur në punë, ka punuar me metodën sovjetike Levçenko Muhanov, ka realizuar dhe tejkaluar normën e punës në 135% dhe ka treguar kujdes për ruajtjen e pasurisë socialiste, duke u bërë kështu shembull në punë edhe për puntorët e tjerë».

Approved For Release 2009/06/15 : CIA-RDP83-00418R001100040009-2

Approved For Release 2009/06/15 : CIA-RDP83-00418R001100040009-2

19) NashoJani Foto
20) Niko Vasil Kati
21) Nako Andon Risti
22) Koço Panajot Loli
23) Stefan Qiro Nano
24) Sulejman Veli Duroli

me këtë motivacion :

«Punëtorë të dalluar dhe të polodhur në punë, kanë organizuar dhe drejtuar mirë punën dhe janë mobilizuar me të gjitha fuqitë e tyre për realizimin dhe tejkalimin e planit të shtetit. Kanë bërë përpjekje për ngritjen e tyre tekniko profesionale dhe kanë treguar kujdes për ruajtjen e pasurisë socialiste».

25) Haseni Hader Haske, me këtë motivacion :

«Si punëtor bahçevan, ka punuar pa u lodhur dhe me punën e tij ka bërë që ekonomija ndihmëse e ndërmarrjes N. L. N. Gjinokastër të jetë një nga më të mirat në këtë qark. Ka prodhuar perime me kualitet të mirë dhe në sasi me të cilat janë furnizuar mencat e punëtorëve, janë furnizuar familjet e punëtorëve dhe janë shitur dhe në treg».

ME URDHËRIN LAVDI NËNËS TË KL. I-rë

1) Athina Vangjel Angjeli

ME URDHËRIN LAVDI NËNËS TË KL. III-të

1) Patra Musa Vangjeli
2) Fatime Habibi
3) Halime Yzeir Malla

VII. NË KOMITETIN EKZEKUTIV TË K. P. TË QARKUT DIBËR ME URDHËRIN E PUNËS TE KL. II-të

1) Isuf Dali Gjani, me këtë motivacion :

«Puntor i dalluar dhe i ndërgjegjëshëm në punë, është mobilizuar me të gjitha forcat e tij për realizimin dhe tejkalimin e planit të shtetit dhe me punën e tij të palodhur është bërë shembull dhe nxitës i emulacionit so cialist në gjithë kolektivin punonjës. Ka treguar kujdes për ruajtjen e materialit, për uljen e kostos dhe ka bërë përpjekje për ngritjen e tij teknikoprofesionale, duke ndihmuar në këtë mënyrë në realizimin e planit të shtetit »

ME URDHËRIN E PUNES TË KL. III-të

1) Riza Hajrulla Leka. me këtë motivacion :

«Punëtor i dalluar dhe i ndërgjegjëshëm në punë, është mobilizuar me të gjithë forcat e tij për realizimin dhe tejkalimin e planit të shtetit në sektorin e sharës Qafë Shtamë, dhe me punën e tij të palodhur është bërë shembull dhe nxitës i emulacionit socialist. Ka treguar kujdes për ruajtjen e materialit dhe ka bërë përpjekje për ngritjen e tij teknikoprofesionale, duke ndihmuar në këtë mënyrë në realizimin e planit të shtetit».

Approved For Release 2009/06/15 : CIA-RDP83-00418R001100040009-2

Approved For Release 2009/06/15 : CIA-RDP83-00418R001100040009-2

ME MEDALJEN E PUNËS

1) Ali Dalip Dervishi
2) Ahmet Osman Beqiri
3) Dali Kurt Totraku
4) Arif Asllan Reçi
5) Hason Ali Bugaci
6) Kasem Hasan Kuka
7) Maliq Isuf Gjoka
8) Mexhit Hasan Bruçi
9) Osman Zenel Lala
10) Sadik Tahir Losha
11) Sadik Ramadan Fera
12) Isuf Osman Kuka
13). Haxhi Hysen Bodini

me këtë motivacion :

«Punëtorë të dalluar dhe të palodhur në punë, kanë punuar me metoda sovjetike në punë dhe kanë tejkaluar normën e punës në 130%; kanë treguar kujdes për ruajtjen e pasurisë socialiste dhe kanë bërë përpjekje për ngritjen e tyre tekniko-profesionale, duke u bërë kështu shembull në punë edhe për puntorët e tjerë»

14. Halit Ibrahim Bruçi
15. Kurt Shaban Lala
16. Tahir Ramadan Lika
17. Kurt Mehmet Murati
18. Tahir Haxhi Biba

me këtë motivacion :

«Punëtorë të dalluar dhe të palodhur në punë, kanë punuar me metoda sovjetike në punë dhe kanë tejkaluar normën e punës në 125%, kanë treguar kujdes për ruajtjen e pasurisë socialiste dhe kanë bërë përpjekje për ngritjen e tyre tekniko-profesionale, duke u bërë kështu shembull në punë edhe për puntorët e tjerë»

19. Ahmet Nezir Pepa
20. Haqif Kapllan Vata
21. Ramazan Mehmet Koleci
22. Ram Kurt Beci
23. Fariz Iljas Beka
24. Iljaz Met Fera

me këtë motivacion :

«Punëtorë të dalluar dhe të palodhur në punë, kanë punuar me metodat sovjetike në punë dhe kanë tejkaluar normën e punës në 140%, kanë treguar kujdes për ruajtjen e pasurisë socialiste dhe kanë bërë përpjekje për ngritjen e tyre tekniko-profesionale, duke u bërë kështu shembull në punë edhe për puntorët e tjerë».

25. Gjon Gjet Cakoli
26. Hajredin Asllan Bardhi
27. Ndrec Lek Locaj

me këtë motivacion :

«Punëtorë të dalluar dhe të palodhur në punë, kanë punuar me metoda sovjetike në punë dhe kanë tejkaluar normat e punës në 135%, kanë treguar kujdes për ruajtjen e pasurisë socialiste dhe kanë bërë përpjekje për ngritjen e tyre tekniko-profesionale, duke u bërë kështu shembull në punë edhe për puntorët e tjerë»

28. Sali Hazis Kuromi
29. Ismail Taf Gjoka

me këtë motivacion :

«Puntorë të dalluar dhe të pa lodhur në punë, kanë punuar me metoda sovjetike në punë dhe kanë tejkaluar normën e punës në 145% ; kanë treguar kujdes për ruajtjen e pasurisë socialiste dhe kanë bërë përpjekje për ngritjen e tyre tekniko-profesionale, duke u bërë kështu shembull në punë edhe për puntorët e tjerë».

30) Mexhit Shaban Torba
31) Sul Ramadan Lala

me këtë motivacion :

«Punëtorë të dalluar dhe të palodhur në punë, kanë punuar me

Approved For Release 2009/06/15 : CIA-RDP83-00418R001100040009-2

Approved For Release 2009/06/15 : CIA-RDP83-00418R001100040009-2

metoda sovjetike në punë dhe kanë tejkaluar normën në një përqindje të konsiderueshme, kanë treguar kujdes për ruajtjen e pasurisë socialiste dhe kanë bërë përpjekje për ngritjen e tyre tekniko profesionale, duke u bërë kështu shembull në punë edhe për puntorët e tjerë».

Tiranë, me 10-1-1955
Nr. i dekretit : 1978

PËR PRESIDIUMIN E KUVENDIT POPULLOR
TË REPUBLIKËS POPULLORE TË SHQIPËRISË

SEKRETARI: Sami Baholli

ZËV. KRYETARI: Pilo Peristeri

DEKRET

për akordim dekoratash

Në mbështetje të nenit 58, pika 8, të Kushtetutës së Republikës Popullore të Shqipërisë;

Me propozimin e Ministrisë së Punve të Brendëshme,

PRESIDIUMI I KUVENDIT POPULLOR

DEKORON

ME URDHËRIN E SHËRBIMIT USHTARAK

1. Gani Musa Goxhi
2. Miti Thanas Teneqexhi
3. Sulo Hekuran Dalipi
4. Tahmas Bahri Beqari
5. Vangjel Sotir Kule

me këtë motivacion:

«Janë dalluar për disiplinë të lartë, për organizimin dhe drejtimin e mirë të punës në sektorin ku punojnë, kanë korur suksese të kënaqëshme në luftë kundër tentativave t' armiqve të pushtetit popullor dhe kanë bërë përpjekje për ngritjen e tyre tekniko-profesionale, duke kontribuar kështu në mbrojtjen dhe forcimin e Republikës Popullore të Shqipërisë».

6. Irakli Spiro Çollaku
7. Kadri Rasim Ismailati
8. Muço Sulo Gjoka
9. Qani Kalo Nako

me këtë motivacion :

«Janë dalluar për disiplinë të lartë, për ngritjen e tyre ushtarako-politike, kanë organizuar dhe drejtuar në mënyrë të kënaqëshme repartet që komandonin dhe që kanë pasur rezultate të mira në ruajtjen dhe forcimin e kufirit shtetëror të Republikës popullore te Shqipërisë».

Jorgo Kristo Malo, me këtë motivacion:

«Gjatë vitit 1954, ka organizuar dhe drejtuar shumë mirë punën dhe ka bërë që plani vjetor të realizohet në mënyrë të kënaqëshme dhe me kualitet të mirë. Ka treguar kujdes për ngritjen e tij politiko-profesionale, ka udhëhequr mirë punën për edukimin ideopolitik të efektivit, duke kontribuar kështu në forcimin e gadishmërisë luftarake të repartit»

ME MEDALJEN E SHERBIMIT USHTARAK

1. Beqir Ali Keci
2. Ilo Kristo Kiço

me këtë motivacion :

«Janë dalluar për organizimin e mirë të punës, për disiplinë të lartë

Approved For Release 2009/06/15 : CIA-RDP83-00418R001100040009-2

Approved For Release 2009/06/15 : CIA-RDP83-00418R001100040009-2

dhe për ngritjen politike-profesionale, kanë udhëhequr në mënyrë të kënaqëshme punën për edukimin ideopolitik të efektivit dhe për forcimin e vigjilencës revolucionare, duke kontribuar kështu në forcimin e gadishmërisë luftarake t' efektivit.

2. Alush Adush Mane
3. Ahmet Alush Stojku
4. Abedin Skendo Elmazaj
5. Ali Abaz Ramollari
6. Aristidh Kozma Ndreu
7. Brahim Jonus Kryemadhi
8. Çelo Dervish Nano
9. Duro Bako Canaj
10. Dhimitër Mark Pjetri
11. Dhori Aleks Nimali
12. Esat Muhamet Gjonaj
13. Et-hem Dervish Dervishaj
14. Ferit Haki Spaho
15. Ferki Hajrulla Bejtiolli
16. Faslli Isuf Tabaj
17. Fadil Ismail Fifo
18. Gaqo Refail Milo
19. Gani Qemal Leka
20. Hamza Meqan Bardhi
21. Hasan Ramadan Hoxha.
22. Haxhi Tahir Bregu
23. Hekuran Ali Goxhi
24. Hajredin Ahmet Tahiraj
25. Haxhi Zaqe Qosja
26. Hasim Yzeir Hodaj
27. Halim Bektash Ajdari
28. Harrun Hysen Xhelili
29. Hysen Besim Baro
30. Ilmi Shaban Hoxhallari
31. Ibrahim Asllan Zenel
32. Izet Ejup Malaj
33. Kozma Ligor Çuko
34. Koço Jani Andrea
35. Kristaq Nikoll Mara
36. Kamber Nezir Suma
37. Koli Ilija Kondi
38. Klime Nikoll Ndini
39. Lik Ram Sula
40. Llembi Simon Petro
41. Mahmut Riza Çullhaj
42. Muharrem Mehmet Muho
43. Mujo Hariz Lazaj
44. Muharrem Yzeir Leshi
45. Niko Dhimiter Jorgji
46. Neim Shaban Shemitraku
47. Preng Frrok Ndreja
48. Qerim Hysni Gjineci
49. Qamil Ramadan Breneshi
50. Qani Sadik Hito
51. Palf Ali Hoxhalliu
52. Suloman Ali Hazisllari
53. Sali Shero Shuaipi
54. Sadik Sulo Liçaj
55. Stefan Kristo Konini
56. Skender Qamil Shkembi
57. Selim Haxhi Topilaj
58. Servet Maliq Sinani
59. Selim Osman Çali
60. Selam Sabri Hoxha
61. Tare Ruzam Isufi
62. Todi Mihal Riza
63. Theodhor Dhimitër Marto
64. Veip Hysni Yzeiraj
65. Vasfi Ymer Mullaj
66. Vangjel Stavro Joti
67. Veis Haxhi Daci
68. Xhafer Hysni Bregu
69. Xhoxhi Thoma Xhoga
70. Sadik Xhavit Gjonbrataj
71. Iljaz Sihat Stepa

me këtë motivacion:

«Janë dalluar për organizimin e mirë të shërbimit, për disiplinë të lartë dhe ngritjen e tyre politiko-profesionale dhe kanë patur suksese të mira në ruajtjen dhe forcimin e kufirit shtetëror të Republikës Popullore të Shqipërisë».

73. Adem Eqerem Çelniku
74. Andon Vangjel Liço
75. Allaman Selim Liko
76. Adem Nezir Jeminaj
77. Reshat Kamber Hasanaj
78. Bajram Hysen Balla
79. Bajram Abaz Bejleri
80. Elmas Et-hem Seferi
81. Faik Lame Lalaj
82. Feti Halil Rodaj
83. Koço Ari Prifti
84. Kasap Ramë Buçpepaj

Approved For Release 2009/06/15 : CIA-RDP83-00418R001100040009-2

Approved For Release 2009/06/15 : CIA-RDP83-00418R001100040009-2

85. Kosta Thanos Talo
86. Mehmet Banush Memelli
87. Murat Mohmut Daja
88. Myfit Ismail Maliqi
89. Muharrem Rakip Dekolli
90. Muharrem Qamil Bejko.
91. Nazif Hysen Shehu
92. Ndrekë Kol Nallbani
93. P'andi Tasi Tandini
94. Rexhep Mustafa Kroj
95. Sabri Sali Memeli
96. Sotir Ilija Karabeci
97. Shaban Kaso Koka
98. Shaban Rakip Bërdëllima
99. Shero Feta Rapaj
100. Tare Bilbil Karabolli
101. Thoma Llambi Buxhaku
192. Zyfer Fiqiri Kamberi
108. Metan Qamil Krakulli
104. Pjeter Preng Gjini
105. Rasim Ali Mici
106. Selfo Refat Çaushaj

Me këtë motivacion :

«Janë dalluar për organizimin e mirë të punës, për disiplinë të lartë dhe ngritjen e tyre politiko-profesionale, kanë patur suksese të kënaqëshme në luftë kundër tentativave të armiqve të Pushtetit popullor, duke kontribuar kështu në mbrojtjen dhe forcimin e Republikës Popullore të Shqipërisë».

107 Abaz Hekuran Xhelili
108. Avni Muharrem Begaj
109. Ali Saliko Asllanaj
110. Ali Veiz Balliu
111. Bajram Haredin Seitaj
112. Bilo Kember Rustemi
113. Brahim Rustem Dallani
114, Beqar Lame Bajrami
115. Caush Kaso Malaj
116, Ded Zef Nikolla
117. Ethem Nexhip Rexhepi
118. Esat Ali Hysenaj
119. Faslli Ymer Dhelpra
120. Gani Jonuz Hila
121. Hasan Seit Jaho
122. Hekuran Hysen Saliu
123. Hazis Banush Çela
124 Hazis Qazim Durmishi
125. Haxhi Ymer Dukati
126. Idriz Ramadan Gjoni
127. Ismail Jonuz Banushi
128. Ismail Muho Muhameti
129. Isuf Xhelal Rustemaj
130. Jake Mustafa Gjoni
131. Jonuz Ali Demo
132. Kasem Abaz Mehmeti
133. Luto Mehmet Brakaj
134. Murat Sulejman Golka
135. Myrteza Osman Saliu
136, Mitat Hajdar Valollari
137. Nexhat Dolo Mullaymeri
138. Ndrec Preng Deda
139. Nuredin Nexhip Bega
140. Ndue Pashka Menga
141. Nazif Rushit Skendo
142. Ramadan Jakup Filaj
143. Refit Daut Zylalaj
144. Sabri Rrapo Asllanaj
145. Sabri Sulejman Fusha
146. Sami Veli Aliu
147. Sabri Hamit Nano
148, Saraç Kapo Dushaj
149. Selo Skendo Selaj
150. Skender Hazis Ceço
151. Shefqet Kaso Melaj
152. Shaban Brahim Cenaj
253. Tefik Refat Kasa
154. Trifon Gori Gjoni
155. Veli Neim Sadushi
156. Xhaferr Jakup Shahini
157. Xhaferr Qazim Micini
158. Xhevit Sulo Tahiri

Me këtë motivacion :

«Të ndërgjegjëshëm dhe të palodhur në kryerjen e detyrës, të disiplinuar dhe të përpiktë në zbatimin e urdhërave, për përpjekje dhe rezultate të kënaqëshme në ngritjen e tyre ideopolitike dhe profesionale».

159. Bexhet Hazbi Spahiu
160. Demo Sade Hida
161. Ismail Xhelil ismailaj
162. Kiço Dhori Jankulla
163. Mystahak Abas Shanaj
154. Ramë Eles Muja
165. Sabri Zyber Jaska
166. Uan Gori Prifti

Approved For Release 2009/06/15 : CIA-RDP83-00418R001100040009-2

Approved For Release 2009/06/15 : CIA-RDP83-00418R001100040009-2

me këtë motivacion:

Janë dalluar për organizimin e mirë të punës, për disiplinë të lartë dhe ngritjen e tyre politike profesionale, kanë korrur suksese të kënaqëshme në luftë kundër tentativave t' armiqve të pushtetit popullor, duke kontribuar kështu në mbrojtjen dhe forcimin e Republikës Popullore të Shqipërisë»

ME MEDALJEN E TRIMËRISË

1. Ismail Hasan Mehmeti, me këtë motivacion:

«Për shpejtësinë, trimërinë dhe guximin që ka treguar në rrethimin e një bande dhe në asgjësimin e kryetarit të saj me datën 13 korrik 1954».

2) Prel Martin Martini
3. Ymer Muho Muhja
4. Rok Pjeter Pjetri

me këtë motivacion:

«Të tre së bashku me inisiativën e tyre kanë kapur një diversant. Janë dalluar për trimëri dhe vendosmëri në kapjen e tij».

Tiranë, më 10-I-1955
Nr. i drekretit: 1982

PËR PRESIDIUMIN E KUVENDIT POPULLOR
TË REPUBLIKËS POPULLORE TË SHQIPËRISË

SEKRETARI: Sami Baholli

ZAV. KRYETARI: Pilo Peristeri

URDHËRESË E QEVERISË

Nr- — 1. dt. 12-1-1955

Mbi

SIGURIMIN VULLNETAR TË GJËSË SË GJALLË

Këshilli i Ministrave i Republikës Popullore të Shqipërisë, në mbledhjen e datës 12/1/1955, me qëllim që të ndihmojë zhvillimin e gjësë së gjallë, duke kompensuar humbjet që pësojnë ndërmarrjet, institucionet, kooperativat, organizatat dhe ekonomitë bujqësore individuale nga ngordhja e kafshëve të tyre prej sëmundjesh ose fatkeqësirash, në bazë të dekretit të Presidiumit të Kuvendit Popullor Nr. 1146 datë 11/IX/1950, nxjerr këtë.

URDHËRESË
MBI

SIGURIMIN VULLNETAR TË GJËSË SË GJALLË

1. — OBJEKTI I SIGURIMIT:

Neni 1.—

Ndërmarrjet shtetërore lokale, institucionet, organizatat dhe kooperativat bujqësore mund të sigurojnë në mënyrë vullnetare pranë arkave të kursimeve dhe sigurimeve shtetërore gjenë e gjallë që vijon:

a) kuajt, mushkat, gomarët me moshë 1 gjer 17 vjet;

Approved For Release 2009/06/15 : CIA-RDP83-00418R001100040009-2

Approved For Release 2009/06/15 : CIA-RDP83-00418R001100040009-2

b) kuajt, gomarët e racës në moshë prej 6 muaj gjer 17 vjet;
c) qetë, lopët, buajt e bullicat me moshë prej 1 vit e lart;
ç) gjedhët e racës ose kryqëzimesh me moshë 6 muaj e lart.

Kooperativat bujqësore mund të sigurojnë jo vetëm gjën e gjallë të tyre, por edhe ato që u jepen nga shteti dhe organizatat kooperativiste në përdorim të përkohshëm.

Neni 2.—

Shtetasit mund të sigurojnë në mënyrë vullnetare pranë arkave të kursimit dhe sigurimeve shtetërore gjënë e gjallë që vijon:
a) kuajt, gomarët, mushkat me moshë prej 1 gjer në 15 vjet;
b) qetë, lopët, buajt e bullicat me moshë prej 1 vit e lart,

Neni 3.—

Nuk mund të sigurohet kjo gjë e gjallë:
a) kafshët e sëmura, të zgjebosura, me plagë të ndryshme, me sëmundje të lëkurës, me sëmundje kronike dhe të verbëra.

Me gjith 'atë kur i siguruari përsërit kontratën e sigurimit nga një vit në tjetrin pa ndërprerje. kafshët që janë sëmurë në kohën që është në fuqi kontrata (kur sëmundja nuk është shkaktuar nga fai i të siguruarit) pranohen të sigurohen.

b) kafshët për të cilat nuk tregohet kujdes dhe mirëmbajtje e përshtatëshme.

c) kafshët që në vizatimin e fundit kanë rezultuar se vuajnë nga bruceloza, tuberkulozi, ose që janë të predispozuara për këtë sëmundje;

ç) kafshët që ndodhen në vënde të vëna në karantine (me përjashtim të atyre që nuk infektohen nga sëmundje për të cilën është vënë karantina.)

Lejohet përsëritja pa ndërprerje e kontratave të sigurimit të kafshëve dhe në rast karantine. Në të tilla raste mund të sigurohen edhe kafshët që për herë të parë kanë hyrë në pronësi ose ato që kanë arritur moshën e sigurimit, me përjashtim të të sëmureve dhe atyre me përqindje të lartë invaliditeti.

II. PËRGJEGJËSIA E ARKAVE TE KURSIMIT DHE SIGURIMEVE SHTETËRORE:

Neni 4.—

Gjëja e gjallë sigurohet kundra rrezikut të ngordhjes, të shkaktuar nga sëmundje dhe fatkeqësi. Rastet e fatkeqësisë caktohen nga Ministria e Financavet.

Gjith' ashtu arkat e kursimeve dhe sigurimeve shtetërore shpërblejnë dëmet e shkaktuara nga therja e detyrueshme të gjësë së gjallë në këto raste:

a) kur therja urdhërohet nga veterineri. infermier-veterineri, ose në mungesë të këtyre nga një antar i këshillit popullor të fshatit, për shkak se kafshës i ka ndodhur një fatkeqësi, që e kërcënon me humbje të pa-evitueshme;

b) kur therja urdhërohet nga veterineri, ose infermier-veterineri për shkak të një sëmundje të pa shërueshme të kafshës që përjashton mundësitë e përdorimit të mëtejshëm të sajë;

c) kur therja urdhërohet nga veterineri ose infermier-veterineri në lidhje

Approved For Release 2009/06/15 : CIA-RDP83-00418R001100040009-2

Approved For Release 2009/06/15 : CIA-RDP83-00418R001100040009-2

me masat në luftën kundra epizootisë për të kufizuar sëmundjet ngjitëse ose për të penguar përhapjen e tyre.

Arkat e kursimit dhe të sigurimeve shtetërore shpërblejnë gjith' ashtu kafshët që u kanë ndodhur fatkeqësi, atëhere kur veterineri ose infermier-veterineri lëshojnë çertifikatë se kafsha nuk ka asnjë mundësi shërimi dhe se është e pa vleshme për çdo lloj pune.

III. — SHUMA E SIGURIMIT:

Neni 5.—

Kuajt, gomarët dhe mushkat sigurohen në bazë të normave që caktohen nga Ministria e Financave.

Neni 6.—

Qetë, lopët, buajt, bullicat sigurohen për një shumë mbrenda kufisë së vleftës së tyre. Vlefta nxirret nga shumëzimi i peshës së mishit të therur me çmime të caktuara nga Ministria e Financavet.

Vlefta e lopëve dhe e bullicave me moshë gjer në 10 vjet që japin sasi të madhe qumështi, rritet sipas kërkesës së te siguruarit, në vartësi me moshën dhe prodhimin e tyre.

Neni. 7.—

Gjëja e gjallë, pronë e dërmarrjeve, institucioneve, organizatave shtetërore, kooperativiste dhe shoqërore që përkohësisht ndodhet pranë një të treti, pranohet për t'u siguruar për një shumë që të mos kalojë 85% të shumës për të cilin ay është përgjegjës përpara pronarit.

Neni 8.—

Kur përsëritet kontrata e sigurimit në nji kohë që kafshët ndodhen në karantinë, shuma e sigurimit. për çdo kafshë, nuk mund të caktohet me një shifër më të madhe nga ajo me të cilën ish siguruar në kontratën e më parëshme.

Kafshët e sëmura gjatë perludhës së kontratës së më parëshme në fuqi, sigurohen në bazë të vleftës së tyre në gjëndje të shëndoshë por shuma e sigurimit, për çdo kafshë, nuk mund të jetë më e madhe nga ajo që siguron kontrata e mëparëshme.

Neni 9.—

Arkat e kursimeve dhe sigurimeve shtetërore mund të kufizojnë shumën e sigurimit nën vleftën e caktuar të gjësë së gjallë, në mënyrë që një pjesë e rrezikut të mbetet në përgjegjësinë e vetë të siguruarit.

Neni 10.—

Kontrata per sigurimin e gjësë së gjallë lidhet për një vit. Për më pak se një vit, sigurohet gjë e gjallë pronë e ndërmarrjeve, institucioneve dhe organizatave kooperativiste dhe shoqërore që përkohësisht ndodhet pranë të tretëve për periudhën që qëndron pranë këtyre.

Përveç kësaj ndërmarrjet, institucionet dhe organizatat, që kanë siguruar kafshët për një vit, mund të sigurojnë me afat më të shkurtër:

a) kafshët që për herë të parë kanë hyrë në pronësi;

b) kafshët që harrijnë në moshën kur mund të sigurohen;

c) kafshët që më përpara nuk janë siguruar për arsye se ishin të sëmura dhe pastaj u shëruan.

Neni 11.—

Përgjegjësija e arkave të kursimeve dhe sigurimeve shtetërore në siguri-

Approved For Release 2009/06/15 : CIA-RDP83-00418R001100040009-2

Approved For Release 2009/06/15 : CIA-RDP83-00418R001100040009-2

min e gjësë së gjallë për rastet e fatkeqësisë, fillon n'orën 24 të ditës së pagimit të primit dhe mbaron në orën 24 të ditës që plotësohet viti, kurse për rastet e tjera përgjegjësia e arkave të kursimit dhe sigurimeve shtetërore fillon pas 21 ditëve nga data e pagimit të primit dhe mbaron n' orën 24 të ditës që plotësohet viti.

Kur kontrata përsëritet pa ndërprerje, përgjegjësia fillon nga dita e skadencës së kontratës së më parëshme.

Neni 12.—

Kur gjëja e gjallë e siguruar kalon në pronësinë e një të tretit përpara mbarimit të afatit të kontratës. përgjegjësia e arkave të kursimit dhe sigurrmeve shtetërore mer fund dhe primi i paguar nuk kthehet.

Neni 13.—

Sigurimi është i vlefshëm dhe kur kafshët e siguruara zëvëndësohen me konditë që i siguruari të lajmërojë mbrenda 15 ditëve nga dita që kafshët për herë të parë kanë hyrë në pronësi.

Në qoftë se vlefta e kafshëve të reja është më e madhe nga ajo e kafshëve të larguara, me kërkesën e të siguruarit dhe pas pagimit të shtesës së primit, mund të shtohet shuma e siguruar.

Në qoftë se vlefta e kafshëve të reja është më e vogël nga ajo e të larguarve shuma e sigurimit zvogëlohet dhe caktohet në të njëjtën përqindje të vleftës së tyre, si dhe për kafshët e tjera të të njejtit lloj. Diferenca e primit nuk i kthehet të siguruarit.

Neni 14.—

Kur gjeja e gjallë ngordh ose largohet përpara se të fillojë përgjegjësia e arkave të kursimit dhe sigurimeve shtetërore (neni 11), primi i paguar i kthehet të siguruarit plotësisht, në rast se ay lajmëron brenda 10 ditëve nga fillimi i përgjegjësisë.

IV. — LIDHJA E KONTRATËS:

Neni 15.—

Kontrata e sigurimit lidhet pas një kontrolli preventiv të gjesë së gjallë dhe vleftësimit nga ana e të ngarkuar të arkave të kursimit dhe sigurimeve shtetore.

Kur gjëndja shëndetësore e gjësë së gjallë rezulton e dyshimtë, i ngarkuari i arkes kursimeve dhe sigurimeve shtetërore nuk duhet të sigurojë kafshët në rast se pronari nuk paraqet një vërtetim nga veterinari ose ndihmës veterinari zyrtar, me të cilin të provohet se ato janë të shëndosha.

Neni 16.—

Kontrata e sigurimit lidhet me konditë që i siguruari të sigurojë të gjitha kafshët e shëndosha të një lloji të caktuar, të cilat kanë harrijtur moshën e sigurimit (neni 1-2).

Neni 17.—

Për të lidhur kontratën e sigurimit, pronari i gjësë së gjallë duhet t'i paraqesë kërkesë me shkrim arkës kursimeve dhe sigurimeve shtetërore në nji formular të posaçëm.

Neni 18.—

Antarët e kooperativave bujqësore, punëtorët, nëpunësit, fshatarët dhe qytetarët e tjerë mund të lidhin kontrata individuale ose kolektive. Konsi-

Approved For Release 2009/06/15 : CIA-RDP83-00418R001100040009-2

Approved For Release 2009/06/15 : CIA-RDP83-00418R001100040009-2

derohet sigurim kolektiv ay në të cilin të paktën 20 vetë sigurojnë sëbashku kafshët e tyre të një llloji.

Neni 19.—

Lidhja e kontratës përfundon me lëshimin e policisë së sigurimit. Policа u dorëzohet ndërmarrjeve, institucioneve, kooperativave dhe organizatave të tjera mbrenda 5 ditëve nga data e pagimit të primit ose nga data e pagimit të 50% të primit, kur pagesa bëhet në këste, kurse privatëve policа u dorëzohet kundrejt pagimit të primit.

V. PRIMËT

Neni 20—

Primet për sigurimin e gjësë së gjallë caktohen në bazë të tarifës së aprovuar nga Ministria e Financavet.

Neni 21.—

Kooperativat bujqësore që tejkalojnë planin shtetëror të rritjes së gjësë së gjallë dhe që kanë koeficientë më të marë për mirëmbajtjen e tyre, u bëhet një zbritje e primit prej 25%.

Neni 22.—

Shtetasve që bëjnë sigurimin kolektiv të kafshëve u akordohet një zbritje primi prej 10% kur kafshët e siguruara kolektivisht janë 20-40 kokë dhe prej 20% kur janë më tepër se 50.

Neni 23.—

Kooperativat bujqësore, ndërmarrjet, institucionet dhe orgonizatot duhet t'a derdhin primin e kontratës në favor të arkës kursimeve dhe sigurimeve shtetërore pranë Bankës së Shtetit, ose pranë arkave të kursimit dhe sigurimeve shtetërore, mbrenda 10 ditëve nga data e kontrollimit dhë vleftësimit të gjësë së gjallë. Në qottë se primi nuk derdhet brenda këtij afati, kontrata nuk mund të lidhet veçse pas një kontrollimi të ri të gjësë së gjallë. Si datë e pagesës, konsiderohet data e derdhjes së primit në Bankë ose në arkën e kursimit dhe sigurimeve shtetërore.

Neni 24.—

Kur primi vjetor, për sigurimin e gjësë së gjallë të kooperativave bujqësore, ndërmarrjeve, institucioneve, kooperativave dhe organizatave të tjera është më i math se 5.000 lekë, mund të paguhet në dy këste; të paktën 50% me rastin e dorëzimit të kontratës dhe teprica mbrenda dy muajve nga data e pagesës së kestit të parë.

Kur kësti i dytë nuk paguhet mbrenda afatit të caktuar, afati i kontratës shkurtohet si vijon:

Përgindja e primit vjetor të paguar	Afati i kontatës
50—60	4 muaj
61—70	5 »
71—75	6 »
76—80	7 »
81—85	8 »
86—90	9 »
91—95	10 »
96—99	11 »

Kur i siguruari paguan më pak se 50% të primit vjetor, sigurimi nuk hyn në fuqi dhe shuma e paguar i kthehet t'interesuarit.

Approved For Release 2009/06/15 : CIA-RDP83-00418R001100040009-2

Approved For Release 2009/06/15 : CIA-RDP83-00418R001100040009-2

Gjith'ashtu kthehet kësti i dytë i primit, që nuk pagohet n'afatin e caktuar.

Neni 25.—

Primi i kontratave për sigurimin e gjësë së gjallë të privatëve nuk mund të paguhet me këste në asnjë rast, por tërësisht në kohën e dorëzimit të policës.

VI. — DETYRIMET E TE SIGURUARIT:

Neni 26 —

I siguruari detyrohet të zbatojë rregullat veterinaro-zooteknike dhe të të marrë masa preventive për t'evituar ngordhjen dhe sëmundjen e gjësë së gjallë, të siguruar.

Në rast se organet e arkave të kursimeve dhe sigurimeve shtetërore konstatojnë se nga mos respektimi i këtyre rregullove, nga ana e të siguarit gjëja e gjallë kërcënohet nga ndonji rrezik. me aprovimin e drejtorisë përgjithëshme të kursimeve dhe sigurimeve shtetërore ose të seksionit financiare të qarkut, sigurimi mund të pezullohet duke mos kthyer primet e paguar.

Sigurimi mund të përsëritet, me kondita e më parëshme (për afatin e më parëshëm dhe pa tjetër pagesë të primit), në rast se i siguruari paraqet një çertifikatë nga veterineri, me të cilën të vertetohet se shkaqet për të cilat u pezullua sigurimi janë eliminuar.

Neni 27.—

Kur kafshët sëmuren i siguruari duhet të kërkojë menjëherë ndihmën e veterinerit ose t' infermier-veterinerit të qendrës më të afërme.

Neni 28.—

Në rast ngordhje ose therje të detyrushme të gjësë së gjallë të sigurua, rit duhet të lajmërojnë mbrenda 24 orëve si vijon: kooperativat bujqësore-ndërmarrjet, institucionet dhe organizatat pranë këshillit fshatit dhe arkës kursimeve dhe sigurimeve shtetërore, antarët e kooperativave bujqësore dhe bujqit e tjerë pranë këshilit të fshatit, bujqit që banojnë në qytet pranë arkës kursimeve dhe sigurimeve shtetërore.

VII. — LIKUIDIMI I DEMIT:

Neni 29.—

Në rast ngordhje, therje të detyrueshme ose invaliditet totol dhe të përhershëm të kuajve, gomarve dhe mushkave, dëmi shpërblehet në masën e shumës së siguruar.

Neni 30.—

Në rast ngordhje ose therje të detyrueshme të qeve, lopëve, buajve dhe buallicave, dëmi shpërblehet në bazë të shumës së siguruar nga e cila zbritet vlefta e mishit të ngrënëshëm.

Neni 31.—

Mundësia e përdorimit për ngrënie të mishit të kafshëve të therura vendoset nga kontrolli veterinar dhe në mungese të tij nga këshilli popullor i fshatit.

Neni 32.—

Shpërblimi ose refuzimi i dëmit bëhet brënda 15 ditëve nga data e aritjes së dokumentave të humbjes së gjësë së gjallë në arkën e kursimeve

Approved For Release 2009/06/15 : CIA-RDP83-00418R001100040009-2

Approved For Release 2009/06/15 : CIA-RDP83-00418R001100040009-2

dhe sigurimeve shtetërore. Në rast refuzimi të pagimit të dëmit, të siguruarit i njoftohet arësyeja e refuzimit.

Neni 33.

Nga shuma e shpërblimit të dëmit nuk munt të bëhet asnjë ndalesë me përjashtim të kështit të dytë të primit, që akoma nuk është paguar.

VIII. — DËMET QË ARKAT E KURSIMEVE DHE SIGURIMEVE SHTETËRORE NUK SHPËRBLEJNË

Neni 34.—

Arkat e kursimeve dhe sigurimeve shtetërore nuk shpërblejnë dëmet e shkaktuara gjësë së gjallë nga faji i të siguruarit (kur nuk i ushqen, nuk i kullot, i trajton keq, nuk u siguron strehë i ngarkon tepër, i mundon etj.)

Neni 35.

Arkat e kursimeve dhe sigurimeve shtetërore nuk shpërblejnë dëmet e shkaktuara gjësë së gjallë nga operacione lufte.

Neni 36.—

Arkat e kursimeve dhe sigurimeve shtetërore kanë të drejtë të refuzojnë shpërblimin e dëmit në rast se i siguruari, duke patur mundësi nuk lajmëron për dëmin që i ka ndodhur, mbrenda afatit të caktuar në nenin 28.

IX. — ZGJIDHJA E KONFLIKTEVE:

Neni 37.—

Konfliktet në mes të siguruarve dhe arkave të kursimeve dhe sigurimeve shtetërore zgjidhen simbas rastit, nga drejtoria e përgjithësshme e kursimeve dhe sigurimeve shtetërore, nga arbitrazhi shtetëror ose nga gjykatat.

Ankesat për veprime të pa drejta të arkave të kursimeve dhe sigurimeve shtetërore të siguruarit duhet t'ia paraqesin drejtorisë përgjithëshme të kursimeve dhe sigurimeve shtetërore brenda një muaji nga data e vërtetimit të ngjarjes për të cilën bëhet ankesa.

Neni 38—

Urdhëresa Nr. 14, datë 5/IV/1951 mbetet pa fuqi.

Neni 39.—

Kjo urdhëresë hyn në fuqi ditën e botimit në gazetën zyrtare.—

ZËV/ KRYEIAR' I KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË R. P. SH.
HYSNI KAPO

URDHËRESË E QEVERISË
Nr. 2 Dt. 17/I/1955

MBI ÇMIMET, STIMULACIONET DHE NORMAT E DORËZIMIT PËR DISA BIMË INDUSTRIALE DHE ARTIKUJ BUJQËSORË DHE BLEGTORALË.

Këshilli Ministrave i Republikës Popullore të Shqipërisë në mbështetje të vendimit të përbashkët të Këshillit të Ministrave të Republikës Popullore të Shqipërisë dhe të Komitit Qëndror të Partisë së Punës së Shqipërisë me Nr. 5 datë 20/XI/1954 «mbi ngritjen dhe harmonizimin e çmimeve dhe stimulacioneve të bimëve industriale dhe disa prodhimeve të tjera bujqësore dhe blegtorale» me qëllim që të përcaktojë dhe saktësojë raportet midis

Approved For Release 2009/06/15 : CIA-RDP83-00418R001100040009-2

Approved For Release 2009/06/15 : CIA-RDP83-00418R001100040009-2

çmimeve dhe stimulacioneve dhe kualiteteve t' artikujve të lart përmendur' në mbledhjen e tij të datës 17/I/1955, nxjerr këtë.

U R D H Ë R E S Ë :

MBI

ÇMIMET STIMULACIONET DHE NORMAT E DORËZIMIT PËR DISA BIMË IDUSTRIALE DHE ARTIKUJ BUJQËSORË DHE BLEGTORALË.

Neni 1.—

Çmimet e blerjes dhe stimulacionet për duhanin, pambukun, panxhar-sheqerin, linin dhe elbin distik janë si vijon;

Nr.	Artikulli	Njis. matj.	Çmimi për kv. lekë		Stimulacion për mallra në 1000 lekë	Kg. misër për 1000 lekë
			Detyrimi	Teprica		
1.	Për duhanin		16.000	19.750	228	19
	a) Duhan vendi:		10.000	12.220	228	19
	Kualiteti I-rë	kv.	5.000	6.350	228	19
	« II-të	»				
	« III-të	»				
	b) Duhan samsun:					
	Kualiteti I-rë	»	20.000	25.400	228	19
	« II-të	»	15.000	18.600	228	19
1.	2.	3.	4.	5.	6.	7.
	Kualiteti III-të	kv.	10.000	12.400	228	19
	« IV-të	»	5.000	6.050	228	19
	c) Duhan oriental:					
	Kualiteti I-rë	»	28.000	34 000	228	19
	« II-të	»	19.000	23.200	228	19
	« III-të	»	12.400	15.100	228	19
	« IV-të	»	5.000	6.200	228	19
	d) Copa dhe filiza sipas kushteve të caktuara:		2.500	3.250	228	19
	Kualiteti extra	kv.	5.000	5.930	495	39.5
	» I-rë	"	4.200	5.070	495	39.5
	» II-të	"	3.400	4.210	495	39.5
	» III-të	"	2.600	3.350	495	39.5
	» jasht stadardit		1.500	1.950	495	39.5
	3. Për panxhar-sheqerin		160	186	490	25
	4. Për linin:					
	a) Lin shufër kual. I-rë		1.400	1.550	237	27

Çmimet e tepricave të duhanit i përfiton fshatari kur ai realizon dorëzimin e prodhimit sipas kualiteteve të caktuara në kontratë.

Approved For Release 2009/06/15 : CIA-RDP83-00418R001100040009-2

Approved For Release 2009/06/15 : CIA-RDP83-00418R001100040009-2

b) » » » II-të	1.200	1.338	237	27
c) » » » III-të	1.000	1.120	237	27
ç) » jasht standardit	600	690	237	27
d) lin farë » »	2.100	2.430	237	27
» jasht standardit	1.400	1.655	237	27
5) Për elbin distik:	780	910	1,020	10

Norma e dorëzimimit të pambukut caktohet në masën 100°/₀ prodhimit të planifikuar

Me qëllim që të stimulohen më mirë prodhuesit e pambukut, në kontigjentin e mallrave të stimulacionit shtohen edhe artikujt pambuk fije, push pambuku dhe vcte.

Neni 2.—

Për ullirin stimulacionet janë si vijon :

Rrethet	Sipas periudhës vjeljes dhe dorëzimit									
	Deri 15 Tetor		16/X/ deri 31/XII/				1/I/ deri në fund sez.			
			Detyrim		Teprica		Detyrim		Teprica	
	Kg. misër për çdo kv	Lekë stim. për kv.	Kg. misër për kv.	Lekë stim. për kv.	Kg. misër për kv.	Lekë stim për kv.	Kg. misër për kv.	Lekë stim. për kv.	Kg. misër për kv.	Lekë stim. për kv.
Fier-Vlorë-Sarandë . . .	30	50	30	300	30	2.050	30	400	30	2.150
Durrës-Lushnje Berat . . .	30	50	30	260	30	1.950	30	350	30	2.050
Ndroq-Peqin-Elbasan-Tepelen-Kruj-Tiranë	30	50	30	230	30	1.850	30	300	30	1.950
Shkodër-Gramsh-Lezhë Skrapar-Përmet Gjirokastër	30	50	30	200	30	1.750	30	250	30	1.850

Nga grupi i stimulacioneve të ndryshme dorëzuesit e ullinjve kanë të drejtë të marrin një litër vaj për kv. ullin të dorëzuar për efekt detyrimi, me çmimin e tregut të garantuar, kurse misëri do t'u shitet me çmimin e tregut reciprok.

Neni 3.—

Çmimet e grumbullimit të leshit për efekt dotyrimi janë si vijon :

Lesh deleje vendi kualiteti	I-rë	kv. lekë	5.000
» » » »	II-të	» »	4.500
» » qethje e dytë		» »	5.000
» » përvjele e qengji		» »	3.700
» » rude qethje I e II		» »	24.000
» » vendi i larë		» »	8.300
» rude i larë		» »	33.000
» dhije		» »	3.300

Approved For Release 2009/06/15 : CIA-RDP83-00418R001100040009-2

Approved For Release 2009/06/15 : CIA-RDP83-00418R001100040009-2

Për efekt të shlyerjes së detyrimit leshit, çdo kgr. lesh rude i pa larë konsiderohet një kgr. lesh i zakonshëm; 0.600 kgr. lesh rude e vendi i larë shlyen një kgr. lesh detyrimi.

Neni 4.—

Çmimet e grumbullimit të qumështit në tregun reciprok janë si vijon:

Qumësht deleje	për	prodhim	kv.	1.500	lekë	dhe	për	konsum	kv.	1.500 lekë
» dhije	»	»	»	1.100	»	»	»	»	»	1,200 »
» lopë	»	»	»	1.300	»	»	»	»	»	1.400 »

Neni 5.—

Çmimet e grumbullimit të farës së jonxhës në tregun reciprok janë 20.000 lekë kv. me stimulacion 100°/₀ i ndarë si vijon: misër kg. 46 dhe stimulacione të ndryshme 19.310 lekë për çdo kv.

Neni 6.—

Me qëllim që t'inkurajohen më tepër prodhuesit e artikujve blegtorale blegtorët profesionistë do të furnizohen me nga 10 kgr. drith buke në muaj për frymë për gjithë vitin, bujqët blegtorë do të furnizohen me nga 8 kgr. drithë në muaj për frymë për një periudhë prej 4 muajsh. Furnizimi për të dy kategoritë do të bëhet brende stimulacioneve dhe ne raport me realizimin e kontratove për dorëzimin e qumështit. Misri për blegtorët do të shitet me çmimin e tregut të garantuar dhe për bujqit blegtorë me çmimin e tregut reciprok,

Neni. 7.—

Stimulacioni për blerjen e orizit çeltik caktohet në 150°/₀.

Neni 8.—

Me hyrjen në fuqi të kësaj urdhëresë abrogohen:

a) çmimet dhe stimulacionet e duhanit, pambukut dhe panxhar-sheqerit të caktuara me vendimin Nr. 102 datë 6-IV-1954;

b) çmimet dhe stimulacionet e elbit distik, linit shufër dhe farë të caktuara në urdhëresën e Qeverisë Nr. 2 datë 5-I-1952 dhe në vendimin e Këshillit të Ministrave Nr. 824 datë 11-XII-1952;

c) çmimet e grumbullimit të leshit për efekt detyrimi të caktuara në urdhëresën e qeverisë Nr. 10 datë 8-IX-1953 (neni 13) dhe ekuivalenti i shlyerjes së leshit detyrim në lesh rude, caktuar në nenin 14 t'urdhëresës së lart përmendur;

ç) stimulacionet e grumbullimit të ullinjve për efekt detyrimi dhe tepricë të caktuara në nenin 2 t'urdhëresës së Qeverisë Nr, 11 datë 8-IX-1953 dhe neni 4 i urdhëresës në fjalë:

d) Çmimet e grumbullimit të qumështit për konsum dhe për prodhim të caktuara në vendimet Nr. 419 datë 25-VI-1950 dhe Nr. 43 datë 24-I-1953;

dh) stimulacioni i orizit çeltik i caktuar në vendimin Nr. 43 datë 24-I-1953;

e) çmimet dhe stimulacionet e farës së jonxhës të caktuara në vendimin Nr, 243 datë 18-8-1953 si dhe çdo dispozitë tjetër që vjen në kundërshtim me këtë urdhëresë.

Neni 9.—

Kjo urdhëresë përsa i përket çmimeve dhe stimulacioneve të bimëve industriale, të leshit, stimulimit të ullinjve me misër dhe farës së jonxhës, hyn në fuqi me prodhimin e sezonit të ri të vitit 1955. Çmimet e blerjes së

Approved For Release 2009/06/15 : CIA-RDP83-00418R001100040009-2

Approved For Release 2009/06/15 : CIA-RDP83-00418R001100040009-2

qumështit hyjnë në fuqi me 1 shkurt 1955. Stimulacioni i dhënies së një liter vaj për çdo kv. ullinj të dorëzuar, hyn në fuqi që me sezionin 1954-1955.

ZËV. KRYETAR' I KËSHILLIT MINISTRAVE TË R.P.SH.
HYSNI KAPO

KËSHILLI I MINISTRAVE

VENDIM

Nr.– 13 më 12-I-1955

MBI

EKONOMITË NDIHMËSE

Këshilli i Ministrave i Republikës Popullore të Shqipërisë, duke marrë parasysh se ekonomitë ndihmëse bujqësore kanë për qëllim përmirësimin e ushqimit në mencat e punonjësvet, duke i furnizuar këto me prodhime bujqësore e blegtorale me çmime më të ulëta nga ato të tregut të lirë; me qëllim që të forcohet nga ana organizative dhe të përmirësohet gjëndja ekonomiko - financiare e ekonomive ndihmëse bujqësore, në mbledhjen e datës 12/I/1955.

V E N D O S I :

1. Ekonomitë ndihmëse bujqësore të ndërmarrjeve ekonomike të organizohen ne hozrashçot të brendëshëm dhe mbajtja e tyre të bëhet duke i përfshirë në veprimtarinë e ndërmarrjes ose e veçuar nga veprimtaria kryesore e ndërmarrjes, duke pasur bilanc të veçantë.

2. Ekonomitë ndihmëse të institucioneve buxhetore, të cilat kanë në planin e tyre mbi 100.000 lekë të ardhura të organizohen në hozrashçot.

3. Tokat e ekonomive ndihmëse nën 5 ha. që ndodhen mbi 5 km larg. qendrës së aktivitetit të ndërmarrjes të shpërndahen brenda vitit 1955. Në raste të veçanta. me autorizim të ministrisë përkatëse, kur këto toka paraqesin leverdi ekonomike dhe janë të domosdoshme mund të mos shpërndahen. Gjithashtu, me aprovimin e komitetit ekzekutiv të k. p. qarkut përkatës. t' u hiqen ekonomive ndihmëse tokat e dhëna nga kadastra, kur nuk vihet në çfrytzim brënda një viti bujqësor.

4. Kudo që ka mundësi, të unifikohen parcelat e shpërndara në shum vende me anë shkëmbimesh me fshatarët individual ose kooperativat bujqësore mbi baza vullnetare ose edhe ndërmjet ndërmarrjesh.

5. Ekonomitë ndihmëse që kanë toka me sipërfaqe të vogla, 0,1-5 ha.. kur nuk paraqesin leverdishmëri ekonomike dhe nuk janë të domosdoshme, me autorizimin e ministrive përkatëse, të suprimohen.

6. Ekonomitë ndihmëse të kontraktojnë me S. M. T. për të krye punimet e nevojëshme bujqësore, Me gjith' atë për punimet bujqësore ekonomive ndihmëse u lejohet që të mbajnë edhe kafshë pune.

7. Ekonomitë ndihmëse detyrohen të mbajnë vetëm lopë produktive me leverdi ekonomike. Lopët inproduktive ose me rendimente të ulëta të zëvëndësohen me lopë produktive. Ministritë të studjojnë shpërndarjen e drejtë

Approved For Release 2009/06/15 : CIA-RDP83-00418R001100040009-2

Approved For Release 2009/06/15 : CIA-RDP83-00418R001100040009-2

të lopëve ekzekutuese, duke u dhënë në radhë të parë ndërmarrjeve me ekonomitë ndihmëse që për karakterin e punës u japin punonjësve qumësht për antidot. Ndalohet mbajtja e dhenëve si jo rentabel nga ekonomitë ndihmëse. Dhentë duhet të zëvëndësohen me lopë produktive.

8. Prodhimet bujqësore, që nxirren nga ekonomitë ndihmëse të ndërmarrjeve ekonomike. për të cilat nuk ekzistojnë çmime të garantuara, sikurse janë perimet, patatet etj. t' u shiten mencave të ndërmarrjeve ose punonjësve me çmime jo më të larta se 10°/₀ më pak nga çmimet e shitjes së kooperativave të konsumit.

3. Ekonomitë ndimëse, mbasi të kenë plotësuar nevojat e punonjësve të tyre, tepricat e prodhimeve mund t' ua shesim kooperativave të konsumit me çmimet që ato grumbullojnë, dhe, në rast të mos pranimit prej tyre, t' i shesin në treg.

10, Prodhimeve bujqësore dhe blegtorale të ekonomive ndihmëse, për të cilat ekzistojnë çmime të garantuara sikurse është qumështi, mishi etj., do t' u aplikohen si çmime shitjeje për mencat kostot efektive (e realizuar) dhe këto raste ku nuk mund të nxirren kostot efektive, të aplikohen si çmime shitjeje kostot e planifikuara dhe aprovuara nga Ministria përkatëse.

11. Fitimet e realizuara nga ekonomitë ndihmëse, kur kolektivi punonjës me punë vullnetare merr pjesë në punimet e ndryshme, pas aprovimit të bilancit vjetor, do të përdoren gjatë vitit pasardhës për përmirësimin e ushqimit në mencat ose për uljen e çmimit të racionit në menca.

12. Ekonomitë ndihmëse të ndërmarrjeve ekonomike, për prodhimet e tyre bujqësore dhe blegtorale përjashtohen nga detyrimet në natyrë ndaj shtetit me përjashtim të leshit, grurit dhe orizit që i dorëzohet totalisht shtetit.

13, U rekomandohet Bashkimeve Profesionale që të interesohen për pjesmarrjen e kolektivave punonjëse të qendrave të punës në punë vullnetare në ekonomitë ndihmëse.

14. Komitetet ekzekutive të k. p. të qarqeve, rretheve dhe qyteteve të ndihmojnë me teknikë kompetentë ekonomitë ndihmëse të ndërmarrjeve dhe institucioneve buxhetore në mënyrë që të sigurojnë me kohë farnat dhe punimet bujqësorë t' i kryejnë simbas agrorregullores.

15. Gjithë ministritë dhe komitetet ekzekutive të marrin këto masa:

a) kontabiliteti në ekonomitë ndihmëse të mbahet simbas planit kontabël të caktuara dhe të plotësohen të gjitha anekset e veprimtarisë ekonomike të këtyre ekonomive;

b) prodhimet e vjelura, t' i dorëzohen magazinës me proçes-verbal të firmuar nga përgjegjësi i ekonomisë ndihmëse ose nga tekniku bujqësor dhe të mbahen në magazinë kartelle për çdo lloj prodhimi;

c) organet e revizionimit, kur revizionojnë ndërmarrjen të kryejnë edhe revizionimin e aktivitetit të ekonomisë ndihmëse, duke patur mundësisht edhe ndihmën e një tekniku bujqësor:

ç) shefi i llogarisë i ndërmarrjes, detyrimisht në çdo muaj të kryej një kontroll në ekonomitë ndihmëse.

16. Ministritë, për ekonomitë ndihmëse që kanë organikë të oprovuar, të mbajnë evidenca të rregullta për sejcilën ekonomi, mbi mbjelljet, rendimentfn dhe koston e prodhimeve bujqësore dhe blegtorale dhe të marrin në shqyrtim në mbledhjen e kolegjumit aktivitetin ekonomiko-financiar dhe materialin e revizionimit të kryer në ato ekonomi.

Approved For Release 2009/06/15 : CIA-RDP83-00418R001100040009-2

Approved For Release 2009/06/15 : CIA-RDP83-00418R001100040009-2

17. Humbjet në ekonomitë ndihmëse, përveç rastit të forcës madhore, nuk do të mbulohen nga buxheti.

18. Të gjitha ministritë brënda muajit shkurt 1955 të marrin në shqyrtim gjëndjen e ekonomive ndihmëse dhe në bashkëpunim me Ministrinë e Bujqësisë dhe komitetet ekzekutive të vendosin suprimimin ose shkrirjen e atyre ekonomive ndihmëse që nuk shërbejnë për përmirësimin e konditave të punonjësve duke u kaluar pasuria ekonomive që janë në gjëndje të punojnë.

19. Ministria e Tregëtisë të furnizojë me artikujt e garantuar qëndrat e punës qind për qind pa marrë parasysh prodhimet e ekonomive ndihmëse të cilat duhet të shërbejnë për përmirësimin e konditave të punonjësve

20. Ministria e Bujqësisë dhe ajo e Financavet brënda datës 20 shkurt 1955 të lëshojnë udhëzime të hollësishme për zbatimin e këtij vendimi duke parashikuar edhe detyra të veçanta që mund të kenë ekonomitë ndihmëse.

21. Me zbatimin e këtij vendimi ngarkohen të gjithë ministritë që kanë ekonomi ndihmëse, ndërsa Ministria e Bujqësisë, Ministria e Financavet. Komisioni i Kontrollit të Shtetit dhe komitetet ekzekutive të k. p. të qarqeve dhe rretheve ngarkohen me kontrollin e zbatimit të tij,

22. Paragrafi i fundit i pikës 3 të vendimit Nr. 416 datë 21/VI/952 të Këshillit të Ministrave si dhe çdo dispozitë tjetër në kundërshtim me këtë vendim mbeten pa fuqi.

23. Dispozitat e këtij vendimi nuk zbatohen për ekonomitë ndihmëse të Ministrisë së Mbrojtjes Popullore dhe asaj të P. të Brëndëshme.

24. Ky vendim hyn në fuqi menjiherë.

ZËV. KRYETAR' I KËSHILLIT MINISTRAVE R.P.SH.
HYSNI KAPO

KËSHILLI I MINISTRAVE
VENDIM
Nr. — 14 në 12.1.1955
MBI

DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË RREGULLOREN MBI SIGURIMIN VULLNETAR TË KULTURAVE BUJQËSORE T'APROVUAR ME VENDIMIN E KËSHILLIT TË MINISTRAVE TE R.P.SH. Nr. 662 DATË 21/VIII/1950

Këshilli i Ministrave i Republikës Popullore të Shqipërisë në mbledhjen e tij të datës 12/1/1955.

V E N D O S I :

1. — Me rregulloren mbi sigurimin vullnetar të kulturave bujqësore t'aprovuar me Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr. 662 datë 21/8/1950 fjalët »Instituti Shtetëror i Sigurimeve (i.S.I.S.) «zëvëndësohen me fjalët «arka e kursimeve dhe sigurimeve shtetërore».

2. — Neni 8 ndryshohet në këtë mënyrë:

"Shuma e sigurimit caktohet në bazë të normave të llogaritura për çdo lloj kulture. Normat caktohen nga Ministria e Financave në bazë të çmimeve të tregut kormercial.

Approved For Release 2009/06/15 : CIA-RDP83-00418R001100040009-2

Approved For Release 2009/06/15 : CIA-RDP83-00418R001100040009-2

Për efekt të skadimit t'afatit në lidhje me mbjelljet për reziqet e grupit të dytë, si datë e lidhjes së kontratës konsiderohet ajo e paraqitjes së kërkesës nga ana e të siguruarit».

3. — Neni 25 ndryshohet në këtë mënyrë:

«Për humbjen e plotë të kulturave të siguruara, dëmi shpërblehet në masën e shumës së siguruar»

4. — Neni 26 ndryshohet në këtë mënyrë:

«Në rast dëmtimi pjesor, dëmi shpërblehet në proporcion me prodhimin e humbur. Gjithashtu, kur dëmi shkaktohet pjesërisht nga reziqet për të cilat është kryer sigurimi dhe pjesërisht nga reziqet që nuk përfshishen në sigurim, dëmi shpërblehet vetëm për atë pjesë që është shkaktuar nga reziqet e para»,

5. — Në nenin 34 pika 6) fjala «Ushtarake» zëvendësohet me fjalën «Luftë».

6. — Neni 35 hiqet.

7. — Ky vendim hyn në fuqi ditën e botimit në gazetën zyrtare.

ZËV. KRYETAR' I KËSHILLIT MINISTRAVE TË R.P.SH.

HYSNI KAPO

Regulla të Ministrisë Bujqësisë rreth kanaleve ujitëse dhe bonifikimet.

MINISTRI I BUJQËSISË

në konformitetet me nenin 17 të Dekretit Nr. 1483 dt. 12.6.952 dhe me nenin 3 të Dekretit Nr. 1928 dt. 6.9.954, nxjerr këto rregulla »mbi zbatimin e Dekreteve Nr. 1483 dt. 17 qershor 1952 dhe Nr. 1928 dt.6.9.1954 «Mbi kanalet ujitëse dhe mbi bonifikimet»,

KAPITULLI I-rë

Dispozita të përgjithëshme.

1. Kanalet ujitëse dhe kulluese dhe veprat e artit që lidhen me to, janë pasuri shtetnore që drejtohet dhe administrohen prej këshillave popullore të qarqeve dhe rretheve përkatëse, nen mbikqyrjen e Ministrisë së Bujqësisë (nenet 1 dhe 2 të dekretit Nr. 1483 dt.12.6.952,

Sistemet e bonifikimeve të ndryshme dhe t'ujitjes përbëjnë një nga mjetet kryesore të prodhimit bujqësor, dhe, sipas rasteve të veçanta, sherbejnë për të bërë të mundur ose për të përmirësuar punimin e tokave, për të siguruar dhe për të shtuar prodhimin; me anë të ngritjes së rendimenteve të kulturave bujqësore.

2. Detyrat kryesore n'administrimin e sistemimit ujitës janë;

a. Sigurimi i sasisë së nevojëshme t'ujit në krye të sistemit dhe shpërndarja e tij e rregullt nëpër tokat e planifikuara për tu ujitur.

b, Ujitja e tokave në kohën më të përshtatëshme, në bazë të normave t'aprovuara dhe radhës së caktuar.

c. Largimi i ujrave që teprojnë nga ujitja për t'ju shmangur rezikut të kripëzimit dhe të kënetëzimit.

3. Detyrat kryesore n'administrimin e sistemit kullues janë:

a. Tërheqja e ujrave të tepërta nga sipërfaqja e tokave.

Approved For Release 2009/06/15 : CIA-RDP83-00418R001100040009-2

Approved For Release 2009/06/15 : CIA-RDP83-00418R001100040009-2

b. Krijimi i konditave të lagështirës për tu punuar toka në kohën e duhur.

KAPITULLI II

Administrimi, çfrytëzimi dhe mirëmbajtja e kanaleve.

4. Sipas dekrerit Nr. 1483 dt.12 6 952 të gjitha kanalet ujitëse e kulluese si dhe veprat e artit që u përkasin, administrohen, çfrytëzohen dhe mirëmbahen nga Komitetet Ekzekutive të Këshillave Popullore të Qarqeve mëpërmjet K.P. të rretheve.

5. Në qarqet ku ka Ndërmarje Shtetnore Lokale të Bonifikimeve, administrimi, çfrytëzimi dhe mirëmbajtje e kanaleve të mëdha ujitëse e kulluese, me vendim të K.P. të qarkut, i besohen N.SH.L.B.-es.

6. Sipas paragrafit të dytë të nenit 2 të dekretit Nr.1483 dt.12.6.952 Kom. Ekzekutive të K.P. rretheve kanë të drejtë tu besojnë Këshillave Popullore të fshatarëva dhe të lagjeve administrimin, çfrytëzimin dhe mirëmbajtjen e kanaleve ujitës e kullues, kur këto i sherbejnë vetëm një fshati ose një lagje.

7. Problemet e vevanta administrative, teknike dhe financiare t'administrimit çfrytëzimit dhe mirëmbajtjes së kanaleve zgjidhen në bazë t'udhëdhëzimeçe të herepasherëshme të Ministrisë së Bujqësisë për çeshtjet e ndryshme. Çeshtje të tilla janë për shembull:

a. Inventarizimi dhe dekumentacioni teknik i kanaleve;
b. Procedura e ndarjes s'ujit;
c. Vjelja e tarifes s'ujitjes;
ç. Organizimi dhe darja e punës për pastrimin e kanaleve;
d. Caktimi i normave t'ujitjes;
f. Administrimi i motopompave etj,

Si mbështetje për zbatimin e këtyre udhëzimeve sherbejnë edhe rregullat e përmbajtura në pikat e mëposhtëme 8-14.

8. Sektori shtetëror dhe kooperativist kanë precedencë n'ujitje para sektorit privat.

9. Kulturat e ndryshme gëzojnë precedencën sipas radhës që vijon: orizi, pambuku, panxhari i sheqerit, perimet, misri, jonxha etj.

10. Kush nuk e përdor ujin në kohën që i caktohet, humbet të drejtën e marrjes së tij.

11. Pastrimi i kanaleve ujitëse dhe kulluese bëhet nga ekonomitë që përfitojnë prej tyre në përpjestim me sipërfaqen që ujisin ose kullojnë.

12, Me propozim të Komitetit Ekzekutiv të qarkut dhe me aprovimin e Ministris së Bujqësisë, pastrimi i kanaleve të mëdha që paraqesin vështirësi dhe volum të math, pune. mund të bëhet me pagesë.

13. Për mbikqyrjen e ndarjes s'ujit ndërmjet ekonomive dhe ruajtjen e kanaleve gjatë fushatës s'ujitjes, me kërkesën e Komitetit Ekzekutiv të rrethit ose të N.SH.L.B.-es. këshillat e fshatrave detyrohen të caktojnë të paktën nga 2 rojtare stinorë.

14. Kur një fermë, kooperative ose fshat nuk i kryen detyrat që i ngarkohen n'udhëzimet e permendura në pikën 7, dhe kështu bëhet i pa mundur përdorimi i mirë i ujit n'ato toka (p.sh. nuk pastrojnë kanalet, nuk caktojnë radhën e ujitjes, nuk caktojnë radhën e rojtarëve stinore etj. (enti që administron kanalin ka të drejtë ta presi ujin, deri në kryerjen e këtyre detyrave.

Approved For Release 2009/06/15 : CIA-RDP83-00418R001100040009-2

Approved For Release 2009/06/15 : CIA-RDP83-00418R001100040009-2

15. Rojtaret stinore mirren në shërbim dhe punojnë vetëm gjatë stinës s'ujitjes dhe shpërblehen në natyrë nga ekonomitë bujqësore që përfitojnë nga kanalet e mbikqyrura prej tyre gjer në 5 kg. drith (grurë ose misër) për ha ne vit.

16. Grumbullimi dhe shpërndarja e drithit për shpërblimin e rojtarëve stinore bëhet nga këshillat popullore të fshatrave.

17. Për mbikëqyrjen dhe koordimin e punës në kanalet e administruara prej K.E. të rretheve ngrihen komisionet e kanaleve.

Këto komisione përbëhen prej 2-3 vetësh, nga një njeri për çdo fshat që ujit.

18. Detyrat e komisioneve të kanaleve janë :

– Të zgjidhin problemet dhe mosmarëveshtjet që mund të dalin në lidhje me ndarjen e ujit.

T' organizojmë punën për pastrimin dhe meremetimin e kanaleve,

– Të njoftojnë K.'E. për problemet dhe nevojat që dalin.

19. Ndërtimi nga ana e enteve dhe organizatave të tjera i veprave t' artit mbi kanale të një sistemi ujitës, hapja e vijave të marrjes s' ujit për nevoja të popullsisë ose t' industrisë, ngritja e mullijve etj. mund të bëhen vetëm me pëlqimin e Komitetit Ekzekutiv të qarkut për kanalet e administruara nga N. SH. L. B.-ja dhe nga K. P. të rretheve për kanalet e tjera.

20. Çfrytëzimi i veprave të përmendura në pikën 17 bëhet nga entet dhe organizatat e interesuara sipas rregullave të konfirmuara nga organet e administrimit t' ujrave.

21. Në kanalet mund të caktohen vende të veçanta për tu dhënë ujë kafshëve, për të bërë banjë, për të larë rroba. për të marrë ujë për nevoja shtëpijake etj. Të gjitha këto vende duhet të jenë të caktuara veçanërisht nga organi që administron kanalin (N. SH. L. B. ose K. E. i rrethit), të jenë të përshtatëshme për nevojat në fjalë, të mbahen në gjendje të mirë e në përshtatje me kërkesat sanitare.

22. Nuk lejohet ndërtimi në kanale i pellgjeve të veçanta e dajlaneve të peshkimit, si dhe çdo punim tjetër që mund të vështirësojë rjedhjen e ujit ose mund të shkaktojë depozitime materjalesh në kanal.

23. Nuk lejohet punimi dhe mbjellja e skarpatave dhe argjinaturave të kanaleve. Këtu nuk përfshihen argjinaturat që nuk janë pjesë e profillit të nevojshëm të kanalit, por që janë formuar vetëm nga që nuk është shpërndarë dheu i gërmuar. Gjithashtu nuk lejohet punimi dhe mbjellja e një rypine 1 m. të gjërë buzë kanaleve kryesore e sekondare, kur kanalet janë në gërmim, dhe buzë argjinaturave kur kanalet janë në mbushje. Edhe buzë të gjitha kanaleve të tjera, duhet të sigurohet mundësia që të kalohet lehtazi me këmbë.

24. Në zonën e ndaluar buzë kanaleve mund të vendoset vija telefonike e ndërlidhjes si edhe rrugët me rëndësi lokale. Ndërtimi i tyre mund të bëhet vetëm me pëlqimin dhe nën kontrollin e personelit teknik t' organeve që administratojnë kanalet.

25. Mbjellja e fidanave pyjore buzë kanalit mund të bëhet vetëm me pëlqimin e organeve që administrojnë kanalet. Kujdesimi për fidanat e mbjellura është detyrë e personelit të bonifikimeve.

26. Kryerojtarët dhe rojtarët, për të mbrojtur kanalet dhe veprat e artit nga dëmtimet dhe prishjet eventuale prej personave keq-bërës, gjatë kohës së shërbimit të tyre qëndrojnë t' armatosur me armë lufte dhe municion.

Approved For Release 2009/06/15 : CIA-RDP83-00418R001100040009-2

Approved For Release 2009/06/15 : CIA-RDP83-00418R001100040009-2

27. Armët e luftës dhe municionet i prokuron Drejtorija ose Dega e Punëve të Mbrendëshme.

29. Kryerojtarët dhe rojtarët, përsa i përket përdorimit t' armëve kundër keqbërsava që dëmtojnë kanalet dhe që nuk u binden urdhërave të tyre ose që refuzojnë të shoqërohen etj. mvaren disiplinarisht nga Dega e Mbrendëshme e rrethit dhe janë përgjegjës personalisht për zbatimin e përpiktë të rregullave të caktuara për policinë e stabilimenteve.

KAPITULLI III

PUNA E DETYRUESHME

29. Si detyrë e veçantë me shumë rëndësi e Komiteteve Ekzekutive të K. P. të qarqeve është organizmi dhe drejtimi i punës së detyruar për sistemimin agrar, sipas nenit 4 të Dekretit. Puna e detyruar përfshin dhe impernjon të gjitha ekonomitë bujqësore që përfitojnë nga sistemimet agrare ose që përfitojnë nga ndonjë objekt bonifikimesh në afërsitë e vendit të punës (gërmime), duke qenë të detyruar të punojnë sipas normativave të caktuara në dekret.

30. Kur normativat e caktuara në paragrafin 1 dhe 2 të nenit 4 të Dekretit nuk janë të mjaftuarshme për të përfunduar punimet e sistemit agrar (30 m^3 gërmim në vit për çdo ekonomi dhe 40/m3 për kulakët), Komitetet Ekzekutive të K. P. të qarqeve mund ti shtojnë ato deri në 50%, duke detyruar ekonomit bujqësore të bëjnë punë gërmimesh deri në 45 m3 dhe ekonomitë kulcke deri në 60 m3 në vit.

Gjithashtu këtë detyrim në gërmime (të thjeshtë ose me shtesën deri 50%) mund ta bëjne që të zbatohet edhe në punime të ndryshme bonifikimi brenda qarkut, uga të cilat ekonomitë kanë përfitim direkt ose indirekt.

Si për shtesën e normativës 50% ashtu edhe për zbatimin e punimeve në vepra bonifikimi të ndryshme brenda qarkut, është e nevojëshme që të të mirret më parë aprovimi i Ministrisë së Bujqësisë (paragrafi 3 i nenit 4 të Dekretit).

31. Komiteti Ekzekutiv i K. P. të qarkut për të nxjerrë fuqinë puntore për punën e detyruar, njofton me fletë-lajmërim çdo ekonomi dhe detajon planin në një formë të tillë që fuqia puntore të nxiret në tremujorin e parë dhe të katërt të çdo viti, për të mos penguar punimet bujqësore.

32. Përjashtohen nga detyrimi për të punuar në punimet e bonifikimeve të gjitha ekonomitë pa krahë pune.

33. Kur në ndonjë rast në punimet e bonifikimit paraqitet nevoja të sigurohen materjale të vendit, si ranë, zhur, gur, dru etj. ose të transportohen këto, atëhere K. P. i qarkut u cakton ekonomive bujqësore që përfitojnë nga vepra bonifikuese në ndërtim, punime të kësaj natyre (nxjerrje gurësh, transportime etj.) n' ekuivalencë. Në këtë rast vlera e punës në gërmime llogaritet në transportimin dhe nxjerrjen e këtyre materialeve, konform koeficienteve të vlerës së tyre.

34. Për të kontrolluar realizimin e punës në sistemimet agrare seksionet e bujqësisë, në marëveshje me N. SH. L. B.-të ose Ndërmarjet e tjera që kryejnë ndërtime n' objektet lokale, caktojnë ndërmjet dy shenjash vendin ku do punojë çdo ekonomi bujqësore.

Approved For Release 2009/06/15 : CIA-RDP83-00418R001100040009-2

Approved For Release 2009/06/15 : CIA-RDP83-00418R001100040009-2

KAPITULLI IV.

DISPOZITA PENALE

35. Marja e ujit për ujitje pa të drejtë, dëmtimi i kanaleve ujitëse e kulluese dhe i veprave t' artit që lidhen me' to, si edhe shkeljen e dispozitave në lidhje me çfrytëzimin dhe mbrojtjen e tyre, formojnë sipas rastit, krimet e parashikuara nga nenet 128-129 të Kodit penal, ose kundravajtjet e parashikuara nga nenet 13 e 14 të Dekretit Nr. 1483 dt. 12.6.952.

36) Sipas nenit 128 të Kodit Penal (neni 12 i Dekretit Nr. 1483 datë 12.6.952 kushdo që pa të drejtë merr ujë për ujitje, duke çpuar brigje, duke hapur penda, duke ndërtuar kanale, vija dhe vepra të tjera, dënohet me punë korektonjëse ose me burgim gjer në dy vjet.

37. Sipas nenit 129 të Kodit Penal (neni 2 i Dekretit Nr. 1483 datë 12.6.952. kushdo që dëmton me dashje kanalet ujitëse e kulluese ose ndërtimet e lidhura me to, dënohet me burgim gjer në dy vjet dhe kur vepra ka shkaktuar pasoja të rënda, me burgim nga tre gjer dhjet vjet.

Disa raste dëmtimesh të këtij lloji janë :

a) Kur sheshohen argjinaturat e kanaleve me qëllim që tcka e okupuar prej tyre ose sipërfaqja e argjinaturës të mbillet;

b) Kur thyhet ndonjë urë, sepse jashtë kapacitetit të saj, ka kaluar një peshë më e madhe se sa është caktuar;

c) Kur nga veprat e artit hiqen porat ose pjesë të tjera të lëvizëshme. Kur heqja bëhet me qëllim përvehtësimi, kemi krimin e përvetimit (vjedhjes) të pasurisë shtetnore të parashikuar nga neni 84 i Kodit Penal.

ç) Kur merret ujë për ujitje duke thyer argjinaturën;

d) Kur shpërdorohet uji dhe prej tij janë shkaktuar pellgje që parashikohet se rezikojnë argjinaturën, veprat e artit etj.

dh) Kur pa leje me shkrim të seksionit të bujqësisë vendosen penda ose ndërtohen këto jo sipas udhëzimeve të dhëna.

38. Në të dy rastet e mësipërme (pika 36 dhe 37) të parashikuara prej neneve 128 e 129 të Kodit Penal (ose neneve 11 e 12 të Dekretit) organet e administratës së kanaleve procedojnë kundra fajtorëve dhe, pasi llogarisim vleftën e dëmit të shkaktuar, proces-verbalin e mbajtur ja përcjellin prokurorisë për të vazhduar hetimet, me qëllim që fajtori të gjykohet nga gjykata popullore në rrethin e së cilës ndodhet kanali i dëmtuar.

39. Sipas nenit 13 të Dekretit Nr. 1483 dt. 12.6.952 kushdo që nuk i shtrohet detyrimit për të punuar në punimet e sistemimit agrar ose në punimet për meremetimin dhe pastrimin e kanaleve (nenet 4 e 9 të Dekretit si edhe kushdo që shkel regullat e përdorimit t' ujit për ujitje, të përcaktuara me dispozitat e këtyre regullave dhe t' udhëzimeve të tjera të Ministrisë së Bujqësisë ose dispozitat e regullave të vëna në planin e ujitjes të seksionit të bujqësisë së rrethit, kryen kundravajtje që dënohet me gjobë që fillon nga 500 lekë dhe arrin gjer në 5000 lekë.

Disa raste kundravajtjesh të këtij lloji janë:

a) Kur merret uji pa leje dhe jashtë radhës;

b) Kur shpërdorohet uji, duke ujitur jo në format e caktuara nga ana e seksionit të bujqësisë;

c) Kur shkelet precedenca e ujitjes së kulturave industriale, dhe në vend të tyre ujiten kultura të tjera, qoftë edhe të të njejtës ekonomi.

ç) Kur refuzohet puna e detyruar në kohën edhe në vendin e caktuar,

Approved For Release 2009/06/15 : CIA-RDP83-00418R001100040009-2

Approved For Release 2009/06/15 : CIA-RDP83-00418R001100040009-2

për punime të sistemimit agrar ose të meremetimit dhe pastrimit të kanaleve etj.

Konsiderohen të kryera rastet e masipërme të kundravajtjes deri sa vija e ujit nuk është këthyer ose nuk është ndryshuar duke shpuar brigjet duke hapur pendat ose ndërtuar vepra të tjera brenda në kanal, në skarpatat ose argjinaturat, sepse në raste të tilla kemi folur veçanërisht në pikën 35 të këtyre rregullave.

40. Sipas nenit 14 të Dekretit Nr. 1483 dt. 12.6.952, kushdo që shkel regullat e vendosura prej Ministrisë së Bujqësisë në lidhje me çfrytëzimin racional dhe mbrojtjen e kanaleve ujitëse e kulluese dhe të veprave t' artit që lidhen me këto, kur vepra nuk formon krim, dënohet me 300 lekë gjobë.

Disa raste kundravajtjesh të kësaj natyre janë:

a) Kur merret ujë kundra regullave të vendosura prej Ministrisë së Bujqësisë, qoftë edhe sikur dëmi i shkaktuar të jetë i vogël, mjafton që të jetë shkaktuar çrregullim në planin e ujitjes.

b) Kur kalohet me kafshë, qerre, etj. në kanale dhe në vende të ndaluara, qoftë edhe sikur dëmi të jetë i pa rëndësishëm.

c) Kur peshkohet në kanal me mjete që mund ti sjellin dëm kanalit.

41. Ekonomitë bujqësore, tokat e të cilave janë planifikuar për t' ujitur, në qoftë se deklarojnë sipërfaqe më të vogla nga ato që në realitet disponojnë, kryejnë sipas rastit krimin e dhënjes s' informatave të rremë (kjo vetëm për faktin e thjeshtë të deklarimit të rremë) që parashikohet nga neni 258 i Kodit Penal dhe dënohet me gjobë gjer në 2000 lekë ose me punë korektonjëse gjer në 6 muaj dhe, kur ato kanë përfituar në fakt ose kanë ujitur sipërfaqe më të mëdha nga ato që kanë deklaruar, kryejnë krimin që parashikohet nga neni 107 i Kodit Penal. Në këtë rast dënohen me gjobë gjer në dyfishin e kundrapagesës së sipërfaqes të padeklaruar që është ujitur, ose me punë korektonjëse (15 dit gjer në 1 vit) ose me burgim gjer në 1 vit.

42. Kundravajtjet e parashikuara nga nenet 13 e 14 të Dekretit Nr. 1483 dt. 12.6.952 (pika 37 e 38 këtyre regullave) gjykohen nga komitetet Ekzekutive të rretheve, në bazë të proçes-verbaleve të regullta të mbajtura nga organet e administratës së kanaleve sipas proçedurës nga ligja mbi kundravajtjet.

43) Për kundravajtjet e parashikuara nga neni 14 i Dekretit Nr. 1483 dt. 12.VI.952 (pika 40 e këtyre regullave), kur kundravajtësi kapet në flagrancë rojtari ka të drejtë të nxjerrë gjobën e 300 lekëve aty për aty, duke i lëshuar kundravajtësit një biletë (dublikatë) për pagimin e gjobës.

Në qoftë se kundravajtësi i kapur në flagrancë, për çdo arësye qoftë, refuzon të paguajë gjobën aty për aty kryerojtari ose rojtari mban proçes-verbalin mbi kundravajtësin dhe ja dërgon Komitetit Ekzekutiv të rrethit për ta gjykuar çështjen sipas regullit të përgjithshëm.

44. Me hyrjen në fuqi të këtyre rregullave, abrogohen rregullat «Mbi zbatimin e Dekretit Nr. 1483 datë 12.VI.952 mbi kanalet ujitëse dhe bonifikimet», botuar në gazetën Zyrtare Nr. dt. 29 Prill 1953.

45. Këto regulla të dala në virtut të nenit 17 të Dekretit Nr. 1483 dt. 12.VI.52 «Mbi kanalet ujitëse dhe mbi bonifikimet» e Dekretit Nr. 1928 dt. 6.IX.954 «Mbi disa shtesa dhe ndryshime në Dekretin Nr. 1483 dt.12.VI.952, dhe për zbatimin e tyre, janë të detyrueshme për të gjithë dhe hyjnë në fuqi me botimin e tyre në Gazetën zyrtare.

Tiranë, me 21 janar 1955

MINISTRI:
Hysni Kapo

Approved For Release 2009/06/15 : CIA-RDP83-00418R001100040009-2

Approved For Release 2009/06/15 : CIA-RDP83-00418R001100040009-2

GAZETA ZYRTARE

E REPUBLIKËS POPULLORE TË SHQIPËRISË

18 Shkurt | Nr. 2 | 1955

PËRMBAJTJA

Pjesa e I-rë

		Faqe
1) Dekret Nr. 1986 dt. 24-I-1955 —	Mbi ndryshime në ndarjen administrative tokësore të Republikës Popullore të Shqipërisë.	36–38
2) Dekret Nr. 1989 dt. 24 I-1955 —	Mbi caktimin e ditës së zgjedhjeve,të zonave elektorale për zgjedhjet e gjykatave popullore dhe të numurit të gjyqtarëve popullorë dhe ndihmës gjyqtarve popullor.	38–42
3) Dekret Nr. 1990 dt. 24-I-1955 —	Mbi gjykatat shoqërore në qendrat e punës.	42–44
4) Dekret Nr. 1991 dt. 7-II-955 —	Për akordim dekoratash	45–48
5) Dekret Nr. 1988 dt. 24-I-1955 —	Për akordim dekoratash	49–57
6) Dekret Nr. 1984 dt. 24-I-1955 —	Për lënie shtetësie	57–57

Pjesa e II-të

7) Urdhëresë e Qeverisë Nr. 4 dt. 25-I-1955	Mbi shtrirjen e sigurimeve shoqërore shtetërore në antarë profesionistë peshkatarë të kooperativave të peshkatarëve	57–59
8) Urdhëresë e Qeverisë Nr. 3 dt. 25-I-1955 —	Mbi mbrojten e rrugave	59–61
9) Vendim i Këshillit të Ministrave Nr. 20 dt. 10-I-1955 —	Mbi komisionin dhe zyrat e arkitekturës dhe urbanistikës	61–62
10) Vendimi i këshillit të Ministrave Nr. 49 dt. 31-I-1955 —	Mbi organizimin e kontrollit të kualitetit në ndërmarrjet industriale dhe tregëtare	63–65
11) Rregullore —	Mbi detyrat dhe të drejtat e zyrave të kontrollit teknik në ndërmarrjet industriale dhe minerale	65–67
12) Rregullore —	E inspektoriatit shtetror të tregtisë dhe kualitetit	67–69
13) Rregullore —	E zyrës së ekspertizës së mallrave pranë komitetit ekzekutiv të k. p. të qarqeve	69–71
14) Lajmërim për ndrim emrash		71–71

Approved For Release 2009/06/15 : CIA-RDP83-00418R001100040009-2

Approved For Release 2009/06/15 : CIA-RDP83-00418R001100040009-2

Tirazhi : 2000

Shtypur në Stabilimentin «Mihal Duri» — Tiranë.

Approved For Release 2009/06/15 : CIA-RDP83-00418R001100040009-2

Approved For Release 2009/06/15 : CIA-RDP83-00418R001100040009-2

D E K R E T

Mbi ndryshime në ndarjen administrative tokësore të Republikes Popullore të Shqipërisë.

Në mbështetje të nenit 11 të ligjës Nr. 1763 datë 26 Nëndor 1953 mbi këshillat popullore,

PRESIDIUMI I KUVENDIT POPULLOR

V E N D O S I :

Të bëhen ndryshime në ndarjen administrative tokësore të Republikës Popullore të Shqipërisë si vijon :

I

QARKU I BERATIT

1) Fshati Terova, i rrethit të Gramshit të qarkut të Elbasanit t'i lidhet lokalitetit të Gjërbësit të rrethit Skrapar.

2) Lagja Liqethi e fshatit Slatinja të rrethit Skraparit të shkëputet nga fshati i sipërmë dhe të formohet fshat në vehte me emërin Liqethi po n'atë rreth.

3) Të shtohet në rrethin e Lushnjes Ferma 29 Nëndori.

II

QARKU I DIBRËS

1) Fshati Arapaj i rrethit të Peshkopisë të ndahet në dy fshatra : Arapaj i epërmë dhe Arapaj i poshtëm.

2) Lagjet Muglio, Oreshnje dhe Golemeran të fshatit Okshtuni i madh të rrethit të Shupenxës të shkëputet nga fshati i sipërmë dhe të formojnë fshat më vehte me emërin Oreshnje po n'atë rreth.

3) Lagja Prodan e fshatit Okshtuni i vogël dhe lagja Likaj e Okshtunit të madh të rrethit të Shupenxës të shkëputen nga fshatrat e sipërmë dhe të formojnë fshat në vehte me emërin Prodani po n'atë rreth.

4) Lagja Murgu e fshatit Kojaveci të rrethit të Shupenzës të shkëputet nga fshati i sipërmë dhe t'i lidhet fshatit Smollnik po n'atë rreth.

5) Fshati Bel-Unjate i rrethit të Klosit të ndahet në dy fshatra : Beli dhe Unjata.

6) Lagjet Kodra e Leshe të fshatit Arrasi të rrethit të Kastriotit të shkëputen nga fshati i sipërmë dhe të formojnë fshat më vehte me emërin Kodralesha po n'atë rreth.

7) Lagja Tej-Mëhallë e fshatit Gur-Reçi të rrethit të Kastriotit të shkëputet nga fshati i sipërmë dhe të formohet fshat më vehte me emërin Tej-Mëhalla po n'atë rreth.

III

QARKU I ELBASANIT

1) Fshati Belshi i rrethit të Cërrikut të ndahet në pesë fshatra Gradishta, Merhoja, Shkoza, Belshi dhe Trojasi.

2) Fshati Zdrajshi i rrethit të Librazhdit të ndahet në dy fshatra t Zdrajshi dhe Vërrija.

Approved For Release 2009/06/15 : CIA-RDP83-00418R001100040009-2

Approved For Release 2009/06/15 : CIA-RDP83-00418R001100040009-2

3) Fshati Polisi i rrethit të Librazhdit të ndahet në katër fshatra: Polisi, Gur-Shpati. Vilani dhe Gostina-Mal.

4) Lagja Trashovica e fshatit Lubinja të rrethit të Gramshit të shkëputet nga fshati i sipërm dhe të formohet fshat më vehte me emërin Trashovica po n'atë rreth.

5) Fshati Terova i rrethit të Gramshit ti lidhet lokalitetit të Gjerbësit të rrethit të Skraparit të qarkut Berat.

6) Fshati Pajuni i rrethit të Peqinit t'i lidhet rrethit të qendrës Elbasan.

7) Fshati Haxhijasi që figuron në rrethin e Cërrikut të hiqet mbasi nuk ekziston në fakt.

IV

QARKU I GJIROKASTRËS

1) Fshati Buz i vogël i rrethit të Tepelenës të ndahet në dy fshatra: Buz i vogël dhe Golemaj.

2) Fshati Tosk-Martallozi i rrethit të Tepelenës të ndahet në dy fshatra: Tosk — Martallozi dhe Vagalati.

3) Fshati Toçi i rrethit të Tepelenës të ndahet në dy fshtra: Toçi dhe Fusha e Toçit.

4) Fshati Qestorati i rrethit të qendrës të ndahet në dy fshatra: Qestorati dhe Prenjas.

5) Fshati Ardhasova i rrethit të Delvinës ti lidhet rrethit të Sarandës.

6) Fshati Iliari i rrethit të Përmetit ti lidhet rrethit Leskovikut të qarkut të Korçës.

7) Fshati Ripsi që figuron në rrethin e Delvinës të hiqet mbasi nuk ekziston në fakt.

V

QARKU I KORÇËS

1) Fshati Katund-Stratobërdha i rrethit të Vithkuqit të ndahet në dy fshatra: Katundi dhe Stratobërdha

2) Fshati Gollobërdha i rrethit të Bilishtit ti lidhet rrethit të qendrës Korçë.

3) Fshati Iljara i rrethit të Përmetit të qarkut të Gjirokastrës t'i lidhet rrethit të Leskovikut.

4) Të shtohet në rrethin e Maliqit ferma «Maliq».

VI

QARKU I SHKODRËS

1) Fshati Selca i rrethit të Koplikut të ndahet në tre fshatra: Lepusha. Tamara dhe Selca

2) Fshatrat Laçi e Qyrsaqi të rrethit të Zadrimës të bashkohen dhe të formojnë nji fshat më vehte me emërin Laç-Qyrsaç.

Fondi i nevojshëm për të përballuar shpenzimet e sigurimeve shoqërore shtetërore për anëtarët profesionistë peshkatarët të kooperativave të peshkatarëve, krijohet në këtë mënyrë:

a) nga shuma që del prej uljes 4% të tatimit mbi xhiro mbi peshkun, vendosur me vendimin Nr. 249 datë 10-IX-1954 të Këshillit të Ministrave dhe që shkon në favor të kooperativave të peshkatarëve;

Approved For Release 2009/06/15 : CIA-RDP83-00418R001100040009-2

Approved For Release 2009/06/15 : CIA-RDP83-00418R001100040009-2

b) shuma tjetër prej 4.50% do të derdhet nga t'ardhurat e vet kooperativave të peshkatarëve.

Neni 8.

Kjo urdhëresë hyn në fuqi menjiherë.

ZËV. KRYETAR I KËSHILLIT MINISTRAVE TË R.P.SH.
HYSNI KAPO

URDHËRESË E QEVERISË

Nr. 3 dt. 25. I. 1955.

Këshilli i Ministrave i Republikës Popullore të Shqipërisë, për të mbrojtur rrugët nacionala dhe lokale nga dëmtimet eventuale prej punimeve të ndryshme që kryhen n'afërsitë e tyre, nxjerr këtë

URDHËRESË
MBI
MBROJTJEN E RRUGËVE

Neni 1.—

Mbrojtja nga dëmtimet e rrugëve nacionale dhe lokale si dhe e veprave t'artit të këtyre rrugëve, rregullohet simbas dispozitave të kësaj urdhërese.

Neni 2.—

Për mbrojtjen e rrugëve publike nga dëmtimet ndalohet:

a) çelja e vijave për kalimin e ujrave mbi shtresën ose në bankinat e rrugëve;

b) nxjerrja e gurëve nga guroret në një largësi më pak se 5 m. nga skarpata e jashtëme e kanalit të rrugës, për rrugët fushore;

c) prerja e pemëve, çkulja ose djegëja e shkarpave (prozhmeve) dhe nxjerrja e gurëve në rrugët kodrinore dhe malore 5 metra nga skarpata e e jashtme e kanalit;

ç) kalimi mbi rrugën i mjeteve mekanike me dhëmbë si traktor etj.

d) zvarisja mbi rrugën e drurëve, lesave, hekurave të çdo madhësije edhe sikur këto të jenë të mbështetura pjesërisht mbi rrota, kur dëmtojnë rrugën;

e) kalimi i automjeteve me tonazh më të math mbi urat në të cilat tonazhi është i kufizuar me tabela të posaçme;

ë) dëmtimi i tabelave tregonjëse, i gurëvet të kilometrazhit dhe i pemëve të mbjellura gjat rrugës si dhe i parapetëve (parmakëve) të urave;

f) depozitimi i gurëve, lëndës të çdo llojë, gëlqeres, rërës etj. në shtratin e rrugës për çdo lloj ndërtimi. Për materialet e nevojshme të rrjetit rrugor depozitimi të bëhet i rregullte në sheshet e depozitimit dhe bankinat ndersa materialet e tjera 2 metra larg nga skarpata e jashtëme e kanalit;

g) pengimi i rrjedhjes së lirë të ujrave në kanalet anësore të rrugëve;

Approved For Release 2009/06/15 : CIA-RDP83-00418R001100040009-2

Approved For Release 2009/06/15 : CIA-RDP83-00418R001100040009-2

gj) mbjellja e pemëve në largësi më të vogël se 1 m. nga buza e jashtëme e kanalit për rrugët fushore, ndërsa në rrugët malore kjo të bëhet në bashkëpunim me kantieret e mirëmbajtjes duke marrë njëkohesisht aprovimin e Ministrisë Ndërtimit dhe Komunikacioneve.

h) vendosja e shtyllave telefonike, telegrafike ose elektrike në bankinat ose skarpatat në largësi më pak se 3 m. nga skarpata e jashtëme e kanalit, veç rastevet kur kjo bëhet në qëndrat e banuara, ku vendosja e tyre bëhet simbas planit rregullues;

i) ndërtimi i furave të gëlqeres dhe i kaminave tullash dhe tjegullash në një largësi më pak se 50 m. në vënde fushore, kur vëndi është i aksidentuar kjo distancë mund të jetë 10 m. nga skarpata e jashtëme e kanalit;

j) ndërtimi i shtëpive ose i mureve rrethonjëse në kthesat e rrugëve dhe në kryqëzimet, kur këto pengojnë shikimin e nevojshëm, simbas dispozitave në fuqi.

Neni 3.—

Për grumbullimin, qoftë dhe përkohesisht. e lëndës së drurit dhe çdo materiali tjetër në bankinat e rrugëvet ose në kanalet e tyre, duhet të kërkohet leja nga organet e Ministrisë së Ndërtimit dhe Komunikacioneve.

Grumbullimi duhet të bëhet në mënyrë që të mos dëmtojë rrugën ose të pengojë qarkullimin dhe natën të vendosen drita të kuqe paralajmëruese.

Neni 4.—

Ekonomitë bujqësore shtetërore, kooperativiste dhe private që për ujittjen e tokave do të ndërtojnë tubacione ose kanale në shtratin e rrugës, duhet tu paraqesin kërkesën dhe projektin e sistemimit definitiv organeve të Ministrisë Ndërtimit dhe Komunikacioneve, e cila jep lejen mbasi të bindet mbi qënien në rregull të projektit të veprës së kalimit t'ujit.

Neni 5.—

Për çdo kryqëzim ose degëzin të ri në rrugët publike për punime të ndryshme të një institucioni shtetënor dhe kooperativist ose ekonomie bujqësore private duhet të kërkohet leje.

Urat, ose tombinat në kanalet anësor do të ndërtohen simbas kërkesave teknike dhe rrugët të ndërtohen me shtresë të njëllojtë me atë të rrugëve kryesore për një gjatësi prej 30 m. për të mbrojtur rrugën kryesore,

Neni 6.—

Organet e Drejtorisë së postave, telegrafeve dhe telefonave duhe të paisen me leje kur kanë për të vendosur shtylla telefonike ose telegrafike, jasht vendeve të banuara me largësi më të vogël nga ajo që përcakfohet në nenin 2 germa h.

Neni. 7.—

Lejet për të cilat bëhet fjalë në nenet 3,4,5 dhe 6 lëshohen nga Ministria e Ndërtimit dhe Komunikacioneve për rrugët nacionale dhe nga komitetet ekzekutive të k.p. të qarqeve për rrugët lokale, mbi kërkesën e të interesuarve që paraqitet me anën e seksionit komunal pranë komitetit ekzekutiv të k.p. qarkut.

Neni 8.—

Ekonomitë bujqësore shtetërore, kooperativiste dhe private që përdo-

Approved For Release 2009/06/15 : CIA-RDP83-00418R001100040009-2

Approved For Release 2009/06/15 : CIA-RDP83-00418R001100040009-2

rin ujin e kanaleve anësore ose të kanaleve ujitëse që ndodhen bri rrugëve detyrohen të marrin masa për të ndaluar përhapjen e ujit mbi rrugë.

Neni 9.—

Ekonomitë bujqësore shtetërore, kooperativiste dhe private që kanë toka anës rrugëve, detyrohen të mirëmbajnë dhe pastrojnë gardhet dhe pemët për të mos u zënë kanali dhe të pengohet kullimi i ujit.

Neni 10.—

Çdo dëmtim i rrugëve ose i veprave të artit të këtyre rrugëve që bëhet nga institucionet, ndërmarrjet, ekonomitë shtetërore, kooperativiste dhe shoqërore si dhe nga përsona privat do të meremetohet nga ana e kantjereve të mirëmbajtjes për llogari të atij që ka shkaktuar dëmin.

Neni 11.—

Kushdo që shkel dispozitat e kësaj urdhrese, dënohet në bazë të ligjës mbi kontravajtjen me punë korektonjëse gjer në 2 muaj ose me gjobë gjer në 10.000 lekë.

Neni 12

Ministrija e P. të Brendëshme (Policia Popullore) ngarkohet që së bashku me mbikqyrjen e qarkullimit në rrugët e Republikës të verifikojë edhe nëse është marrë leje për kryerjen e punimeve që përmendën në nenet 3,4,5 dhe 6 të kësaj urdhërese.

Neni 13.—

Kjo urdhëresë hyn në fuqi menjëherë.

ZËV. KRYETAR' I KËSHILLIT MINISTRAVE TË R.P.SH.
HYSNI KAPO

KËSHILLI I MINISTRAVE

VENDIM

Nr. 20 Datë 10/I/1955

MBI

KOMISIONIN DHE ZYRAT E ARKITEKTURËS DHE URBANISTIKËS

Këshilli i Ministrave i Republikës Popullore të Shqipërisë, me qëllim që të zhvillohet dhe të përmirësohet puna e projektimit dhe e ndërtimit në qytete dhe në qendra të tjera të banuara, në mbledhjen e datës 10/I/1955.

V E N D O S I :

1. – Të krijohet pranë Ministrisë Ndërtimit dhe Komunikacioneve Komisioni i arkitekturës dhe urbanistikës, i cili të ketë këto detyra:

Approved For Release 2009/06/15 : CIA-RDP83-00418R001100040009-2

Approved For Release 2009/06/15 : CIA-RDP83-00418R001100040009-2

a) Të drejtojë ndërtimet urbanistike në qendrat e banimit të Republikës Popullore të Shqipërisë, të lëshojë udhëzime mbi mënyrën e projektimit të ndërtesave dhe të planeve rregulluese, të ndjekij zbatimin e tyre me anën e degës së urbanistikës pranë Ministris së Ndërtimit dhe Komunikacioneve dhe zyrave të urbanistikës pranë komiteteve ekzekutive të qyteteve ose të qarqeve.

b) Të aprovojë projekt-idetë e objekteve me rëndësi, simbas rregullores që do të aprovohet nga Ministria e Ndërtimit dhe Komunikacioneve, dhe të pregatisij me anën e N. SH. Projekt:t dokumentimin për paraqitjen në Këshillin e Ministrave të planeve rregulluese, rregulloreve përkatëse, dhe të projekteve që duhet të apravohen prej këshillit të Ministrave.

c) Të aprovojë projektet tip.

ç) Të aprovojë dispozitat teknike për projektimin dhe zbatimin e punimeve të ndërtimit dhe normat në ndërtime.

2. – Komisioni i sipërm i arkitekturës dhe urbanistikës të përbëhet nga këta persona:

Ministri i Ndërtimit dhe Komunikacioneve Kryetar, me anëtarë zëvëndës ministrat e Mbrojtjes Popullore, Drejtësisë, dhe Shëndetësisë, drejtorin e ndërmarrjes shtetërore projekti, drejtorin e drejtorisë s' ekonomisë komunale dhe njerin nga zëvendës presidentët e Komisionit të Planit të Shtetit.

Në këtë komision mund të thirren, sipas nevojës, që të marrin pjesë, edhe persona të tjerë.

3. – Të krijohet në Ministrinë e Ndërtimit dhe Komunikacioneve dega e arkitekturës dhe urbanistikës me këtë organikë: një ingjiner, dy gjeometra, një kryeferent dhe një dizenjator.

4. – Zyrat e urbanistikës pranë komiteteve ekzekutive të k. p. të qarqeve Tiranë, Durrës, Shkodër dhe Korçë të kalojnë në varësin e komiteteve ekzekutive të k. p. të qyteteve respektive duke ushtruar funksionet e urbanistikës edhe për qëndrat e tjera të qarqeve të sipërme si edhe përpara.

5. – Zyrat e urbanistikës në qytetin e Tiranës të ketë në organikë 1 ingjiner dhe 2 gjeometra, ajo e Durrësit 1 ingjinier dhe 1 gjeometër, ndërsa zyrat e urbanistikës të qyteteve Shkodër dhe Korçë dhe ato të komiteteve ekzekutive të k. p. të qarqeve Elbasan dhe Vlorë të kenë në organikë vetëm 1 gjeometër.

6. – Në komitetet ekzekutive të k. p. të qarqeve Berat, Gjirokastër dhe Dibër të suprimohet vendi i ingjinerit të urbanistikës dhe funksioni i tij të kryhet nga seksioni i industrisë dhe ndërtimit pranë komitetit ekzekutiv të k. p. të qarkut.

7. – Fondet e nevojshme, për shkak të krijimit të shërbimit të arkitekturës dhe urbanistikës, të mbulohen nga ekonomitë që rezultojnë në vet Ministrin e Ndërtimit dhe Komunikacioneve dhe në komitetet ekzekutive të k. p. të qarqeve përkatëse.

8. – Ministria e Ndërtimit dhe Komunikacioneve të caktojë më hollësisht, me anë rregulloreje, detyrat e Komisionit të arkitekturës dhe urbanistikës dhe përgjithësisht të zyrave të arkitekturës dhe urbanistikës.

9. – Çdo dispozitë që vjen në kundërshtim me këtë vendim mbetet pa fuqi.

10. – Ky vendim hyn në fuqi menjiherë.

ZËV. KRYETAR' I KËSHILLIT MINISTRAVE TË R.P.SH.

HYSNI KAPO

Approved For Release 2009/06/15 : CIA-RDP83-00418R001100040009-2

Approved For Release 2009/06/15 : CIA-RDP83-00418R001100040009-2

KËSHILLI I MINISTRAVE

VENDIM

Nr. 49 dt. 31. I. 1955.

MBI

ORGANIZIMIN E KONTROLLIT TË KUALITETIT NË NDËRMARRJET INDUSTRIALE DHE TREGËTARE

Këshilli i Ministrave i Republikës Popullore të Shqipërisë, në mbledhjen e tij të datës 31-I-1955, me qëllim që të organizohet dhe të forcohet kontrolli në lidhje me kualitetin e prodhimit në ndërmarrjet industriale dhe tregëtare.

V E N D O S I :

PËR MINISTRIN E INDUSTRISË DHE MINIERAVE:

1) Gjer në fund të muajit Mars 1955 të krijohen në ndërmarrjet industriale zyrat e kontrollit teknik simbas listës që i bashkangjitet këtij vendimi dhe formon pjesë përbërëse të tij.

2) Të shtohet në organikat e ndërmarrjeve industriale kuadri i kimistave dhe i laburantave që përmënden në listën e bashkangjitur. Për ndërmarrjet minerale të merren të gjitha masat në mënyrë që të krijohen laboratore, brenda mundësive të pajisjeve që disponohen. Për vitin 1956 të merren të gjitha masat që të ngrihen laboratoret në ndërmarrjet minerale.

3) Ministria e Industrisë dhe Minierave, brenda 3 mujorit të parë 1955, të caktojë nga fuqia puntore dhe simbas karakterit dhe volumit të prodhimit, kontrollorët teknikë për çdo sektor prodhimi në ndërmarrjet industriale dhe minerale.

4) Detyrat dhe të drejtat e zyrave të kontrollit teknik caktohen në rregullloren tip që formon pjesë përbërëse të këtij vendimi. Ministria e Industrisë dhe Minierave në bazë të kësaj rregullorje dhe duke marrë parasysh natyrën e prodhimit të çdo ndërmarrjeje, të caktojë me hollësi detyrat e zyrave të kontrollit për çdo qendër prodhimi.

5) Në të gjitha ndërmarrjet e tjera ku kontrolli i prodhimit ka karakterin e kontrollit të laboratorit, funksionet e zyrës së kontrollit teknik t' i kryejë laboratori i ndërmarrjes. Në ndërmarrjet e vogla ku nuk ka zyrë kontrolli teknik as edhe laboratorë, detyrat e zyrës kontrollit teknik t'i kryejë tekniku dhe mjeshtrat e prodhimit.

6) Si kryetar i zyrës së kontrollit teknik dhe kontrollorë teknikë të caktohen teknikët ose puntorët më të mirë të ndërmarrjes. Kyetar' i zyrës së kontrollit teknik emërohet dhe shkarkohet nga detyra vetëm me aprovimin e Ministrit. Emërimet, transferimet ose shkarkimet nga detyra e kontrollorëve teknikë bëhen me propozimin e kryetarit të zyrës së kontrollit teknik dhe me aprovimin e drejtorisë përkatëse të Ministrisë.

7) Poga mujore e kryetarit të zyrës së kontrollit teknik të jetë e njëllojtë me atë të degëve apo seksioneve përkatëse të planit të ndërmarrjes ose sipas gradës teknike që kanë. Drejtoria e ndërmarrjes ka si detyrë që kryetarit të zyrës së kontrollit teknik ti japë preçedencë përsa i përket banimit sikurse dhe drejtuesave të tjerë të ndërmarrjes.

Approved For Release 2009/06/15 : CIA-RDP83-00418R001100040009-2

Approved For Release 2009/06/15 : CIA-RDP83-00418R001100040009-2

8) Pagesa e kontrollorëve teknikë bëhet sipas karakterit dhe rëndësisë së punës që këta kryejnë, dhe mund të jetë, më e ulët, e barabartë ose më e lartë nga ajo e puntorëve që kontrollojnë. Në rastin e fundit kjo mund të harrij gjer në një klasë më lartë se sa ajo e puntorit më të lartë q'ata kontrollojnë, në qoftë se nuk ka klasë më të lartë atëhere ata marrin një shtesë gjer 15% mbi rrogën bazë. Pagesa e kontrollorëve teknikë (plus 15% kur është rasti) nuk mund të jetë më e lartë nga ajo e shefave të reparteve.

Kontrollorët teknikë kur kryejnë qind për qind detyrat që u janë ngarkuar dhe kur nuk zbulohen gabime në lidhje me caktimin e kualiteteve të prodhimit marrin prejmjalkën 1-25% mbi rrogën bazë. Shpërblimi bëhet në bazë të propozimit të kryetarit të zyrës së kontrollit teknik dhe aprovimit të drejtorisë së ndërmarrjes. Ministria e Industrisë dhe Minierave të lëshojë udhëzime të hollësishme për caktimin e kondi.tave për dhënien e premjalkës

9) Për të kualifikuar dhe për të ngritur nga ana tekniko-profesionale përsonelin e zyrave të kontrollit teknik. Ministria e Industrisë dhe Minierave të nxjerrë udhëzime dhe të orgonizojë kurse kualifikimi simbas sektorëve të prodhimit.

10) Ministria e Industrisë dhe Minierave të japë udhëzime dhe të marrë masa në mënyrë që në çdo ndërmarrje gjer në fund të 3/mujorit të I-rë 1955 të jetë vendosur metodika e kontrollit të lëndëve të para, ndihmëse. prodhimeve në proçes, gjatë fazave të ndryshme, si dhe të prodhimeve të gatëshme, duke përcaktuar me hollësi llojin e kontrollit, mënyrën e bërjes së kontrollit (me anë laboratori, veglave matëse etj.) kohën e bërjes së kontrollit dhe personat që do të bëjmë kontrollin.

11) Të mos lejohet përdorimi në prodhim i asnjë lëndë të parë ose ndihmëse pa kaluar në kontroll të rregullt. Gjithashtu të mos lejohet të dali nga ndërmarrja as një prodhim i gatëshëm pa u kontrolluar dhe pa u vërtetuar përshtatëshmërija e tij me standardet shtetërore dhe kushtet teknike. Çdo pjesë prodhimi të gatëshëm, që vihet në shitje nga ndërmarrja, të shoqërohet me dokument të rregullt (pashaporta, çertifikata etj.) ku të vërtetohet kualiteti i prodhimit simbas standardeve shtetërore ose kushteve teknike. Mollrat që nuk do të jenë të pojisura me dokumenta të vërtetuara nga ana e zyrës së kontrollit teknik të mos merren në dorëzim nga organizatat tregëtare. Kur lejohet dalja nga ndërmarrja e prodhimit industrial me cilësi jo të mirë ose jo të plotë ose në kundërshtim me standardet e caktuara, përgjegjësit e kontrollit teknik dhe në radhë të parë kryetari i zyrës kontrollit, kanë përgjegjësi penale simbas nenit 90 të Kodit Penal.

12) Mbasi kualiteti i mirë i prodhimit arrihet vetëm atëherë kur ka proçese teknollogjike të drejta dhe kur mbikqyret me reptësi zbatimi i tyre, Ministria e Industrisë dhe Minierave të marrë masa në mënyrë që të gjitha ndërmarrjet industriale të kenë gjer në fund të tremujorit I-rë 1955 të dokumentuara dhe të aprovuara proçeset teknollogjike, ku të përcaktohen të gjitha konditat teknike të domosdoshme për regjimin e regullt teknollogjik.

13) Të merren masa, gjithashtu që, gjer në fund të muajit Maj 1955 për të gjitha ato prodhime industriale e minerale që nuk kanë standarde shtetërore dhe nuk ka akoma kondita teknollogjike për të nxjerrë të tilla standarde, të nxirren kushte teknike të përkohëshme, të cilat të aprovohen prej Ministrisë Industrisë dhe Minierave. Nga 1 qershor 1955 asnjë prodhim të mos shpërndahet e të vihet në shitje në qoftë se nuk ka për të standarde ose kushte teknike të aprovuara.

Approved For Release 2009/06/15 : CIA-RDP83-00418R001100040009-2

Approved For Release 2009/06/15 : CIA-RDP83-00418R001100040009-2

14) Çdo puntor detyrohet të lajmë ojë drejtorinë e ndërmarrjes kur konstaton se prodhimi që ay nxjerr eshtë skarto e më të meta. Për prodhime që dalin skarto për faj të puntorit, për ato që dalin skarto jo për faj të tij dhe për prishjen e materialeve në pregatitjen e prodhimeve zbatohen dispozitat e kodit të punës.

15) Drejtoritë dhe komitetet profesionale të ndërmarrjeve të marrin masa edukative në mënyrë që çdo puntor të jetë i qartë për kushtet teknike që duhet të ketë prodhimi që ai nxjerr si dhe për regjimin teknollogjik që ai duhet të mbojë gjatë prodhimit. Këta treguesa të rëndësishëm të afishohen bukur e në mënyrë që të jenë të lexueshme pranë vëndeve të punës.

PËR MINISTRINË E TREGËTISË:

16) Pranë Ministrisë Tregëtisë të krijchet inspektorioti shtetëror i tregëtisë dhe kualitetit me nji kryeinspektor dhe 12 inspektora nga të cilët 10 (dhjetë) në qarqe.

17) Pranë komiteteve ekzekutive të këshillove popullore të qarqeve (seksioneve të tregtisë) të krijohen zyrat e ekspertizës së mallrave. Në qarqet: Tiranë, Durrës, Shkodër, Korçë dhe Elbasan për detyrën e shefit të zyrave t'ekspertizës të caktohen punonjës të posaçëm në organikë, paga e tyre të jetë e njëllojtë me atë të referenteve të artikujve ushqimorë të sejcilit qark.

18) Inspektoriati shtetëror i Tregëtis dhe i kualitetit, ka të drejtë të kontrollojë kualitetin e mallrave të gatëshme të konsumit të gjërë pranë ndërmarrjeve dhe organizatave prodhonjëse dhe kur konstoton se mallrat janë prodhuar në kundërshtim me standardet ose kushtet teknike të shtrojë çështjen prahë organeve drejtonjëse duke venë në dijeni menjëherë kur është rasti organet e Prokurorisë dhe Ministrinë e Tregtis.

19) Aprovohen si pas aneksve që formojnë pjesë përbërëse të këtij vendimi rregulloria mbi detyrat dhe të drejtat e Inspektoriotit shtetëror të tregëtisë dhe kualitetit si dhe rregulloria e zyrave të ekspertizës së mallrave.

20) Për zbatimin e këtij vendimi ngarkchet Ministria e Industrisë dhe Minierave, Ministria e Tregëtisë dhe Ministria e Financave.

21) Institucionet e tjera ekonomike qëndrore të marrin masat e nevojshme, në frymën e këtij vendimi, për organizimin e kontrollit teknik në ndërmarrjet dhe organizatat vartëse mbrenda gjashtëmujorit I-rë 1955.

22) Ky vendim hyn në fuqi me nië herë.

ZËV. KRYETAR' I KËSHILLIT MINISTRAVE TË R.P.SH.
HYSNI KAPO

RREGULLORE

MBI

DETYRAT DHE TË DREJTAT E ZYRAVE TË KONTROLLIT TEKNIK NË NDËRMARRJET INDUSTRIALE DHE MINERALE.

1). — Për të luftuar me vendosmëri kundra prodhimeve skarto dhe shkeljes së standardeve shtetërore nga ana e ndërmarrjeve industriale dhe minerale, krijohen pranë tyre zyrat e kontrollit teknik.

2. — Detyrat kryesore e zyrës së kontrollit teknik është që të ndalojë t'u shpërndahen konsumatorëve prodhime me kualitet jo të mirë ose jo të plotë

Approved For Release 2009/06/15 : CIA-RDP83-00418R001100040009-2

Approved For Release 2009/06/15 : CIA-RDP83-00418R001100040009-2

ose që nuk u përgjigjen standardeve shtetërore, kushteve teknike të përkohëshme dhe mostrave (modeleve).

3. – Zyra e kontrollit teknik është një organ i veçantë në ndërmarrje. Kryetari i saj emërohet e shkarkohet direkt nga Ministri. Emërimi, transferimi ose shkarkimi i kontrollorëve teknikë bëhet me propozimin e zyrës së kontrollit teknik dhe me aprovimin e drejtorisë përkatëse të Ministrisë. Si kryetar i zyrës teknike dhe kontrollora teknikë caktohen persona të cilët kanë të paktën një stazh prej tre vjet në atë sektor prodhimi.

4. – Detyrat e hollësishme të zyrës së kontrollit teknik janë këto:

a) Kontrollon kualitetin e prodhimeve të ndërmarrjes me anën e provave, analizave, ekspertizave në bazë të standardeve shtetërore, kushteve teknike të përkohëshme e etaloneve dhe vërteton se prodhimi i përgjigjet karakteristikave teknike të caktuara.

b) Kontrollon kualitetin e lëndëve të para, lëndëve ndihmëse të nevojshme për proçesin teknollogjik të prodhimit, verifikon në bazë të provave e analizave në se këto i përshtaten standardeve shtetërore e kushteve teknike të përkohëshme dhe jep leje për marrjen e tyre në dorëzim nga ana e ndërmarrjes.

c) Kontrollon në mënyrë periodike respektimin e proceseve teknologjike në të gjitha fazat e prodhit dhe që kanë lidhje me kualitetin e prodhimit.

ç) Kontrollon, në rast nevoje, kualitetin e amballazhit saktësinë e tarave si dhe respektimin e konditave teknike për ruajtjen e lëndëve të para, lëndëve ndihmëse e prodhimeve të gatëshme në magazina.

d) Nuk jep leje për t'u marrë në dorëzim lëndë të para ose lëndë ndihmëse ose për t'u shpërndarë prodhime të gatëshme të cilat nuk i përgjigjen standardeve shtetërore ose kushteve teknike. Kryetari i zyrës kontrollit ka të drejtë të kërkojë nga kryeingjineri i ndërmarrjes dokumenta përkatëse dhe duhet të informohet mbi të gjitha ndryshimet e bëra ose të propozuara të kushteve teknike ose të proçesit tekgollogjik,

dh) Nënshkruan të gjitha pasapartat ose dokumentat e tjera që shoqërojnë sasitë e prodhimit që shpërndan ndërmarrja. Pa vertetimin ose vulën e zyrës së kontrollit teknik asnjë prodhim nuk mund të vihet në shitje nga ndërmarrja.

e) Jep udhëzime klasifikuesit, aballazhuesit, pakëtuesit dhe etiktuesit të ndërmarrjes, përsa i përket kualitetit të punës së tyre dhe këta përgjigjen përpara zyrës teknike për këtë punë.

ë) Udhëzon dhe organizon punën në lidhje me mbajten e evidencës së prodhimeve simbas kualiteteve, të skartove dhe të prodhimeve me të meta. Llogaritja e prodhimeve simbos kualiteteve dhe e skartove bëhet nga personeli i llogarise. Dokumentat për prodhimet me të meta e skarto nënshkruhen nga kryetari i zyrës kontrollit teknik ose vartësit e tij.

f) Krijon avidencën në lidhje me kualitetin, të metat, skartot e reklamimet e lëndëve të para gjysmë fabrikatave dhe nënshkruan proçes-verbalet përkatëse. Kryetari i zyrës së kontrollit teknik është i detyruar të studjojë të gjitha reklamimet e bëra nga konsumatorët për prodhimet e ndërmarrjes. Ai duhet të informohet mbi të gjitha reklamimet për kualitetin e prodhimeve.

g) Studjon dhe përpunon ankesat në lidhje me reklamimet e arbitrazhit për sa i përket kualitetit dhe ajo përfaqëson ndërmarrjet në të gjitha konfliktet përsa i përket kualitetit.

Approved For Release 2009/06/15 : CIA-RDP83-00418R001100040009-2

Approved For Release 2009/06/15 : CIA-RDP83-00418R001100040009-2

gj) Është përgjegjëse për prodhimet që dalin nga ndërmërrja ose për lëndët e para e ndihmëse që hyjnë në prodhim dhe që nuk i përgjigjen karakteristikave të standardeve shtetërore dhe kushteve teknike.

h) I dërgon simbas udhëzimeve të dhëna, Drejtorisë së prodhimit në Ministri, raport mbi kualitetin e prodhimeve.

i) Për të dhënë gjykimin mbi kualitetin e prodhimit shfrytëzon të dhënat e laboratorëve të ndërmarrjes, përgjegjësitë e të cilave përgjigjen për saktësinë e përfundimeve të analizave.

j) Ka të drejtë të hyjë në çdo repart dhe të marë mostra nga çdo lloj prodhimi që ajo mendon dhe është përgjegjëse për nxjerrjen e mostrave e ruajtjen e tyre,

k) Ka të drejtë të ndalojë marrjen në dorëzim të lendëve të para ose shpërndarjen e prodhimeve të gatëshme kur këto nuk i përgjigjen standardeve ose kushteve teknike. Ka të drejtë të ndalojë punën në çdo fazë të prodhimit kur ky del në kundërshtim me standardet e kushtetet teknike. Ky vendim mund të anullohet me shkrim vetëm nga drejtori i ndërmarrjes. Kur drejtori i ndërmarrjes anullon vendimin e zyrës së kontrollit teknik kryetari i zyrës është i detyruar të lajmërojë menjiherë drejtorinë përkatëse teknike të Ministrisë dhe drejtorisë teknike të Ministrisë.

l) Është e detyruar ti zbatojë duke mos pasur të drejtë t'i ndryshojë, t'i prishij ose t'i shtojë standardet shtetërore e kushtet teknike, metodikën e analizave si dhe të gjitha rregullat e tjera që janë aprovuar. Ajo ka të drejtë të propozojë ndryshime në këtë drejtim.

ll) Merr pjesë në përpunimin e propozimeve të kushteve teknike e projekt-standardeve dhe jep mendimin për ato që janë përpunuar. Zyra e kontrollit teknik bashkëpunon në përpilimin e proçesit teknollogjik.

m) Bën sistematikisht analizën e shkaqeve të skartove dhe prodhimeve me kualitet jo të mirë dhe i jep raport, simbas dispozitave të caktuara, drejtorit të ndërmarrjes. Së bashku me udhëheqjen e ndermarrjes merr pjesë në përpunimin e masave për të luftuar dhe evituar prodhimet skarto.

n) Merr pjesë në përpunimin e masave për përmirësimin e kualitetit, zgjerimin e asortimenteve si dhe në përpunimin e rregullave mbi mënyrën e marrjes në dorëzim të mallrave.

o) Ka detyrë të ndihmojë aktivisht me të gjitha mjetet për përmirësimin e mëtejshëm të kualitetit të prodhimit dhe lajmëron përgjegjësat e reparteve dhe punonjësit e prodhimit mbi kualitetin e prodhimeve të tyre.

5. – Kryetari i zyrës kontrollit teknik nuk ka të drejtë të marë masa administrative kundrejt personave fajtor për prodhim skarto. Këto masa merren nga drejtoria si dhe drejtuesit e prodhimit. Këta në marrjen e këtyre masave duhet të përdorin materialet dhe shënimet e zyrës së kontrollit teknik.

6. – Nga kryetari i zyrës kontrollit teknik të ndërmarrjes varen kontrollorët teknikë në ndërmarrje dhe këtij i japin llogari.

7. — Personeli i zyrës së kontrollit teknik (kryetari i zyrës, kontrollorët etj.) nuk merren me punë të tjera.

8. — Në ato ndërmarrje ku nuk ka zyra të kontrollit teknik dhe ku kontrolli i prodhimit bëhet në laborator detyrat e zyrës së kontrollit teknik i ngarkohen laboratorit të ndërmarrjes.

ZËV. KRYETAR' I KËSHILLIT MINISTRAVE R.P.SH.

HYSNI KAPO

Approved For Release 2009/06/15 : CIA-RDP83-00418R001100040009-2

Approved For Release 2009/06/15 : CIA-RDP83-00418R001100040009-2

RREGULLORE

E

INSPEKTORIATIT SHTETËROR TE TREGËTISË DHE KUALITETIT

I. ORGANIZIMI I INSPEKTORIATIT SHTETËROR TË TREGËTISË DHE KUALITETIT.

1) Inspektoriati Shtetëror i Tregëtisè dhe kualitetit krijohet pranë Ministris së Tregëtisë.

2) Inspektoriati Shtetëror i Tregëtisë dhe kualitetit drejtohet nga Kryeinspektori.

3) Inspektorët shtetëror të tregëtisë dhe kualitetit emërohen nga Ministri i Tregëtisë.

II. TË DREJTAT DHE DETYRAT E INSPEKTORIATIT SHTETEROR TE TREGTISË DHE KUALITETIT.

4) Inspektoriati Shtetëror i Tregtisë dhe kualitetit ushtron kontroll pranë gjithë ndërmarrjeve dhe organizatave tregtare shtetërore dhe kooperativiste të çdo sistemi për zbatimin e legjislacionit të tregëtisë, dhe posaçërisht në lidhje me:

a) Respektimin e çmimeve me pakicë dhe të marzheve tregtare;

b) dhënien e mallrave konsumatorëve në masë të plotë, peshë netto dhe llogari të sakte;

c) verifikimin e gjëndjes së veglave matëse dhe të peshimit në lidhje me funksionimin e tyre të rregullt;

ç) zbatimin e gjithë rregullave të tregtisë;

q) shqyrtimin e lutjeve të paraqitura nga blerësit për çrregullime dhe shpërdorimin e rjetit tregëtar;

e) kontrrollimin e rjetit të tregtisë së vogël private në lidhje me zbatimin e rregullavet të tregtisë;

ë) kontrollimin sistematik mbi ndërmarrjet e tregëtisë me shumicë, dhe pakicë, në mënyrë që ato të mos pranojnë mallra të kualitetit të keq dhe në kundërshtim me standardet ose konditat teknike.

5) Veç ç'ka tregohet në pikën e më sipërme inspektoriati shtetëror i tregëtisë dhe kualitetit ka edhe këto të drejta dhe detyra:

a) të vërë përpara përgjegjësisë penale personat përgjegjës të organizatave tregtare e kooperativiste që lejojnë marrjen ne dorëzim dhe hedhjen në treg të mallrave jashtë standardeve shtetërore ose konditave teknike t'aprovuara ose që shkelin regullat e tregëtisë;

b) të bllokojë menjëherë, pranë bazave grosiste ose tregëtisë me pakicë mallrat e prodhuara jashtë standardit ose jashtë konditave teknike duke i njoftuar njikohësisht Prokurorisë përgjegjësin e kësaj mungese, dhe Ministrisë Tregëtisë sasinë e mallit të bllokuar dhe masat që duhet të merren për vënien e tij në shitje;

c) të verë në lëvizje dhe t'aktivizojë zyrat e ekspertizës që do të ngrihen në çdo qark, nën drejtimin e seksioneve të tregëtisë;

ç) të kërkojë nga organet kompetente heqjen nga përgjegjësia e personave që kanë lejuar shkeljen e rregullave të tregtisë ose kur është rasti të kërkoië marrien e masave disiplinore kundrejt tyre;

d) të dërgojë për analizë ose eksertizë me shpenzimet e ndërmarrjeve

Approved For Release 2009/06/15 : CIA-RDP83-00418R001100040009-2

Approved For Release 2009/06/15 : CIA-RDP83-00418R001100040009-2

ose të organizatave të interesuara, mallrat që dyshon se janë prodhuar në kundërshtim me standardet shtetërore ose kushtet teknike;

dh) të bëjë inventarizime të mallrave dhe të giëndjes s'arkës në ato njësi tregëtare ku janë zbuluar mashtrime të blerësave ose dyshohet për një gjë të tillë;

e) të japë udhëzime të detyruarshme për ndërmarrjet dhe organizatat tregëtare, dhe tregëtarët e vëgjël privat në lidhje me masat që duhet të merren n'afate të caktuara për t'evituar shkeljet e konstatuara të rregullave të tregëtis:

ë) të gjobisë me gjobë gjer me 500 lekë për shkeljet sipas procedurës që parashikohen në dekretin mbi kundravajtjet në tregëti Nr. 1435 datë 12 qershor 1952.

6) Inspektoriati shtetëror i tregëtisë dhe i kualitetit, ka të drejte të kontrollojë kualitetin e mallrave të gatëshme të konsumit të gjerë pranë ndërmarrjeve dhe organizatave prodhonjëse dhe kur konstaton se mallrat janë prodhuar në kundërshtim me standardet ose kushtet teknike të shtrojë çështjen pranë organeve drejtonjëse pro dhonjëse duke vënë në dijeni menjiherë kur është rasti organet e prokurorisë dhe Ministrinë e Tregëtisë.

7) Ndërmarrjet dhe organizatat tregëtare dhe të prodhimit detyrohen t'i paraqesin inspektoriatit shtetëror të tregëtisë dhe kualitetit në bazë të kërkesës së tij, dokumentat dhe sqarimet e nevojshme që kanë lidhje me kontrollet që bëhen nga punonjësit e inspektoriatit.

8) Punonjësit e inspektoriatit shtetëror të tregëtisë dhe kualitetit që kanë konstatuar shpërdorime por nuk kanë marrë masa ligjore ose kanë shkelur ose ometuar detyrat e tyre kanë sipas rastit përgjegjësi disiplinore ose penale.

ZËV/KRYETAR'I KËSHILLIT TE MINISTRAVE TE R.P.SH.
HYSNI KAPO

RREGULLORE
E
ZYRES S'EKSPERTIZËS SE MALLRAVE PRANË KOMITETEVE EKZEKUTIVE TE K.P. TË QARQEVE

I- DISPOZITA TE PËRGJITHËSHME:

1) Zyra e ekspestizës së mallrave krijohet pranë Seksioneve të Tregtis të komiteteve ekzekutive të K.P. të Qarqeve.

2) Zyra e ekspertizës së mallrave në bazë të kërkesave që paraqiten bën ekspertizën e mallrave në lidhje me kualitetin e artikujve të konsumit të gjërë, ushqimore dhe jo ushqimore e t'amballazhit të ndërmarrjes dhe organizatave tregëtare.

3) Zyra bën ekspertiza në rastet që vijojnë:

a) Kur midis marrësit në dorëzim të mallrave dhe furnitorit ka mosmarrëveshje në lidhje me përcaktimin e kualitetit të mallrave.

b) Kur mallrat nuk i përgjigjen kualitetit dhe në vendin e marrjes në dorëzim nuk paraqitet ose mungon përfaqsuesi i furnitorit.

c) Kur mungon fatura ose specifikimi i furnitorit për mallrat që merren në dorëzim;

Approved For Release 2009/06/15 : CIA-RDP83-00418R001100040009-2

Approved For Release 2009/06/15 : CIA-RDP83-00418R001100040009-2

d) kur midis organizatës që posedon mallin dhe organizatës që merr mallin për ruajtje ose transportim ka mosmarveshje në lidhje me përcaktimin e kualitetit të këtij malli.

4) Zyra ekspertizës së mallrave studjon proçes-verbalet e ekspertizave, përpunon propozime për përmirsimin e kualitetit të mallrave dhe kur është e nevojshme, u shtron organeve përkatëse probleve në lidhje me ndryshimin e standardeve dhe kushteve teknike ekzistuese, që nuk u përgjigjen vendimeve t'organeve qeveritare, ndryshimeve të prodhimit ose kërkesave të konsumatorëve.

5) Zyra e ekspertizës së mallrave drejtohet nga shefi i saj dhe perbëhet nga 3–7 eksperta. Përveç ekspertit në organike, ekspertet e tjera jashtë organikës caktohen prej shefit të seksionit të tregëtisë së qarkut nga rradhët e merceologëve me të mirë të ndërmarrjeve dhe organizatave tregëtare. Antar' i zyrës s'ekspertizës është dhe i deleguari i Inspektoriatit sanitar.

Shefi i zyrës dhe eksperti n'organikë emërohen nga komiteti ekzekutiv i k.p. të qarkut.

Eksperteve të zyrës s' ekspertizës, si atyre n'organikë ashtu dhe atyre jashtë organikës bashkë me emerimin, u përcaktohet dhe lista e mallrave për të cilat seicili prej tyre lejohet t' ushtrojë ekspertiza.

6) Për ç'do ekspertizë që kryhet në bazë të kërkesave që paraqesin ndërmarrjet paguhet nga ndërmarrja 50 lekë për çdo ore punë të kryer.

T'ardhurat e kësaj natyre shkojnë në favor të ekspertit që ka kryer ekspertizen.

7) Zyra e ekspertizës së mallrave nuk ngarkohet me përgjegjësi materjale për humbjet që mund të shkaktohen nge konkluzionet e gabuara t'ekspertave. Kur vërtetohet raste humbjesh të tilla, eksperti vihet para përgjegjësis dhe njëkohësisht përjashtohet nga zyra e ekspertizës.

II. FUNKSIONET E ZYRES S' EKSPETIZËS SË MALLRAVE

8) Zyra e ekspertizës së mallrave në përputhje me detyrat që i janë ngarkuar, ka këto funksione:

a) Ben ekspertiza për përcaktimin e llojit, kualitetit, gjëndjes dhe qenies së plotë të mallrave dhe t'amballazhit.

b) Kontrollon në se mallrat u përgjigjen standardeve, kushteve teknike dhe modeleve t'aprovuara, që parashikohen nga kontratat e lidhura midis furnitorëve dhe blerësave.

c) Kontrollon saktësin e markave dhe a u përgjigjen këto kërkesave të standarteve, kushteve teknike dhe modeleve.

d) Përcakton vleftën e plotë të mallrave, caqet në të cilat duhet të arrijë vlefta për rastet e uljes së kualitetit të mallrave mbrenda kufive të parashikuara nga standardet shtetnore, kushtet teknike. kontratat etj., përcakton shkaqet që kanë bërë t'ulet vlefta e mallrave,

e) Merr pjesë në marrjen në dorëzim të mallrave nga ana numerike kur është e domosdoshme të përcaktohet gjëndja numerike e mallrave (thyerje ose dëmtime mallrash gjatë transportimit etj.) si dhe kur kontrollohet në se përmbajtja e mallrave t'amballazhuara nga fabrika korespondon në sasinë që shënohet n'etiketën e fabrikës.

9) Për ç'do ekspertize që kryhet hartohet proçes-verbal sipas formës së caktuar. Proçes-verbalet aprovohen nga shefi i zyrës dhe brenda 24 orëve

Approved For Release 2009/06/15 : CIA-RDP83-00418R001100040009-2

Approved For Release 2009/06/15 : CIA-RDP83-00418R001100040009-2

mbas përfundimit t' ekspertizës i dërgohen organizatës ku është bërë ekspertiza

10) Për rastet që është e domosdoshme të bëhen ekspertiza komplekse zyra organizon komision ekspertash në të cilin marrin pjesë specialiste ose teknike të Kualifikuar,

11) Kur zbulohet që ndërmarrjet prodhonjëse prodhojnë mallra të kualitetit të dobët, në kundërshtim me standardet, kushtet teknike ose modelet e aprovuara ose mallra jo të plota, zyra e ekspertizës së mallrave i a përcjellë çështjen prokurorisë për venien para përgjegjësis të shkaktarëve, njofton prokurorin e përgjithëshme për ato raste dhe i përcjellë Ministris së Tregëtis kopjen e materjaleve të dërguara organeve të prokuroris.

12) Zyra e ekspertizës së mallrave kur kanstaton se prodhohen mallra të kualitetit të dobët, kur shkelen standardet dhe kushtet teknike ose përdoren amballazhime jo të rregullta, njofton për të gjitha këto raste edhe organet qëndrore të ndërmarrjeve prodhuese.

13) Kur mallrat që ndodhen ndër depot e ndërmarrjeve tregëtare mumbasin gjatë ruajtjes së tyre pjesërisht vlefën, zyra e ekspertizës të hallrave ka të drejtë të vendosi zbritjen e tyre në kualitete me t'ulta.

ZËV/KRYETAR' I KESHILLIT TË MINISTRAVE TË R.P.SH.
HYSNI KAPO

LAJMËRIM PER NDRIM EMERASH

Me vendim Nr. 4 dt. 27-3-1954 të Ministris së Punëve të Mbrendëshme Pashko Dhimitri ndroi emërin në Panajot Dhimitri.

Me vendim Nr. 26 dt. 26-5-1954 të Ministrisë Punve të Mbrëndëshme Xhanushka Kamba ndroi emërin në Suzana Kamba.

Approved For Release 2009/06/15 : CIA-RDP83-00418R001100040009-2

Approved For Release 2009/06/15 : CIA-RDP83-00418R001100040009-2

GAZETA ZYRTARE

E REPUBLIKËS POPULLORE TË SHQIPËRISË

16 Mars | Nr. 3 | 1955

PËRMBAJTJA

Pjesa e I-rë

		Faqe
1) Dekret Nr. 2001 datë 7-III-955	– Mbi emetimin e huasë së katërt shtetrore për zhvillimin e ekonomisë dhe të kulturës së Republikës 'Popullore të Shqipërisë . . .	72
2) Dekret Nr. 2003 dt. 7-III-1955	– Mbi abrogimin e dekret-ligjës Nr 790 datë 17-li-1950 mbi ndalimin e dërgimit të pakove dhe të kolipostave nga ana e t'aratisurve jashtë shtetit dhe mbi konfiskimin e tyre dhe te germës «e» të nenit 2 të dekretit Nr. 1836 datë 22-III-1954 mbi konfiskimet . . .	72-73
3) Dekret Nr. 1997 dt. 21-II-1951	– Mbi disa ndryshime në dekretin Nr. 1944 datë 25-X-1954 mbi krijimin e titullit «Hero i Punës Socialiste»	73-73
4) Dekret Nr. 1996 dt. 21-II-1951	– Mbi betimin solemn të puntorëve dhe nëpunësave civile që shërbejnë në Ushtrinë Popullore dhe në Ministrinë e P. të Brendëshme	73-74

Pjesa e II të

5) Urdhresa e Qeverisë Nr. 5 datë 21-I-1955	– Mbi fondin e drejtorit në njësitë me hozrashot të brendëshëm	74-77
6) Urdhresë e Qeverisë Nr. 6 datë 12-I-1955	– Mbi fondin e drejtorit në nd/jet ekonomike shtetrore që administrohen në hozrashot të plote me rëndësi nacionale dhe lokale. .	77-80
7) Urdhresë e Qeverisë Nr. 7 datë 8-III-1955	– Mbi konditat dhe organizimin e emetimit të huas së katërt shtetrore për zhvillimin e ekonomisë dhe të kulturës së Republikës Popullore të Shqipërisë	80-82
8) Urdhresë e Qeverisë Nr. 8 datë 23-II-1955	– Mbi përdorimin e fitimit dhe krijimin e fondit të drejtorit dhe fondeve të tjera në ndermarrjet bujqësore me rëndësi nacionale . .	83-86
9) Vendim i Këshillit të Ministrave Nr, 53 datë 9-II-1955.	– Mbi shpërblimin suplementar të grupeve të peshkatarëve për tejkalimin e planit të peshkut	86-86
10) Vendim i Këshillit të Ministrave Nr. 61 datë 22-II-1955.	– Mbi çmimin e biljetave të transportit urban dhe interurban	87-87
11) Vendim i Këshillit të Ministrave Nr. 69 datë 23-II-1955	– Mbi dhënien e shpërblimeve ndërmarrjeve-bujqësore shtetrore nacionale për dorëzim mbi plane	87-88
12) Vendim i Këshillit të Ministrave Nr. 82 datë 19-II-1955.	– Mbi sigurimin e farnave të zgjedhura dhe riorganizimin e ndërmarjes së farnave . .	88-94
13) Rregullore Nr. 52 dt. 9-3-1955	– E Ministrisë Industrisë dhe Minierave . .	94-98

Approved For Release 2009/06/15 : CIA-RDP83-00418R001100040009-2

Approved For Release 2009/06/15 : CIA-RDP83-00418R001100040009-2

D E K R E T

mbi emetimin e huasë së katërt shtetërore për zhvillimin e ekonomisë dhe të kulturës së Republikës Popullore të Shqipërisë,

Në mbështetje të nenit 58, pika 6, të Kushtetutës së Republikës Popullore të Shqipërisë ;

Me propozimin e Qeverisë,

PRESIDIUMI I KUVENDIT POPULLOR

nxjerr këtë dekret ;

DEKRET MBI EMETIMIN E HUASË SË KATËRT SHTETËRORE PËR ZHVILLIMIN E EKONOMISË DHE TË KULTURËS SË REPUBLIKËS POPULLORE TË SHQIPËRISË

Neni 1.

Me qëllim që të sigurohen mjete të tjera financiare për të kontribuar në zhvillimin e mëtejshëm t' ekonomisë popullore, për rritjen e mirëqenies materiale dhe për ngritjen e nivelit kultural të masave punonjëse, si dhe për financimin e veprave të planit pesë-vjeçar, autorizohet Këshilli i Ministrave të emetojë, "HUAN E KATËRT SHTETËRORE„ për zhvillimin e ekonomisë dhe të kulturës së Republikës Popullore të Shqipërisë,

Huaja e katërt shtetërore të emetohet për nji shumë prej lekë 400 milion dhe me afat shlyerje për 20 vjet.

Neni 2.—

Konditat dhe organizimi i emetimit të huas së katërt shtetërore caktohet me urdhëresë të Qeverisë.

Neni 3.—

Obligacionet e huas së katërt shtetërore, t' ardhurat dhe fitimet nga kjo hua, përjashtohen nga çdo tatim e taksë,

Neni 4.—

Ky dekret hyn në fuqi me 15 mars 1955,
Tiranë, me 7 mars 1955
Nr i dekretit : 2001

PËR PRESIDIUMIN E KUVENDIT POPULLOR
TË REPUBLIKËS POPULLORE TË SHQIPËRISË

SEKRETARI Sami Baholli

ZËV. KRYETARI Pilo Peristeri

D E K R E T

Mbi abrogimin e dekret-ligjës Nr. 790 datë 17-2-1950 mbi ndalimin e e dërgimit të pakovet dhe të kolipostave nga ana e t' aratisurve jashtë Shtetit dhe mb konfiskimin e tyre dhe të germës «e» të nenit 2 të dekretit Nr. 1836 datë 22-3-1954 mbi konfiskimet.

Në mbështetje të nenit 58, pika 6, të Kushtetutës së Republikës Popullore të Shqipërisë :

Me propozimin e qeverisë;

PRESIDIUMI I KUVENDIT POPULLOR

nxjerr këtë dekret :

Approved For Release 2009/06/15 : CIA-RDP83-00418R001100040009-2

Approved For Release 2009/06/15 : CIA-RDP83-00418R001100040009-2

DEKRET MBI ABROGIMIN E DEKRET-LIGJES NR. 790 DATË 17-2-1950 MBI NDALIMIN E DËRGIMIT TË PAKOVE DHE TË KOLIPOSTAVE NGA ANA E T'ARATISURVE JASHTË SHTETIT DHE MBI KONFISKIMIN E TYRE DHE TË GERMËS «E» TË NENIT 2 TË DEKRETIT NR. 1836 DATË 22-3-1954 MBI KONFISKIMET

Neni 1.—

Dekret-ligje Nr. 790 datë 17-2-1950 mbi ndalimin e dërgimit të pakove dhe të kolipostave nga ana e t'aratisurve jashtë Shtetit dhe mbi konfiskimin e tyre, kthyer në ligjë me Nr. 799 datë 13-3 1950, si dhe germa e nenit 2 të dekretit Nr. 1836 datë 22 3-1954 mbi konfiskimet abrogohen.

Neni 2.—

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë.
Tiranë, me 7 mars 1955
Nr. i dekretit: 2003

PËR PRESIDIUMIN E KUVENDIT POPULLOR
TË REPUBLIKËS POPULLORE TË SHQIPËRISË
SEKRETARI — Sami Baholli
ZËV. KRYETARI — Pilo Peristeri

D E K R E T

mbi disa ndryshime në dekretin nr. 1944 datë 25-10-1954 mbi krijimin e titullit «Hero i Punës Socialiste».

Në mbështetje të nenit 58, pika 6, të Kushtetutës së Republikës Popullore të Shqipërisë;

PRESIDIUMI I KUVENDIT POPULLOR

nxjerr këtë dekret.

DEKRET MBI DISA NDRYSHIME NE DEKRETIN Nr. 1944 DATE 25-10-1954 MBI KRIJIMIN E TITULLIT «HERO I PUNËS SOCIALISTE»

Neni 1.—

Fjalia e dytë e paragrafit I-rë të nenit 4 të dekretit Nr 1944 datë 25 10-1954 mbi krijimin e titullit «Hero i Punës Socialiste» ndryshohet në këtë mënyrë: «Gjatësia e rezevet të yllit nga qendra është 15 m/m».

Fjalia e fundit e paragrafit II-të po të nenit 4 ndryshohet në këtë mënyrë: Medalja «Hero i Punës Socialiste» punohet prej bronxi i larë me ar.

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë
Tiranë, më 21-II-1955
Nr, i dekretit 1997

PËR PRESIDIUMIN E KUVENDIT POPULLOR
TË REPUBLIKËS POPULLORE TË SHQIPËRISË
SEKRETARI — Sami Baholli
ZËV. KRYETARI — Pilo Peristeri

D E K R E T

mbi betimin solemn të punëtorëve dhe nëpunsave civilë që shërbejnë në Ushtrinë Popullore dhe në Ministrinë e P. të Brendëshme

Approved For Release 2009/06/15 : CIA-RDP83-00418R001100040009-2

Approved For Release 2009/06/15 : CIA-RDP83-00418R001100040009-2

Në mbështetje të nenit 58, pika 6, të Kushtetutës së Republikës Popullore të Shqipërisë:

Me propozimin e Qeverisë,

PRESIDIUMI I KUVENDIT POPULLOR

nxjerr këtë dekret:

DEKRET MBI BETIMIN SOLEMN TE PUNETORËVE DHE NËPUNSAVE CIVILË QË SHËRBEJNË NË USHTRINË POPULLORE DHE NË MINISTRINË E P. BRËNDESHME

Neni 1.—

Që të rritet ndjenja e përgjegjësisë në kryerjen e detyrës, dhe në ruajtjen e sekretit ushtarak, punëtorët dhe nëpunësit civilë që hyjnë në shërbim në repartet dhe institutet e Ushtërisë Popullore dhe të Ministrisë së P. të Brendëshme detyrohen të bëjnë betimin solemn.

Neni 2.—

Formula e betimit solemn caktohet si vijon:

Unë, Shtetas i Republikës Popullore të Shcipërisë, duke hyrë në shërbim në repartet dhe institutet e Ushtrisë Popullore ose të Ministrisë së P. të Brendëshme, betohem se do të punoj me nder, do të jem i drejtë i disiplinuar dhe vigjilent, do të zbatoj me përpikësi ligjet e shtetit, urdhërat dhe udhëzimet e eprorëve të mij, do të ruaj sekretet ushtarake dhe shtetërore, materialin ushtarak dhe pasuritë shtetërore.

Betohem se do të jem besnik gjer në fund ndaj popullit, Partisë së Punës dhe Atdheut t' im.

Betohem se do të jem i pamëshirëshëm në luftën për zbulimin dhe demaskimin e armiqëve të popullit dhe të Atdheut, për mbrojtjen dhe forcimin e fitoreve të revolucionit popullor,

Në rast se shkel betimin t' im solem, le të bjerë mbi mua dënimi i rëndë i ligjeve të shtetit dhe le të meritojë urejtjen dhe mallkimin e popullit dhe të Atdheut.

Neni 3.—

Ministrija e Mbrojtjes Popullore dhe ajo e P. të Brendëshme autorizohen që të japin udhëzimet e nevojshme për zbatimin e këtij dekreti.

Neni 4.—

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë.

Tiranë, me 21-2-1955

Nr. i dekretit, 1996

PËR PRESIDIUMIN E KUVENDIT POPULLOR
TË REPUBLIKËS POPULLORE TË SHQIPËRISË

SEKRETARI — Sami Baholli

ZËV. KRYETARI — Pilo Peristeri

URDHËRESË E QEVERISË
Nr. 5 dat. 21-I-1955

Këshilli i Ministrave i Republikës Popullore të Shqipërisë, me qëllim që të forcohet inisiativa dhe përgjegjësia e drejtorëve të njësive në hozrashot të brendëshëm në lidhje me realizimin e planit dhe uljen e kostos, në bazë të nenit 62 të dekret-ligjës Nr. 418 datë 22-III-1947 mbi ndërmarrjet ekonomike shtetërore, në mbledhjen e datës 2-I-1955 nxjerr këtë,

Approved For Release 2009/06/15 : CIA-RDP83-00418R001100040009-2

Approved For Release 2009/06/15 : CIA-RDP83-00418R001100040009-2

URDHËRESË:

MBI

FONDIN E DREJTORIT NE NJESITË ME HOZRASHOT TE BRENDËSHËM

Neni 1.—

Fondi i drejtorit në njësitë në hozrashot të brendëshëm krijohet dhe rregullohet simbas dispozitave të kësaj urdhërese.

Neni 2.—

Si burime për formimin e fondit të drejtorit janë fitimi i planifikuar dhe jashtë planit dhe për njësitë me hozrashot të brendëshëm që punojnë me humbje të planifikuar ose që nuk kanë fitime, kursimi që rrjedh nga ulja e kostos.

Neni 3.—

Fondi i drejtorit krijohet në të gjitha njësitë e organizuara me hozrashot të brendëshëm me bilanç të veçantë ose pa bilanç të veçantë, të ndërmarrjeve ekonomike shtetërore me rëndësi nacionale dhe lokale simbas sektorit përkatës, kur njesia me hozrashot të brendëshëm plotëson ose tejkalon:

I) *Sektori i industrisë dhe minerave*:

a) planin e prodhimit në sasi e asortiment, planin e kërkimeve, thellimeve të çpimeve në sasi e asortiment:

b) detyrën e uljes së kostos.

II) *Sektori i tregëtisë*:

a) Planin e xhiros së mallrave:

b) detyrën e uljes së shpenzimeve të shit–blerjes (qarkullimit) në raport me xhiron.

III) *Sektori i ndërtimit* :

a) planin e ndërtimit si volum pune në total:

b) realizimin e planit të kostos në ndërtime pa kaluar koston e preventivuar të shpenzimeve direkte.

IV) *Sektori i komunikacioneve* :

a) planin e punës në T/km, ose T/mil dhe planin e punës në km/pasagjer ose mil pasagjer.

b) detyrën e uljes së kostos,

V) *Sektori i grumbullimit të bimëve medicinale*:

a) planin e grumbullimit në total si vlefte e shprehur me çmimin e blerjes.

b) planin e uljes të shpenzimeve të shit-blerjes në raport me xhiroshitjen të shprehur me çmim blerje.

VI) *Sektori i sherbimeve të ndryshme (komunale ngarkim çkarkim).*

a) planin e sherbimeve,

b) detyrën e uljes së kostos (shpenzimevet) për shërbimet që kryhen dhe,

c) repartet e ngarkim-çkarkimit të porteve të realizojnë vetëm të ar dhurat e planifikuara të repartit,

Neni 4.—

Llogaritja e fondit të drejtorit për shpërblime bëhet mbi fitimin e planifikuar, mbi kursimin që lind nga planifikimi i uljes së kostos, mbi tejkalimin e fitimive dhe mbi kursimet e arrijtura nga ulja e kostos përtej detyrës së caktuar si vijon.

Approved For Release 2009/06/15 : CIA-RDP83-00418R001100040009-2

Approved For Release 2009/06/15 : CIA-RDP83-00418R001100040009-2

1. Mbi fitimin e planifikuar dhe mbi kursimin e planifikuar nga ulja e kostos:

a) 6% për degën e prodhimit të naftës, përpunimit të naftës, çpimit në naftë, bitumit, linjitit, kromit, bakërit, për kërkimet e çpimet e ndryshme, degën e ndërtimeve bonifikimeve, material ndërtimi, lëkurë dhe gomave:

b) 4% për degën e prodhimit të këpucëve, ofiçinave, prodhimeve metalike dhe elektrike, tekstileve, transport hekurudhor, detar, automobilistik dhe ngarkim shkarkimi.

c) 2% për sektorin e grumbullimit të bimeve medicinale:

ç) 2% për degën e prodhimeve ushqimore, miell-oriz, kimike, farmaceutike, sportive dhe për sektorët e industrisë lokale:

d) 0,6% për sektorin e tregëtisë nacionale e lokale dhe për sektorin e ndërmarrjeve komunale dhe furnizimin e punëtorëve.

2. Mbi tejkalimin e planit të fitimit ose uljes së mëtejshme të kostos së prodhimit ose shpenzimeve të qarkullimit nga ato të planifikuara:

a) 35% për degët e përmendura në germat a,b, numur 1 të këtij neni;

b) 25% për degët e përmendura në germat c, dhe ç numur 1 të këtij neni;

c) 20% për degët e përmëndura në germën d numur 1 të këtij neni.

Neni 5.—

Shuma e përgjithëshme vjetore e fondit të drejtorit në njësitë me hozrashot të brendëshëm e krijuar nga fitimi i planifikuar nga tejkalimi i këtij fitimi si dhe nga kursimi i arritur nga ulja e kostos nuk duhet të kalojë 3% të fondit të pagave vjetore të planifikuara të punëtorëve ose ingjinero-teknikëve të njësisë me hozrashot të brëndëshëm në raport me përqindjen e realizimit të planit të prodhimit.

Neni 6.—

Drejtorët e njësive me hozrashot të brëndëshëm, drejtorët e ndërmarrjeve dhe organet eprore kompetentë për efekt të llogaritjes së «Fondit të Drejtorit» në njësitë me hozrashot të brendëshëm detyrohen që në caktimin e volumit të fitimit dhe të kursimit që arrihen nga ulja e kostos, të marrim parasysh ndryshimet që mund të jenë vërtetuar nga faktorë të jashtëm.

Neni 7.—

Gjatë vitit drejtorët e ndërmarrjeve lejohen të kalojnë në fondin e drejtorit në njësit me hozrashot të brëndëshëm në mbarim të çdo 3/mujori në bazë të bilançeve përkatëse 50% të shumave që llogariten si fond drejtori në konformitet me nenet 4,5 dhe 6 të kësaj urdhërese. Për 3/ mujorin e dytë llogaritjet bëhen duke marrë parasysh realizimin e planit të fitimit për krejt 6/ mujorin dhe për 3/ mujorin e tretë llogaritjet bëhen mbi krejt 9 mujorin.

Neni 8.

Kur në fund të vitit del se njësia në hozrashot të brendëshëm nuk e gëzon fondin e drejtorit të njësisë, avancet e përdorura gjatë vitit për llogari të fondit të drejtorit të njësisë, kalojnë në rezultatin ekonomik të vitit të mbyllur pa u konsideruar si avancë në ngarkim të vitit ardhëshëm.

Neni. 9.—

Njësia me hozrashot të brëndëshëm në rast se ka plotësuar konditat

Approved For Release 2009/06/15 : CIA-RDP83-00418R001100040009-2

Approved For Release 2009/06/15 : CIA-RDP83-00418R001100040009-2

që parashikohen në nenin 3 i kësaj urdhërese ka të drejtë të krijojë «fondin e drejtorit» pamvarësisht në se ndërmarrja si tërësi nuk plotëson konditat për krijimin e fondit të drejtorit për ndërmarrjen. Kur ndërmarrja në tërësi dhe njësia në hozrashot të brendëshëm në veçansi i kanë plotësuar konditat për krijimin e fondit të drejtorit dhe të drejtorit të njesisë, pjesa që takon fondit të drejtorit të ndërmarrjes nuk mund të jetë më e vogël se 30°/₀ e «fondit të dtejtorit të njësisë» që u takon të gjitha njësive me hozrashot të brendëshëm që bëjnë pjesë në atë ndërmarrje.

Neni 10.—

Drejtorëve të ndërmarrjeve dhe drejtorëve të njësive me hozrashot të brendëshëm u jepet e drejta të bëjnë shpenzime nga fondi i drejtorit të njësisë me hozrashot të brendëshëm, në marëveshje me komitetin profesional të ndërmarrjes, për dhënie shpërblimesh individuale, për blerje biletash për shtëpitë e pushimit, për dhënië ndihme të menjëherëshme si dhe në raste të veçanta për argëtime kolektive të punëtorëve, ingjinero teknikëve dhe nëpunsave të njësisë me hozrashot të brendëshëm.

Neni 11.—

Tërheqjet ose shpenzimet nga fondi i drejtorit të njësisë me hozrashot të brendëshëm mund të kryhen vetëm mbrenda kufijve të shumave disponibël. Ndalohet tërheqja ose shpenzimi në llogari të shumave që parashikohet të kalojnë në fondin e drejtorit të njesisë.

Neni 12.—

Ministrija e financave ngarkohet të lëshojë udhëzime mbi organizimin administrativ dhe financiar kontabël të njësive me hozrashot të brendëshëm.

Ministritë përkatëse në bashkëpunim me Ministrin e Financave autorizohen të lëshojnë udhëzime të hollësishme për zbatimin e kësaj urdhërese

Neni 13

Kjo urdhëresë hyn në fuqi me njëherë.

ZËV. KRYETAR' I KËSHILLIT MINISTRAVE TË R.P.SH.

HYSNI KAPO

URDHËRESE E QEVERISË

Nr 6. dat 12-I-55

Këshilli i Ministrave të Republikës Popullore të Shqipërisë, me qëllim që të forcohet inisiativa dhe përgjithësia e drejtorëve të ndërmarrjeve në lidhje me realizimin e planit dhe uljen e kostos, në bazë të nenit 62 të dekret-ligjës Nr. 418 datë 22-III-1947 mbi ndërmarrjet ekonomike shtetërore, në mbledhjen e datës 12-I-1955 nxjerr këtë,

URDHËRESË

MBI

»FONDIN E DREJTORIT» NË NDËRMARJET EKONOMIKE SHTETERORE QE ADMINISTROHEN ME HOZRASHOT TE PLOTË ME RËNDËSI NACIONALE DHE LOKALE

Neni 1.—

Fondi i drejtorit në ndërmarrjet ekonomike shtetërore rregullohet simbas dispozitave të kësaj urdhërese.

Neni 2.—

Burimet për formimin e fondit të drejtorit janë, fitimi i planifikuar dhe jashtë planit dhe për ndërmarrjet që punojnë me humbje të planifikuar ose që nuk kanë fitime, kursimi që rrjedh nga ulja e kostos.

Approved For Release 2009/06/15 : CIA-RDP83-00418R001100040009-2

Approved For Release 2009/06/15 : CIA-RDP83-00418R001100040009-2

Neni :3.—

Fondi i drejtorit krijohet në të gjitha ndërmarrjet ekonomike shtetërore me rëndësi nacionale dhe lokale që administrohen në hozrashot të plotë dhe që kanë bilanc independent, kur këto plotësojnë ose tejkalojnë :

I *Ndërmarrjet me karakter industrial e mineral dhe lëndë djegëse.*

a) planin e prodhimit në sasi e asortimente të caktuara në planin e shtetit, planin e kërkimeve, thellimeve e çpimeve në sasi e asortiment:

b) planin e uljes së kostos në fabrikë në total në raport me prodhimet e nxjera :

c) realizimin e planit të fitimit në total.

II. *Nërmarrjet e ndërtimit dhe të bonifikimeve*

a) planin e ndërtimit ose bonifikimeve në total si volum pune.

b) planin e uljes së kostos së ndërtimeve e bonifikimeve në total. për ndërtimet e kryera;

c) realizimin e planit të fitimit në total,

III. *Ndërmarrjet automobilistike, hekurudhore*

a) planin e sherbimit si asortiment në t/km. për mallrat dhe km/ për pasagjerët :

b) planin e uljes së kostos në total në raport me shërbimet e kryera:

c) planin e fitimit në total.

IV. *Drejtoria e portit.*

a) të ardhurat e pianifikuara për ndërmarrjen,

b) planin e uljes së kostos në total:

c) planin e fitimit në total.

V. *Ndërmarrjet tregëtare të ushqimit social, furnizimit të punëtorëve dhe ndërmarrja e farnave*

a) Planin e xhiros (të shitjes) të mallrave dhe të ushqimit social në total (xhirua e mallrave të vlerësuara në tregun e garantuar):

b) planin e uljes së shpenzimeve të shit-blerjes në raport me xhiron:

c) planin e fitimit në total,

VI. *Ndërmarrjet e grumbullimit të çdo natyre.*

a) planin e grumbullimit në total si vleftë e shprehur me çmim blerje dhe për artikuj drithë, tagji, mish, lëkurë, si sasi;

b) planin e uljes së shpenzimeve të shit-blerjes, në raport me xhiro shitjen të shprehur me çmim blerje,

c) planin e fitimit në total.

VII. *Ndërmarrjet lokale të shërbimit komunal.*

a) planin e të ardhurave nga shërbimet që kryejnë në total;

b) planin e fitimit në total nga aktiviteti i sherbimeve.

Neni 4.—

Llogaritja e «Fondit të Drejtorit» bëhet mbi fitimin e planifikuar, mbi kursimin që lind nga planifikimi i uljes së kostos, mbi tejkalimin e fitimit dhe mbi kursimet e arrijtura nga ulja e kostos përtej detyrës së caktuar si vijon:

1) Mbi fitimin e planifikuar dhe mbi kursimin e planifikuar nga ulja e kostos :

a) 10o/o për degët: e prodhimit të naftës, përpunimit të naftës, çpimit në naftë, linjitit, kromit, bitumit, bakërit, sharrat dhe kombinatit të drurit;

b) 8o/o për degët; e ndërtimeve dhe bonifikimeve, çimenton, zdruktarinë, tullat, lëkurat dhe gomat;

c) 6o/o për degët: e prodhimit të këpucëve, tekstilit transportit auto-

Approved For Release 2009/06/15 : CIA-RDP83-00418R001100040009-2

Approved For Release 2009/06/15 : CIA-RDP83-00418R001100040009-2

mobilistik, hekurudhor, Portin Durrës, Shtypshkronjat, lëndë djegëse; elektrike, ofiçinat dhe uzinat mekanike :

d) 5% për ndërmarrjet e grumbullimit :

e) 4% për degët : e prodhimit të industrisë ushqimore. duhanit, fabrikat e mjell-orizit, degën kimike. ndërmarrja industriale e prodhimit farmaucetik, ndërmarrjet industriale me karakter lokal dhe N.I.SH artikujve sportive ;

f) 1o/o për sektorin e tregëtisë dhe të ushqimit social nacional e lokal, për ndërmarrjet e furnizimit të puntorëve, për ndërmarrjet e farnave dhe për sektorin e ndërmarrjeve të shërbimit komunal.

2) Mbi tejkalimin e fitimit ose uljen e mëtejshme të kostos ose shpenzimeve të qarkullimit nga ato të planifikuara :

a) 50o/o për degët e përmendura në germën a numur 1 të këtij neni :

b) 40o/o për degët e përmendura në germat b,c,d, dhe numur 1 të këtij neni :

c) 30o/o për degët e përmëndura në germën f numur 1 të këtij neni.

Neni 5.

Drejtorët e ndërmarrjeve ekonomike shtetërore dhe organet epro re kompetente për efekt të llogaritjes së «fondit të drejtorit» detyrohen që në caktimin e volumit të fitimit dhe të kursimit që arihen nga ulja e kostos, të marin parasysh ndryshimet që mund të jenë vërtetuar nga faktorë të jashtëm të cilat do të përcaktohen nga Ministria e Financavet, në bashkëpunim me ministritë përkatëse.

Neni 6.—

Gjatë vitit drejtorët e ndërmarrjeve ekonomike shtetërore lejohen të kalojnë në «fondin e drejtorit», në mbarim të çdo 3/ mujori, në bazë të bilanceve tremujore, 50o/o të shumave për llogaritjen si fond drejtori, në konformitet me nenet 4 dhe 5 të kësaj urdhërese. Për tremujorin e II-të llogaritjet bëhen duke marë parasysh realizimin e planit të f,timit për krejt 6 mujorin dhe për 3 mujorin e III-të llogaritjet bëhen mbi krejt 9 mujorin. Shuma përfundimtare që kalon në fondin e drejtorit në bazë të bilancit vjetor mbas aprovimt të këtij bilanci.

Neni 7.—

Kur në fund të vitit, nga analiza e rendikonteve del se ndërmarrja nuk e gëzon fondin e drejtorit avancet e përdorura gjatë vitit për llogari të fondit të drejtorit, kalojnë në rezultatin ekonomik të vitit të mbyllur pa u konsideruar si avancë në ngarkim të vitit ardhëshëm.

Neni 8.—

Drejtorëve të ndërmarrjeve ekonomike shtetërore me rëndësi nacjonale dhe lokale u jepet e drejta të shpenzojnë nga fondi i drejtorit për qëllimet e poshtëshënuara :

a) ju më pak se 40o/o të fondit të drejtorit për investime që kanë për qëllim zgjerimin e prodhimit të çdo kategorije (prodhimit në industri, xhiro tregëti etj.) dhe për ndërtimin e meremetimin e banesave, çerdheve, kopshteve për fëmijë, menca. klubeve të ndërmarrjeve jashtë planit të investimeve ;

b) për përmirësimin e konditave të jetës dhe të konditave kulturale të ndërmarrjeve, për zgjerimin dhe paisjen me inventarin përkatës, të kopshteve dhe çerdheve për fëmijët, të shtëpive të pushimit, mencave, klubeve ahe për masa fiskulturale;

c) Për dhënie shpërblimesh individuale puntorëve, ingjinero-teknikëve dhe nëpunësave të ndërmarrjes. Për blerjen e biletave për shtëpitë e pu-

Approved For Release 2009/06/15 : CIA-RDP83-00418R001100040009-2

Approved For Release 2009/06/15 : CIA-RDP83-00418R001100040009-2

shimit dhe për ohënie ndihmë të menjëhershme puntorëve dne nëpunsave ingjinero-teknikëve.

Shpërblimet që shënohen në pikën c) nuk mund të jenë gjatë vitit për puntorët më shumë se 5°/o të fondit të pagave vjetore të planifikuar të puntorëve të prodhimit industrial (tregëtisë, etj,) dhe për ingjinero-teknikët dhe nëpunësit më shumë se 2°/o të fondit të pagave vjetore të planifikuar të ingjinero-teknikëve dhe nëpunsave.

Përdorimi i fondit të drejtorit bëhet në bazë të një preventivi të aprovuar nga drejtori i ndërmarrjes në marëveshje me komitetin profesional.

Neni 9

Tërheqjet ose shpenzimet nga fondi i drejtorit mund të kryhen vetëm mbrënda kufijve të shumave disponibël. Ndalohet tërheqja ose shpenzimi në llogari të shumave që parashikohet të kalojnë në «fondin e drejtorit».

Neni 10.—

Ministritë përkatëse në bashkëpunim me Ministrinë e Financavet kanë të drejtë të japin aprovimin për krijimin e fondit të drejtorit kur një nga asortimentet e prodhimit të rëndësisë së dytë nuk është realizuar për arësye objektive me konditë që plani të jetë realizuar si total si dhe në asortimentet kryesore.

Neni 11

Për kategoritë e ndërmarrjeve që nuk përfshihen në nenet 3 dhe 4 të kësaj urdhëresë autorizohen ministritë përkatëse në bashkëpunim me Ministrinë e Financavet dhe Këshillin Qëndror të Bashkimeve Profesionale të Shqipërisë të caktojnë konditat e krijimit të fondit të drejtorit dhe të llogaritjes së fondit të drejtorit, brënda përqindjeve maksimale e minimale që shënohen në nenin 4 të kësaj urdhëresë,

Neni 12

Ministritë përkatëse në bashkëpunim me Ministrinë e Financavet të lëshojnë udhëzime të hollësishme për zbatimin e kësaj urdhëresë.

Neni 13

Urdhëresat Nr. 30 datë 10-8-1949, Nr. 44 datë 10-9-1949, Nr. 45 datë 10-9-1949, Nr. 5 datë 4-2-1950, Nr. 18 datë 29-V-1951, Nr. 32 datë 27-12-1952 dhe Nr. 17 datë 2-8-1955 mbi krijimin e fondit të drejtorit si dhe çdo dispozitë tjetër që vjen në kundërshtim me këtë urdhëresë mbeten pa fuqi.

Neni 14.—

Kjo urdhëresë hyn në fuqi menjëherë.

ZËV. KRYETAR' I KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË R. P. SH.
HYSNI KAPO

URDHËRESË E QEVERISË
Nr. 7 dt. 8-3-1953
MBI
KONDITAT DHE ORGANIZIMIN E EMETIMIT TË HUASË KATËRT SHTETËRORE PËR ZHVILLIMIN E EKONOMISË DHE TË KULTURËS SË REPUBLIKËS POPULLORE TË SHQIPËRISË

Neni 1

Pjesmarrja e masave punonjëse në nënështkrimin e huasë katërt Shtetërore është fakultative.

Neni 2

Huaja e katërt Shtetërore për zhvillimin e ekonomisë dhe të kulturës së Republikës Popullore të Shqipërisë emëtohet për nji shumë, prej lekë

Approved For Release 2009/06/15 : CIA-RDP83-00418R001100040009-2

Approved For Release 2009/06/15 : CIA-RDP83-00418R001100040009-2

400 milion dhe me nji afat shlyerje për 20 vjet: 1 Janar 1956 deri 1 Janar 1976.

Neni 3

Huaja e katërt Shtetërore ndahet në kategori prej 100 milion lekë sejcila; çdo kategori ndahet në 20 000 Seri prej lekë 5.000 sejcila. Seritë e të gjithë kategorive kanë të njëjtën numër renduer prej 00.001 deri në numër 20 000. Çdo seri përbëhej prej 10 obligacionesh bazë nga lekë 500. Çdo obligacion, përveç serisë do të ketë edhe numërin e obligacionit duke filluar prej numërit 1 e deri në 10.

Neni 4.

Obligacionet e huasë së katërt Shtetërore emetohen në premjen prej lekë 1.000 – 500 – 100 dhe 50. Oblgacionet bazë janë me premje lekë 1.000, përbëhen prej 2 obligacionesh bazë nga lekë 500 të një serije dhe kanë dy numëra obligacioni, këto japin të drejtën për dy fitime llotarije. Obligacionet prej lekë 100 dhe 50, janë pjesë t'obligacionit bazë prej lekë 500 dhe japin të drejtën e fitimit respektivisht për 1/5 dhe 1/10 e fitimit të obligacionit bazë.

Neni 5.—

Interesat që japin të gjithë obligacionet, do të paguhen me llotari fitimi. Shuma e fitimeve është caktuar për 20 vjetët e huasë mesatarisht 4 përqind në vit. Gjatë afatit të 20 vjetëve të huas, do të fitojnë me anë llotarije fitimi 1/3 e të gjithë obligacioneve dhe 2/3 do të shlyhen me llotaritë e shlyemjes në bazë të vleftës së tyre nominale. Obligacionet që fitojnë në llotari shlyhen dhe përjashtohen nga heqjet e mëvonëshme të llotarisë. Fitimet e llotarisë caktohen në masën prej lekë 100.000, 50.000 25.000, 10.000, 5.000 dhe 1.000 për obligacionin bazë prej lekë 500, të cilat përfshijnë edhe vleftën nominale të obligacionit.

Neni 6.—

Gjatë 20 vjetëve të huasë duke fiiluar prej vitit 1956 do të hiqen 40 llotari fitimi. Data dhe vendet e heqjes së llotarisë do të caktohen nga Ministrija e Financave.

Neni 7.—

Llotarija e fitimit hiqet për nji kategori obligacionesh. Të gjitha obligacionet e kotegorive të tjera që kanë numërat e serive dhe t'obligacionit të kategorisë për të cilën hiqet llotarija, fitojnë në mënyrë të barabartë.

Neni 8.—

Për çdo heqje llotarije dhe për çdo kategori të huasë së katërt d.m.th. për çdo 100 milion lekë fitojnë sasitë e obligacioneve të poshtëshënuara:

1	fitim	prej	lekë	100.000	baraz	me	lekë	. . . . 100.000
2	fitime	»	»	50.000	»	»	»	. . . . 100 000
4	fitime	»	»	25.000	»	»	»	. . . . 100.000
10	fitime	»	»	10.000	»	»	»	. . . . 100.000
50	fitime	»	»	5.000	»	»	»	. . . . 250.000
1.633	fitime	»	»	1.000	»	»	»	. . . . 1633.000
1.700	fitime	gjithësejt		lekë				2.283.000

Approved For Release 2009/06/15 : CIA-RDP83-00418R001100040009-2

Approved For Release 2009/06/15 : CIA-RDP83-00418R001100040009-2

Neni 9

Obligacionet që nuk fitojnë në llotaritë e fitimit, riblehen me vleftën e tyre nominale mbrenda 15 jetëve, duke filluar që nga viti 1961.

Për çdo kategori prej 100 milion lekë të huas, blihen për çdo vit gjatë periudhës 1961 - 1965 lekë 2.500.000 obligacione. gjatë periudhës 1966-1970 nga 4200,000 lekë dhe gjatë periudhës 1971 — 1975 nga 6.200.000 lekë. Obligacionet që do të riblehen me vleftën e tyre nominale prej vitit 1961 deri në vitin 1975. caktohen me anën e llotarisë së shlyerjes që hiqen për çdo vit. Data dhe vendet e heqjes së llotarisë së shlyerjes do të caktohen për çdo vit nga Ministrija e Finanancave.

Obligacionet që nuk kanë fituar me llotarinë e shlyerjes, riblehen duke filluar nga data 1 Janar 1976 deri me 31 Dhjetor 1976

Neni 10.—

Obligacionet që kanë fituar në llotari si dhe obligacionet që do të riblehen për vleftën e tyre nominale, duhet të paraqiten për t'u paguar deri në 31 Dhjetor 1976, Mbas kësaj date humbasin të drejtën për t'u paguar.

Neni 11.—

Fitimet dhe riblerja e obligacioneve kryhet vetëm me pagesë me lekë si për shtetësit shqipëtare ashtu edhe për shtetasit e huaj.

Neni 12

Në huanë e katërt shtetërore kanë të drejtë të nënshkruajnë shtetësit shqipëtarë dhe shtetasit e huaj me banim në Republikën Popullore të Shqipërisë si edhe shtetasit shqipëtarë që ndodhen në shtetet e tjera.

Neni 13

Nënshkrimi i huasë së katërtë shtetërore organizohet me komisionet e bashkëpunimit të qarkut, rrethit ose qytetit. Nënshkrimi i huas në repartet ushtarake dhe Drejtoritë, Degat dhe seksionet e punëve të Brendëshme, organizohet nga Komanda e reparteve ushtarake dhe nga Drejtoritë, Degat dhe seksionet e punëve të Brendëshme.

Neni 14.—

Për realizimin me sukses të nënshkrimeve dhe për ndjekjen e vazhdueshme t'arkëtimeve të huas. ngarkohen komisionet e bashkëpunimit të qarqeve, rretheve dhe qyteteve. të lokaliteve, të qendrave të punës dhe të fshatrave.

Neni 15.—

Për realizimin e arkëtimeve nga nënshkruesit, komisionet e bashkëpunimit caktojnë për çdo qendër pune, lagje, fshat, repart ushtarak apo drejtori, degë dhe seksion të punëve të Brendëshme, persona të ngarkuar të cilët janë organe të komisionit të bashkëpunimit.

Neni 16.—

Ngarkohet Ministria e Financave të nzjerrë udhëzime më të hollësishme për zbatimin e kësaj urdhërese.

Neni 17.—

Kjo urdhëresë hyn në fuqi me 15 Mars 1955.

ZV|KRYETAR I KËSHILLIT TË MINISTRAVE TE R.P.SH.
HYSNI KAPO

Approved For Release 2009/06/15 : CIA-RDP83-00418R001100040009-2

Approved For Release 2009/06/15 : CIA-RDP83-00418R001100040009-2

URDHËRESË E QEVERISË
Nr. 8 dt. 23-II-1955

MBI
PERDORIMIN E FITIMIT DHE KRIJIMIN E FONDIT TË DREJTORIT DHE FONDEVE TË TJERA NË NDËRMARRJET BUJQËSORE ME RENDËSI NACIONALE

Këshilli i Ministrave i Republikës Popullore të Shqipërisë. me qëllim që të forcohet hozrashoti në ndërmarrjet bujqësore shtetërore me rëndësi nacionale dhe të nxiten punonjësit e këtyre ndërmarrjeve për realizimin dhe tejkalimin e planit të shtetit, në mbledhjen e datës 23-II-1955, nxierr këtë

U R D H Ë R E S Ë
M B I
PËRDORIMIN E FITIMIT DHE KRIJIMIN E FONDIT TË DREJTORIT DHE FONDEVE TË TJERA NË NDËRMARRJET BUJQESORE SHTETËRORE ME RËNDËSI NACIONALE

Neni 1.—
Fitimi që realizojnë ndërmarrjet bujqësore shtetërore me rëndësi nacionale përdoret:
a) për të krijuar :
I) fondin e drejtorit
II) fondin e sigurimit kundrejt fakeqsive të natyrës.
III) fondin e zgjerimit dhe të forcimit t'ekonomisë dhe
b) për të mbuluar humbjet eventuale të periudhave të mëparëshme

I. KRIJIMI DHE PËRDORIMI I FONDIT TË DREJTORIT

Neni 2.—
Burimet për formimin e fondit të drejtorit janë: fitimi i planifikuar dhe itimi mbi plan dhe për ndërmarrjet që nuk kanë fitim, kursimi që rrjedh nga ulja e kostos.

Neni 3.
Fondi i drejtorit krijohet në të gjitha ndërmarrjet bujqësore shtetërore me rëndësi nacionale që administrohen në hozrashot të plotë dhe që kanë bilanc indipendent, kur këto plotësojne ose tejkalojnë :
a) planin e prodhimit në total si vleftë; planin e prodhimit dhe të dorëzimit kundrejt shtetit të prodhimeve që përbëjnë drejtimin kryesor të ndërmarrjes si dhe pianin e prodhimit dhe dorëzimit kundrejt shtetit në drithra buke dhe mish.
b) planin e numërit të krerëve të bagëtisë në mbarim të vitit në gjedhe, për ndërmarrjet që kanë drejtim kryesor prodhimin e qumështit, në dhen për ndërmarrjet që kanë drejtim kryesor prodhimin e leshit, në derra për ndërmarrjet që kanë drejtim kryesor rritjen e derrave dhe në një njethundrake për ndërmarrjet që kanë drejtim kryesor njëthundraket,
c) planln e kostos në total për prodhimet që i dorëzohen shtetit.

Neni 4.—
Llogarija e fondit të drejtorit, bëhet mbi fitimin e planifikuar, mbi kursimin e planifikuar nga ulja e kostos, mbi tejkalimin e fitimit të planifikuar dhe tejkalimin e kursimit të reolizuar nga ulja e kastos, kundrejt detyrës së dhenë, si vijon :

Approved For Release 2009/06/15 : CIA-RDP83-00418R001100040009-2

Approved For Release 2009/06/15 : CIA-RDP83-00418R001100040009-2

a) 5% mbi fitimin e planifuar ose mbi kursimin e planifikuar nga ulja e kostos.

b) 40% mbi tejkalimin e fitimit të planifikuar ose mbi tejkalimin e e kursimit të planifikuar nga ulja e kostos.

Neni 5.—

Drejtorët e ndërmarrjeve bujqësore shtetërore dhe organet eprore kompetente. për efekt të llogaritjes së fondit të drejtorit, në caktimin e volumit ose kursimit të harrijtur nga ulja e kostos, marrin parasyshë ndryshimet që mund të jenë vërtetuar nga faktorët e jashtëm të cilët do të përcaktohen nga Ministrija e Bujqësisë dhe nga Ministria e Financave.

Neni 6.—

Shuma vjetore e fondit të drejtorit nuk duhet të kapërcejë 5% të fondit të pagave vjetore të planifikuar për punëtorët e prodhimit duke marrë parasyshë edhe përpjestimet që rjedhin në tejkalimin e fondit të pagave nga tejkalimi i planit prodhimit.

Neni 7.

Shuma që kalon në fondin e drejtorit caktohet në bazë të billancit vjetor të aprovuar.

Neni 8.—

Drejtorëve të ndërmarrjeve bujqësore shtetërore me rëndësi nacionale u jepet e drejta të shpenzojnë nga «fondi i drejtorit» për qëllimet e poshtëshënuara:

a) Jo, më pak se 50°/o të fondit të drejtorit për investime jashtë planit që kanë për qëllime zgjerimin e prodhimit bujqësor, blektoral dhe të aktiviteteve të tjera ndihmëse e sekondare, për ndërtime dhe meremetime jashtë planit të banesave të punonjësve, çerdheve, kopshteve për fëmijë, mensave, klubeve etj,

b) Pjesa tetër e këtij fondi përdoret për përmirësimin e kondtave të jetetesës dhe të kanditave kulturale të punonjësve të ndërmarrjeve, për zgjerimin dhe pajisjen me inventar përkatës të kopshteve, çerdheve shtëpive të pushimit, mensave, klubeve dhe përmasa fiskulturale etj,, për dhenie shpërblimesh individuale puntorëve specialistëve, teknikëve dhe nëpunsave të ndërmarrjes, për blerjen e biletave për shtëpi pushimi dhe për dhenie ndihme të menjiherëshme puntorëve, specialistëve teknikëve dhe nëpunsave.

Përdorimi i «fondi të drejtorit» bëhet në bazë të nji preventivi të aprovuar nga drejtori i ndërmarrjes në marëveshtje me Komitetin profesional.

Neni 9.—

Shpenzimet nga «fondi i drejtorit» kryhen vetëm brenda kufijve të shumave disponibel. Ndalohet të bëhen shpenzime përkundrejt shumave që parashikohet të kalojnë në «fondin e drejtorit»,

II. KRIJIMI DHE PËRDORIMI I FONDIT TË SIGURIMIT KUNDREJT FATKEQSIVE TË NATYRËS

Neni 10.

Fondi i sigurimit kundrejt fatkeqsive të natyrës krijohet në masën 30°/o të fitimit simbas billancit vjetor të aprovuar.

Neni 11.—

Mjetet e fondit të sigurimit përqëndrohen në mënyrë të centralizua

Approved For Release 2009/06/15 : CIA-RDP83-00418R001100040009-2

Approved For Release 2009/06/15 : CIA-RDP83-00418R001100040009-2

pranë bankës së Shtetit në llogari të posaçme me emër të Ministrisë Bujqësisë.

Neni 12

Derdhja e «fondit të sigurimit» në Bankë do të bëhet me aprovimin e bilancit vjetor, pasi të jetë caktuar shuma përkatëse mbi fitimin efektiv që do të rezultoje nga bilanci.

Neni 13.—

Ministrija e Bujqësisë ka të drejtë të disponojë nga llogaria e posaçme pranë Bankës e «fondit të sigurimit» për qëllimet e poshtë shënuara:

a) Për të mbuluar dëmet që mund të vërtetohen në ndërmarrjet nga fatkeqësitë e natyrës (breshëri, inondata, thatësira, ngordhje nga sëmundje epidemike, zjarri, sëmundje në bimët etj.

b) Për të shlyer kreditë bankare, të pa paguara në afat, të ndërmarrjeve bujqësore shtetërore, kur kreditë nuk garantohen nga t'ardhurat e ndërmarrjes.

Disponimi nga llogaria speciale bankare e «fondit të sigurimit» për dëmet nga fatkeqësitë e natyrës bëhet nga Ministtia e Bujqësisë në bazë të proçes–verbaleve që paraqesin ndërmarrjet, që kanë pësuar dëmet me anën e të cilave të vertetohet dëmi efektiv sipas çmuarjes se nje komisioni dhe masat e marra.

III. KRIJIMI DHE PËRDORIMI I «FONDIT TË ZGJERIMIT DHE FORCIMIT TË EKONOMISË».

Neni 14. —

Fondi i zgjerimit dhe forcimit të ekonomisë krijohet nga ajo pjesë e fitimit që mbetet e lirë pasi të jetë llogaritur «fondi i drejtorit», «fondi i sigurimit» dhe të jenë mbuluar humbjet eventuale të periudhave të më parëshme.

Neni 15.—

Përcaktimi i shumës së fitimit që kalon në fondin e zgjerimit dhe të forcimit t'ekonomisë bëhet me mbylljen dhe aprovimin e bilancit vjetor.

Neni 16. —

Mjetet e «fondit të sigurimit dhe forcimit të ekonomisë» derdhen në, llogari të posaçme bankare në emër të ndërmarrjes pas aprovimit të billancit.

Neni 17.—

Drejtorët e ndërmarrjeve kanë të drejtë të disponojnë nga llogaria e posaçme «e fondit të zgjerimit dhe forcimit të ekonomis» për investime nën limit mbi planin e investimeve t'aprovuara (ndërtime dhe pajisje bujqësore e blegtorale, banesa, zgjerim sektorësh, aktivitete ndihmëse e sokondare financim pemtoreje, vreshtash e ullishtash gjer sa të kalojë në prodhim etj).

Neni 18.—

Investimet nën limit mbi plan aprovohen nga Ministirja e Bujqësisë në marrëveshtje me Ministrin e Financave dhe financohen nga Banka e Shtetit sipas dispozitave dhe proçedurës së caktuar për investimet e planit.

Neni 19. —

Ministria e Bujqësisë në marëveshtje me Ministrin e Financave ngarkohen të lëshojnë udhëzime të hollësishme për zbatimin e kësaj urdhërese.

Neni 20.

Urdhëresat Nr. 13 datë 2/III/1950 Nr. 13 bis datë 19/4/50 mbeten pa fuqi. Urdheresa Nr. 47 datë 10/2/1949 mbi përdorimin e fitimit, mbetet

Approved For Release 2009/06/15 : CIA-RDP83-00418R001100040009-2

Approved For Release 2009/06/15 : CIA-RDP83-00418R001100040009-2

gjithashtu pa fuqi, përsa u përket ndërmarrjeve bujqësore shtetërore si dhe çfarëdo dispozite tjetër që është në kundërshtim me këtë urdhëresë.

Neni 21.

Kjo urdhresë hyn në fuqi menjiherë.

ZËV. KRYETAR' I KËSHILLIT MINISTRAVE TË R.P.SH.
HYSNI KAPO

KËSHILLI I MINISTRAVE
VENDIM
Nr. 53 Dt. 9.II. 1955.

MBI SHPËRBLIMIN SUPLEMENTAR TË GRUPEVE TË PESHKATARËVE PROFESIONISTË ANTARË TË KOOP. PESHKATARËVE PËR TEJKALIMIN E PLANIT TË PESHKUT

Këshilli i Ministrave i Republikës Popullore të Shqipërisë, me qëllim inkurajimi të antarëve të kooperativës të peshkatarëve profesionistë, në mbledhjen e datës 9/II/1955,

V E N D O S I :

1. — Grupet e peshkatarëve, antarë profesionistë të kooperativës të peshkatarëve, që tejkalojnë planin mujor të peshkimit, të marin një shpërblim suplementar mbi vleftën e tejkalimit të planit si vijon:

a) për tejkalim plani 1 gjer 15% të shpërblehen në masën 15% të vleftës së peshkut që përfaqëson tejkalimin e planit, të llogaritur me çmimin e shitjes nga peshkatarët;

b) për tejkalimin mbi 16% të shpërblehen në masën 30%.

2. — Grupet e peshkatarëve antarë profesionistë të kooperativave të peshkatarëve që tejkalojnë planin mujor të peshkimit në dajlane, të marin një shpërblim suplementar mbi vleftën e tejkalimit të planit si vijon:

a) për tejkalim plani 1 gjer 15% të shpërblehen në masën 7% të vleftës së peshkut që përfaqëson tejkalim plani, të llogaritur me çmimin e shitjes nga peshkatarët;

b) për tejkalim mbi 16% të shpërblehen në masën 15%.

3. — Drejtuesit dhe kuadri tjetër teknik dhe adminstrativ të kooperativës të peshkatarëve, për rastin e tejkalimit të planit 3/mujor të peshkimit të kooperativës, të përfitojnë një shpërblim suplementar baras me 1% të rogës së tyre për 3/mujorin, për çdo përqindje të tejkalimit të planit 3/mujor të peshkimit.

4. — Fondi për shpërblimin e grupeve të peshkatarëve profesionistë të kooperativave, si edhe kuadrit drejtues, teknik dhe administrativ të sigurohet nga pokësimi i tatimit mbi xhiro për shitjen e peshkut nga 8% në 6% dhe diferenca të mbulohet nga vet kooperativat peshkatareve.

5. — Dhënia e shpërblimeve suplementare, për të cilat bëhet fjalë në pikat 1 dhe 2 të këtij vendimi, të bëhet, për çdo muaj dhe për ato që bëhet fjalë në pikën 3, një herë në 3 muaj,

6. — Ky vendim hyn në fuqi me 1 Mars 1955.

ZËV. KRYETAR' I KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË R. P. SH.
HYSNI KAPO

Approved For Release 2009/06/15 : CIA-RDP83-00418R001100040009-2

Approved For Release 2009/06/15 : CIA-RDP83-00418R001100040009-2

KËSHILLI I MINISTRAVE
VENDIM
Nr. 61 më 22/II/1955.
MBI
ÇMIMIN E BILJETAVE TË TRANSPORTIT URBAN INTERURBAN

Këshilli i Ministrave i Republikës Popullore të Shqipërisë, në mbledhjen e datës 22/II/ 1955, në mbështetje të germës c) të nenit 1 të urdhëresës së Qeverisë Nr 25 dat. 25-X-1952 mbi « proçedurën e caktitimit të çmimeve »,

V E N D O S I :

1) Çmimi i biljetave të autobuzave të shërbimit urban për të gjitha qytetet të jetë lekë 3 (tre).

2) Për të gjithë ata që abonohen për një muaj duke përfshirë edhe nxënësit dhe studentet mbi çmimin e caktuar të biljetës të behet një zbritje prej 10o/o.

3) Për të gjithë ata që abonohen për 3 (tre) muaj, të bëhet një zbritje si vijon :

a) Për nxënësit dhe studentet 50o/o zbritje mbi çmimin e caktuar të biljetës;

b) Për gjithë popullin 20o/o zbritje mbi çmimin e caktuar të biljetës.

4) Çmimi i biletave të veturave (taksi) të jetë :

a) lekë 20 (njëzet) për kilometër—maqinë për shërbimin urban ;

b) lekë 10 (dhjeië) për kilometër—maqinë për shërbimin interurban ;

c) lekë 180 (njëqintetëdhjetë) për çdo orë pritje veture në dispozicjon për shërbimin urban dhe interrurban ;

ç) në shërbimin urban për 5 (pesë) minutat e para dhe në shërbimin interurban për 20 (njëzet) minutat e para të qëndrimit të veturës në vendin e mbritjes të mos merret shpërblim.

5) Ngarkohet Ministria e Ndërtimit dhe Komunikacjoneve të nxjerri udhëzime për zbatimin e këtij vendimi.

6) Humbja, që do të shkaktohet nga ulja e tarifës për abonimin mujor dhe tremujor në transportin urban, të mbulohet nga buxheti,

7) Ky vendim hyn në fuqi me 1 Prill 1955.

ZV/KRYETAR' I KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË R. P. SH.
HYSNI KAPO

KESHILLI I MINISTRAVE
VENDIM
Nr. 69 Dt. 23-II-56
DHËNIEN E SHPËRBLIMEVE NDËRMARRJEVE BUJQËSORE SHTETËRORE NACIONALE PËR DOREZIM MBI PLANE

Këshilli i Ministrave i Republikës Popullore të Shqipërisë, me qëllim që të nxiten përpjekjet e ndërmarrjeve bujqësore shtetërore për tejkalimin e planeve të dorëzimit shtetit të prodhimeve bujqësore e blegtorale dhe të forcohet hozrashoti dhe ana financiare e këtyre ndërmarrjeve në mbledhjen e datës 23-II-1955.

VENDOSI :

1) Ndërmarrjeve bujqësore shtetërore nacionale t' u jepen nga buxheti, për sasitë e prodhimeve të dorëzuara mbi plan, shpërblimet nxitëse në masën që vijon :

Approved For Release 2009/06/15 : CIA-RDP83-00418R001100040009-2

Approved For Release 2009/06/15 : CIA-RDP83-00418R001100040009-2

a) për çdo kv. drithë buke të dorëzuara mbi plan lek 350
b) « « « ullij « « « « « 500
c) « « « panxhar-sheqeri të « « « « 50
ç) « « « « « farë « « « « « 1000
d) « « « pambuk « « « « « 500
dh) « « « duhan « « « « » 2000
e) « « « perime e patate « « « « « 100
ë) « « « fruta « « « « « 250
f) « « « qumësht lope « « « « « 400
g) « « « qumësht dele e dhije « « « « 400
gj) « « « lesh dorëzuar mbi plan « 1000
h) « « « mish derri dorëzuar mbi plan « 1500
i) « « « mish shpendësh dorëzuar mbi plan « 2000
j) « « « mish dele e dhije dorëzuar mbi plan « 500
k) « « « Për çdo 1000 kokra vezë dorëzuar mbi plan 1000

2) Shpërblimi për drithra buke do të bëhet me konditë që të jetë siguruar plani i farës dhe për mish me konditë që të jetë siguruar plani i rritjes së krerëve në mbarim të vitit.

3) Dhënia e shpërblimeve nxitëse që përmban pika 1 e këtij vendimi do të bëhet në periudhat që shënohen më poshtë;

a) Për drithërat e bukës. panxhar sheqeri, pambuk, duhan, fruta, patate, qumësht deleje e dhije dhe lesh në mbarim të sezonit.

b) Për qumësht lope, mish dhe perime për çdo tremujor në bazë të planit tremujor.

c) Për vezë dhe ullinjtë në mbarim të vitit.

4) Dhënia e shpërblimit do të bëhet nga ana e Bankës së Shtetit kundrejt paraqitjes së një dokumenti të institucionit grumbullues ku të vërtetohet sasija e dorëzuar efektivisht mbi plan. Për drithrat bukë dhe mish, përveç dokumentit të institucionit grumbullues duhet të paraqitet në bankë edhe një shkresë e drejtorisë përgjithëshme të N. B. SH.-ve ku të vërtetohet se ndërmarrja e ka plotësuar konditën që përcakton pika 2 e këtij vendimi.

5) Shpërblimet e më sipërme që merrr ndërmarrja derdhen në llogari likuiduese të ndërmarrjes dhe përdoren:

a) 20°/₀ për të shpërblyer punonjësit që janë dalluar dhe kanë kontribuar më tepër për tejkalimin e planit të prodhimeve dorëzuar shtetit për sektorin përkatës të pradhimit.

b) 80°/₀ në «fondin e zgjerimit dhe forcimit të ekonomisë» përdorimi i të cilit bëhet simbas urdhëresës së posaçme.

6) Me zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Ministria e Bujqësisë dhe Ministria e Financave.

7) Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

ZËV. KRYETAR' I KËSHILLIT TË MINISTRAVE R. P. SH.
HYSNI KAPO

KESHILLI I MINISTRAVE
VENDIM
Nr. 82 dt. 19-I-1955
MBI
SIGURIMIN E FARNAVE TË ZGJEDHURA DHE RIORGANIZIMIN E NDËRMARRJES SË FARNAVE

Këshilli i Minirtrave i Republikës Popullore të Shqipërisë, në mbledhjen

Approved For Release 2009/06/15 : CIA-RDP83-00418R001100040009-2

Approved For Release 2009/06/15 : CIA-RDP83-00418R001100040009-2

e dt. 19-II-1955 mori në shqyrtim problemin e sigurimit dhe shpërndarjes së farnave të zgjedhura dhe

KONSTATOI:

Për sigurimin e farnave të zgjedhura është treguar në vjetët e fundit kujdes më i math si nga organet e bujqësisë ashtu dhe nga vetë ekonomitë bujqësore dhe cilësia e farnave ka ardhur duke u përmirësuar, sidomos pas organizimit të inspektoratit shtetëror të farnave dhe të laboratorëve anekse.

Por me gjithë këto një seri të metash serioze janë çfaqur në këtë sektor; Ministria e Bujqësisë, komitet ekzekutive në qarqe e rrethe dhe N. B. SH. nuk e kanë vlerësuar ende si duhet problemin e sigurimit të farnave të zgjedhura dhe nga kjo arsye nuk është bërë rajonizimi i llojeve më të përshtatëshme të farnave për çdo zonë dhe kjo ka shkakëtuar që grumbullimi dhe shpërndarja e farnave të bëhet pa ndonjë kriter të shëndoshë dhe të mbillen lloje më pak prodhuese; fara e jonxhës nuk është siguruar, parcellat e farës, që janë një faktor kryesor për sigurimin e farnave të zgjedhura nuk janë shfrytzuar si duhet në disa qarqe si Shkodër, Gjirokastër, Dibër dhe në N. B. SH. Maliq, Lushnje dhe Fier; organet e bujqësisë në qarqe dhe rrethe nuk janë kujdesur që çdo kooperativë bujqësore dhe, me sa të jetë e mundur, edhe ekonomitë private të caktojnë me kohë dhe për çdo kulturë porcellat e farës në tokat më të mira dhe të kryhen në to të gjitha shërbimet agroteknike; disa N. B. SH. si ajo e Maliqit, Lushnjes dhe Fierit, nga mungesa e parcellave të farës dhe nga mos zbatimi i masave agroteknike nuk kanë siguruar farë të pastërta as për nevojat e tyre; organizimi i shpërndarjes së farnave dhe materialeve të tjera bujqësore që kryhen nga N. SH. F. F. B. nga N. SH. G. dhe kooperativat e konsumit nuk është studjuar mirë dhe shpërndarja e farnave, plehrave dhe materialeve të tjera bujqësore për ti ardhur në ndihmë sa më mirë fshatarësisë, nuk kryhet si duhet, në mjaft qëndra bujqësore mungesa e depove të farnave, ka penguar grumbullimin dhe shpërndarjen e farnave; Instituti i Kërkimeve Shkencore Bujqësore gjër më sot nuk e ka ndihmuar konkretisht praktikën për çështjen e farnave, duke u kufizuar më tepër me punët eksperimentale të bazave të veta.

Me qëllim që të zhduken mungesat e konstatuara dhe të sigurohen farëra të zgjedhura për bujqësinë tonë, të inkurajohet prodhimi i farnave të zgjedhura edhe nga ana e ekonomive bujqësore si dhe të sigurohet shpërndarja e mirë e farnave dhe të materialeve bujqësore Këshilli i Ministrave.

VENDOSI:

I. MBI KONDITAT E GRUMBULLIMIT DHE SHPËRNDARJES SË FARNAVE

A. MBI ÇMIMET E FARNAVE TË ZGJEDHURA TË GRURIT, MISËRIT DHE ORIZIT TË NDARA NË KATEGORI PËR SEKTORIN SHTETROR

1. Ndërmarrja Bujqësore Shtetërore t'ua shesin degëve të N. SH. F. F. B. farën e grurit, misërit dhe orizit të ndarë në kategori dhe me çmimet që vijojnë:

A) FARA E GRURIT:

1.	Fara e grurit	elite	2.400	lekë	kv.
2.	« « kategorija	I rë	1.200	«	«
3.	« « «	II-të	1.000	«	«
4.	« « «	III-të	800	«	«

Approved For Release 2009/06/15 : CIA-RDP83-00418R001100040009-2

Approved For Release 2009/06/15 : CIA-RDP83-00418R001100040009-2

5. Fara e grurit kategorija IV-të 700 lekë kv.

b) PARA E MISËRIT:

1. Fara e misërit	elite	1.500	«	«
2. « « kategorija	I-rë	900	«	«
3. « « «	II-të	800	«	«
4. « « «	III-të	700	«	«
5. « « «	IV-të	600	«	«

(c) Fara e orizit:

1. Fara e orizit	Kategorija	I-rë	1. 300	lekë	kv.
2. » »	»	II-të	1.100	»	»
3. » »	»	III-të	900	»	»
4. » »	»	IV-të	800	»	»

B. MBI GRUMBULLIMIN E FARËS GRURIT, MISËRIT DHE ORIZIT NGA EKONOMITË KOOPERATIVISTE DHE PRIVATE DHE MBI SHPËRNDARJEN E KËTYRE FARNAVE.

2. Ekonomive bujqësore kooperativiste që prodhojnë farna të zgjehhura gruri, misëri dhe orizi dhe i dorëzojnë këto për llogari të detyrimeve të tyre ndaj shtetit, t'u shtohet çmimi i blerjes si vijon :

Për farnat e kategoris së parë, dytë, tretë dhe katërtë, respektivisht 300%, 200%, 100% dhe 50% mbi çmimin e detyrimeve që i dorëzohen shtetit duke u caktuar këto çmime në këtë mënyrë :

		Gruri	Misëri	Orizi
Për farën e kateg.	I-rë	1000 lek Kv,	800 lek Kv.	3.000 lek Kv.
« « «	II-të	750 » »	600 » »	2.250 » »
« « «	III-të	500 » »	400 » »	1.500 » »
« « «	IV-të	375 » »	300 » »	1.125 » »

3. Ekonomive bujqësore private që prodhojnë farna të zgjedhura, gruri, misëri dhe orizi dhe i dorëzojnë për llogari të detyrimeve të tyre ndaj shtetit, t'u behet zbritje nga fondi i detyrimit për çdo kv. fare të dorëzuar më këto përqindje :

Për farën e kateg. së	I-rë	20%
« « «	II-të	15%
« « «	III-të	10%
« « «	IV-të	5%

4. Ekonomitë kooperativiste dhe private që prodhojnë farna të zgjedhura, gruri, misëri dhe orizi dhe ua dorëzojnë degëve të N.SH.F.F.B. si teprice mbi fondin e detyrimit: të marrin si shkëmbim grure, misër dhe oriz standard konsumi si vijon :

Për 100 Kg. farë gruri, misëri ose orizi kategorija I-rë, II-të III-të ose IV-të, t'u jepet respektivish 130, 125, 110 dhe 100 Kg. grurë misër ose oriz standard konsumi.

5. Kur dorëzohet mbi detyrimin fara e mirë gruri, misëri ose orizi e pa aprobuar, mbasi t'analizohet fuqia mbirese ose vitaliteti i kësaj fare, mundet me autorizimin e inspektorit shtetror të farnave dhe agronomit, të grumbullohet kjo farë dhe të stimullohet ekonomia si për farën e kategorisë së tretë ose të katërtë (pika 4 e këtij vendimi.)

6. Ekonomive bujqësore kooperativiste, që do të prodhojnë farë elite gruri dhe misëri dhe e dorëzojnë këtë farë në degët e N.SH.F.F.B. t'u jepet

Approved For Release 2009/06/15 : CIA-RDP83-00418R001100040009-2

Approved For Release 2009/06/15 : CIA-RDP83-00418R001100040009-2

për çdo kv. farë gruri ose misëri elite të dorëzuar, dy kv. grurë ose misër standard konsumi.

7. Farnat e zgjedhura të grurit, misërit dhe orizit të vihen në shpërndarje nga degët e N.SH.F.F.B. si vijon: Për çdo 100 kg. farë të zgjedhur grurë, misër ose oriz të shpërndarë, të mirret si shkëmbim 112 Kg. drithi të njëllojta konsumi,ose sasi ekuivalente të drithrave të tjera për farën e misërit.

8. Fara elite t'u shpërndahet ekonomivet të caktuara për prodhim fare si vijon; Për çdo 100 kg. fare elite, të dorëzohen 100 kg. farë të njëllojtë të kategoris I-rë dhe II-të ose 105 kg e kategoris tretë dhe e katërtë dhe në mungesë të këtyre të dorëzohen 110 kg. grurë standard konsumi.

9. Me autorizimin e plot-fuqishmit të grumbullimit dhe shefit të seksionit bujqësis mund t'u shpërndahet farë gruri ose orizi, kundrejt ekuivalenteve të tjera, ekonomive që për shkaqe klimaterike ose ndonjë shkak tjetër nuk disponojnë grurë ose oriz konsumi për të shkëmbyer farën

II. MBI KONDITAT E SHPËRNDARJES SË FARES SË JONXHËS.

10. Çmimi i shitjes së farës së jonxhës nga degët e N.SH.F.F.B. të jetë 200 lekë Kg. plus rabatin 5%. Shpërndarja e kësaj fare të bëhet me autorizim të seksionit të bujqësis dhe t'u jepet ekonomive që mbjellin për herë të parë ose për arsye fatkeqsije ose konditash atmosferike nuk mund të sigurojnë vetë këto farë, me donditë që me anë kontratoje të detyrohen t'a kthejnë sasin e farës së jonxhës të tërhequr në kohën e prodhimit të saj, d.m.th. mbas 2 vjetësh nga koha e mbjelljes, ndryshe të paguajnë si shpërblim trefishin e çmimit të blerjes. Këto ekonomi ku e këthejmë farën e jonxhës nuk kanë të drejtën e marrjes së stimulacionit por vetëm çmimin e blerjes prej 200 lekë Kg.

III. MBI GRUMBULLIMIN DHE SHPËRNDARJEN E FARËS SË FASULES.

Grumbullimi :

11. Kur ekonomitë bujqësore kooperetiviste ose private dorëzojnë për efekte detyrimi farë fesuleje të pastër dhe nga varietetet e përshtatëshme për atë zonë, të vërtetuara këto nga kontrolli i bërë nga seksioni i bujqësisë, t'u paguhet atyre ekonomive 100% më tepër në lekë mbi çmimin e grumbullimit të detyrueshëm. Po me këtë shtesë t'u paguhet edhe N.B.SH. që dorëzojnë fasule të mira për farë.

12. Kur dorëzohet farë fasuleje nga ekonomitë bujqësore kooperativiste dhe private, jashtë detyrimit të tyre ndaj shtetit, për çdo Kg. farë fasule të dorëzuar, t'u jepet si shkëmbim 2.5 Kg. misër standard konsumi ose t'u paguhet me çmimin 36 lek Kg. dhe 200% stimulacjon nga të gjitha llojet e regut reciprok.

Shpërndarja :

13. Fara e fasules të vihet në shpërndarje nga degët e N.S.H.F.F.B. me shkëmbim duke u dorëzuar për çdo Kg. farë fasule 2.6 Kg. misër ose 2.5 Kg. grure ose 1.8 Kg. oriz çeltik.

14. Shpërndarja e farës së fasules me fasule të zakonshme konsum. të bëhet si vijon : Për çdo kg. farë fasule që shpërndahet, të dorëzohet 1.2 Kgi fasule konsumi.

15. Shpërndarje e fares fasules me shkëmbim me misër të bëhet në rastet e veçanta me autorizim të Ministrisë Bujqësisë.

Approved For Release 2009/06/15 : CIA-RDP83-00418R001100040009-2

Approved For Release 2009/06/15 : CIA-RDP83-00418R001100040009-2

IV. MBI GRUMBULLIMIN DHE SHPËRNDARJEN E FARËS SË PATATES

16. N.SH.F.F.B. të grumbullojë farë të mirë patate nga parcellat e farës, me 2—3 lekë për Kg. më tepër se çmimi i tregut të lirë.

17) Shpërndarja e farës së patates nga ana e degëve të N.SH.F.F.B. të bëhet me çmimin e blerjes plus rabatin.

V. MBI GRUMBULLIMIN DHE SHPËRNDARJEN E FARAVE TË PERIMEVE

13. N. B. SH. — të «8 Nëndori» Sukth «Ylli Kuq» Kamëz dhe «Irakli Terova» Korçë të prodhojnë farna perimesh të përshtatshme dhe të specifikuara për çdo lloj.

19. Fara e panxhar-sheqerit, përveç N.B.SH. Maliq, të riprodhohet edhe në ekanomit e tjera bujqësore të përshtatëshme për këtë kulture.

20. Grumbullimi i farnave të perimeve nga N. B. SH. — të bëhet me çmim 30% më tepër se ai i kostos.

21. Çmimi i shpërndarjes së farnave të perimeve të jetë baraz me çmimin e blerjes plus rabatin.

22. Duke filluar nga viti 1956 shpërndarja e farnave të perimeve të bëhet e specifikuar në lloje dhe me paraqitje tërheqëse për blerësin.

23. Në derogim të paragrafit 3 të nenit 2 të urdhëresës Nr. 7 datë 9-II-1951 «mbi rregullimin e marëdhënieve të transportit etj. «lejohet transportimi me anë automjetesh i farës së patates, të fidanave frutore dhe të perimeve gjatë vjave hekurudhore.

VI. MBI KONTRAKTIMIN E FARNAVE

24. Për sigurimin e farnave sipas planit, detyrohen degët e N.SH.F.F.B. të lidhin kontrata me ekonomite prodhuese, qofshin këto kooperativa bujqësore ose ekonomi private.

VII MBI RIORGANIZIMIN E SHPËRNDARJES SË FARNAVE TË FURNIZIMEVE BUJQËSORE.

25. Ndërmarrja e farnave dhe furnizimeve bujqësore N.SH.F.F.B. të bëjë shpërndarjen e farnave, veglave bujqësore, plehrave kimike, dhe insekticidevo në të gjitha qëndrat bujqësore kryesore të Republikës, duke pasur organikën e bashkangjitur, që ban pjesë anekse të këtij vendimi, duke i ardhur kështu sa më afër në ndihmë fshatarësisë.

26. Ne degët kryesore të N.SH.F.F.B. të ketë nga një teknik bujqësor për farnat.

27. Në rrethet Ballsh, Ersekë dhe Këlcyrë grumbullimi dhe shpërndarja e farnave, veglave bujqësore plehrave kimike dhe insekticideve të kryhe nga ndërmarrja e grumbullimit duke u shtuar në organikën e tyre në fuqi nga një magazinier.

Në rrethet në të cilat nuk ka ndërmarrje të grumbullimit si Skrapar, Gramsh, Kastriot, Zadrimë, Pukë, Mirditë, Krujë dhe Petrelë. këtë shërbim ta kryejnë Bashkimet e Kooperativave të shit-blerjes; në sa në rrethet Librazhd, Klos, Kotë, Himarë. Leskovik, Vidhkuq dhe Tepelenë, ndërmarrja e grumbullimit të kryejë grumbullimin dhe shpërndarjen e farnave dhe Bashkimi i Kooperativave të shit-blerjes të kryejë shpërndarjen e veglave bujqësore, plehrave kimike dhe insekticideve.

Approved For Release 2009/06/15 : CIA-RDP83-00418R001100040009-2

Approved For Release 2009/06/15 : CIA-RDP83-00418R001100040009-2

VIII. MBI ORGANIZIMIN E FUNKSIONIMIT TË TRIORAVE

28. Ministrija e Bujqësisë. Komitetet Ekzekutive, N.SH.G, N.B.SH. dhe gjithë institucionet e tjera që disponojnë triore të marrin masa që brënda muajt Qershor 1955 t'i kenë inventarizuar dhe riparuar gjithë triorat.

29. Ndërmarrjet që disponojnë triora, mbasi të kenë kryer triorimin e farës së tyre, ti venë këto në dispozicion të fshatarësisë. Komitetet Ekzekurive t'a venë në dispozicion degëve të N.SH.F.F.B. puntorë sezonal që të shkojnë me triora nëpër fshatra për t'i ardhur në ndihmë fshatarësisë për trioromin e farnave.

30. Ekonomitë bujqësore, për çdo kv. farë gruri, orizi etj. që do të triarjnë në triorat e N.SH.F.F.B. ose të ndonjë ndërmarrje tjetër, do të japin si shpërblim për përballimin e shpenzimeve të nevojshme 1 kg. drithë të njëllojtë konsumi.

31. T'importohen në vitin 1956 triora në sasi të mjaftueshme,

IX. MBI PARCELLAT E FARËS DHE EKONOMITE E CAKTUARA PER PRODHIM FARE.

32. Detyrohen N.B.SH.-të dhe kooperativat bujqësore të caktojnë parcellat e farës për çdo kulturë që mbjellin dhe për vit, nga të cilat të sigurojnë farën për nevojat e tyre dhe për N.SH.F.F.B. Gjithashtu u rekomandohet ekonomive bujqësore private që të kenë parcella fare për kulturat e ndryshme.

X. MBI DETYRAT E INSPEKTORIATEVE SHTETNORE TE FARNAVE

33. Inspektoriatet shtetnore të farnave të zbatojnë terësisht kompetencat dhe detyrat e tyre dhe të forcojnë kontrollin e ndihmën për sigurimin e farnave të zgjedhura.

34. Të gjitha analizat e farnave të kryhen gratis.

35. Inspektoriati shtetnor i farnave në Tiranë të kryejë njëkohëhisht dhe funkjonimin e inspektoriatit qëndror dhe të shtohet n'organikë një laborator teknik.

36. Përgjegjësit, agronomët dhe teknikët e N.B.SH.-ve dhe kooperativave bujqësore që mbjellin farna të pa analizuara ose jashtë standardit shtetëror pa autorizim të veçantë të Ministisë Bujqësisë dënohen nga inspektori shtetëror i farnave me gjobë nga 100 gjer 10.000 lekë, sipas dispozitave të dekretit mbi kondravajtjet

Kundër vendimit të inspektorit shtetëror bëhet ankim brenda 5 ditëve nga data e Komunikimit të vendimit. Ankesa i paraqitet Ministrisë Bujqësisë dhe shqyrtohet nga Dega e prodhimit të Farnave.

XI. MBI PUNËN E INSTITUTIT TË KËRKIMEVE SHKENCORE BUJQESORE

37. Instituti i Kërkimeve Shkencore Bujqësore ngarkohet :

a) Të tregojë më tepër kujdes që udhëheqjen metodike për prodhimin e farnave të zgjedhura dhe të ndihmojë më tepër praktikën.

b) Të japë rezultatet e rajonizimit në zonat kryesore të Republikës për llojet e grurit brenda vitit 1955 dhe për atë të misërit brenda vitit 1956,

c) Të fillojë në vitin 1955 studimin krahasonjës për llojet e përhapura të perimeve kryesore dhe të ndihmojë nga ana metodike N.B.SH.-të e caktuara për prodhim farnash të zgjedhura perimesh.

ç) Brenda vitit 1955 të rekomdojë çiftet e llojeve të përshtatëshme për

Approved For Release 2009/06/15 : CIA-RDP83-00418R001100040009-2

Approved For Release 2009/06/15 : CIA-RDP83-00418R001100040009-2

prodhimin e farës hybride të misërit në zonat kryesore të Republikës dhe të drejtojë punën për zbatimin e kësaj metode në vitin 1956 në N.B.SH. dhe në ekonomit e prodhimit të farnave.

XII. MBI ORGANIZIMIN E NDJEKJES SE PROBLEMEVE TE FARNAVE DHE MBI DETYRAT E TJERA TË MINISTRISË SE BUJQËSISË DHE TË KOMITETEVE EKZEKUTIVE TË K.P. TE QARQEVE DHE RRETHEVE

38. Ministrija e Bujqësisë të organizojë në t'artnmen më mirë ndjekjen e problemit të farnave dhe çdo tremuaj t'informojë Qeverinë me raport të veçantë të hollësishme mbi këtë çështje, duke njoftuar edhe rendimentet e arritjura.

39. Në seksionet e bujqësisë të qarqeve në rrethet Lushnjë, Fier dhe Bilisht si dhe në N.B.SH «8 Nëndori» Sukth, «Maliq Muço» Xhafzotaj. «Ylli Kuq» Kamëz. «29 Nëndori» Lushnje, Maliq «Çlirimi» Fier dhe Cërrik të ketë nga një agronom ose teknik farnash.

40. Në kooperativat bujqësore që do të prodhojnë farna të zgjedhura të ketë nga një teknik bujqësor që të merret me prodhimin e farnave. Këta të paguhen nga buxheti nacional.

41. Brenda muajit Maj 1955 Ministrija e Bujqësisë t'organizojë seminaret ma agronomët dhe teknikët bujqësorë të caktuar për farna.

42. Komitetet ekzekutive të k.p. të qarqeve dhe rretheve të marrin të gjitha masat për kryerjen e të gjitha shërbimeve kulturale të nevojëshme në parcellat e farës dhe të bejnë me kohe aprobimin e farnave në fushë në bazë të rregullave tekniko-shkencore të caktuara.

43. Ministria e Bujqësisë të ndihmojë ekonomitë e caktuara për prodhim farë me anën e S.M.T.-ve plehrave kimike etj.

44. Ministria e Bujqësisë dhe Komitetet ekzekutive të qarqeve dhe rretheve të propagandojnë në fshatarësinëmasat favorizonjëse të këtij vendimi për sigurimin dhe dorëzimin e farnave të zgjedhura.

XIII. DISPOZITA TË FUNDIT

45. Me hyrjen në fuqi të këtij vendimi abrogohen pika 1 dhe 2 të germës A të Vendimit Nr. 282 datë 17.5.1952, Vendimi Nr. 73 datë 24.II.53 pika 1 e vendimit Nr. 123 datë 4.5.54, paragrafi 3 i nenit 2 i urdhëresës Nr. 7 datë 9.II.51 përsa i përket farës patateve dhe fidanove frutore e të perimeve si dhe çdo dispozitë tjetër që vjen në kundërshtim me këtë vendim.

46. Me zbatimin e këtij vendimi ngarkohen Ministrija e Bujqësis, Ministrija e Financave, Ministrija e Tregëtisë, Ministrija e Ndërtim-Komunacjoneve, Komiteti Shtetror i Grumbullimeve, Bashkimi Qëndror i Kooperativave të Konsumit dhe Komitetet Ekzekutivë të qarqeve dhe rretheve.

47. Ky vendim hyn në fuqi me njëherë.

ZV/KRYETAR' I KËSH.LLIT TE MINISTRAVE TË R.P.SH.
HYSNI KAPO

RREGULLORE
E
MINISTRISE INDUSTRISE DHE MINIERAVE
Nr. 52 datë 9.II.1955

Këshilli i Ministrave i Republikës Popullore të Shqipërësë, në mbledh-

Approved For Release 2009/06/15 : CIA-RDP83-00418R001100040009-2

Approved For Release 2009/06/15 : CIA-RDP83-00418R001100040009-2

jen e datës 9.II.1955, me qëllim që të përcaktohen funksionet e Ministrisë Industrisë dhe Minierave nxjerr këtë,

RREGULLORE;
TË
MINISTRISË INDUSTRISË DHE MINIERAVE

Neni 1.—

Ministrija e Industrisë dhe Minierave e Republikës Popullore të Shqipërisë është krijuar në bazë të ligjës Nr. 1905 datë 20 Korrik 1954.

Neni 2.—

Ministrija e Industrisë dhe Minierave drejton dhe kontrollon këto dega të industrisë dhe të minierave;

Industrinë e naftës dhe të minierave, të lëndës së drurit, të përpunimit të drurit, të materialeve të ndërtimit, elektrike, mekanike. ushqimore, veshmbathje si dhe nga ana teknike dhe organizative aktivitetin e ndërmarrjeve të industrisë lokale. Gjithashtu drejton sektorin e grumbullimit të bimëve industriale (duhani, panxhar-sheqeri, pambuk) të ullinjve, aktivitetin gjeollogjik si dhe aktivitetin e ndërmarrjeve të furnizimit të puntorëve.

Neni 3.—

Ministria e Industrisë dhe Minierave administron ndërmarrjet nacionale të industrisë dhe të minierave.

Neni 4.—

Ministria e Industrisë dhe Minierave ka këto detyra:

a) Organizon, ndihmon dhe drejton ndërmarrjet vartëse për realizimin e planit të prodhimit dhe të ndërtimeve kapitale' për zhvillimin e gjith' anëshëm dhe propocional të degëve të industrisë, për prodhimin e të gjithë artikujve të një kualiteti të lartë dhe me asortimentet e duhura në përputhje me kërkesat e popullsisë, për për përmirësimin e vazhdueshëm të jetesës puntorëve, për sigurimin dse kualifikimin e kuadrove puntore, për zgjedhjen dhe pregatitjen e kuadrove drejtuese dhe ingjinero-teknike, për shtimin e kapacitetit prodhonjës të ndërmarrjeve, për shfrytëzimin e plotë të maqinerisë, për mekanizimin e proçeseve teknollogjike, për shtimin e rendimentit të punës, për uljen sistematike të kostos së prodhimeve, për sigurimin e rentabilitetit të ndërmarrjeve vartese, për organizimin e studimeve, projektimeve, kërkimeve dhe çpimeve në lëmin e gjeollogjisë si dhe për grumbullimin e bimëve industriale dhe për punimin e tyre

b) Përpunon dhe harton, në përputhje me direktivat e Qeverisë, planet e zhvillimit dhe të prodhimit për degët e industrisë.

c) Aprovon për drejtoritë e prodhimit dhe për disa ndërmarrje të veçuara planin e prodhimit, të fuqisë puntore dhe fondit të pagave, të materialeve dhe maqinerisë, të uljes së kostos, planin financiar dhe planin e ndërtimit dhe rimontit kapital, kontrollon, analizon dhe verifikon zbatimin e tyre: siguron realizimin e planit simbas sasisë, cilësisë dhe asortimentit, merr masa për përmirësimin e vazhdueshëm të kualitetit të prodhimeve që fabrikojnë ndërmarrjet vartëse të saj,

ç) Kryen drejtimin teknik dhe u jep ndihmën teknike drejtorive të prodhimit si dhe ndërmarrje vartëse, kontrollon zbatimin e regullave të sigurimit teknik dhe të mbrojtjes në punë, përpunon masa për futjen në prodhim të metodave të reja teknike.

d) Organizon propagandën teknike dhe shkëmbimin e eksperiencës së

Approved For Release 2009/06/15 : CIA-RDP83-00418R001100040009-2

Approved For Release 2009/06/15 : CIA-RDP83-00418R001100040009-2

prodhimeve teknike midis ndërmarrjeve dhe organizatave vartëse, drejton punën për përfeksionimin teknik. për çpikjet dhe racionalizimet.

dh) Kontrollon drejtoritë e prodhimit dhe ndërmarrjet vartëse për vënien në zbatim të regullave të eksploatimit teknik.

e) Organizon furnizimin e ndërmarrjeve dhe organizatave vartëse me lëndë të parë dhe materiale, pjesë,këmbimi, maqineri dhe instrumenta, me lëndë djegëse dhe karburanta të importit dhe të vendit.

ë) Merr masa për administrimin dhe ruajtjen e pasurisë në ndërmarrjet dhe organizatat vartëse.

f) Drejton normimin teknik dhe organizimin e punës në ndërmarrjet dhe organizatat vartëse, përpunon dhe ve në zbatim masat për forcimin e disiplinës në punë.

g) Merr masa për pregatitjen dhe ngritjen e kualifikimit të kuadrove puntore, ingjinero-teknike dhe drejtuese, duke organizuar shkolla dhe kurse siguron zhvillimin e gjithanëshëm të garave socialeste për realizimin dhe tejkalimin e planit të shtetit; merr masa për futjen dhe përhapjen në industri dhe në miniera të metodave sovietike dhe te punëtorëve përparimtarë të vendit.

gj) Kontrollon konditat e banimit dhe të jetesës së puntorëve, ingjinero-teknikëve dhe nëpunësave të ndërmarrjeve vartëse dhe merr masa për përmirësimin e tyre

h) Organizon shpërndarjen e prodhimeve të ndërmarrjeve vartëse, përpunon konditat kryesore të evadimit të mallrave dhe përfundon protokoll-marëveshtjen me institucionet furnitorë dhe konsumatore.

i) Siguron furnizimin e ndërmarrjeve dhe organizatave vartëse, drejton veprimtarinë e tyre financiare dhe përpunon projektet e çmimeve për prodhimet e ndërmarrjeve vartëse.

j) Rishpërndan midis ndërmarrjeve vartëse mjetet e xhiros, fitimet dhe fondet e çmortizuara, simbas rregullave në fuqi.

k) Studjon dhe kontrollon zbatimin e planeve kontabël, shqyrton dhe aprovan bilancet e ndërmarrjeve si dhe ushtron revizionimin financiar në gjithë sistemin e Ministrisë.

l) Merr masa për organizimin dhe forcimin e hozrashotit dhe disiplinën financiare në ndërmarrjet dhe organizatat vartëse, si dhe për uljen e kostos dhe sigurimin e rentabilitetit.

ll) Drejton kryerjen e ndërtimeve kapitale në ndërmarrjet vartëse të saj, si dhe aprovon simbas rregulloreve në fuqi projektet teknike dhe preventivet.

m) Organizon kontrollin dhe verifikimin e zbatimit të urdhërave për ndërmarrjet dhe organizatat vartëse.

n) Hap llogari buxhetore dhe llogari rrjedhëse në Bankë.

o) Boton revista për çështjet teknike, ekonomike dhe organizative për sektorin e industrisë dhe të minierave.

Neni 5.—

Në krye të Ministrisë qëndron Ministri, i cili drejton punët e Ministrisë të ndërmarrjeve dhe të organizatave vartës.

Neni 6.—

Ministri në punën e tij, ndihmohet prej zëv.ministrave, prej të cilëve njeri është zëvëndës i parë, dhe u cakton këtyre sektorin e punës u jep direktiva dhe urdhëra dhe kontrollon veprimtarinë e tyre.

Approved For Release 2009/06/15 : CIA-RDP83-00418R001100040009-2

Approved For Release 2009/06/15 : CIA-RDP83-00418R001100040009-2

Zëv.ministrat janë përgjegjës para Ministrit për gjithë veprimtarinë e sektorit që drejtohet prej tyre.

Neni 7.—

Ministri simbas nenit 68 të kushtetutës, brenda kufive të kompetencës së tij, jep urdhëra dhe udhëzime të detyrueshme në bazë të ligjeve dhe për zbatim të ligjeve në fuqi, të urdhëresave dhe të vendimeve të Qeverisë, kontrollon zbatimin e tyre dhe përgjigjet para Qeverisë për respektimin e të gjitha dispozitave që i përkasin industrisë dhe minierave.

Neni 8.—

Ministri ka këto të drejta dhe detyra :

a) Pezullon dhe anullon urdhërat dhe udhëzimet e ndërmarjeve dhe të organizatave vartëse të Ministrisë, kur këto janë në kundërshtim me ligjet, urdhëresat dhe vendimet e Qeverisë si dhe me urdhërat dhe udhëzimet e tij.

b) Propozon, emëron dhe bën lëvizjen e punonjësve të Ministrisë të ndërmarrjeve dhe të organizatave vartëse, simbas regullave në fuqi.

c) Firmon vetë ose zëvëndësit e tij pa ndonjë autorizim të veçantë ose persona të tjerë me autorizimin e tij, çdo lloj marrëveshje, detyrim dhe dekumenta me vlefтë.

ç) Aprovon rregulloret e ndërmarrjeve. të organizatave vartëse, të drejtorive të prodhimit. të drejtorive dhe të degëve të Ministrisë.

d) Bën rishpërndarjen e lëndës së parë, lëndës djegëse e materialeve midis ndërmarrjeve dhe organizatave vartëse brenda limitit total të aprovuar për Ministrinë, për sigurimin e realizimit të planit dhe të ndërtimeve kapitale.

dh) Autorizon ndërmarrjet që të mbulojnë tejkalimet e fondit të pagave. brenda limitit të fondit të pagave të aprovuar për Ministrinë,

e) Merr masa. disiplinore kundrejt drejtorave dhe nëpunësave të Ministrisë si drejtorave të ndërmarrjeve simbas dispozitave në fuqi.

ë) Ka të drejtë të autorizojë dhënie shpërblimesh dhe t'u japë të tilla punonjësve t'aparatit të Ministris dhe drejtorave të ndërmarrjeve në bazë të fondit aprovuar, por shpërblimi te mos kalojë një rrogë mujore.

f) Aprovon projektet dhe preventivat e objekteve nënlimit.

g) Aprovon ose refuzon vendimin e kryeinspektorit të Inspektoratit Shtetëror të paisjeve nën presion për ndalimin e punës së kaldajave që punojnë jashtë konditave teknike të aprovuara, për ndërmarrjet e të gjithë ministrive.

gj) Aprovon normat e prodhimit si dhe normat e shërbimit të maqinerisë për ndërmarrjet vartëse.

i) Është i detyruar të marrë të gjitha masat per kryerjen e detyrave që i ngarkohen Ministrisë dhe përgjigjet pare Këshillit të Ministrave për realizimin e plotë të planeve shtetërore t'aprovuara për ndërmerrjet dhe organizatat vartëse.

Neni. 9.—

Në Ministrinë e Industrisë dhe Minierave krijohet kolegjiumi i Ministrisë i përbërë nga Ministri (kryetar) nga zv. ministrat dhe nga punonjës e drejtonjës të Ministrisë.

Përbërja e kolegjumit aprovohet nga Këshilli i Ministrave mbi propozimin e Ministrit.

Kolegjumi në mbledhje të rregullta që bën,, shqyrton çështjet e udhë

Approved For Release 2009/06/15 : CIA-RDP83-00418R001100040009-2

Approved For Release 2009/06/15 : CIA-RDP83-00418R001100040009-2

heqjes praktike, e kontrollit të zbatimit të vendimeve dhe e zgjedhjes së kuadrove si dhe urdhërat dhe udhëzimet më të rëndësishme të Ministrit, si dhe dëgjon raportet e punonjësve drejtonjës të Ministrisë dhe të ndërmarrjeve dhe institucioneve vartëse.

Vendimet e kolegjiumit vihen në zbatim me anë urdhërash të Ministrit.

Në rast mos marëveshjeje midis Ministrit dhe kolegjiumit, Ministri, ve në zbatim vendimet e tij duke njoftuar Këshillin e Ministrave për mos marëveshjen e lindur, kurse anëtarët e kolegjiumit, nga ana e tyre, mund t' i drejtohen Këshillit të Ministrave.

Neni 10.—

Për të arritur në zgjidhjen më të mirë të problemeve teknike më të rëndësishme të Ministrisë dhe për të patur mendimin e më shumë ekspertëve teknikë mbi projektet, studimet teknike, novacionet më të rëndësishme dhe zbatimin e metodave të reja në punë, krijohet këshilli teknik si organ konsultativ i Ministrit për çështje me karakter kryekëput teknik.

Përbërja e këshillit teknik aprovohet nga Ministri. Këshilli teknik kryesohet prej Ministrit ose prej personave që cakton Ministri.

Neni 11

Struktura e Minitrisë së Industrisë dhe Minierave aprovohet nga Këshilli i Ministrave.

Detyrat e hollësishme për sektorët e ndryshëm të Ministrisë caktohen nga Ministri me rregullore të posaçme.

Neni 12

Me qëllim që të kalohet eksperienca e mirë nga një ndërmarrje në një tjetër të së njëjtës degë prodhimi, ose nga një degë prodhimi në një tjetër si dhe për të analizuar veprimtarin e një dege ose edhe problemë të rëndësishme me karakter të përbashkët për të gjithë sektorët si edhe për të dëgjuar referatet dhe diskutimet rreth vendimeve më të rëndësishme të Partisë dhe të Qeverisë, Ministria organizon mbledhje të aktivistëve më të mirë të një ose më shumë degë prodhimi, simbas rasteve që mund të paraqiten.

Neni 13

Ministria e Industrisë dhe Minierave ka vulën e saj me stemën e Republikës Popullore të Shqipërisë dhe me emrin e vetë.

Neni 14

Kjo rregullore hyn në fuqi menjëherë.

ZËV. KRYETARI I KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË R. P. SH.
HYSNI KAPO

M. 3 A.XH. V.P.

Approved For Release 2009/06/15 : CIA-RDP83-00418R001100040009-2

Approved For Release 2009/06/15 : CIA-RDP83-00418R001100040009-2

GAZETA ZYRTARE

E REPUBLIKËS POPULLORE TË SHQIPËRISË

30 Prill | Nr. 4 | Viti 1955

P Ë R M B A J T J A

Pjesa I

1) Ligje Nr. 2021 dt. 1-IV-1955 — Mbi aprovimin e buxhetit të Shtetit për vitin 1955 99-100

2) Ligje Nr. 2022 dt. 2-IV-1955 — Mbi pjesën e përgjithshme të kodit civil të Republikës Popullore të Shqipërisë. . 100-113

3) Ligje Nr. 2023 dt. 2-IV-1955 — Mbi zbatimin e pjesës së përgjithshme të kodit civil të Republikës Popullore të Shqipërisë. 113-114

4) Ligje Nr. 2024 dt. 2-IV-1955 — Mbi një ndryshim në nenin 92 të Kushtetutës së Republikës Popullore të Shqipërisë 114-115

5) Ligje Nr. 2025 dt. 2-IV-1955 — Mbi aprovimin e dekreteve të Presidiumit të Kuvendit Popullor të Republikës Popullore të Shqipërisë 115-116

6) Dekret Nr. 1995 dt. 21-II-1955 — Mbi dhënien e disa mullinjve shtetrorë kooperativave bujqësore 116-117

7) Dekret Nr. 2014 dt. 17-III-1955 — Mbi mbarimin e gjendjes së luftës midis Shqipërisë dhe Gjermanisë 118-118

8) Dekret Nr. 2017 dt. 18-III-1955 — Mbi thirjen e Kuvendit Popullor në sesion të II-të të zakonshëm të Legjislaturës së III-të 119-119

9) Dekret Nr. 2004 dt. 7-III-1955 — Mbi shtetëzimin e një godine. . . 119-119

10) Dekret Nr. 2005 dt. 7-III-1955 — Mbi ngritjen e shtetëzimit mbi godinën e Budin Petros dhe Andrea Pepa . . 119 120

11) Dekret Nr. 2013 dt. 14-III-1955 — Për një ndryshim në Qeveri . . . 120-120

12) Dekret Nr. 1999 dt. 21-II-1955 — Për akordim dekoratash 120-123

13) Dekret Nr. 2009 dt. 7-III-1955 — Për akordim dekoratash 123-126

14) Dekret Nr. 2012 dt. 7-III-1955 — Për akordim dekoratash 126-126

15) Dekret Nr. 2016 dt. 18-III-1955 — Për akordim dekoratash 126-127

16) Dekret Nr. 2020 dt. 25-III-1955 — Për akordim dekoratash 127-127

17) Dekret Nr. 2006 dt. 7-III-1955 — Mbi dhënie shtetësie 127-128

18) Dekret Nr. 2027 dt. 11-IV-1955 — Mbi ndryshimin e nenit 77 të ligjës Nr. 1763 mbi këshillat popullore . . . 128-129

19) Vend. Pres. K. P. Nr. 37 datë 2-IV-1955 — Mbi zgjedhjen e gjykatës së Lartë të Republikës Popullore të Shqipërisë . . 129-130

20) Vend. Pres. K. P. Nr. 36 datë 2-IV-1955. — Mbi ndryshime në Prokurorinë e Përgjithshme. 130-130

Pjesa II

21) Vend. Kësh. Ministrave Nr. 87 datë 11-III-1955 — Mbi vajin lubrifikant të djegur. . . 130-131

22) Vend. Kësh. Ministrave Nr. 105 dt. 4-IV-1955 — Mbi disa favorizime për anëtarët e kolektivave bujqësore 131-132

Approved For Release 2009/06/15 : CIA-RDP83-00418R001100040009-2

Approved For Release 2009/06/15 : CIA-RDP83-00418R001100040009-2

NDREQJE GABIMI

Në Gazetën Zyrtare Nr. 2 dt. 18 Shkurt 1955 në faqen 58 në radhën 30 mbas fjalëve «kuota prej 4%» duhet shtuar: «për të përballuar ndihmën mjeksore dhe pensionet që shteti u paguan.....»

NGA ADMINISTRATA E GAZETËS ZYRTARE

STASH 2204 — 52

Shtypur në 2.000 copë

N.SH.B. Stabilimenti «Mihal Duri» — Tiranë.

Approved For Release 2009/06/15 : CIA-RDP83-00418R001100040009-2

Approved For Release 2009/06/15 : CIA-RDP83-00418R001100040009-2

Pjesa e I-rë

LIGJË

mbi aprovimin e buxhetit të Shtetit për vitin 1955.

KUVENDI POPULLOR I REPUBLIKËS POPULLORE TË SHQIPËRISË

V E N D O S I :

Neni 1.—

Aprovohet Buxheti i Shtetit për vitin 1955 si vijon :

TARDHURA	Lekë	12.300.000.000
SHPENZIME	»	11.600.000.000
	Sufiçiti :	700.000.000

Neni 2.—

Aprovohet buxheti i Këshillave popullore të qarqeve si vijon :

QARKU :	T'ardhurat:	Shpenzimet:
1. Berat	162.550.000	162.550.000
2 Dibër	83,868.000	83.868.000
3. Durrës	191,234.000	191.234.000
4. Elbasan	191.157.000	191.157.000
5. Gjirokastër	185.294.000	185.294.000
6. Korçë	223.551.000	223.551.000
7. Kukës	66.554.000	66.554.000
8. Shkodër	259.412.000	259.412.000
9. Tiranë	401.093.000.	401.093.000
10. Vlorë	209.166.000	209.166 000
S H U M A :	1.973.879.000	1.973.879.000

Neni 3.—

Aprovohet pjesëmarrja e buxhetit të komiteteve ekzekutive të këshillave popullore të qarqeve nga t'ardhurat nacionale :

a) Mbi tatimin mbi xhiro, tatimi mbi ekonominë bujqësore dhe t'ardhurat nga S. M. T. në këto shuma absolute :

Qarku :	Tatimi mbi xhiro	Tat. Ekon, Bujq.	T'ardh. nga S.M.T.
1. Berat	11.480.000	32.000 000	12.820.000
2. Dibër	9.900.000	15.500.000	—
3 Durrës	34.040.000	21.000.000	14.104.000
4. Elbasan	45.000.000	50.100.000	7.500.000
5. Gjirokastër . . .	37.910.000	32.650.000	6.820.000
6. Korçë	39.450.000	16.500.000	8.700.000
7. Kukës	6.000.000	15.000.000	—
8. Shkodër	65.280.000	34.000.000	80.610.000
9. Tiranë	109 440.000	38.400.000	10.160.000
10. Vlorë.	42.780 000	26.000.000	15.980.000
Shuma;	401.280.000	281.150.000	84.694.000

b) Nga Huaja Shtetërore e fshatarësisë dhe popullatës qytetare nga tatimi mbi t'ardhurat dhe taksa e patentës së Kooperativave Tregëtare, t'artizanatit, nga tatimi mbi t'ardhurat e Kooperativës Bujqësore dhe nga tatimi mbi t'ardhurat e beqarëve të popullatës fshatare dhe qytetare në masënë 100.%

Approved For Release 2009/06/15 : CIA-RDP83-00418R001100040009-2

Approved For Release 2009/06/15 : CIA-RDP83-00418R001100040009-2

Neni 4.—

Aprovohet buxheti konsuntiv i Shtetit për vitin 1953 si vijon :

T'ardhura :	Lekë	10.537.028.036,50
Shpenzime :	»	9.985.473.776,50
Diferencë aktive :	»	551.554.260

Neni 5.—

Kjo ligjë hyn në fuqi nga data 1 janar 1955.

Tiranë, me 1 prill 1955

Nr. 2021

SEKRETARI I PRESIDIUMIT TE KUVENDIT POPULLOR TE R. P. SHQIPËRISE
Sami Baholli

KRYETARI I PRESIDIUMIT TË KUVENDIT POPULLOR TË R. P. SHQIPËRISË
Haxhi Lleshi

LIGJË

mbi pjesën e përgjithëshme të kodit civil të Republikës Popullore të Shqipërisë,

KUVENDI POPULLOR I REPUBLIKËS POPULLORE TË SHQIPËRISË

V E N D O S I :

Aprovimin e ligjës mbi pjesën e Përgjithëshme të kodit civil të Republikës Popullore të Shqipërisë.

KAPITULLI I I.

Dispozita themelore.

Neni 1.—

E drejta civile rregullon marëdhëniet pasurore midis organizatave socialiste, midis këtyre dhe shtetasve si dhe midis shtetasve.

E drejta civile bazohet në rendin shoqëror socialist të vendosur me Kushtetutën e Republikës Popullore të Shqipërisë.

Neni 2.—

Të drejtat civile mbrohen nga ligja.

Të drejtat civile nuk mund të ushtrohen në kundërshtim me detyrat e ndërtimit socialist ose me rregullat e bashkëjetesës socialiste.

Neni 3.—

Konfliktet që rrjedhin nga të drejtat civile zgjidhen, sipas rastit, nga gjykata ose nga arbitrazhi shtetëror, përveç kur në ligjë parashikohet ndryshe.

Neni 4.—

Dispozitat e ligjës interpretohen sipas kuptimit të tyre të vërtetë dhe në mënyrë që tu përgjigjen detyrave të ndërtimit socialist dhe rregullave të bashkëjetesës socialiste.

Neni 5.—

Kur mungojnë dispozita të ligjës, ose kur këto nuk janë të plota zbatohen dispozitat që rregullojnë raste të ngjasëshme, në qoftë se një zbatim i tillë u përgjigjet detyrave të ndërtimit socialist dhe rregullave të bashkëjetesës socialiste, kur kjo nuk është e mundur, zbatohen parimet themelore të së drejtës socialiste.

Neni 6.—

Dispozitat e ligjës kanë fuqi vetëm për marëdhëniet juridike civile që lindin pas hyrjes së tyre në fuqi. Zbatimi i tyre për marëdhëniet juridike që kanë lindur më parë lejohet vetëm kur parashikohet shprehimisht në ligjë

Approved For Release 2009/06/15 : CIA-RDP83-00418R001100040009-2

Approved For Release 2009/06/15 : CIA-RDP83-00418R001100040009-2

KAPITULLI I II.

Subjekte të së drejtës

I. P E R S O N A T

Zotësia Juridike

Neni. 7.—

Të gjithë personave, pa dallim seksi, kombësie, besimi dhe origjine u njihet zotësia juridike, d. m. th. zotësia për të patur të drejta dhe detyrime civile,

Në pajtim me këtë, çdo person gëzon të drejtën e punës; ka të drejtë të zgjedhë veprimtarinë dhe mjeshtrinë që nuk është e ndaluar dhe të marrë pjesë në organizatë shoqërore; gëzon të drejtën e pronësisë dhe të drejtën e trashëgimisë brënda kufijve të lejuar nga ligja; ka të drejtë të kryejë veprime juridike si dhe të gëzojë çdo të drejtë tjetër të njohur nga ligja.

Neni 8.—

Askush nuk mund të kufizohet në të drejtat civile, veçse në mënyrën dhe në rastet e caktuara në ligjë.

Çdo veprim juridik që kufizon zotësinë juridike është i pavlefshëm.

Neni. 9.—

Zotësia juridike fillon me lindjen e një personi gjallë dhe mbaron me vdekjen e tij.

Fëmija që nga koha e zënijes gëzon të drejtat civile në qoftë se lind e gjallë.

Neni 10.—

Kur dy ose më shumë persona kanë vdekur dhe nuk mund të provohet se kush prej tyre ka vdekur më parë, quhet se të gjithë kanë vdekur në një kohë.

Zotësia për të vepruar

Neni 11.—

Personi që ka mbushur moshën 18 vjeç (madhori) gëzon zotësi të plotë për të vepruar. d.m.th. zotësi që me veprimet e tij të fitojë të drejta dhe të marrë përsipër detyrime civile.

Zotësi të plotë për të vepruar fiton me anë të martesës edhe personi që nuk ka mbushur moshën 18 vjeç (i mituri) dhe nuk e humbet këtë zotësi edhe sikur martesa të deklarohet e pavlefshme ose të zgjidhet para se të ketë mbushur moshën 18 vjeç.

Neni 12.—

I mituri që nuk ka mbushur moshën 14 vjeç është i pazoti për të vepruar. Megjithatë ai mund të kryejë veprime juridike që i përshtatëten moshës së tij dhe që ekzekutohen aty për aty si dhe veprime juridike që i sjellin dobi pa asnjë kundër shpërblim. Veprimet e tjera juridike i kryen në emër të tij përfaqësuesi i tij ligjor (prindi, kujdestari).

Neni 13.

I mituri që ka mbushur moshën 14 vjeç mund të kryejë veprime juridike vetëm me pëlqimin paraprak të përfaqsuesit të tij ligjor (prind, kujdestar). Megjithatë ai mund të hyjë si anëtar në kooperativa dhe në organizata të tjera shoqërore, të lidhë kontratë pune dhe të disponojë lirisht atë

Approved For Release 2009/06/15 : CIA-RDP83-00418R001100040009-2

Approved For Release 2009/06/15 : CIA-RDP83-00418R001100040009-2

që fiton me punën e tij, të bëjë depozita në arkën e kursimit dhe ti disponojë vetë këto depozita.

I mituri që ka mbushur moshën 14 vjeç përgjigjet për dëmet e shkaktuara prej tij.

Neni 14.—

Personit që ka mbushur moshën 14 vjeç dhe që është krejt i pazoti të kujdeset për punët e tij për shkak sëmundjeje psihike ose zhvillimi mendor të metë, me vendim të gjykatës mund ti hiqet zotësia për të kryer veprime juridike.

Për këtë person zbatohen dispozitat e nenit 12

Neni 15.—

Madhorit që për shkak sëmundjeje psihike ose zhvillimi mendor të metë nuk është krejt i pazoti të kujdeset për punët e tij, me vendim të gjykatës mund ti kufizohet zotësia për të kryer veprime juridike.

Për këtë person zbatohen dispozitat e nenit 13.

Neni 16.

Çdo veprim juridik që kufizon zotësinë për të vepruar është i pavlefshëm.

BANIMI

Neni 17.—

Banimi është vëndi ku personi,për shkak të shërbimit, të punës së përhershme ose të ndodhjes së pasurisë, qëndron zakonisht ose të shumtën e kohës.

Neni 18.—

Të miturit që nuk kanë mbushur moshën 14 vjeç si dhe ata të cilëve u është hequr zotësia për të vepruar (neni 14) kanë për banim atë të përfaqësuesve të tyre ligjorë.

Kur prindërit që ushtrojnë të drejtën prindërore kanë banime të ndryshme, fëmija e tyre nën 14 vjeç ka për banim atë të prindit pranë të cilit jeton.

Deklarimi i zhdukjes ose i vdekjes së një personi

Neni 19.

Një person që mungon nga vëndi i banimit të tij dhe për të cilin nuk ka lajme për një kohë më shumë se një vit, me kërkesën e çdo të interesuari, mund të deklarohet me vendim të gjykatës i zhdukur.

Kur dita e lajmeve të fundit nuk mund të caktohet, afati një vjeçar fillon nga dita 1 e muajit që vjen pas atij në të cilin janë marrë lajmet e fundit, dhe kur nuk mund të caktohet as muaji , nga dita 1 janar e vitit të mëpasmë.

Me deklarimin e çdukjes së një personi, për pasurinë e tij caktohet kujdestar sipas rregullave të përgjithëshme.

Neni 20.—

Personi që është deklaruar i çdukur, me kërkesën e çdo të interesuari, mund të deklarohet me vëndim të gjykatës i vdekur kur kanë kaluar 3 vjet nga dita që është dhënë vendimi i deklarimit të çdukjes.

Neni 21

Një person që ka humbur gjatë veprimeve luftarake dhe kjo humbje vërtetohet nga organet kompetente ushtarake, mund të deklarohet i vdekur

Approved For Release 2009/06/15 : CIA-RDP83-00418R001100040009-2

Approved For Release 2009/06/15 : CIA-RDP83-00418R001100040009-2

kur kanë kaluar dy vjet nga mbarimi i veprimeve luftarake, pa qenë e nevojshme që të deklarohet më parë i çdukur.

Neni 22.—

Një person që ka humbur gjatë një fatkeqësie në rrethana të tilla që bëjnë të besohet se ka vdekur, mund të deklarohet i vdekur kur ka kaluar një vit nga dita që ka ngjarë fatkeqësia, pa qenë e nevojëshme që të deklarohet më parë i çdukur.

Kur nuk mund të caktohet dita në të cilën ka ndodhur fatkeqësia, afati një vjeçar fillon nga dita 1 e muajit që vjen pas atij në të cilin ka ndodhur fatkeqësia, dhe, kur nuk mund të caktohet as muaji, nga dita janar e vitit të mëpasmë.

Neni 23

Gjykata, kur deklaron vdekjen e një personi të çdukur, cakton ditën që pranon se duhet të ketë ngjarë vdekja. Në qoftë se kjo ditë nuk është e mundur të dihet, si ditë të vdekjes gjykata cakton ditën e fundit të afateve të parashikuara, sipas rastit, nga nenet 20, 21 dhe 22.

Kur më pas del se personi ka vdekur në një ditë tjetër nga ajo e caktuar në vendimin, me kërkesën e çdo të interesuari, data e vdekjes ndryshohet nga gjykata që ka dhënë vendimin.

Vdekja e deklaruar me vendim të gjykatës barazohet në të gjitha pasojat me vdekjen e vërtetë.

Neni 24

Kur personi që është deklaruar i vdekur del se është gjallë, me kërkesën e çdo të interesuari, vendimi që ka deklaruar vdekjen prishet nga gjykata që e ka dhënë.

Martesa e zgjidhur me deklarimin e vdekjes bëhet prapë e vlefëshme, përveç kur bashkëshorti i personit të deklaruar të vdekur ka lidhur martesë tjetër.

Personi i deklaruar i vdekur që del se është gjallë ka të drejtë të kërkojë në çdo kohë pasurinë e tij dhe pasurinë e fituar me anën e asaj nga personat të cilëve kjo pasuri u ka kaluar për shkak të deklarimit të vdekjes së tij. Gjithashtu ai ka të drejtë të kërkojë në çdo kohë pasurinë e tij edhe nga personat e tretë që e kanë fituar nga ata të cilëve u ka kaluar kjo pasuri për shkak të deklarimit të vdekjes së tij, por vetëm kur këta e dinin se personi i deklaruar i vdekur ishte gjallë, ose kur e kanë fituar këtë pasuri pa kundër shpërblim.

II. PERSONAT JURIDIKË

Kuptimi i personit juridik

Neni 25.—

Personat juridikë janë institucionet, ndërmarrjet dhe organizatat të cilat në emër të tyre mund fitojnë të drejta pasurore, të marrin përsipër detyrime dhe të jenë paditës dhe të paditur në gjyq.

Në pajtim me këtë, janë persona juridikë: këshillat popullore, institucionet shtetërore buxhetore, që kanë llogari të pavarur, ndërmarrjet dhe organizatat ekonomike shtetërore që veprojnë në hozrasçot, organizatat kooperativiste dhe shoqërore si dhe ndërmarrjet dhe institucionet e krijuara pranë tyre dhe çdo organizatë tjetër e njohur posaçërisht nga ligja si person juridik.

Approved For Release 2009/06/15 : CIA-RDP83-00418R001100040009-2

Approved For Release 2009/06/15 : CIA-RDP83-00418R001100040009-2

Neni 26.—

Shteti paraqitet si subjekt të drejtash dhe detyrimesh vetëm në marëdhëniet juridike që lindin nga disponimi drejt për drejt prej tij i mjeteve buxhetore dhe i pasurisë shtetërore që nuk u është dhënë për administrim organeve të ndryshme shtetërore si dhe në marëdhëniet e tjera juridike në të cilat ai merr pjesë drejt për drejt.

Në rastet e treguara më sipër, në emer të shtetit vepron Ministria e Financave dhe organet financiare lokale, përveç kur ligja cakton për këtë qëllim organe të tjera.

Krijimi i personit juridik.

Neni 27.—

Personi juridik krijohet:

a) me akt të organit shtetëror kompetent;

b) me akt të atyre që e themelojnë, i aprovuar nga organi shtetëror kompetent i cili kontrollon nëse janë plotësuar kushtet e parashikuara nga ligja për krijimin e këtij personi juridik;

c) me akt të atyre që e themelojnë pasi të jetë dhënë më parë pëlqimi i organit shtetëror kompetent i cili çmon në se është e dobishme që të krijohet ky person juridik;

ç) me çdo mënyrë tjetër të parashikuar nga ligja.

Neni 28.—

Institucionet shtetërore mund të krijohen si persona juridikë me ligjë, ose me vendim të qeverisë, kurse ndërmarrjet dhe organizatat ekonomike shtetërore edhe me vendim të këshillave popullore në kushtet e parashikuara nga ligja.

Institucionet dhe ndërmarrjet ndihmëse krijohen po në mënyrën e sipërme ose edhe me vendim të institucionit, ndërmarrjes eos organizatës shtetërore pranë të cilëve krijohen në qoftë se një mënyrë e tillë krijimi është lejuar nga ligja ose nga vendimi i qeverisë.

Neni 29

Organizatat kooperativiste si dhe institucionet dhe ndërmarrjet pranë tyre njihen si persona juridikë me aprovimin e krijimit të tyre nga organi shtetëror kompetent dhe në kushtat e parashikuara nga ligja.

Bashkimet kooperativiste njihen si persona juridikë pasi të jetë dhënë më parë pëlqimi për krijimin e tyre nga bashkimi kooperativist më i lartë.

Neni 30

Organizatat shoqërore që nuk ndjekin qëllime ekonomike, si organizatat sportive dhe të mbrojtjes, shoqatat kulturale, teknike dhe shkencore, si dhe institucionet dhe ndërmarrjet pranë tyre njihen si persona juridikë pasi të jetë dhënë më parë pëlqimi për krijimin e tyre nga organi shtetëror kompetent dhe në kushtet e parashikuara nga ligja.

Organizatat e bashkimeve profesionale njihen si persona juridike pasi të jetë dhënë më parë pëlqimi për krijimin e tyre nga këshilli qendror i bashkimeve profesionale.

Neni 31.—

Personat juridikë, në rastet e parashikuara nga ligja, duhet të regjistrohen në organet kompetente.

Approved For Release 2009/06/15 : CIA-RDP83-00418R001100040009-2

Approved For Release 2009/06/15 : CIA-RDP83-00418R001100040009-2

Zotësia e personit juridik

Neni 32.

Personi juridik ka zotësi të fitojë të drejta dhe të marrë përsipër detyrime që nga koha e krijimit të tij dhe, në rastet që duhet të rregjistrohet, që nga koha e rregjistrimit.

Neni 33.—

Personi juridik mund të kryejë vetëm ato veprime juridike që janë në pajtim me qëllimet e veprimtaris së tij të caktuara në ligjën, në aktin e krijimit në statutin ose rregulloren.

Çdo veprim juridik i kryer në kundërshtim me qëllimet e veprimtarisë së personit juridik është i pavlefshëm.

Neni 34.—

Personi juridik vepron me anën e organeve të tij të parashikuar në ligjë, statut ose rregullore.

Veprimet juridike të kryera nga organet e personit juridik, brënda kufijve të kompetencës së tyre, quhen si veprime të vetë personit juridik.

Përgjegjësija e personit juridik

Neni 35.—

Personi juridik është përgjegjës për dëmet e shkaktuara nga organet e tij në kryerjen e detyrave të tyre.

Neni 36.

Personi juridik përgjigjet për detyrimet me pasurinë e tij brënda kufijve të caktuara në ligjë.

Neni 37.

Shteti dhe personat juridike shtetërore, organizatat ekonomike shtetërore, kooperativiste ose shoqërore dhe institucionet ose ndërmarrjet e tyre, organizatat kooperativiste ose shoqërore më të larta dhe organizatat e njëjta më të ulta, anëtar ose jo të tyre, nuk përgjigjen për detyrimet e njeri tjetrit, përveç kur kjo është pranuar prej tyre ose është parashikuar shprehimisht në ligjë.

Shteti gjithashtu nuk përgjigjet për detyrimet që lindin nga veprimet e tregëtisë së jashtëme të kryera nga ndërmarrjet shtetërore të importit dhe eksportit përveç kur shteti ka pranuar shprehimisht një përgjegjësi të tillë.

Të drejtat dhe detyrat e anëtarëve të organizatave kooperativiste dhe shoqërore.

Neni 38.—

Hyrja si anëtar në organizatën kooperatviste ose shoqërore dhe dalja nga ajo është e lirë, por në kushtet e parashikuara nga statuti.

Anëtari mund të përjashtohet nga organizata, në rastet e parashikuara nga statuti ose kur ka shkaqe me rëndësi, me vendim të organit kompetent të organizatës, i cili, kur nuk tregohet në statut, është mbledhja e anëtarëve të organizatës.

Kundër vendimit të përjashtimit nga organizata anëtari ka të drejtë të bëjë ankim në gjykatën popullore në rast se nuk parashikohet nga statuti një organ tjetër kompetent për shqyrtimin e ankesës ose për aprovimin e vendimit të përjashtimit.

Approved For Release 2009/06/15 : CIA-RDP83-00418R001100040009-2

Approved For Release 2009/06/15 : CIA-RDP83-00418R001100040009-2

Neni 39

Të gjithë anëtarët kanë të drejta të barabarta për të marrë pjesë në administrimin e punëve të organizatës dhe për të përfituar nga shërbimet e saj.

Anëtarët kanë të drejtë të marrin pjesë në mbledhjet e organizatës si dhe të zgjedhin dhe të zgjidhen në organet drejtonjëse të organizatës.

Neni 40

Cilësia e anëtarit të organizatës nuk mund ti kalojë një tjetri dhe as të trashëgohet.

Neni 41

Anëtari i organizatës kooperativiste të prodhimit ka për detyrë të marrë pjesë me punën e tij personale në veprimtarinë e organizatës dhe, sipas punës që kryen, ka të drejtë të marrë një shpërblim, në të holla ose në natyrë, nga të ardhurat e organizatës.

Neni 42.—

Anëtarët e organizatës kooperativiste dhe shoqërore nuk përgjigjen për detyrimet e organizatës, përveç rasteve dhe në masën që një përgjegjësi e tillë parashikohet nga statuti i organizatës kooperativiste.

Qendra dhe emëri i personit juridik

Neni 43.—

Personi juridik ka qendrën e tij atje ku ndodhet organi drejtues i tij

Neni 44

Personi juridik ka emërin e tij.

Emëri i organizatës ekonomike është firma e saj, e cila duhet të tregojë sidomos qëllimin e veprimtarisë së saj.

Mbarimi i personit juridik

Neni 45

Personi juridik mbaron me shkrirje, thithje dhe ndarje ose me shpërndarje.

Neni 46.—

Me shkrirjen dy ose më shumë persona juridikë bashkohen dhe formojnë një person juridik të ri.

Me thithjen një ose më shumë persona juridikë thithen nga një ose më shumë persona juridikë të tjerë që ekzistojnë.

Me ndarjen gjithë pasuria e një personi juridik ndahet ndërmjet dy ose më shumë personave juridikë që krijohen rishtas.

Neni 47

Personi juridik nuk mbaron kur vetëm një pjesë e pasuris së tij çkëputet nga ai dhe kalon në një ose më shum persona juridikë të tjerë që ekzistojnë ose që krijohen rishtas.

Neni 48.—

Me shpërndarjen personi juridik pushon veprimtarinë e tij dhe vihet në likuidim.

Neni 49.—

Shkrirja, thithja, ndarja dhe shpërndarja e institucioneve, ndërmarrjeve dhe organizatave të tjera ekonomike si dhe çkëputja e një pjese të pa-

Approved For Release 2009/06/15 : CIA-RDP83-00418R001100040009-2

Approved For Release 2009/06/15 : CIA-RDP83-00418R001100040009-2

surisë së tyre, bëhen me ligjë ose me vendim të organit shtetëror që i ka krijuar.

Neni 50.—

Shkrirja thithja, ndarja dhe shpërndarja e organizatave kooperativiste si dhe çkëputja e një pjese të pasurisë së tyre bëhen me vendim të organeve kompetente të tyre, kurse e organizatave të tjera shoqërore si me vendim të organeve kompetente të tyre ashtu dhe me vendim të organizatave më të larta nga të cilat ato varen.

Shpërndarja e organizatave kooperativiste dhe shoqërore bëhet edhe vet vetiu kur koha për të cilën u krijua organizata është plotësuar, kur qëllimi i saj është përmbushur ose nuk ka mundësi të përmbushet si dhe kur numuri i anëtarëve të organizatës ka zbritur nën numurin e caktuar në ligjë ose në aktin e krijimit.

Organizatat kooperativiste dhe shoqërore mund të shpërndahen edhe me akt të organit shtetëror kompetent por vetëm kur ato largohen nga qëllimet e caktuara në statut, kur veprimtaria e tyre zhvillohet në kundërshtim me interesat e shtetit ose me rregullat e bashkëjetesës socialiste si dhe kur ato bëhen të panevojëshme nga ndryshimi i kushteve të ndërtimit ekonomik, kultural dhe shoqëror.

Neni 51.

Me shkrirjen, të drejtat dhe detyrimet e personave juridikë të shkrirë i kalojnë personit juridik të ri.

Me thithjen, të drejtat dhe detyrimet e personave juridike të thithur i kalojnë personit juridik që i ka thithur.

Neni 52.

Me ndarjen, të drejtat dhe detyrimet e personit juridik, pasuria e të cilit ndahet ndërmjet personave juridikë të tjerë, u kalojnë këtyre personave në mënyrën që tregohet në aktin për ndarjen e personit juridik.

Neni 53.—

Me çkëputjen, të drejtat dhe detyrimet e personit juridik nga i cili çkëputet një pjesë e pasurisë, ndahen midis këtij dhe personave juridikë të cilëve u kalon pasuria në mënyrën që tregohet në aktin për çkëputjen e pasurisë.

Neni 54.

Kalimi i të drejtave dhe i detyrimeve në rast shkrirjeje, thithjeje, ndarjeje dhe shkëputjeje të personave juridikë, për të cilët kërkohet rregjistrimi, sjell pasoja vetëm me rregjistrimin e veprimit përkatës dhe qysh nga koha e rregjistrimit.

Për personat juridikë, për të cilët nuk kërkohet regjistrimi, kalimi i të drejtave dhe i detyrimeve, në rastet e parashikuara nga paragrafi i sipërmë, sjell pasoja qysh nga koha e aprovimit të bilancit të ndarjes ose të bilancit përkatës nga organi kompetent.

Neni 55

Likuidimi i personit juridik të shpërndarë bëhet me realizimin e të drejtave dhe pagimin e detyrimeve nga komisioni i likuidimit i caktuar nga organi që ka vendosur shpërndarjen e tij.

Neni 56.

Pasuria e organizatës kooperativiste ose shoqërore të shpërndarë, që mbetet pas likuidimit, disponohet në mënyrën e parashikuar në aktin e kri-

Approved For Release 2009/06/15 : CIA-RDP83-00418R001100040009-2

Approved For Release 2009/06/15 : CIA-RDP83-00418R001100040009-2

jimit në statutin ose në aktin e organit që ka vendosur shpërndarjen.

Në çdo rast pasuria që mbetet pas likuidimit nuk mund tu ndahet anëtarëve t'organizatës së shpërndarë me përjashtim të fondit të kuotave të organizatës kooperativiste.

Neni 57

Kur personi juridik shpërndahet për shkak se veprimtaria e tij zhvillohet në kundërshtim me interesat e shtetit ose me rregullat e bashkëjetesës socialiste pasuria e mbetur pas likuidimit i kalon shtetit.

II. MBROJTJA E TË DREJTAVE PERSONALE JO PASURORE

Neni 58

Personit, të cilit i cënohet e drejta e emërit ose pseudonimit, e drejta e autorit ose çpikësit, nderi dhe çdo e drejtë tjetër personale jo pasurore mund të kërkojë nga gjykata njohjen e së drejtës së tij, pushimin e cënimit, rivendosjen e së drejtës që i është cënuar dhe, në rast se i është shkaktuar një dëm material, shpërblimin e dëmit sipas rregullave të përgjithëshme.

Të drejtat personale jo pasurore mbrohen edhe pas vdekjes.

Dispozitat e paragrafit të parë të këtij neni zbatohen edhe për personat juridikë.

IV. ZOTËSIA JURIDIKE E TË HUAJVE

Neni 59

Zotësia juridike e të huajve rregullohet nga traktatet që Republika Popullore e Shqipërisë ka lidhur me shtetet e tyre.

Kur mungojnë traktatet, të huajt kanë po ato të drejta civile që u njihen shtetasve shqiptarë. Megjithatë, me ligjë ose me dispozita të Qeverisë mund të vihen kufizime.

Neni 60

Personat juridikë të huaj mund të zhvillojnë veprimtarinë e tyre në Republikën Popullore të Shqipërisë vetëm me autorizim të posaçëm të Qeverisë.

Personat juridikë të huaj që nuk kanë këtë autorizim gëzojnë mbrojtjen gjyqësore në Republikën Popullore të Shqipërisë për të drejtat e tyre që kanë lindur jasht shtetit kundër personave që banojnë në Republikën Popullore të Shqipërisë, por me kusht që një mbrojtje të tillë gjyqësore të gëzojnë edhe personat juridikë shqiptarë në shtetet e huaj.

KAPITULLI III

PËRFAQËSIMI

Neni 61

Kuptimi dhe llojet e përfaqësimit

Një person mund të kryejë veprime juridike, edhe me anë të një personi tjetër që ka zotësi për të vepruar (përfaqsues), përveç kur përfaqësimi nuk lejohet sipas ligjës.

E drejta për të përfaqësuar mund të bazohet në ligjë (përfaqësimi ligjor) ose në vullnetin e të përfaqësuarit (prokura).

Approved For Release 2009/06/15 : CIA-RDP83-00418R001100040009-2

Approved For Release 2009/06/15 : CIA-RDP83-00418R001100040009-2

Kufijtë dhe pasojat e përfaqësimit

Neni 62.—

Veprimet juridike të kryera nga përfaqësuesi në emër dhe në dobi të të përfaqësuarit, brënda kufijve të të drejtave që i janë dhënë, sjellin pasoja drejt për drejt për të përfaqësuarin.

Neni 63.—

Kufijtë e të drejtave të përfaqësuesit ligjor caktohen nga dispozitat që parashikojnë emërimin e këtij përfaqësuesi, kurse kufijtë e të drejtave të përfaqësuesit të emëruar nga i përfaqësuari caktohen në prokurë. Të drejtat e përfaqësuesit mund të nxirren edhe nga rrethanat në të cilat kryhen veprimet përkatëse.

Kur për kryerjen e një veprimi janë caktuar si përfaqësues dy ose më shum persona, sejcili nga këta mund të veprojë veç e veç, në qoftë se në prokurë nuk është parashikuar ndryshe.

Neni 64 —

Veprimi juridik i kryer nga përfaqësuesi mund të deklarohet i pavlefshëm për të përfaqësuarin kur vullneti i përfaqësuesit është me ves.

Në rastet në të cilat ka rëndësi për veprimin juridik dijenia ose padijenia e rrethanave të caktuara merret parasyshë personi i përfaqësuesit.

Neni 65.—

Përfaqësuesi nuk mund të kryej veprime juridike në emër të të përfaqësuarit as me veten e tij as me persona të tretë të përfaqësuar nga ai.

Neni 66.—

Veprimi juridik i kryer në dëm të të përfaqësuarit për shkak marëveshjeje me keqbesim midis përfaqësuesit dhe personit të tretë mund të deklarohet i pavlefshëm për të përfaqësuarin.

Neni 67.

Përfaqësuesi detyrohet të veprojë personalisht dhe nuk mund të emërojë një zëvëndës të tij, përveç kur është lejuar për këtë nga i përfaqësuari ose kur kjo shihet e nevojëshme për mbrojtjen e interesave të të përfaqësuarit.

Përfaqësuesi duhet të njoftojë menjëherë të përfaqësuarin për zëvëndësin që ka zgjedhur, për ndryshe ai përgjigjet për veprimet e zëvëndësit si për veprimet e tij.

Zëvëndësi mund të revokohet në çdo kohë si nga i përfaqësuari ashtu dhe nga përfaqësuesi që e ka emëruar.

Neni 68.

Kur një person vepron si përfaqësues pa patur këtë cilësi ose kur përfaqësuesi kapërcen kufijtë e të drejtave që i janë dhënë, veprimi juridik i kryer nuk është i detyrueshëm për personin, në emër të të cilit është kryer përveç kur ky e ka aprovuar këtë veprim. Kur veprimi nuk aprovohet, personi që ka vepruar si përfaqësues pa patur këtë cilësi ose që ka kapërcyer kufijtë e të drejtave të tij, detyrohet ti shpërblejë dëmin personit të tretë që ka qenë në mirëbesim.

Përfaqësimi me prokurë

Neni 69.

Prokura për të lidhur një kontratë e cila sipas ligjës mund të bëhet

Approved For Release 2009/06/15 : CIA-RDP83-00418R001100040009-2

Approved For Release 2009/06/15 : CIA-RDP83-00418R001100040009-2

vetëm me akt noterial si dhe prokura për të kryer veprime para gjykatave dhe institucioneve të tjera shtetërore duhet të jepet me akt të përpilluar ose të vërtetuar nga noteri për ndryshe është e pavlefshme, përveç kur me dispozita të veçanta lejohet që vërtetimi i prokurës të bëhet në një mënyrë tjetër.

Prokura në emër të institucioneve, ndërmarrjeve dhe organizatave shtetërore, kooperativiste ose shoqërore mund të jepet edhe vetëm me nënshkrimin e drejtonjësit dhe me vulën e institucionit, ndërmarrjes ose organizatës.

Neni 70.

Prokura për të lidhur një kontratë e cila sipas ligjës mund të bëhet vetëm me shkresë, duhet të jepet po me shkresë për ndryshe është e pa vlefshme.

Neni 71.

I përfaqësuari mund të revokojë prokurën dhe përfaqësuesi të heqë dorë nga ajo në çdo kohë. Çdo marëveshje e kundertë është e pa vlefshme

Neni 72

Prokura merr fund: a) kur përfaqësuesi ka kryer veprimet juridike për të cilat ishte dhënë prokura; b) kur ka kaluar afati për të cilin ishte dhënë prokura; c) kur i përfaqësuari ka revokuar prokurën ose ka vdekur ose ka humbur zotësinë për të vepruarë; ç) kur përfaqësuesi ka hequr dorë nga prokura ose ka vdekur ose ka humbur zotësinë për të vepruarë; d) kur ka mbaruar personi juridik që ka dhënë prokurën ose që ka qenë emëruar si përfaqësues.

Neni 73.

Veprimet juridike të kryera nga përfaqësuesi, pas ndryshimeve të bëra në prokurë ose pas marrjes fund të prokurës, janë të detyrueshme për të përfaqësuarin ose për trashëgimtarët e tij në qoftë se personat e tretë me të cilët janë lidhur ato veprime nuk kanë patur dijeni për ndryshimet ose marrjen fund të prokurës.

Neni 74.

Kur prokura ka marrë fund, me kërkesën e të përfaqësuarit, përfaqësuesi duhet ti kthejë atij aktin e prokurës.

KAPITULLI I IV.

P A R A S H K R I M I

Dispozita të Përgjithëshme

Neni 75

E drejta për të kërkuar realizimin e një të drejte civile në mënyrë të detyrueshme (e drejta e padisë) shuhet në qoftë se nuk ushtrohet brënda kohës së caktuar nga ligja (parashkrimi shuës).

Neni 76.

Nuk parashkruhet e drejta e padis së shtetit, kooperativave dhe organizatave të tjera shoqërore për kërkimin e pasuris së tyre të lujtëshme ose të paluejtëshme, nga cilido posedues i paligjëshëm.

E drejta e padis së shtetit për kërkimin e pasurisë shtetërore nuk parashkruhet as kundrejt kooperativave dhe organizatave të tjera shoqërore.

Gjithashtu nuk parashkruhet e drejta e shtetit për të kërkuar nxjerrjen e tatimeve, taksave dhe pagesave të tjera të detyrueshme.

Approved For Release 2009/06/15 : CIA-RDP83-00418R001100040009-2

Approved For Release 2009/06/15 : CIA-RDP83-00418R001100040009-2

Neni 77.

Parashkrimi fillon nga çasti që lind e drejta e padisë.

Për detyrimet që ekzekutohen me kërkesën e kreditorit, parashkrimi fillon që kur lind detyrimi.

Në konfliktet midis institucioneve, ndërmarrjeve ose organizatave shtetërore, kooperativiste ose shoqërore që rrjedhin nga furnizimi i mallrave me cilësi në kundërshtim me kushtet e kontratës, parashkrimi fillon nga dita e përpillimit të aktit të verifikimit për cilësinë e mallit dhe kur akti i verifikimit nuk është përpilluar, nga dita e mbarimit të afatit për përpillimin e tij.

Neni 78.

Me parashkrimin e padisë për kërkesën kryesore parashkruhen edhe paditë për kërkesat e tjera që rrjedhin prej saj edhe sikur për këta të mos jetë plotësuar koha e parashkrimit.

Neni 79.

Personi që ka ekzekutuar detyrimin e tij pas plotësimit të parashkrimit' nuk mund të kërkojë kthimin e asaj që ka dhënë edhe sikur të mos dinte se kishte kaluar koha e parashkrimit.

Neni 80.

Nuk është e vlefshme marëveshja e palëve për zgjatjen ose shkurtimin e kohës së parashkrimit, përveç rasteve të parashikuara nga ligja.

Nuk është e vlefshme heqja dorë nga parashkrimi qoftë edhe pas plotësimit të tij.

Neni 81.

Parashkrimi i plotësuar meret parasyshë nga gjykata edhe pa u kërkuar nga pala e interesuar.

Afatet e parashkrimit

Neni 82.

Kur në ligjë nuk caktohet ndryshe, e drejta e padisë parashkruhet:

a) me kalimin e një viti e gjysmë në konfliktet midis institucioneve, ndërmarrjeve dhe organizatave shtetërore, kooperativiste ose shoqërore;

b) me kalimin e tre vjetëve për konfliktet midis privatëve ose midis privatëve dhe institucioneve, ndërmarrjeve ose organizatave shtetërore, kooperativist ose shoqërore, me përjashtim të konflikteve në lidhje me të drejtat mbi pasuritë e palujtëshme për të cilat e drejta e padisë parashkruhet me kalimin e 6 vjetëve.

Neni 83.

E drejta e padisë parashkruhet:

a) Me kalimin e gjashtë muajve për paditë që rrjedhin nga furnizimi i mallrave me cilësi në kundërshtim me kushtet e kontratës;

b) me kalimin e gjashtë muajve për paditë në lidhje me gjobat, penalitetet dhe kushtet penale;

c) me kalimin e gjashtë muajve për paditë që rrjedhin nga transportimet direkte të mallrave dhe pasagjerëve me anë të hekur-udhës, anijeve, automobilave ose aeroplaneve dhe një viti për të njëjtat padi që rjedhin nga transportime të përziera:

ç) me kalimin e një viti për paditë e anëtarëve të kooperativave bujqësore në lidhje me ditët e punës.

Approved For Release 2009/06/15 : CIA-RDP83-00418R001100040009-2

Approved For Release 2009/06/15 : CIA-RDP83-00418R001100040009-2

d) me kalimin e dy vjetëve për paditë të lidhje me pagimin e shpërblimit sipas kontratës së sigurimit.

Neni 84.

E drejta për të kërkuar ekzekutimin e një vendimi të formës së prerë të gjykatës ose të arbitrazhit shtetëror ose të një akti tjetër ekzekutiv, parashkruhet me kalimin e një viti në konfliktet midis institucioneve, ndërmarrjeve ose organizatave shtetërore, kooperativiste ose shoqërore dhe me kalimin e gjashtë vjetëve në të gjitha rastet e tjera, edhe sikur e drejta e padisë në vet-vehte ti shtrohet një parashkrimi tjetër më të gjatë ose më të shkurtër.

Neni 85.

Gjykata ose arbitrazh shtetëror mund të zgjatë afatin e parashkrimit edhe kryesisht ku i gjenë të bazuara shkaqet për të cilat u la të plotësohet parashkrimi.

Megjithatë nuk lejohet zgjatja e parashkrimeve të shkurtëra të parashikuara nga neni 83 i këtij kodi ose nga ligjet e tjera, përveç kur vetë ligja parashikon ndryshe.

Pezullimi i parashkrimit

Neni 86.

Parashkrimi pezullohet kur ka forcë madhore, kur shpallet moratoriumi i detyrimeve ose kur pala, qoftë paditësi qoftë i padituri, është në ushtrinë popullore që ndodhet në gjëndje lufte dhe përsa kohë vazhdon kjo gjëndje në qoftë se këto rrethana kanë ngjarë në gjashtë muajt e fundit të afatit të parashkrimit.

Neni 87.

Parashkrimi pezullohet:

a) midis bashkëshortëve:

b) midis fëmijve dhe prindërve, gjersa këta ushtrojnë të drejtën prindërore:

c) midis personave që ndodhen në kujdestari dhe kujdestarëve të tyre;

ç) paditë e të miturve dhe personave të tjerë që nuk kanë zotësi për të vepruar gjersa të emërohet përfaqësuesi ligjor ose të bëhen të zotë për të vepruar dhe gjashtë muaj pas emërimit të përfaqësuesit ose të pushimit të pazotësisë.

Neni 88.

Koha e pezullimit nuk llogaritet në afatin e parashkrimit.

Pas pushimit të pezullimit parashkrimi vazhdon dhe kur koha që mbetet është më e shkurtër se gjashtë muaj, afati i parashkrimit zgjatet edhe për gjashtë muaj.

Ndërprerja e parashkrimit

Neni 89.

Parashkrimi ndërpritet:

a) me çdo veprim të të detyruarit që përmban njohen e së drejtës. njohja e së drejtës nuk vlen për ndërprerje e parashkrimit në konfliktet midis institucioneve, ndërmarrjeve ose organizatave shtetërore, kooperativiste ose shoqërore:

Approved For Release 2009/06/15 : CIA-RDP83-00418R001100040009-2

Approved For Release 2009/06/15 : CIA-RDP83-00418R001100040009-2

b) me paraqitjen e kërkesës padisë, qoftë edhe në një gjykatë ose arbitrazh shtetëror që nuk është kompetent;

c) me paraqitjen e kërkesës për ekzekutim të vendimit ose të aktit ekzekutiv.

Neni 90

Koha e kaluar para ndërprerjes së parashkrimit nuk llogaritet dhe nga ndërprerja fillon një afat i ri parashkrimi.

Neni 91 —

Kur parashkrimi ndërpritet për shkak të paraqitjes së kërkesë padisë afati i ri i parashkrimit fillon nga çasti që vendimi me të cilin zgjidhet çeshtja në themel merr formën e prerë.

Kur vendoset rrëzimi i kërkesë padisë pa u zgjidhur çeshtja në themel si dhe kur vendoset shuarja e gjykimit të çështjes parashkrimi nuk quhet i ndërprerë, përveç kur rrëzimi bëhet për shkak inkompetence. Në këtë rast afati i ri i parashkrimit fillon nga çasti i paraqitjes së kërkesë padisë që u rrëzua.

Neni 92 —

Kur gjykimi i çeshtjes pezullohet, afati i ri i parashkrimit fillon:

a) kur pezullimi i gjykimit vendoset për shkak të vdekjes së njerës nga palët ose për shkak të mbarimit të personit juridik që është palë ndërgjyqëse, nga çasti që u dha vendimi për pezullimin e gjykimit:

b) Kur pezullimi i gjykimit vendoset për shkak se shihet nevojë ti emërohet njerës nga palët një përfaqësues ligjor ose për shkak se më vonë njera nga palët ka humbur zotësinë për të qenë ndërgjyqës, nga çasti i emërimit të gërfaqësuesit ligjor ose të pushimit të pazotësisë;

c) kur pezullimi i gjykimit vendoset për shkak të thirrjes të njerës palë në ushtrinë popullore, që ndodhet në gjëndje lufte, nga çasti që pala është liruar nga ushtërija;

ç) kur pezullimi i gjykimit vendoset për shkak se duhet zgjidhur më parë një çeshtje tjetër civile, penale ose administrative, nga çasti që vendimi i dhënë për këtë çeshtje ka marrë formën e prerë.

Tiranë, më 2 prill 1955
nr. 2022

SEKRETARI I PRESIDIUMIT TË KUVENDIT POPULLOR TË R. P. TË SHQIPËRISË
Sami Baholli

KRYETARI I PRESIDIUMIT TË KUVENDIT POPULLOR TË R.P. TË SHQIPËRISË
Haxhi Lleshi

L I G J Ë

mbi zbatimin e Pjesës së Përgjithëshme të kodit civil të Republikës Popullore të Shqipërisë.

KUVENDI POPULLOR I REPUBLIKËS POPULLORE TË SHQIPËRISË
V E N D O S I:

Aprovimin e ligjës mbi zbatimin e Pjesës së Përgjithëshme të kodit civil të Republikës Popullore të Shqipërisë.

Neni 1 .—

Pjesa e Përgjithëshme e kodit civil të Republikës Popullore të Shqipërisë hyn në fuqi më 1 Maj 1955.

Approved For Release 2009/06/15 : CIA-RDP83-00418R001100040009-2

Approved For Release 2009/06/15 : CIA-RDP83-00418R001100040009-2

Me dekret të veçantë do të bëhet bashkimi i Pjesës së Përgjithëshme të kodit civil me pjesët e tjera të këtij kodi pasi këto të jenë shpallur si dhe me pjesën mbi trashëgimin që ka hyrë në fuqi.

Neni 2.—

Personat të cilëve u është hequr ose kufizuar zotësia për të vepruar me vendim të gjykatës para hyrjes në fuqi të Pjesës së Përgjithëshme të kodit civil për shkaqe që nuk njihen nga ky kod fitojnë zotësinë për të vepruar ditën e hyrjes në fuqi të këtij kodi.

Neni 3.—

Deklarimi i mungesës (absencës) së një personi i shpallur me vendim të gjykatës para hyrjes në fuqi të Pjesës së Përgjithëshme të kodit civil barazohet për të gjitha pasojat me deklarimin e çdukjes së personit sipas dispozitave të këtij kodi.

Neni 4.—

Afatet e parashkrimit të parashikuara nga Pjesa e Përgjithëhme e kodit civil zbatohen edhe për të drejtat civile që kanë lindur dhe që nuk janë parashkruar sipas ligjeve të mëparëshmë para 25 korrik 1953, datë në të cilën ka hyrë në fuqi dekreti «Mbi parashkrimin» Nr. 1670 datë 10 Maj 1953.

Kur afati i parashkrimit i parashikuar nga Pjesa e Përgjithëshme e kodit civil që zbatohet për të drejtat civile të lindura dhe të paparashkruara para 25 korrik 1953, plotësohet para kësaj date ose brënda gjashtë muajve nga kjo datë, afati i parashkrimit zgjatet edhe gjashtë muaj nga hyrja në fuqi e dekretit «Mbi parashkrimin» d.m.th. gjer në 25 Janar 1954.

Rregullat e sipërme nuk zbatohen për afatet e parashkrimeve të shkurtëra gjer në një vit të parashikuara nga ligjet e vëna pas çlirimit, afate të cilat vazhdojnë të zbatohen edhe në të ardhmen.

Neni 5.—

Kjo ligjë hyn në fuqi bashkë me Pjesën e Përgjithëshme të kodit civil.

Neni 6.—

Dekreti «Mbi parashkrimin» nr. 1670 date 30 maj 1953 abrogohet.

Tiranë, më 2 Prill 1955

Nr, 2023

SEKRETARI I PRESIDIUMIT TË KUVENDIT POPULLOR TË R. P. TË SHQIPËRISË
Sami Baholli

KRYETARI I PRESIDIUMIT TË KUVENDIT POPULLOR TË R. P. SHQIPËRISË
Haxhi Lleshi

LIGJË

mbi një ndryshim në nenin 92 të Kushtetutës së Republikës Popullore të Shqipërisë

KUVENDI POPULLOR I REPUBLIKËS POPULLORE TË SHQIPËRISË

V E N D O S I :

Neni 1.—

Paragrafi i II të i nenit 92 të Kushtetutës ndryshohet në këtë mënyrë: «Gjeveria mund të anullojë çdo akt të kundraligjëshmë ose të pa rregullt

Approved For Release 2009/06/15 : CIA-RDP83-00418R001100040009-2

Approved For Release 2009/06/15 : CIA-RDP83-00418R001100040009-2

të komiteteve ekzekutive të këshillave popullore. Komitetet ekzekutive të këshillave popullore më të larta kanë po këtë të drejtë kundrejt komiteteve ekzekutive të unjta".

Neni 2.—

Kjo ligjë hyn në fuqi menjëherë.

Tiranë, me 2 prill 1955
Nr. 2024

SEKRETARI I PRESIDIUMIT TË KUVENDIT POPULLOR TË R.P. TË SHQIPËRISË
Sami Baholli

KRYETARI I PRESIDIUMIT TË KUVENDIT POPULLOR TË R.P. TË SHQIPËRISË
Haxhi Lleshi

LIGJË

mbi aprovimin e dekreteve të Presidiumit të Kuvendit Popullor të Republikës Popullore të Shqipërisë.

KUVENDI POPULLOR I REPUBLIKËS POPULLORE TË SHQIPËRISË

V E N D O S I :

Neni 1

1. Aprovohen pa ndryshime dekretet e Presidiumit të Kuvendit Popullor :

Dekret Nr. 1694 datë 9 korrik 1953 mbi interpretimin e nenit 56 të Kodit të Punës.

Dekret Nr. 1906 datë 2 gusht 1954 mbi internimin dhe dëbimin si masë administrative.

Dekret Nr. 1907 datë 2 gusht 1954 mbi disa ndryshime dhe shtesa në dekretin Nr. 1352 datë 1-11-1951 mbi arësimin fillor të detyruar.

Dekret Nr. 1903 datë 2 gusht 1954 mbi disa ndryshime në dekretin Nr. 1484 datë 12-6-1952 mbi arësimin shtatëvjeçar të detyruar.

Dekret Nr. 1918 datë 23 gusht 1954 mbi disa ndryshime në ndarjen administrative tokësore të Republikës Popullore të Shqipërisë.

Dekret Nr. 1928 datë 6 Shtator 1954 mbi disa ndryshime dhe shtesa në dekretin Nr. 1483 datë 12-6-1952 mbi kanalet ujitëse dhe mbi bonifikimet.

Dekret Nr. 1933 datë 20 shtator 1954 mbi veprimet juridike në lidhje me arin dhe valutën e huaj dhe mbi eksportimin e tyre, të metaleve, sendeve dhe gurëve të çmueshëm.

Dekret Nr. 1934, datë 20 shtator 1954 mbi dhënien e urdhërave dhe medaljeve të punës të Republikës Popullore të Shqipërisë, punonjësve të bujqësisë për vjetet 1954-1955.

Dekret Nr. 1937 datë 4 tetor 1954 mbi dhënie pensioni.

Dekret Nr. 1938 datë 4 tetor 1954 mbi një ndryshim në ligjën organike të Bankës së Shtetit Shqiptar Nr. 522 datë 8-8-1947, ndryshuar në dekret-ligjën Nr. 745 datë 26-11-1949.

Dekret Nr. 1943 datë 25-10-1954 mbi disa shtesa dhe ndryshime në ligjën Nr. 80 datë 9 korrik 1945 mbi krijimin e urdhërave, siç është ndryshuar me dekretin Nr. 874 datë 9 korrik 1949,

Approved For Release 2009/06/15 : CIA-RDP83-00418R001100040009-2

Approved For Release 2009/06/15 : CIA-RDP83-00418R001100040009-2

Dekret Nr. 1944 datë 25-10-1954 mbi krijimin e titullit «Hero i Punës Socialiste».

Dekret Nr. 1959 datë 9 nëntor 1954 mbi dhënien e kredive agrare ekonomive fshatare individuale, antarëve të kooperativave bujqësore, punëtorëve dhe nëpunësave.

Dekret Nr. 1960 datë 9 nëntor 1954 mbi Agjensinë Telegrafike Shqiptare.

Dekret Nr. 1973 datë 13-12-1954 mbi ndryshimin e nenit 11 të ligjës mbi këshillat popullore.

Dekret Nr. 1979 datë 10-1-1955 mbi një ndryshim në dekretin Nr. 1354 datë 1 nëntor 1951 mbi krijimin e rezervave të punës.

Dekret Nr. 1980 datë 10-1-1955 mbi ngritjen e shtetëzimit mbi shtëpinë e Tahir Shkrelit.

Dekret Nr. 1990 datë 24 janar 1955 mbi gjykatat shoqërore në qendrat e punës.

Dekret Nr. 1995 datë 21-2-1955 mbi dhënjen e disa mullinjve shtetërore kooperativave bujqësore.

Dekret Nr. 1996 datë 21 shkurt 1955 mbi betimin solemn të puntorëve dhe nëpunësave civilë që shërbejnë në Ushtrinë Popullore dhe në Ministrinë e P. Brëndëshme.

Dekret Nr. 1997 datë 21-2-1955 mbi disa ndryshime në dekretin Nr. 1944 datë 25-10-1954 mbi krijimin e titullit «Hero i Punës Socialiste».

Dekret Nr. 2001 datë 7-3-1955 mbi emetimin e huasë së katërt shtetërore për zhvillimin e ekonomisë dhe të kulturës së Republikës Popullore të Shqipërisë.

Dekret Nr. 2003 datë 7-3-1955 mbi abrogimin e dekret-ligjës Nr. 790 datë 17-2-1950 mbi ndalimin e dërgimit të pakove dhe të kolipostav nga ana e t'arratisurve jasht shtetit dhe mbi konfiskimin e tyre dhe të gërmës «e» të nenit 2 të dekretit Nr. 1836 datë 22-3-1954 mbi konfiskimet.

Dekret Nr. 2004 datë 7-3-1955 mbi shtetëzimin e një godine.

Dekret Nr. 2005 datë 7-3-1955 mbi ngritjen e shtetëzimit mbi godinën e Budin Petros dhe Andrea Pepa.

2. — Aprovohet me një ndryshim dekreti:

Nr. 1986 datë 24-1-1955 mbi ndryshime në ndarjen administrative tokësore të Republikës Popullore të Shqipërisë.

Në qarkun e Gjirokastrës në pikën 5 të bëhet ky ndryshim:

«Fshati Ardhasova i rrethit të Sarandës ti lidhet rrethit të Delvinës»

Neni 2.—

Kjo ligjë hyn në fuqi menjëherë.

Tiranë, më 2 prill 1955
Nr. 2025.

SEKRETARI I PRESIDIUMIT TË KUVENDIT POPULLOR TË R.P. TE SHQIPËRISË
Sami Baholli

KRYETARI I PRESIDIUMIT TË KUVENDIT POPULLOR TË R.P. TË SHQIPËRISË
Haxhi Lleshi

DEKRET

mbi dhënien e disa mullinjëve shtetërore kooperativave bujqësore.

Në mbështetje të nenit 58, pika 6, të Kushtetutës së Republikës Popullore të Shqipërisë;

Approved For Release 2009/06/15 : CIA-RDP83-00418R001100040009-2

Approved For Release 2009/06/15 : CIA-RDP83-00418R001100040009-2

Me propozimin e Qeverisë,

PRESIDIUMI I KUVENDIT POPULLOR

nxjerr këtë dekret:

DEKRET MBI DHËNIJEN E DISA MULLINJËVE SHTETËRORE KOOPERATIVAVE BUJQËSORE.

Neni 1.—

Mullinjtë shtetërorë, që ndodhen në kooperativat bujqësore ose në afërsitë e tyre, simbas listës anekse të këtij dekreti u jepen pa shpërblim në pronësi kooperativave bujqësore përkatëse, duke u rregjistruar si pasuri kooperativiste prej datës 1 Shkurt 1955.

Neni 2.—

Autorizohet Drejtorija e Ekonomisë Komunale që të japë udhëzime për zbatimin e këtij dekreti.

Neni 3.

Ky dekret hyn në fuqi me 1 shkurt 1955

Tiranë, me 21-2-1995

Nr. i dekretit: 1955

PËR PRESIDIUMIN E KUVENDIT POPULLOR TË REPUBLIKËS POPULLORE TË SHQIPËRISË

SEKRETARI — Sami Baholli

ZËV. KRYETARI — Pilo Peristeri

LISTA E MULLINJVE KOMUNAL QË DUHET TU KALOJNË KOOPERATIVAVE BUJQËSORE

Nr.	Vendi ku ndodhet mulliri	Cilës koop. duhet t'i kalojë	Largësia që ka nga kooperativa.	Kush e administ.	Lloji i motorit	Kuaj fuqi
I. QARKU BERAT:						
1)	Katund. Poshnje	koop. Poshnje	Brenda në kooperativë	Drejtoria Ekon. Kom.	Grosleji	26
2)	» Perondi	» Perondi	» »	» »	Xhems	28
3)	» Mertishe	» Komishtaj	1 kilometër	» »	Modaag	30
4)	» Bishqethem	» K. Posht.	2 »	» »	»	30
5)	» Halilaj	» Bubullimë	1 »	» »	Rugstem	35
6)	» Godolesh	» Kamçishte	1 »	» »	Bllangston	18
7)	» Karbunare	» Karbunare	1 »	» »	Modaag	18
8)	» Delisufaj	» Toshkëz	0.50 »	» »	Langenwolf	35
9)	» Cukaj vjetër	» Cinarit	1 »	» »	Gultner	19
10)	» Libofshë	» Libofshë	brenda koop.	» »	Modaag	30
II. QARKU DURRËS:						
11)	Katund. Karpen	koop. Karpen	» »	» »	Groslej	22
12)	» Beden	» Beden	» »	» »	»	22
III. QARKU TIRANË:						
13)	Katundi Vorë	Koop. Vorë	» »	» »	Langenwolf	20
IV. QARKU GJIROKASTRËS						
14)	Katundi Vrion	Koop. Vrion	» »	» »	Sa ima	12
V. QARKU VLORË:						
5)	Katundi Cakran	Koop. Cakran	» »	» »	Deux	22
6)	» Ramaj	» Sioq Marinas	Afër	» »	Modaag	30
7)	» Mifol	» Novosel	Afër	» »	Gjerman	10

Approved For Release 2009/06/15 : CIA-RDP83-00418R001100040009-2

Approved For Release 2009/06/15 : CIA-RDP83-00418R001100040009-2

DEKRET

Mbi mbarimin e gjendjes së luftës midis Shqipërisë dhe Gjermanisë

Duke marrë parasysh se mbas agresionit të Gjermanisë hitleriane, që pati si pasojë të pushtohej edhe Shqipëria nga trupat naziste, u krijua gjëndja e luftës midis Shqipërisë dhe Gjermanisë dhe populli shqiptar luftoi pa pushim kundër agresorëve gjer në shpartallimin e plotë të Gjermanisë hitleriane nga Bashkimi Sovjetik që ishte forca vendimtare në koalicionin antihitlerian;

Duke marrë parasysh se vendimet e konferencës së Potsdamit të vitit 1945 përcaktojnë rrugët e zhvillimit të mëtejshëm të Gjermanisë, si një shtet i bashkuar, paqedashës dhe demokratik, duke vërtetuar nevojën e përfundimit të një traktati të paqes me Gjermaninë;

Por, me gjithë që kanë kaluar 10 vjet që nga dita që u është dhënë fund luftimeve, akoma nuk është përfunduar traktati i paqës me Gjermaninë për shkak se qëveritë perëndimore pengojnë çdo marëveshje midis fuqive të interesuara për rivendosjen e bashkimit të Gjermanisë mbi baza paqësore dhe demokratike;

Duke marrë parasysh forcimin dhe zgjerimin e marëdhënieve miqësore midis Republikës Popullore të Shqipërisë dhe Republikës Demokratike Gjermane të cilat vazhdimisht forcohen edhe më tepër për interes të popujve të të dy vendeve;

Me qëllim që të vendosen marëdhënie të mira dhe bashkëpunimi paqësor në mes të popullit shqiptar dhe të popullit gjerman;

Në mbështetje të nenit 58 pika 12 të Kushtetutës së Republikës Popullore të Shqipërisë;

Me propozimin e Qeverisë;

PRESIDIUMI I KUVENDIT POPULLOR

nxjerr këtë dekret:

DEKRET MBI MBARIMIN E GJENDJES SË LUFTËS MIDIS SHQIPËRISË DHE GJERMANISË.

Neni 1

Gjendja e luftës midis Shqipërisë dhe Gjermanisë mer fund dhe midis dy vendeve vendosen marrëdhënie paqësore.

Neni 2

Mbarimi i gjëndjes së luftës me Gjermaninë nuk ndryshon detyrimet e saj ndërkombëtare dhe nuk prek të drejtat dhe detyrimet e Republikës Popullore të Shqipërisë që rrjedhin nga marrëveshjet ndërkombëtare me Gjermaninë në të cilat bën pjesë edhe Shqipëria.

Neni 3.—

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë.

Tiranë, me 17 mars 1955
Nr. i dekretit: 2014

PËR PRESIDIUMIN E KUVENDIT POPULLOR
TË REPUBLIKËS POPULLORE TË SHQIPËRISË

SEKRETARI
Saimi Baholli

ZËV. KRYETARI
Pilo Peristeri

Approved For Release 2009/06/15 : CIA-RDP83-00418R001100040009-2

Approved For Release 2009/06/15 : CIA-RDP83-00418R001100040009-2

D E K R E T

mbi thirrjen e Kuvendit Popullor në sesion të II-të të zakonshëm të Legjislaturës së III-të

Në mbështetje të neneve 47 e 58 të Kushtetutës së Republikës Popullore të Shqipërisë;

PRESIDIUMI I KUVENDIT POPULLOR

V E N D O S I :

I. — Thirrjen e Kuvendit Popullor në sesion të II-të të zakonëshëm të Legjislaturës së III-të më 30 mars 1955, ditë e enjte, ora 17.

II. — Ky dekret hyn në fuqi menjëherë.

Tiranë, me 18 mars 1955
Nr. i dekretit: 2017

PËR PRESIDIUMIN E KUVENDIT POPULLOR
TË REPUBLIKËS POPULLORE TË SHQIPËRISË
SEKRE ARI — ZËV. KRYETARI
Sami Baholli — Pilo Peristeri

D E K R E T

mbi shtetëzimin e një godine

Në mbështetje të nenit 58, pika 6, të Kushtetutës së Republikës Popullore të Shqipërisë;

Me kërkimin e qeverisë;

PRESIDIUMI I KUVENDIT POPULLOR

nxjerr këtë dekret:

DEKRET MBI SHTETËZIMIN E NJË GODINE.

Neni 1.—

Shtetëzohet pa shpërblim një godinë prej 12 dhomash e ndodhur në fshatin Arameras të rrethit Fush-Krujë e kufizuar me rrugën e përgjithëshme dhe me tokën e Avdi Zirit; jugë-lindje toka e Deli Zirit dhe perëndim toka e Avdi Zirit; pronë e Deli dhe Avdi Ziri, e përdorur sot si shkollë shtatë vjeçare.

Neni 2.

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë.

Tiranë, me 7 mars 1955
Nr. i dekretit: 2004

PËR PRESIDIUMIN E KUVENDIT POPULLOR
TË REPUBLIKËS POPULLORE TË SHQIPËRISË
SEKRE ARI — ZËV. KRYETARI
Sami Baholli — Pilo Peristeri

D E K R E T

mbi ngritjen e shtetëzimit mbi godinën e Budin Petros dhe Andrea Pepa.

Në mbështetje të nenit 58, pika 6, të Kushtetutës së Republikës Popullore të Shqipërisë;

Approved For Release 2009/06/15 : CIA-RDP83-00418R001100040009-2

Approved For Release 2009/06/15 : CIA-RDP83-00418R001100040009-2

Me propozimin e Qeverisë;

PRESIDIUMI I KUVENDIT POPULLOR

nxjerr këtë dekret:

DEKRET MBI LIGJEN E SHTETEZIMIT MBI GODINEN E BUDIN PETROS DHE ANDREA PEPA.

Neni 1.

Ngrihet shtetëzimi mbi godinën e Budin Petros e Andrea Pepa të vendosur me dekret ligjën Nr. 533 datë 24-9-1947 ku ishte e instaluar fabrika e çekollatave pronë e firmës «Eden» Tiranë.

Neni 2.—

Ky dekret hyn në fuqi me shpalljen e tij në gazetën zyrtare.

Tiranë, me 7 mars 1955
Nr. i dekretit: 2005

PËR PRESIDIUMIN E KUVENDIT POPULLOR
TË REPUBLIKËS POPULLORE TË SHQIPËRISË
SEKRETARI — Sami Baholli
ZËV. KRYETARI — Pilo Peristeri

DEKRET
për një ndryshim në qeveri

Në mbështetje të nenit 58, pika 13 të Kushtetutës së Republikës Popullore të Shqipërisë;

Me propozimin e Qeverisë,

PRESIDIUMI I KUVENDIT POPULLOR

vendosi:

1. Shoku Medor Shtylla të shkarkohet nga funksionet si Ministër i Shëndetësisë, për arësye se nuk e ka kryer detyrën si duhet dhe është treguar i pa aftë për drejtimin e Ministrisë së Shëndetësisë.

2. Shoku Dr. Ibrahim Dervishi të ngarkohet me funksionet si Ministër i Shëndetësisë.

3. Ky dekret hyn në fuqi menjëherë.

Tiranë, me 14 mars 1955
Nr. i dekretit: 2013

PËR PRESIDIUMIN E KUVENDIT POPULLOR
TË REPUBLIKËS POPULLORE TË SHQIPËRISË
SEKRETARI — Sami Baholli
ZËV. KRYETARI — Pilo Peristeri

DEKRET
për akordim dekoratash

Në mbështetje të nenit 58, pika 8, të Kushtetutës së Republikës Popullore të Shqipërisë;

PRESIDIUMI I KUVENDIT POPULLOR

Dekoron:

I. NË MINISTRINË E PUNËVE TË BRENDËSHME
ME MEDALJEN E PUNËS

1) Veniamin Petro Xhavara 2) Noli Llazar Taçi

me këtë motivacion:

«Punonjës të ndërgjegjëshëm dhe të pa lodhur në punë, kanë kry-

Approved For Release 2009/06/15 : CIA-RDP83-00418R001100040009-2

Approved For Release 2009/06/15 : CIA-RDP83-00418R001100040009-2

detyrën me përpikmëni, kanë nxjerrë punë të pastër dhe kanë bërë përpjekje për ngritjen e tyre politike-profesionale ».

II. NË KOMITETIN EKZEKUTIV TË K. P. TË QARKUT TË SHKODRËS ME URDHËRIN E PUNËS TË KL. TË I-rë

1) Theatrin «Migjeni», me këtë motivacion :

«Mishëron traditat më të mira të artit theatral në qarkun e Shkodrës. Bërthama e tij ka zhvilluar aktivitet gjatë luftës nacional-çlirimtare duke kontribuar në mobilizimin e masave popullore në luftën dhe për demaskimin e reaksionit. Është bërë përçonjës i mirë i vijës së Partisë ndër masat punonjëse të qytetit dhe të fshatit në qarkun e Shkodrës. Ka realizuar në kualitet të lartë premierat «Kopraci», «Agimi», «Toka e jonë», etj. Ka marrë pjesë aktive në pregatitjen e filmit «Skenderbeu» Ka nxitur e ndihmuar lëvizjen delitante. Ka tejkaluar planin e punës tij.

2) Zef Cin Jubani, me këtë motivacion :

«Si aktor i theatrit profesionist «Migjeni», ka interpretuar me një cilës të naltë artistike rolet që i janë ngarkuar, është admiruar nga masa dhe me punën e tij të palodhur dhe krijonjëse ka ndihmuar në ngritjen në një kualitet të mirë artistik të çfaqjeve dhe premierave».

ME URDHËRIN E PUNËS TË KL. II-të

1) Preng Kol Jakova, me këtë motivacion :

«Kompozitor i shumë kantateve dhe i veprimit muzikor «Dritë mbi Shqipëri». Me punën e tij të palodhur ka ndihmuar aktivisht në pregatitjen me kualitet të mirë të korit dhe orqestrës së shtëpisë kulturës dhe krijimtarisë popullore të qarkut të Shkodrës»

2) Lec Prel Shllaku, me këtë motivacion :

«Ka qënë kurdoherë i gatëshëm dhe i palodhur në punën e tijë si regjizor. Ka dhënë një kontribut të mirë në ngritjen artistike të kolektivës së theatrit që drejton».

3) Simon Gjush Rrota, me këtë motivacion :

«Për punën e tij të palodhur si profesor vizatimi, për prodhimet me vlerë artistike në pikturë dhe për aktivitete të mira në muzeun popullor të qarkut të Shkodrës».

ME URDHËRIN E PUNËS TË KI. III.

1) Adem Met Kastrati
2) Tinka Ded Kurti
3) Vitore Ujka (Nino)
4) Lec Luigj Bushati

me këtë motivacion :

«Si aktorë të theatrit profesionist «Migjeni» kanë interpretuar me një cilësi të naltë artistike rrolet që u janë ngarkuar, janë admiruar nga masa dhe me punën e tyre të palodhur u kanë dhënë një ndihmë të mirë grupeve theatrale në qendrat e punës».

5) Tonin Lec Harapi, me këtë motivacion :

«Kompozitor i melodramit »Kufitaret», i oratoriumit «Fletë-Lavdija» dhe i muzikimit të prrallës për fëmijë «Mësime nga Pylli». Me punën e tij të palodhur kori dhe orkestrina e shtëpisë pionierit të qarkut të Shkodrës ka zënë vendin e parë në sliotet dhe festivalet nacionele».

6) Antoneta Pashuk Fishta, me këtë motivacion :

«Si aktore e theatrit profesionist «Migjeni» ka interpretuar me një

Approved For Release 2009/06/15 : CIA-RDP83-00418R001100040009-2

Approved For Release 2009/06/15 : CIA-RDP83-00418R001100040009-2

cilësi të naltë artistike rrolet që i janë ngarkuar, është admiruar nga masa dhe me punën e saj ka ndihmuar në realizimin e premierave».

ME MEDALJEN E PUNËS

1) Xhemal Avdyl Bajraktari, me këtë motivacion :

«Si aktor i theatrit profesionist «Migjeni» ka interpretuar mirë rrolet që i janë ngarkuar dhe ka ndihmuar në realizimin e premierave».

2) Preng Ndue Lekunda, me këtë motivacion :

«Si aktor i theatrit profesionist «Migjeni» ka interpretuar mirë rrolet që i janë ngarkuar, është admiruar nga masa dhe me punën e tij të palodhur u ka dhënë një ndihmë të mirë grupeve diletante në qëndrat e punës ».

3) Violeta Nuçi Pema, me këtë motivacion :

«Si aktore e theatrit profesionist «Migjeni» ka interpretuar mirë rrolet që i janë ngarkuar, është admiruar nga masa dhe me punën e saj të palodhur i ka dhënë një ndihmë të mirë grupit diletant të shtëpisë së kulturës dhe krijimtaris popullore».

4) Maliq Tahir Seidini, me këtë motivacion :

«Si puntor skene i theatrit profesionist «Migjeni» është mobilizuar me të gjitha fuqitë e tij për realizimin e planit, duke u bërë kështu shembull në punë edhe për punonjësit e tjerë».

5) Teufik Reshit Gjyli
6) Ton Gasper Shoshi
7) Frano Mark Gjelaj
8) Jonuz Din Puka

me këtë motivacion :

«Si aktivistë të palodhur të rrethit letrar të shtëpisë së kulturës dhe krijimtarisë popullore të qarkut të Shkodrës dhe me veprat e tyre letrare kanë ndihmuar në realizimin e problemeve të vëndit tonë».

9) Bik Ndoj Gjergji
10) File Lec Gjeloshi

me këtë motivacion :

«Si solistë popullorë të shtëpisë së kulturës dhe krijimtarisë popullore të qarkut të Shkodrës, kanë dalë me cilësi të mirë artistike para masës dhe janë dalluar për punë të palodhur si në qytet ashtu edhe në fshat».

11) Ndrek Mark Gjergji, me këtë motivacion :

«Si solist i shtëpisë së kulturës dhe krijimtarisë popullore të qarkut të Shkodrës, ka realizuar me cilësi të mirë artistike rrolin e minatorit si tenor në «Dritë mbi Shqipëri» dhe si solist në oratoriumin «Fletë-Lavdija».

12) Adem Smajl Buraj, me këtë motivacion :

«Si anëtar i orkestrës popullore të shtëpisë së kulturës dhe krijimtarisë popullore të qarkut të Shkodrës, është treguar i palodhur në punën si në qytet eshtu dhe në fshat».

13) Angjelin Simon Dodmasej, me këtë motivacion :

«Ka realizuar me cilësi të naltë artistike kuadrin «Kthimi» me rastin e konkursit për 10 vjetorin e çlirimit. Është treguar i palodhur dhe kurdoherë i gatshëm në punë».

14) Jup Hasan Kastrati, me këtë motivacion:

«Është mobilizuar me të gjitha forcat dhe me punën e tij të palodhur ka drejtuar mirë rrethin letrar të shtëpisë së kulturës dhe krijimtarisë popullore të qarkut të Shkodrës e cila ka patur suksese në krijimtarinë letrare ».

15) Filip Ndrek Gjergji, me këtë motivacion :

«Ka drejtuar mirë baletin e shtëpisë së kulturës dhe krijimtarisë po-

Approved For Release 2009/06/15 : CIA-RDP83-00418R001100040009-2

Approved For Release 2009/06/15 : CIA-RDP83-00418R001100040009-2

pullore të qarkut të Shkodrës dhe ka ndihmuar pa u lodhur grupet e baletit të shkollave dhe të qëndrave të punës».

16) Vladimir Pjeter Jani, me këtë motivacion :

«Ka drejtuar mirë kursin e vizatimit në shtëpinë e kulturës dhe krijimtarisë popullore të qarkut të Shkodrës dhe ka realizuar me cilësi të naltë artistike kuadrin «Tre heronjtë».

17) Gjovalin Luigj Çarkaxhija, me këtë motivacion :

«Si instruktor i shtëpisë së pionierit të Shkodrës, ka punuar pa u lodhur në pregatitjen artistike të theatrit të shtëpisë së pionierit që ka fituar çmimin e parë në olimpiadat nacionale».

18) Nush Kol Shllaku, me këtë motivacion :

«Me punën e tij të palodhur, ka dhënë një ndihmë të mirë në pregatitjen artistike të bandës së qytetit e cila ka patur suksese në çfaqjet e saj ».

19) Skënder Elmaz Villa, me këtë motivacion :

«Si antar i shtëpisë së kulturës dhe krijimtarisë popullore të qarkut të Shkodrës, është mobilizuar me të gjitha fuqitë e tij dhe ka dhënë një ndihmë të mirë në rrethin letrar».

Tiranë, më 21-II-1955

Nr. i dekretit : 1999

PËR PRESIDIUMIN E KUVENDIT POPULLOR
TË REPUBLIKËS POPULLORE TË SHQIPËRISË

SEKRETARI : Sami Baholli

ZËV. KRYETARI Pilo Peristeri

DEKRET

për akordim dekoratash

Në mbështetje të nenit 58, pika, 8 të Kushtetutës së Republikës Popullore të Shqipërisë :

PRESIDIUMI I KUVENDIT POPULLOR
DEKORON

ME URDHËRIN E PUNËS TË KL. II të

1) Pupo Ibrahim Shyti
2) Muhamer Nazmi Spahiu
3) Myqerem Ismail Fuga

me këtë motivacion ;

«Janë dalluar për punën frutdhënëse që nga krijimi i Komisionit të Planit në vendin t'onë. Me punën e tyre të palodhur kanë ndihmuar në studimet e ndryshme ekonomike, duke kontribuar kështu në forcimin e planifikimit të ekonomisë popullore dhe në zhvillimin e ekonomisë dhe të kulturës popullore».

4) Ilias Kadri Reka, me këtë motivacion :

«Është dalluar për punë frutdhënëse në çeshtjen e planifikimit të ekonomisë. Me punën e tij të palodhur ka ndihmuar në studimet e ndryshme ekonomike, duke kontribuar kështu në forcimin e planifikimit të ekonomisë popullore dhe në zhvillimin e ekonomisë dhe të kulturës popullore».

ME URDHËRIN E PUNËS TË KL. III-të

1) Zeqir Asllan Lika
2) Stavri Ilo Gambeta
3) Petro Arqile Dode
4) Islam Nevzat Kokona
5) Jani Irakli Mio
6) Perika Sotir Pikuli

Approved For Release 2009/06/15 : CIA-RDP83-00418R001100040009-2

Approved For Release 2009/06/15 : CIA-RDP83-00418R001100040009-2

me këtë motivacion:

«Janë dalluar për punë të palodhur dhe kanë patur rezultate të mira në kryerjen e detyrave të ngarkuara duke punuar prej një kohe të gjatë në Komisionin e Planit. Kanë ndihmuar në forcimin e planifikimit të ekonomisë popullore dhe në zhvillimin e ekonomisë sonë të planifikuar».

ME MEDALJEN E PUNËS

1) Iliaz Ibrahim Lloja
2) Piro Thimi Veshi
3) Nazif Sherif Ruli
4) Petro Sevo Sevi
5) Rahmi Osman Mamaqi
6) Tahir Bajram Tauzi
7) Braho Demir Hasani
8) Abdyl Hasan Zaloshnja
9) Nuci Stavro Dono
10) Isuf Ahmet Idrizi
11) Dhori Kristaq Laçi
12) Reshat Shaban Hajdaraga
13) Nezaqet Hysen Kodra
14) Kaliro Athanas Demirxhi
15) Remzije Bajram Emiri
16) Hajdar Hysen Dauti
17) Naxhi Xhemal Totozani
18) Jaho Sait Dibra

Me këtë motivacion:

«Punonjës të vjetër të Komisionit të Planit, janë mobilizuar dhe kanë kryer mirë detyrat e ngarkuara. Në hartimin e planeve të shtetit dhe në probleme të tjera kanë nxjerrë punë të kualifikuar dhe të pastër, duke ndihmuar kështu për mbarëvajtjen e sektoreve ku punojnë.

19) Pandush Nikolla Ballço
20) Lec Gjergj Bengliani
21) Simon Pando Çika

me këtë motivacion:

«Punonjës të vjetër në sektorët e planifikimit lokal, janë mobilizuar dhe kanë kryer mirë detyrat e ngarkuara. Në hartimin e planeve lokale kanë nxjerrë punë të kualifikuar dhe të pastër duke ndihmuar kështu për mbarëvajtjen e sektorëve ku punojnë».

NË GAZETËN «ZËRI I POPULLIT»

ME URDHËRIN E PUNËS KL. II-të

1) Fiqiri Et-hem Vogli, me këtë motivacion:

«Gazetar me talent dhe me eksperiencë. Ka ndihmuar për përmirësimin e cilësisë së gazetës me eksperiencën e shtypit sovjetik. I palodhur në punë dhe organizator i mirë. Ka lojtur një rol me rëndësi në drejtimin e gazetës si sekretar i kolegjumit e si zëv. kryeredaktor».

ME URDHËRIN E PUNËS KL. III-të

1) Taho Mehmet Sejko, me këtë motivacion:

«Gazetar me eksperiencë për çeshtjet ekonomike dhe organizator i mirë në punë. Për 5 vjet ka drejtuar seksionin ekonomik në «Zërin e Popullit» dhe ka ndihmuar shumë që gazeta të plotësoi detyrat për forcimin e sektorit socialist të ekonomisë dhe realizimin e planit të shtetit».

1) Amali Petro Dishnica, me këtë motivacion:

«Gazetare me talent dhe organizatore e mirë. Ka drejtuar sektorin e propagandës në gazetë dhe me punën e saj ka ndihmuar që gazeta të kryejë detyrat që i janë ngarkuar për zbatimin e vijës së Partisë».

3) Niko Misto Nishku, me këtë motivacion:

«Gazetar me talent dhe organizator i mirë. Prej pesë vjetësh drejton

Approved For Release 2009/06/15 : CIA-RDP83-00418R001100040009-2

Approved For Release 2009/06/15 : CIA-RDP83-00418R001100040009-2

seksione me rëndësi të gazetës duke dhënë kështu një ndihmë të çmuar që gazeta të plotësojë detyrat e saj për zbatimin e vijës së Partisë».

ME MEDALJEN E PUNËS

1) Qako Goli Dango 2) Vasil Koci Rali

me këtë motivacion:

«Gazetarë të palodhur. Kanë qenë të lidhur me punën dhe kanë dhënë një ndihmë të mirë në pasqyrimin e problemeve të politikës së jashtëme për vënien në dukje të politikës paqësore të Bashkimit Sovjetik dhe të kampit të paqës dhe për demaskimin e politikës luftënxitëse të qarqeve imperialiste me Shtetet e Bashkuara në krye.

3) Vasil Spiro Prifti, me këtë motivacion:

«Gazetar i palodhur dhe organizator i mirë. Ka ndihmuar gazetën për ndriçimin e çeshtjeve të jetës së partisë».

4) Gjylso Reshat Shtino, me këtë motivacion:

«Puntore e palodhur. Ka dhënë një kontribut të mirë në forcimin e lidhjeve të gazetës me masat e lexonjësve dhe ka ndihmuar në zhvillimin dhe forcimin e kritikës nga masat në gazetë».

5) Guri Nisi Lubonja, me këtë motivacion:

«Puntor i vjetër i shtypit. Një nga të parët që punon që prej ribotimit të gazetës. Është treguar i palodhur në punë».

6) Dylbere Ismail Zorba, me këtë motivacion:

«Puntore e dalluar dhe e palodhur në punë, si daktilografiste është mobilizuar me të gjitha fuqitë e saj dhe ka nxier punë me kualitet të mirë dhe shpejt, duke u bërë kështu një ndihmëse e mirë për gazetën».

7) Naun Petro Papuciu, me këtë motivacion:

«Ka vënë të gjitha forcat e tija çeshtjes së nxjerrjes me kohë dhe mirë të gazetës duke mbajtur në mënyrë të gjallë dhe operative lidhjet e redaksisë me shtypshkronjën».

8) Zija Xhemal Koçiu, me këtë motivacion:

«Gazetar i palodhur dhe operativ. I është përgjigjur me kohë detyrave të redaksisë duke pasqyruar në mënyrë të gjithëanëshme jetën e qarkut në gazetë, duke kontribuar kështu në ngritjen e cilësisë së gazetës».

9) Spiro Dhimitër Kufo, me këtë motivacion:

«Gazetar i palodhur, Ka pasqyruar në gazetë jetën e qarkut me forma të reja shkrimi me material të jetës së Partisë, të ekonomisë, të fshatit dhe me informacione, duke dhënë kështu një kontribut të mirënë përmirësimin e punës së gazetës».

10) Piro Ligor Joti, me këtë motivacion:

«Gazetar i mirë. Ka organizuar mirë punën në qark duke krijuar mundësitë që gazeta të pasqyrojë jetën e qarkut mirë dhe në shumë drejtime».

11) Marjana Vasil Kote (Toçi), me këtë motivacion:

«Puntore e dalluar dhe e palodhur në punë, është mobilizuar me të gjitha fuqitë e saj dhe ka organizuar mirë punën në kartotekën e gazetës' duke krijuar kështu mundësit e një ndihme sa më të mirë në punën e gazetës».

12) Niko Poskal Tanini, me këtë motivacion:

Puntor i palodhur, ka dhënë një kontribut të mirë për unifikimin e gjuhës në gazetë, duke ndihmuar kështu në ngritjen e kualitetit të saj

Approved For Release 2009/06/15 : CIA-RDP83-00418R001100040009-2

Approved For Release 2009/06/15 : CIA-RDP83-00418R001100040009-2

NË MINISTRINË E P. TË BRENDËSHME
ME MEDALJEN E TRIMËRISË

1) Dësh. Koço Theodhor Brisku 2) Dësh. Selim Qazim Meta

me këtë motivacion:

«Janë treguar trima dhe të vendosur në rethimin dhe asgjësimin e një bande kriminelash, kanë luftuar deri në momentin e fundit të jetës tyre duke kontribuar kështu në mbrojtjen dhe forcimin e Republikës Popullore të Shqipërisë»,

ME MEDALJE E SHERBIMIT USHTARAK

1) Ali Hysen Zerfaj
2) Bajram Besim Zyfi
3) Isuf Mus Musaj
4) Sulo Refat Backa

me këtë motivacion:

«Janë dalluar për organizimin e mirë të punës, për disiplinë të lartë dhe ngritjen e tyre politike e profesionale, kanë korur suksese të kënaqëshme në luftë kundër tentativave t'armiqve të pushtetit popullor, duke kontribuar kështu në mbrojtjen dhe forcimin e Republikës Popullore të Shqipërisë»

Sh. Ismail Kazi Pali i anullohet medalja e çlirimit akorduar me dekretin e Nr. 1948 datë 25-10-1954 dhe i akardohet medalja e trimërisë.

Tiranë., me 7-3-1955

Nr. i dekretit: 2009

PËR PRESIDIUMIN E KUVENDIT POPULLOR
TË REPUBLIKËS POPULLORE TË SHQIPËRISË

SEKRETARI Sami Baholli

ZËV. KRYETARI Pilo Peristeri

DEKRET

për akordim dekorate

Në mbështetje të nenit 58, pika 8, të Kushtetutës së Republikës Popullore të Shqipërisë;

PRESIDIUMI I KUVENDIT POPULLOR

Dekoron

ME URDHËRIN E LIRISË RË KL. II-të

1) Aleksandër Jani Xhuvani, me këtë motivacion:

Me rastin e 75 vjetorit të lindjes dhe për kontributin e tij patriotik në lëmin e gjuhësisë, të shkollës dhe të kulturës shqiptare.

Tiranë, me 7-3-1955

Nr. i dekretit: 2012

PËR PRESIDIUMIN E KUVENDIT POPULLOR
TË REPUBLIKËS POPULLORE TË SHQIPËRISË

SEKRETARI: Sami Baholli

ZËV.KRYETARI: Pilo Peristeri

DEKRET

për akordim dekoratash

Më mbështetje të nenit 58, pika 8, të Kushtetutës së Republikës Popullore të Shqipërisë;

PRESIDIUMI I KUVENDIT POPULLOR

Dekoron:

ME URDHËRIN E TRIMËRISË

1) Dësnmor Nik Pjetër Ndreka, me këtë motivacion:

«Për vigjilencë, guxim dhe trimëri që ka treguar në vitin 1952 në de-

Approved For Release 2009/06/15 : CIA-RDP83-00418R001100040009-2

Approved For Release 2009/06/15 : CIA-RDP83-00418R001100040009-2

noncimin e një grupi diversantësh në forcat e kufirit, duke kryer në këtë mënyrë një akt patriotik deri sa dha jetën e tij.»
Tiranë, me 18-3-1955
Nr. i dekretit: 2016

PËR PRESIDIUMIN E KUVENDIT POPULLOR
TË REPUBLIKËS POPULLORE TË SHQIPËRISË
SEKRETARI ZËV. KRYETARI
Sami Baholli Pilo Peristeri

DEKRET

për akordim dekorate

Në mbështetje të nenit 58, pika 8, të Kushtetutës së Republikës Popullore të Shqipërisë;
Me propozimin e Ministrisë së Mbrojtjes Popullore,

PRESIDIUMI I KUVENDIT POPULLOR

DEKORON:

URDHËRIN YLLI KUQ

1) Shkollën Ushtarake Skënderbeg, me këtë motivacion:
«Për shërbimet e mëdha që ka bërë gjatë 10 vjetëve të ekzistencës në pregatitjen dhe edukimin e nxënësave ushtarakë me cilësi të larta moralo-politike, me besnikërinë e pa kufishme ndaj Atdheut e popullit, ndaj Partisë së Punës të Shqipërisë dhe Bashkimit të math Sovjetik, me dashurinë për artin ushtarak dhe për forcimin e ushtrisë tonë popullore».
Tiranë, me 25-3-1955
Nr. i dekretit: 2020

PËR PRESIDIUMIN E KUVENDIT POPULLOR
TË REPUBLIKËS POPULLORE TË SHQIPËRISË
SEKRETARI ZËV. KRYETARI
Sami Baholli Pilo Peristeri

DEKRET

Në mbështetje të nenit 3 të dekretit Nr. 1874 datë 7-6-1954 mbi shtetësinë shqiptare,

PRESIDIUMI I KUVENDIT POPULLOR

vendosi:

I. T'u jepet shtetësia shqiptare personave të posht-shënuar;

1) Veli Emin Blakçori	dl.1920	banues rruga Xhafer Stermasi Nr. 7 Tiranë.
2) Nikolla Panajot Thano	» 1911	banues në katundin Poro Vlorë
3) Stamato Jani Thano	» 1913	» » » » »
4) Nikolin Gjuro Margjonaj	» 1932	banues rruga Aleksandër Gogo Nr. 162 Durrës
5) Emilio Andon Plauta	» 1896	banues lagja 18 Tetor Fier

Approved For Release 2009/06/15 : CIA-RDP83-00418R001100040009-2

Approved For Release 2009/06/15 : CIA-RDP83-00418R001100040009-2

6)	Pashan Osman Axhagiq	» 1912	banues Vilaj Nr. 8 Shkodër
7)	Hankushe Osman Axhagiq	» 1934	» » Nr. 8 Shkodër
8)	Murat Murat Boshnjaku	» 1906	banues në Rubik
9)	Rexhep Selim Selimi	» 1923	banues rruga Sandër Goga Nr. 297 Durrës
10)	Marjie Kol Leka	» 1924	banues në katundin Mal i Jushit Shkodër
11)	Zade Sokol Sadiku	» 1923	banuese në katundin Kukel Shkodër
12)	Gjyste Lulash Deda	» 1917	» » » » »
13)	Velika Spaso Lubonja	» 1931	» në katundin Omaraj-Vrah Shkodër
14)	Natije Lubomir Mihajl (Gjergjeviq)	» 1932	banuese rruga Ésat Gjyli Nr. 22 Shkodër
15)	Sanije Tahir Piraniqi	» 1931	banuese në katundin Shtoj i Ri Shkodër
16)	Andrea Vaso Vaso	» 1934	banuese në katundin Vrak Shkodër
17)	Adem Selim Gegiçi	» 1908	banues në Fermë Sukth
18)	Qerim Ymer Haçkaj	» 1924	banues Rr. 4 qersh. Nr. 38 Shkodër
19)	Hanë Martin Martinia	» 1927	banues në kat. Vermosh Koplik
20)	Sadike Qazim Gruda	» 1934	» » » » » Shkodër
21)	Vasil Konstandin Bleca	» 1911	» » » Dobraç Shkodër
22)	Aleksandra Panajot Bleca	» 1913	banues në katundin Poro Vlorë
23)	Kostandin Vasil Bleca	» 1933	» » » » Vlorë
24)	Gjysto Zef Lulati	» 1930	» » » » Vlorë
25)	Llavredia Jovan Dallamango	» 1900	» » » Ivananaj Koplik
26)	Marta Paja	» 1922	banuese në rrugën Perlat Rexhepi Nr. 42/c Tiranë banuese në lagjën Xak Pegili Krujë
27)	Natan Shatar	» 1913	banues në Fush-Krujë

II. — Ky dekret hyn në fuqi me datën 21-3-1955.

III. — Për zbatimin e këtij dekreti ngarkohet Ministria e Punve të Brëndëshme.

Tiranë, me 7-3-1955

Nr. i dekretit: 2006

PËR PRESIDIUMIN E KUVENDIT POPULLOR
TË REPUBLIKËS POPULLORE TË SHQIPËRISË

SEKRETARI — Sami Baholli

ZËV. KRYETARI — Pilo Peristeri

DEKRET

mbi ndryshimin e nenit 47 të ligjës Nr. 1763 datë 26 nëntor 1953 mbi këshillat popullore

Në mbështetje të nenit 58, pika 6 të Kushtetutës së Republikës Popullore të Shqipërisë:

PRESIDIUMI I KUVENDIT POPULLOR

nxjerr këtë dekret:

DEKRET MBI DRYSHIMIN E NENIT 47 TË LIGJËS NR. 1763 DATË 26 NËNTOR 1953, MBI KËSHILLAT POPULLORE.

Neni 1

Neni 46 i ligjës Nr. 1763 date 26 nëntor 1953 mbi këshillat popullore

Approved For Release 2009/06/15 : CIA-RDP83-00418R001100040009-2

Approved For Release 2009/06/15 : CIA-RDP83-00418R001100040009-2

ndryshohet në këtë mënyrë: «Këshilli i Ministrave munt të anullojë çdo akt të kondraligjëshëm ose të pa rregullt të komiteteve ekzekutive të këshillave popullore. Komitetet ekzekutive të këshillave popullore kanë po këtë të drejtë kundrejt komiteteve ekzekutive më të ulëta».

Neni 2. —

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë.

Tiranë, me 11 prill 1955
Nr. i dekretit: 2027

PËR PRESIDIUMIN E KUVENDIT POPULLOR
TË REPUBLIKËS POPULLORE TË SHQIPËRISË

SEKRETARI: Sami Baholli

KRYETARI: Haxhi Lleshi

VENDIM

Mbi zgjedhjen e Gjykatës së Lartë të Republikës Popullore të Shqipërisë.

KUVENDI POPULLOR I REPUBLIKËS POPULLORE TË SHQIPËRISË

Zgjodhi Gjykatën e Lartë të Republikës Popullore të Shqipërisë me përbërjen që vijon:

1) Aranit Çela	kryetar	7) Frederik Nosi	antar
2) Mustafa Qilimi	n/kryetar	8) Sofokli Papajani	»
3) Gaqo Floqi	n/kryetar	9) Nonda Papuli	»
4) Nedret Hoxha	antar	10) Sotir Spiro	»
5) Nazmi Peza	»	11) Loni Dimoshi	»
6) Jusuf Alibali	»	12) Hilmi Telegrafi	»

1) Ali Dedaj	Ndihmës	gjyqtar	34) Sulo Bedini	ndihmës	gjyqtar
2) Fiqret Spahiu	»	»	35) Tamas Beqari	»	
3) Hasan Alimerko	»	»	36) Niko Paskali	»	
4) Bajram Preza	»	»	37) Janaq Lilo	»	
5) Zylfije Gabrani	»	»	38) Vasil Dalani	»	
6) Llambi Ziçishti	»	»	39) Haxhi Doraci	»	
7) Mane Nishova	»	»	40) Gjylfidan Kallfa	»	
8) Marika Isak	»	»	41) Vangjeli Gjollca	»	
9) Shpresa Fuga	»	»	42) Todo Kavaja	»	
10) Stefi Kotmila	»	»	43) Silva Mazi	»	
11) Veronika Tirana	»	»	44) Ndrek Frania	»	
12) Zihni Sako	»	»	45) Qazim Luli	»	
13) Drita Stafa	»	»	46) Nexhip Visha	»	
14) Besim Levonja	»	»	47) Rahman Balushi	»	
15) Ramazan Vrapi	»	»	48) Misin Ymeri	»	
16) Hysen Seseri	»	»	49) Irfan Kadriu	»	
17) Tajar Grepcka	»	»	50) Mendu Saraçi	»	
18) Refat Veshaj	»	»	51) Bajram Tafa	»	
19) Sotir Filto	»	»	52) Vangjo Vasili	»	
20) Andon Sheti	»	»	53) Dhimitra Serani	»	
21) Rexho Mema	»	»	54) Todi Dhiko	»	
22) Grigor Daiu	»	»	55) Sali Qamili	»	
23) Sami Koloneci	»	»	56) Isuf Toska	»	
24) Abdyl Omeri	»	»	57) Eqrem Beçiu	»	
25) Qamil Poda	»	»	58) Mehmet Gina	»	

Approved For Release 2009/06/15 : CIA-RDP83-00418R001100040009-2

Approved For Release 2009/06/15 : CIA-RDP83-00418R001100040009-2

26)	Latif Hoxha	ndihmës gjyqtarë	59)	Ramadan Meçia	ndihmës gjyqtarë
27)	Ilo Koti	» »	60)	Ruzhdi Hoxha	»
28)	Tomor Spahiu	» »	61)	Liri Hakani	»
29)	Koço Tollkuçi	» »	62)	Tom Preçi	»
30)	Elmaz Dino	» »	63)	Servete Kadiu	»
31)	Ceno Nushi	» »	64)	Petrit Saliu	»
32)	Xheladin Krifca	» »	65)	Minello Moni	»
33)	Arri Zelenica	» »	66)	Nuri Radhima	»
			67)	Emine Isaj	»

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Tiranë, me 2 prill 1955

Nr. i vendimit 37

SEKRETARI I KUVENDIT POPULLOR TË REPUBLIKËS POPULLORE TË SHQIPËRIRË
Sali Mborja

KRYETAR I KUVËNDIT POPULLOR TË REPUBLIKËS POPULLORE TË SHQIPËRISË
Gogo Nushi

VENDIM

mbi ndryshime në Prokurorinë e Përgjithëshme
KUVENDI POPULLOR I REPUBLIKËS POPULLORE TË SHQIPËRISË

vendosi:

1. Shkarkon nga funksioni si Ndihmës Prokuror i Përgjithshëm shokun Sotir Spiro.

2. Emëron Ndihmës Prokuror të Përgjithëshëm shokun Vangjel Kocanin.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë,

Tiranë, më 2 prill 1955

Nr. i vendimit 36

SEKRETAR I KUVËNDIT POPULLOR TË REPUBLIKËS POPULLORE TË SHQIPËRISË
Sali Mborja

KRYETARI I KUVËNDIT POPULLOR TË REPUBLIKËS POPULLORE TË SHQIPËRISË
Gogo Nushi

PJESA E II-të.

KËSHILLI I MINISTRAVE

VENDIM

Nr. 87 Datë 11-III-955
MBI
VAJIN LUBRIFIKANT TË DJEGUR

Këshilli i Ministrave i Republikës Popullore të Shqiperisë, në mbledhjen e tij të datës 11-III-1955 me qëllim që të sigurohet përdorimi i vajit lubrifikant të djegur nga ana e industrisë;

VENDOSI:

1. Të gjitha Ministritë institucionet dhe organizatat shtetërore kooperativiste dhe shoqërore, kundrejt sasisë së vajit të mirë lubrifikant që do të furnizohen sipas planit, të dorëzojnë vajin lubrifikant të djegur në përqindjet e më poshtëme:

Approved For Release 2009/06/15 : CIA-RDP83-00418R001100040009-2

Approved For Release 2009/06/15 : CIA-RDP83-00418R001100040009-2

a) Ministria e Bujqësisë 22%.

b) gjithë Ministritë e tjera si dhe institucionet dhe organizatat shtetërore kooperativiste dhe shoqërore 10%

2. Të gjitha Ministritë, si dhe institucionet dhe organizatat shtetërore kooperativiste dhe shoqërore të detajojnë menjiherë përqindjen e sipërme që u përket në ndërmarrjet vartëse duke patur mundësi që të caktojnë përqindje të ndryshme për ndërmarrjet dhe institucionet e tyre por n'asnjë mënyrë të mos ndryshohet përqindja që u është caktuar me pikën e parë të këtij vendimi dhe mbrenda 15 ditëve nga dalia e këti vendimi ti dërgojnë listën e detajimit Ministrisë Tregëtisë.

3. Ministria e Tregëtisë ngarkohet me këto detyra :

a) të ndërpresë menjiherë furnizimin me vaj lubrifikant të mirë për të gjitha ato ndërmarrje ose institucione që nuk do t'i dorëzojnë vaj lubrifikant të djegur sipas përcaktimit të bërë dhe që i është njoftuar asaj Ministrie (pika 2 e këtij vendimi) ;

b) gjithë sasia e vajit lubrifikant të djegur që do të grumbullohet në bazë të këtij vendimi t' ia dorëzojë Ministrisë Idustrisë dhe Minierove :

c) të furnizojë ndërmarrjet dhe institucionet që dorzojnë vaj lubrifikant të djegur dhe qe kanë nevojë me amballazh jashtë përdorimit, që disponon dhe herë pas herë t' u shpërndajë ato sasi që vazhdimisht dalin jashtë përdorimit.

4. Pika 5 e vendimit Nr. 291 datë 5-X-1954 të Këshillit të Ministrave mbetet pa fuqi.

5. Ky vendim hyn në fuqi menjiherë.

KRYETAR I KËSHILLIT MINISTRAVE TË R.P.SH.
MEHMET SHEHU

KËSHILLI I MINISTRAVE

VENDIM

Nr. 105 Dt. 4-IV-1955

MBI

DISA FAVORIZIME PËR ANTARËT E KOLEKTIVAVE BUJQËSORE

Këshilli Ministrave i Republikës Popullore të Shqipërisë duke u mbështetur në direktivat e Partisë në lidhje me përhapjen e formave të thjeshta të kolektivizimit të bujqësisë, dhe me qëllim që të nxitet bashkimi i fshatarëve punonjës në kolektivat bujqësore për të kryer bashkarisht punimet bujqësore.

vendosi :

1) Antarëve të kolektivave bujqësore të tipit të II-të, t' u bëhet 15% zbritje dhe atyre të kolektivave bujqësore të tipit të I-rë 10% zbritje mbi shumën e përgjithëshme të tatimit t'ekonomisë bujqësore individuale.

2) Atarëve të kolektivave bujqësore të tipit të I-rë dhe të tipit të II-të për ato sipërfaqe toke që fusin në kolektivë t'u zbritet detyrimi ndaj shtetit në prodhime bujqësore e blegtorale në masën që vijon :

Approved For Release 2009/06/15 : CIA-RDP83-00418R001100040009-2

Approved For Release 2009/06/15 : CIA-RDP83-00418R001100040009-2

	Kolektivë e tipit II-të	Kolektivë e tipit I-rë
a) Në drithra e fasule . .	7 °/o	5 °/o
b) Në misër	10 °/o	7 °/o
c) në lesh	20 °/o	10 °/o
ç) në vezë	20 °/o	15 °/o

3) Favorizimet në detyrimet në natyrë dhe në tatimin e ekonomisë bujqësore u bëhen antarëvë të kolektivave bujqësore, që punojnë bashkarisht kulturat e ndryshme drithra dhe bimë industriale si dhe bahçevaneve kur bashkohen në kolektivë për perimet.

4) Blegtorëve që bashkojnë në kolektivë bagëtit e tyre t'u bëhet zbritje 15 °/o për tipin e dytë të kolektivave dhe 10 °/o për tipin e parë mbi shumën e përgjithëshme të tatimit t'ekonomisë bujqësore individuale dhe në detyrimet në natyrë t'u bëhet zbritje: për tipin e dytë në mish 10 °/o dhe në lesh 20 °/o dhe për tipin e parë në mish 7 °/o dhe në lesh 10 °/o

5) Kur kolektivat bujqësore të çdo tipi kryejnë mbi 40% të punimevet bujqësore pranë S.M.T.-ve, duke u përfshirë në këtë përqindje dhe punime që kryejnë individualisht antarët e tyre në S.M.T., antarëve të kolektivave u bëhet për detyrimet e tyre ndaj shtetit në drithra e fasule, edhe nji zbritje tjetër prej 7°/o.

Kjo zbritje zbatohet në detyrimet e vitit pasardhës nga viti, që janë kryer punimet bujqësore.

6) Tokat që kolektivat bujqësore do t'i mbjellin me farë të seleksionuar për riprodhim farnash të zgjedhura nuk i nënshtrohen detyrimit të drithrave dhe fasuleve.

7) Komitetet ekzekutive të k. p, të qarqeve e rretheve t'u japin precedencë kolektivave bujqësore në ndihmën me kredi agrare, farna, inventar bujqësor, plehra, kullota për blegtorin etj.

8) Ky vendim hyn në fuqi menjiherë.

ZËV. KRYETAR I KËSHILLIT MINISTRAVE TË R.P.SH.
HYSNI KAPO

M. 2. B. B. N. Q.

Approved For Release 2009/06/15 : CIA-RDP83-00418R001100040009-2

Approved For Release 2009/06/15 : CIA-RDP83-00418R001100040009-2

GAZETA ZYRTARE

E REPUBLIKËS POPULLORE TË SHQIPËRISË

16 Maj | Nr. 5 | Viti 1955

P Ë R M B A J T J A

Pjesa e I-rë

Faqe

1) Dekret Nr. 2035 dt. 11-IV-1955, Mbi dhënie shtetësie 133-133
2) Vendim i Pres. Kuv. Popullor Nr. 55 dt. 18-IV-1955 Mbi dhënie emrash dhe flamuresh luftarake brigadave kufitare 134-134

Pjesa e II-të

3) Urdhëresë e Qeverisë Nr. 9 dt. 9-IV-1955.
4) Urdhëresë e Qeverisë Nr. 10 dt. 9-IV 955.

5) Vendim i Këshillit Ministrave Nr. 125 dt. 9-IV-1955.
6) Vendim i Këshillit Ministrave Nr. 129 dt. 9-IV-1955.

7) Vendim i Këshillit Ministrave Nr. 130 dt. 9 IV-1955
8) Urdhër i Ministrisë Bujqësisë Nr. 195/10 dt. 18-IV-1955.
9) Rregullore e Ministrisë Financave

Mbi afatet e pagimit të tatimit të ekonomisë bujqësore. 134-135
Mbi një ndryshim në Urdhëresën e Qeverisë Nr. 25 dt. 13-VII-1949 mbi tarifën e tagrave doganore 135-135
Mbi aprovimin e Statutit të Institutit të Shkencave . . . 136 141
Mbi aprovimin e Statutit tip të Teknikumeve (shkollave të mesme profesionale) . . . 141-150
Mbi masat për mbrojtjen e monumenteve të kulturës . .150-155
Mbi ndalimin e prerjes së manave 155-155
Mbi sigurimin vullnetar të sendeve shtëpijake 156-163

Approved For Release 2009/06/15 : CIA-RDP83-00418R001100040009-2

Approved For Release 2009/06/15 : CIA-RDP83-00418R001100040009-2

Pjesa e I-rë

D E K R E T

mbi dhënie shtetësie

Në mbështetje të nenit 3 të dekretit nr. 1874 datë 7-6-1954 mbi shtetësin shqiptare,

PRESIDIUMI I KUVENDIT POPULLOR

V E N D O S I :

1. — Tu jepet shtetësia shqiptare personave të poshtë shënuar:

1) Fadile Foto Uruçeviç banuese lagja Vojo Kushi Rr Haslikaj Nr. 8 Shkodër.

2) Gjon Gjek Markolaj, banues lagja nr. 3 Rr. Kol Luku Nr. 35 Durrës.

3) Nuredin Selman Pocesta banues lagja 8 Nandori Rr, Dervish Hekali Nr. 47 Tiranë

4) Rabije Murat Pocesta, banuese lagja 8 Nandori Rr. Dërvish Hekali Nr. 47 Tiranë.

5) Halime Mehmet Gani. banuese Lagja Misto Mame Rr. Bajram Curri Nr. 59 Tiranë,

6) Danica Nikoll Vuksanoviq, banuese lagja Vasil Shanto Rr. Shyqëri Berxolli nr. 17 Tiranë.

7) Enver Zeqir Mustafa, pranë Kombinatit Energjitik Tiranë.

8) Halit Nazir Beri ha, banues lagja Sallbeg Kavajë.

9) Marije Martin Prela, banuese Ishull Lezhë.

10) Soli Zeko Zeka, banues lagja Vasil Shanto Rr. Myslym Llagami Nr. 110 Tiranë.

11) Jorgji Joni Gallaçi, pranë parkut automobilistik Tiranë.

12) Gazi Zit Zita, banues lagja Sulmit Rr. Qemal Stafa Nr. 42 Tiranë.

13) Ali Gazi Zita. banues lagja e Sulmit Rr. Qemal Stafa Nr. 42 Tiranë.

14) Zyhdi Gani Zita. banues lagja e Sulmit Rr. Qemal Stafa Nr. 42 Tiranë.

15) Fatime Stanko Zita, banuese lagja e sulmit Rr. Qemal Stafa Nr. 42 Tiranë.

16) Miltiadh Pandeli Qefallo, banues katundi Neçe Pogradec.

17) Marjanthi Tempo, banuese katundi Vermik Bilisht.

18) Dushko Stojani, banues lagja Nr. 6 Durrës.

19) Harallamb Nika, banuese katundi Dhjuvjan Gjinokastër,

II — Ky dekret hyn në fuqi me datën 26-4-1955.

III.— Për zbatimin e këtij dekreti ngarkohet Ministrija e Punve të Brëndëshme,

Tiranë, më 11-4-1955
Nr. i dekretit 2036

PËR PRESIDIUMIN E KUVENDIT POPULLOR
TË REPUBLIKËS POPULLORE TË SHQIPËRISË

SEKRETARI: Sami Babolli

KRYETARI: Haxhi Lleshi

Approved For Release 2009/06/15 : CIA-RDP83-00418R001100040009-2

Approved For Release 2009/06/15 : CIA-RDP83-00418R001100040009-2

VENDIM
mbi dhënien emërash dhe flamuresh luftarake brigadave kufitare.

PRESIDIUMI I KUVENDIT POPULLOR

V E N D O S I :

.— Brigadat kufitare të marrin emëra dhe flamure luftarake si vijon:

a) Brigada e I-rë Kufitare, të marrë emërin Brigada e I-rë kufitare Ali Kelmendi".

b) Brigada e II.-të kufitare të marrë emërin" Brigata e II-të kufitare, 'Bajram Curri"

c) brigada e III-të kufitare të marrë emërin "Brigata e III-të kufitare Heronjt e Vigut".

ç) Brigata e IV-të kufitare të marrë emërin" Brigada e IV-të kufitare Avni Rustemi".

II.— Ky vendim hyn në fuqi mënjëherë.

Tiranë, me 18-4-1955
Nr. i vendimit: 55

PËR PRESIDIUMIN E KUVENDIT POPULLOR
TË REPUBLIKËS POPULLORE TË SHQIPËRISË

SEKRETARI: Sami Baholli

KRYETARI: Haxhi Lleshi

Pjesa e II-të

URDHËRESË e QEVERISË

Nr. 9 Datë 9/IV/1955.—

Këshilli i Ministrave i Republikës Popullore të Shqipërisë. në bazë të nenit 26 të dekretit Nr. 1914 datë 9-VIII-1954. mbi tatimin e ekonomisë bujqësore me qëllim që të lehtësohen ekonomitë bujqësore në pagesën e tatimit, në mbledhjen e datës 9-IV-1955 nxjerrë këtë.

URDHËRESË
MBI
AFATET E PAGIMIT TË TATIMIT TË EKONOMISË BUJQËSORE

Neni 1

Duke filluar nga viti 1955, tatimi i ekonomisë bujqësore të paguhet në formë avance, në afatet dhe masën që vijojnë:

a) kesti i rë, gjer me 31 Maj në masën 20% të shumës së tatimit të vërtetuar për seicilin pagëdhënës në vitin e kaluar;

b) kesti i II të, gjer me 31 Gusht, në masën 3[illegible]% të shumës së tatimit të vërtetuar për seicilin pagëdhënës në vitit e kaluar;

c) kesti i III-të, gjer më 31 Tetor, në masën baraz me diferencën që do të rezultojë në mes të shumës së tatimit të vertetuar definitivisht për vitin përkatës dhe të shumës së të dy kësteve që janë komunikuar.

Për zonat duhanore që caktohen me vendim të komitetit ekzekutiv të k. p. të qarkut mbi propozimin e komitetit ekzekutiv të k. p. rrethit përkatës, kesti i tretë do të paguhet gjer me datë 30 Nëndor.

Approved For Release 2009/06/15 : CIA-RDP83-00418R001100040009-2

Approved For Release 2009/06/15 : CIA-RDP83-00418R001100040009-2

Neni 2

Duke filluar nga viti 1956, për zonat e agrumeve, të ullinjëve dhe ato blegtorale që caktohen me vendin të komitetit ekzekutiv të k. p. të qarkut mbi propozimin e komitetit ekzekutiv të K P. të rrethit përkatës, kesti i pa ë do të paguhet gjer me 1 Mars.

Neni 3.—

Ministrija e Financavet autorizohet që për raste të veçanta të caktojë edhe afate të tjera dhe të lëshojë udhëzimet e nevojshme mbi mënyrën e nxjerrjes së tatimit në formë avance.

Neni 4.—

Urdhëresa e Qeverisë Nr. 6 datë 31 Korrik 1954 mbetet pa fuqi

Neni 5.—

Kjo urdheresë hyn në fuqi menjëherë.—

SEKRETAR' I PËRGJITHËSHËM I KËSHILLIT MINISTRAVE
MUHAMER SPAHIU

KRYETAR' I KËSHILLIT MINISTRAVE TË R.P.SH
MEHMET SHEHU

URDHËRESË E QEVERISË

Nr. 10 Dt. 9-IV-1955

MBI

NJË NDRYSHIM NË URDHËRESËN E QEVERISË Nr. 25 DATË 13-VI-1949 MBI TARIFËN E TAGRAVE DOGANORE

Këshilli i Ministrave i Republikës Popullore të Shqipërisë, me qëllim që të ndalohet spekullimi në barnat që importohen nga privatët në mbledhjen e datës 9-IV-1955 nzjerrë këtë.

URDHËRESË

MBI

NJË NDRYSHIM NË URDHËRESËN E QEVERISË Nr. 25 DATË 13--VII-1949. MBI TARIFEN E TAGRAVE DOGANORE

Neni 1

Neni 5 i urdhëresës Nr. 25 datë 13-VII-1949 mbi tarifën e tagrave doganore ndryshohet si vijon:

"Ndalohet importimi dhe shitja nga privatët i të gjitha llojeve të barnave, qofshin këto edhe antibiotike,

Mund të importohen nga privatët pa iu shtruar tagrave doganore barna vetëm për nevoja të tyre përsonale ose të pjestarëve të familjeve të tyre, në sasitë që nevojiten, simbas raportit të lëshuar nga komisioni mediko-legal i poliklinikës së qarkut të vërtetuar nga kryemjeku.

Barnat e importuara tej sasive të parashikuara në par grafin e më sipërm, të çdo lloji qofshin këto, ose të ndodhura sot në doganë ose në duar të privatëve, do të blihen nga farmacitë e shtetit me çmimet në fuqi simbas udhëzimeve të Ministrisë së Shëndetësisë".

Neni 2 --

Kjo urdhëresë hyn në fuqi menjeherë.—

SEKRETAR' I PËRGHJITHËSHËM I KËSHILLIT TË MINISTRAVE
MUHAMER SPAHIU

ZËV KRYETAR' I KËSHILLIT MINISTRAVE TË REPUBLIKËS POPULLORE SHQIPËRISË
MANUSH MYFTIU

Approved For Release 2009/06/15 : CIA-RDP83-00418R001100040009-2

Approved For Release 2009/06/15 : CIA-RDP83-00418R001100040009-2

KËSHILLI I MINISTRAVE

VENDIM

Nr. 125, dt. 9-4-1955

MBI

APROVIMIN E STATUTIT TË INSTITUTIT TË SHKENCAVE

Këshilli i Ministrave i Republikës Popullore të Shqipërisë, në mbledhjen e datës 9 IV-1955 duke marrë parasysh zhvillimin ekonomik dhe kulturor të vendit që kërkon një organizim të ri të Institutit të Shkencavet në mënyrë që ky t'u përgjigjet sa më mirë nevojave të ndërtimit të socializmit në vendin tonë, si dhe me qëllim që të nxitet sa më shumë zhvillimi i shkëncës dhe i teknikës dhe të përkrahet inisiativa krijonjëse e punonjësve të shkencës.

VENDOSI:

1. — Aprovimin e statutit të Institutit të Shkencave të Republikës Popullore të Shqipërisë me përmbajtjen që vijon:

Kap. I.

Qëllimi

Neni 1

Instituti i Shkencavet i Republikës Popullore të Shqipërisë është Institucioni shkencor shtetëror më i larë i vëndit dhe varet ngo Këshilli i Ministrave i Republikës Popullore të Shqipërisë, i cili aprovon planet shkencore të Institutit të Shkencave dhe të cilit ky Institut i paraqet çdo vit raport për veprimtarinë e tij.

Instituti i Shkencavet është person juridik dhe përfaqësohet para institucioneve dhe para personave të tretë ngo Kryetari ose Zëvëndësi i tij.

Instituti i Shkencavet e ka qendrën e tij në Tiranë.

Neni 2

Instituti i Shkencave ka për qëllim të ndihmojë në zgjedhjen e problemeve shkencore të lidhura me zhvillimin ekonomik, kulturor dhe shoqëro të vendit.

Neni 3 .—

Për të realizuar këtë qëllin Instituti i Shkencavet:

a) zhvillon gjithë veprimtarinë e tij shkencore në bazë të materializmit dialektik dhe historik;

b) studjon problemet kryesore të lidhura me shfrytëzimin racional të pasurive natyrore dhe të forcave prodhuese të vendit dhe me shumëzimin e zhvillimin e tyre të mëtejshëm; studjon problemet kryesore të lidhura me historinë, gjuhësinë, letërsinë e popullit shqiptar duke luftuar sistematikisht kundër të gjitha teorive pseudo-shkencore;

c) lidh ngushtë punën e tij shkencore me nevojat e praktikës dhe organizon çkëmbimin e eksperiencës midis njerëzve të shkencës dhe të prodhimit;

ç) studjon dhe zbaton realizimin e shkencës sovjetike dhe të shkencës përparimtare botërore duke i vënë ato në shërbim të ndërtimit të shoqërisë socialiste;

d) merret me pregatitjen e kuadrove të reja shkencore dhe me kualifikimin e tyre me anën e ospiturës dhe të seminarëve të ndryshëm të lichuro me veprimtarinë e tij shkencore;

dh) përhap në masat punonjëse të vendit njohuritë shkencore.

Approved For Release 2009/06/15 : CIA-RDP83-00418R001100040009-2

Approved For Release 2009/06/15 : CIA-RDP83-00418R001100040009-2

Neni 4.—

Forma kryesore e punës shkencore të Institutit të Shkencavet është puna e planifikuar; por Instituti i Shkencavet ndihmon gjithashtu edhe inisiativën personale në punë shkencore të punonjësve të shkencës brënda dhe jashtë Institutit.

Neni 5.—

Instituti i Shkencavet;

a) Organizon herë pas here sesione shkencore, konferenca dhe konsulta për të diskutuar probleme të ndryshme shkencore;

b) organizon ekspedita kërkimesh shkencore;

c) organizon studime shkencore në bashkëpunim me shkencëtarë të Bashkimit Sovjetik, të vendeve të demokracisë popullore dhe me shkencëtarë përparimtarë të vendeve të tjera.

ç) krijon, pranë seksioneve përkatëse, për organizimin e studimeve, komisione ku ftohen të marrin pjesë edhe njerëz të shkencës që punojnë jashtë Institutit;

d) botoh rezultatet e punës së tij shkencore, vepra të anëtarëve të nstitutit dhe të punonjësve të tjerë të shkencës, si edhe organin periodik ë tij «Buletinin e Institutit të Shkencavet» në dy seri: për shkencat natyore dhe për shkencat shoqërore.

Kap. II.

Përbërja

Neni 6.—

Instituti i Shkencavet përbëhet nga anëtarët dhe kandidatët e Institutit të Shkencavet. Numuri i anëtarëve dhe i kandidatëve nuk është i kufizuar.

Neni. 7.—

Anëtarë të Institutit të Shkencavet bëhen ata njerëz përparimtarë që punojnë në fushën e shkencës dhe teknikës dhe që me punën e tyre kanë dhënë një kontribut të çmuar në ndërtimin e socializmit në Republikën Popullore të Shqipërisë.

Anëtarë të Institutit të Shkencavet mund të jenë kuadro të këtij Instituti ose punonjës të shkencës jashtë tij.

Neni 8.—

Kandidatë të Institutit të Shkencavet bëhen ata njerëz përparimtarë të shkencës që kanë treguar aftësi në punë shkencore dhe kanë ndihmuar me punën e tyre në zgjidhjen e problemeve shkencore e praktike për ndërtimin e socializmit.

Kandidatët e Institutit të Shkencavet mund të jenë kuadro të këtij Instituti ose punonjës të shkencës jashtë tij.

Neni 9.—

Anëtarët dhe kandidatët e Institutit të Shkencavet zhvillojnë punë shkencore brënda planit të këtij Instituti dhe japin llogari përpara tij për veprimtarinë e tyre, marrin pjesë aktive në punimet e asamblesë dhe të mbledhjeve plenare të seksioneve, zbatojnë porositë e veçanta të Institutit dhe e ndihmojnë atë aktivisht për përgatitjen dhe kualifikimin e kuadrove shkencore.

Approved For Release 2009/06/15 : CIA-RDP83-00418R001100040009-2

Approved For Release 2009/06/15 : CIA-RDP83-00418R001100040009-2

Neni 10.—

Anëtarët dhe kandidatët e parë të Institutit të Shkencavet caktohen nga Këshilli i Ministrave i Republikës Popullore të Shqipërisë. Pranimi i anëtarëve dhe kandidatëve të rinj bëhet në bazë të zgjedhjeve.

Neni 11.—

Anëtarët e rinj zgjidhen nga radhët e kandidatëve dhe kandidatët e rinj nga radhët e punonjësve të dalluar të shkencës në bazë të propozimeve me shkrim që bëjnë organizatat shoqërore dhe kulturale si edhe punonjës shkencorë të veçantë.

Neni 12

Kandidaturat e paraqitura për anëtarë dhe kandidatë të Institutit të Shkencavet shqyrtohen në bazë të relacioneve që paraqiten në mbledhjen plenare të seksionit përkatës, e cila në bazë të votimit të hapët, me shumicë votash shprehet pro ose kundër kandidaturës. Kandidatët që fitojnë, seksioni i a paraqet presidiumit të Institutit të Shkencavet dhe ky i fundit Asamblesë. Si anëtarë të zgjedhur të Institutit të Shkencavet quhen ata që kanë marrë shumicën e thjeshtë të votave të asamblesë me votim të fshehtë. Si kandidatë të Institutit të Shkencavet quhen ata që kanë marrë shumicën e thjeshtë të votave të asamblesë me votim të hapët.

Neni 13

Nuk mund të jenë anëtarë dhe kandidatë të Institutit të Shkencavet persona që kanë zhvilluar ose zhvillojnë një veprimtari antipopullore. Në qoftë se persona të tillë janë anëtarë ose kandidatë të Institutit të Shkencavet, këta përjashtohen nga radhët e anëtarëve ose kandidatëve me vendim të presidiumit, vendim i cili duhet të aprovohet me votim të fshehtë nga Asambleja në mbledhjen vjetore të saj me shumicë të thjeshtë votash.

Neni 14.—

Kuadrot shkencore të Institutit të Shkencavet punojnë në seksionet, muzetë, laboratorët dhe institutet e tij.

Këto kuadro bëjnë pjesë në organikën e Institutit të Shkencavet e cila aprovohet nga Këshilli i Ministrave i Republikës Popullore të Shqipërisë, me propozimin e presidiumit të Institutit të Shkencavet.

Kap. III.

Organet drejtuese.

Neni 15

Organet drejtuese të Institutit të Shkencavet janë: asambleja, presidiumi, kryesija e presidiumit, byroja e seksionit, kryesija e seksionit dhe drejtorija administrative.

Neni 16

Asambleja është organi më i lartë dhe përbëhet prej anëtarëve dhe kandidatëve të Institutit të Shkencavet. Anëtarët kanë votë votë deliberative dhe kandidatët votë konsultative.

Asambleja në mbledhjen e saj vjetore dëgjon dhe aprovon raportin e presidiumit mbi punën vjetore të Institutit të Shkencavet, cakton direktivat kryesore të punës shkencore të Institutit të Shkencavet, vendos për çështjet kryesore me karakter organizativ, aprovon planin vjetor, shqyrton probleme

Approved For Release 2009/06/15 : CIA-RDP83-00418R001100040009-2

Approved For Release 2009/06/15 : CIA-RDP83-00418R001100040009-2

me karakter shkencor dhe zgjedh anëtarët dhe kandidatët e Institutit të Shkencavet si edhe presidiumin e tij

Neni 17

Asambleja thirret nga presidiumi i Institutit të Shkencavet në mbledhje të zakonëshme jo më pak se një herë në vit, dhe në mbledhje të jashtëzakonëshme sa herë që ky e shikon të nevojëshme. Fondi i ditës i punimeve të asamblesë caktohet nga presidiumi i Institutit të Shkencavet dhe aprovohet nga asambleja.

Asambleja merr vendim kur në të marrin pjesë të paktën dy të tretat e anëtarëve të saj.

Neni 18.—

Presidiumi i Institutit të Shkencavet përbëhet prej kryetarit, nën/kryetarëve, kryetarëve të seksioneve, sekretarit shkencor të presidiumit dhe disa anëtarëve që zgjidhen nga kuadrot shkencore më të dalluara të Institutit të Shkencavet. Në presidium merr pjesë me votë konsultative drejtori administrativ i Institutit të Shkencavet.

Presidiumi zgjedh kryesinë e cila varet prej tij.

Neni 19

Presidiumi zgjidhet nga asambleja çdo tre vjet. Presidiumi duhet të përbëhet nga anëtarë të Institutit të Shkencavet.

Neni 20

Presidiumi zbaton vendimet e asamblesë dhe në intervalet midis mbledhjeve t'asamblesë është organi drejtues më i lartë i Institutit të Shkencavet.

Presidiumi i paraqet asamblesë për aprovim në sesionin e saj më të afërtë vëndimet më të rëndësishme që ka marrë.

Neni 21

Presidiumi jep udhëzime për hartimin e planeve të punës shkencore të seksioneve, shqyrton dhe aprovon planet e punës shkencore të seksioneve, dëgjon raportet e tyre, ndjek realizimin e planit, shqyrton dhe vendos për çështjet shkencore dhe organizative, aprovon buxhetin vjetor të Institutit të Shkencavet dhe ndarjen e tij midis seksioneve dhe institucioneve vartëse, është disponuesi kryesor i kredive, kontrollon shpenzimet e fondeve, mban lidhjet e Institutit të Shkencavet me të gjitha institucionet qeveritare me onën e kryesisë së tij, drejton punën e shtypit të Institutit të Shkencavet dhe mban lidhjet me botën e jashtëme.

Neni 22.—

Presidiumi u jep punonjësve të shkencës tituj shkencorë.

Neni 23

Vendimet e Presidiumit merren me shumicë të thjeshtë votash.

Neni 24

Kryesija e Presidiumit të Institutit të Shkencavet përbëhet prej kryetarit, n/kryetarëve dhe sekretarit shkencor të presidiumit. Ajo drejton Institutin e Shkencavet në intervalin midis dy mbledhjeve të presidiumit.

Neni 25

Organi udhëheqës i seksioneve është byroja e seksionit, e cila përbëhet prej kryetarit të seksionit, drejtorëve dhe zëvëndës drejtorëve të instituteve, kryetarëve të komisioneve që punojnë nën mvarësinë e seksionit dhe nierëzve të tjerë të dalluar të shkencës të caktuar nga presidiumi.

Anëtarët e byrosë caktohen nga presidiumi i Institutit të Shkencavet.

Approved For Release 2009/06/15 : CIA-RDP83-00418R001100040009-2

Approved For Release 2009/06/15 : CIA-RDP83-00418R001100040009-2

Neni 26.—

Kryesija e seksionit përbëhet nga kryetari i seksionit, i cili kryeson byronë dhe drejton punën shkencore të seksionit.

Neni 27.—

Drejtorija administrative e Institutit të Shkencavet drejton punën ekonomike dhe administrative të këtij Instituti.

Neni 28.—

Kryesija e seksioneve, byroja dhe drejtorija administrative funksionojnë në bazë të një rregulloreje të veçantë, aprovuar nga presidiumi i Institutit të Shkencavet.

Institucionet vartëse të Institutit të Shkencavet funksionojnë në bazë ë rregulloreve t'aprovuara nga Presidiumi i Institutit të Shkencavet.

Kap. IV.

Buxheti dhe mjetet.

Neni 29.—

Instituti i Shkencavet është institucion shtetëror buxhetor që ka llogari të pavarur.

Neni 30

Të glithë anëtarët dhe kandidatët e Institutit të Shkencavet marrin një shpërblim mujor të caktuar nga Këshilli i Ministrave pavarësisht nga paga që kanë ose vendi ku punojnë.

Neni 31

Kuadrot shkencore të Institutit të Shkencavet marrin paga në bazë të kategorizimit shkencor. Për funksionet në udhëheqjen e Institutit të Shkencavet ose të institucioneve vartëse, punonjësit shkencorë marrin shtesa të caktuara mbi pagën bazë.

Neni 32.

Anëtaret e Institutit të shkencavet dhe glithë punonjësit shkencorë brënda dhe jashtë këtij Instituti, kur ngarkohen me detyra të posaçme jashtë planit, marrin, me vendim të presidiumit, shpërblime brënda kuadrit të buxhetit vjetor të Institutit. Këto shpërblime caktohen nga byroja e seksionit përkatës.

Neni 33.—

Për vepra shkencore origjinale që janë parashikuar ose jo në plan që meritojnë të botohen, punonjësit shkencorë brënda ose jashtë Institutit të Shkencavet shpërblehen sipas dispozitave në fuqi.

Për përkthime, redaksime dhe punë të tjera të kryera në lidhje me botimet e Institutit paguhen shpërblimet përkatëse.

Kap. V.

Dispozita të fundit.

Neni 34.—

Instituti i Shkencavet ka vulë te rrumbullaktë në të cilën është stema e Republikës dhe rrotull saj emri i Institutit të Shkencavet me emblemën e vet: një kurorë prej kallijsh gruri dhe dafinë me libër të hapur në mes dhe mbi të një yll pesë cepash.

Approved For Release 2009/06/15 : CIA-RDP83-00418R001100040009-2

Approved For Release 2009/06/15 : CIA-RDP83-00418R001100040009-2

II. — Rregullorja e përkohëshme e Institutit të Shkencavet aprovuar me vendimin e Këshillit të ministrave Nr. 16 datë 82-I-1947 mbetet po fuqi.

III. — Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETAR I KËSHILLIT MINISTRAVE TË R.P.SH
MEHMET SHEHU

SEKRETAR I PËRGJITHËSHËM I KËSHILLIT MINISTRAVE
MUHAMER SPAHIU

KËSHILLI I MINISTRAVE

VENDIM

Nr. 129 dt. 9-IV-1955

MBI
APROVIMIN E STATUTIT TIP. TË TEKNIKUMEVE (SHKOLLAVE të MESME PROFESIONALE)

Këshilli i Ministrave i Republikës Popullore të Shqipërisë, në mbledhjen e datës 9-IV-1955 me qëllim që t'unifikohet organizimi i brendëshëm i teknikumeve (shkollave të mesme profesionale) të forcohet regulli në to dhe të sigurohet mbarëvajtja e tyre.

vendosi:

1. — Aprovimin e Statutit tip te teknikumeve (shkollave të mesme profesionale) me përmbajtjen që vijon:

KAPITULLI I I-rë.

Qëllimet dhe detyrat.

Neni 1.—

Në përputhje me artikullin —31— të kapitullit të III-të të Kushtetutës së Republikës Popullore të Shqipërisë, teknikumet (shkollat e mesme profesionale) realizojnë të drejtën që kanë shtetasit e Republikës Popullore të Shqipërisë për arësim dhe kanë për detyrë të pregatisim kuadro të kualifikuara me arësim të mesëm profesional, besnikë ndaj Atdheut tonë socialist, popullit, Partisë dhe Bashkimit të madh Sovjetik.

_____, që varet nga _____ duke plotësuar këtë detyrë, pregatit specialistë _____ _____ dhe zhvillon punën e tij mësimor-edukative në bazë të rregullave të më poshtëme:

KAPITULLI I II-të

Të drejtat dhe detyrat e nxënësit.

Neni 2.—

Të drejtën për të hyrë dhendjekur mësimet në një teknikum (shkollë të mesme profesionale) e gëzojnë shtetasit e Republikës Popullore të Shqipërisë të moshës gjer në 25 vjeç dhe që kanë mbaruar shkollën 7-vjeçare.

Në teknikumet e natës dhe me korespondencë, ku mësojnë nxënës pa u shkëputur nga puna në prodhim, nuk ka kufizim moshe për pranim

Approved For Release 2009/06/15 : CIA-RDP83-00418R001100040009-2

Approved For Release 2009/06/15 : CIA-RDP83-00418R001100040009-2

Neni 3.—

Pranimi i nxënësve në teknikumet (shkollat e mesme profesionale) bëhet duke zgjedhur elementët me të dalluar simbas aftësisë së tyre për-djekjen e secilës shkollë.

Neni 4.—

Nxënësi i një teknikumi (shkollë të mesme profesionale) është i detyruar:

a) të frekuentojë rregullisht mësimet të përvetësojë më së miri njohuritë e lëndëve mësimore që zhvillohen në shkollë, të kryejë në kohën e caktuar të gjitha detyrat shtëpijake, punët e ndryshme praktike-laboratorike, praktikën mësimore dhe atë në prodhim dhe të japë provimet në afatet e caktuara:

b) të jetë i disiplinuar dhe t'iu nënshtrohet absolutisht urdhërave të drejtorit, të zëvëndësit të tij dhe të mësonjësve;

c) të mbajë sjellje të hijëshme kundrejt drejtorit, zëvëndësit të tij, mësonjësve, kundrej personelit tjetër ndihmës mësimor dhe shërbenjës si dhe kundrejt të gjithë të riturve dhe nxënësve të tjerë;

ç) të zbatojë me përpikësi rregullat e regjimit të brendëshëm;

d) të ruajë pronën e shkollës.

Neni 5.—

Kur ndonjë nxënës shkel rregullat e caktuara për të, mund të merren kundra tij këto masa:

a) vërejte;

b) qortim para klasës;

c) ulje e notës në sjellje;

ç) Vërejtje e rëndë me paralajmërim për përjashtim nga shkolla;

d) përjashtim nga shkolla për një vit:

dh) Përjashtim nga të gjitha shkollat e Republikës.

Në rastet kur merren masa të tilla, menjëherë mbahen shënimet për katëse në dosjen personale të nxënësit.

Kur nxënësi përmirësohet, drejtori ka të drejtë (për masat e pikave «c» dhe «ç») — mbasi t'a shqyrtoje në këshillin pedagogjik t'i heqij dënimin e marë për të cilin është mbajtur shënim përkatës në dosjen personale të nxënësit.

Neni 6.—

Vërejtja dhe qortimi para klasës bëhen me urdhër të drejtorit, kurse ulja e notës në sjellje, vërejtja e rëndë me paralajmërim për përjashtim dhe masa për përjashtim një vit nga shkolla jepen me urdhër të drejtorit, por mbasi të jetë bërë shqyrtimi në këshillin pedagogjik.

Përjashtim nga të gjitha shkollat e Republikës jepet me urdhër të drejtorit mbas një shqyrtimi në keshillin pedagogjik dhe me aprovimin e Ministrisë s'Arësimit dhe Kulturës.

Dënimi për përjashtim nga shkolla jepet për shkelje sistematike të rregullave të regjimit të brendëshëm dhe të disiplinës shkollore, për mos frekuentimin e mësimeve dhe për kryerje aktesh të dobëta, të pahijëshme për një nxënës të shkollës sonë të re.

Neni. 7.—

Për përparim të mirë në mësime, për sjellje shëmbëllore dhe për punë aktive shoqërore përdoren këto forma emulacioni:

Approved For Release 2009/06/15 : CIA-RDP83-00418R001100040009-2

Approved For Release 2009/06/15 : CIA-RDP83-00418R001100040009-2

a) lavdërim verbal;
b) dhënia e çmimeve;
c) dhënie e fletë-lavdërimeve.

Neni 8.—

Çdo nxënës, mbas kryerjes me sukses dhe n'afatin e caktuar të kursit teorik dhe të praktikës mësimore dhe në prodhim, që janë të detyruarshme në bazë të planit dhe programeve mësimore, është i detyruar të japi provimet e shtetit ose të mbrojë projektin e diplomës (ashtu siç parashifet në planin mësimor) para komisionit shtetëror të kualifikimit, i cili vepron në bazë të udhëzimit të posaçëm mbi provimet semestrale, mbi provimet e shtetit dhe të mbrojtjes së diplomës në shkollat e mesme profesionale që ka nxierrë Ministria e Arësimit dhe Kulturës.

Neni. 9.—

Nxënësit që kanë kryer të gjitha detyrimet e planit mësimor dhe që kanë dhënë me sukses provimet shtetërore ose kanë mbrojtur me sukses projektet e diplomës, marrin një «Diplomë» mbi mbarimin e teknikumit (shkollës së mesme profesionale), ku shënohet kualifikimi që kanë fituar.

Neni 10.—

Nxënësit që kanë kryer planin mësimor në të gjitha lëndët mësimore si edhe praktikën mësimore dhe në prodhim duke marë notën «5» në jo më pak se 75% të lëndëve mësimore dhe notën «4» në të gjitha lëndët e tjera dhe që kanë dhënë provimet e shtetit ose që kanë mbrojtur projektin e diplomës me notën «5», marrin «Diplomë të shkëlqyer» dhe kanë këto të drejta:

a) të kenë preferencë për të hyrë në punë sipas specialitetit të tyre:
b) të kenë preferencë për t'u futur në numërin e kandidatëve për të hyrë në shkollat e larta pa patur vjetërsinë tre vjeçare në prodhim

Neni 11.—

Emërimet e nxënësve që mbarojnë shkollën bëhen nga institucion përkatës para mbarimit të shkollës.

KAPITULLI I III-të

Organizimi i punës mësimore.

Neni 12.—

Për të siguruar një nivel të lartë të punës mësimore, për të zhvilluar tek nxënësit shprehitë e punës së pavarur dhe aftësitë për të vënë në praktikë njohuritë e fituara në teknikum, caktohen këto forma të punës mësimore:

a) orët e mësimit;
b) punët praktike në laboratorë, kabinete, klinika, njisi ekonomike-didaktike, punishte eksperimentale, ofiçina etj;
c) praktika në prodhim;
ç) puna mësimore e nxënësit joshtë klasës (për kryerjen e detyrave shtëpijake, projekti i kurseve etj.).

Neni 13

Përparimi dhe sjellja e nxënesve vlerësohen në bazë të sistemit të pesë notave: «5» (shumë mirë), «4» (mirë), «3» (mjaftuarshëm) «2» (keq), «1» (shumë keq).

Approved For Release 2009/06/15 : CIA-RDP83-00418R001100040009-2

Approved For Release 2009/06/15 : CIA-RDP83-00418R001100040009-2

Vlerësimi i përparimit të nxënësve në mësime bëhet gjatë kontrollit të përditëshëm të njohurive dhe gjatë dhënjes së provimeve.

Për vlerësimin e sjelljes së nxënësve merret parasysh sjellja e tyre në shkollë, në praktikën mësimore, në praktikën në prodhim, në konvikt dhe jashtë shkollës.

Neni 14.—

Viti shkollor ndahet në dy semestra.

Ndarja e vitit shkollor në mësime teorike, në praktikën mësimore, në praktikën në prodhim, në provime si dhe afati i pushimeve semestrale dhe vjetore caktohet në planet mësimore.

Neni 15.—

Planet mësimore hartohen nga Ministria përkatëse dhe vihen në zbatim mbasi të jenë aprovuar dhe nga Ministrija e Arësimit dhe e Kulturës.

Programet e lendëve të kulturës së përgjithëshme pregatiten nga Ministrija e Arësimit dhe Kulturës dhe ato të lëndëve të kulturës profesionale pregatiten nga Ministria përkatëse.

Neni 16.—

Orari i mësimeve përpillohet për çdo semestër dhe shpallet 10 ditë para fillimit të mësimeve.

Ora e mësimit zgjat 45 minuta dhe pushimet midis orëve të mësimit zgjatin nga 10 minuta.

Neni 17.—

Kalimi i nxënësve në klasë më të lartë bëhet në bazë të notave të përparimit në mësimet teorike dhe në praktikat.

KAPITULLI I IV-të

Trupi mësimor dhe detyrat e tij.

Neni 18.—

Mësonjësit në teknikumet (shkollat e mesme profesionale) rregullisht duhet të jenë persona që kanë arësim të lartë.

Në raste të veçanta të pashmangëshme mund të merren për punë mësimore edhe personat me arësim të mesëm që kanë eksperiencë në punë pedagogjike ose në prodhim.

Neni 19

Emërimi i mësonjësve në teknikumet (shkollat e mesme profesionale) bëhet nga Ministrija e Arësimit dhe Kulturës për lëndët e kulturës përgjithëshme dhe nga Ministritë përkatëse për lëndët e kulturës profesionale.

Neni 20

Mësonjësve të teknikumeve (shkollave të mesme profesionale) iu ngarkohen këto detyra:

a) të kryejnë punën mësimore në volumin e parashikuar nga plani mësimor, nga programet mësimore dhe nga orari i mësimeve;

b) të kontrollojnë sistematikisht njohuritë e nxënësve, të drejtojnë dhe të kontrollojnë punën e tyre të pavarur;

c) të zhvillojnë punën edukative me nxenësit;

ç) të udhëheqin punën e rretheve të nxënësve;

d) të marrin pjesë në punën metodike të shkollës;

Approved For Release 2009/06/15 : CIA-RDP83-00418R001100040009-2

Approved For Release 2009/06/15 : CIA-RDP83-00418R001100040009-2

dh) të përfeksionojnë sistematikisht pregatitjen e tyre profesionale dhe të ngrejnë vazhdimisht nivelin e tyre ideo-politik;

e) të punojnë për realizimin e planit t' edukimit të nxënësve dhe ruajtjen e kontigjentit të këtyre gjatë vitit shkollor;

ë) të ruajnë, të shtojnë dhe të shfrytëzojnë mjetet mësimore.

Neni 21

Drejtori i teknikumit mund t'iu ngarkojë mësonjësve përgjegjësinë e laboratoreve dhe kabineteve mësimore në bazë të specialitetit të tyre,

Neni 22

Drejtori i teknikumit, me qellim që të ndiqet çdo ditë mësimi dhe edukimi i nxënësve, cakton për çdo klasë nga një mësonjës si kujdestar klase.

Mësonjësit kujdestar klase zhvillojnë punën e tyre në bazë të udhëzimeve të posaçme të Ministrisë s'Arësimit dhe Kulturës.

KAPITULLI I V-të

Struktura dhe udhëheqja.

Neni 23

[redacted]ka në përberjen e tij:

a) degët dhe specialitetet;

b) komisionet e lëndëve:

c) njësitë dhe institucionet mësimore ndihmëse (laboratore, kabinete, ofiçina, biblioteka, njësi ekonomike didaktike, klinika, punishte eksperimentale etj.);

ç) njësitë ekonomike ndihmëse.

Neni 24

Çelja e degëve dhe e specialiteteve të reja si dhe mbyllja e degëve dhe specialiteteve ekzistonjëse, bëhet me urdhërin e Ministrisë përkatëse në marrëveshje me Ministrinë e Arësimit dhe Kulturës.

Neni 25.—

Institucionet mësimore ndihmëse dhe njesitë ekonomike ndihmëse ngrihen dhe likujdohen me urdhërin e Ministrisë përkatëse.

Neni 26.—

Teknikumet (shkollat e mesme profesionale) ngrihen dhe mund të likujdohen vetëm me vendim të Këshillit të Ministrave.

Neni 27.—

Drejtori.

Në krye të teknikumit (shkollës së mesme profesionale) qendron drejtori, i cili regullisht duhet të ketë arësim të lartë dhe eksperiencë në punë pedagogjike ose në prodhim.

Neni 28

Drejtori emërohet dhe hiqet nga detyra prej Ministrisë përkatësë mbasi të jetë marrë dhe mendimi i Ministrisë s'Arsimit dhe të Kulturës.

Neni 29

Drejtori është përgjegjës para Ministrisë përkatëse dhe Ministrisë s'Arësimit dhe Kulturës për udhëheqjen e shkollës, për pregatijen dhe nxjerrjen në kohën e caktuar të specialistëve të rinj të kualifikuar.

Approved For Release 2009/06/15 : CIA-RDP83-00418R001100040009-2

Approved For Release 2009/06/15 : CIA-RDP83-00418R001100040009-2

Neni 30

Drejtori i shkollës ka këto detyra:

a) drejtimin e gjithë veprimtarisë së teknikumit dhe përfaqësimin e ti

b) zbatimin e planeve dhe të programeve mësimore;

c) kontrollin e punës së mësonjësve;

ç) drejtimin e të mesuarit të nxënësve dhe konktrollin e përparimit të tyre në mësime;

d) drejtimin e punës politike, edukative dhe kulturale që zhvillohet me nxënësit, me mësonjësit dhe personelin tjetër ndihmës;

dh) aprovimin e orëve të mësimit dhe të provimeve: aprovimin e rregullave të regjimit të mbrendëshëm dhe vëzhgimin mbi zbatimin e përpiktë të tyre;

e) drejtimin e edukatës fizike dhe kontrollin e ndjekjes e gjendjes shëndetësore të nxënësve;

ë) zbatimin e planeve të caktuara për pranimin e nxënësve të rinj dhe për nxjerrjen e specialistëve të rinj të kualifikuar;

f) organizimin e shërbimit të përditëshëm për plotësimin e nevojave të nxënësve dhe personelit mësimor;

g) disponimin e financave dhe të pasurisë;

gj) realizimin e planit t'edukimit dhe ruajtjen e kontigjentit të nxënësve

h) drejtimin e punës dhe të jetës së konviktit.

ZËV/DREJTORI PËR PUNËN MESIMORE

Neni 31.—

Zëv/Drejtor për punën mësimore caktohet një nga mësonjësit më të kualifikuar të teknikumit (shkollës së mesme profesionale), i cili emërohet dhe shkarkohet nga detyra prej Ministrisë përkatëse me propozim të drejtorit

Neni 32.—

Zëv/drejtori për punën mësimore është përgjegjës para drejtorit dhe Ministrisë përkatëse për punën mësimore metodike të mësonjësve dhe për përparimin e nxënësve.

Zëv/drejtori për punën mësimore ka këto detyra:

a) organizimin dhe drejtimin e punës mësimore-edukative:

b) përpilimin e orarit të mësimeve dhe të provimeve si edhe kontrollin e zbatimit të tyre;

c) organizimin dhe drejtimin e praktikës mësimore dhe praktikës në prodhim;

ç) drejtimin e punës edukative me nxënësit;

d) organizimin e mbledhjeve metodike mësimore si edhe drejtimin e punës së komisioneve të lëndëve;

dh) drejtimin dhe kontrollimin e punës së bibliotekës, institucioneve mësimore ndihmëse etj.

e) organizimin dhe drejtimin e punës për ngritjen e nivelit të kualifikimit të personelit mësimor dhe ndihmës mësimor;

ë) zëvëndësimin e drejtorit në mungesë të tij.

ZËV/DREJTORI PËR PUNËT ADMINISTRATIVE-EKONOMIKE

Neni 33.

Zëv/drejtori për punët administrative-ekonomike emërohet dhe shkarkohet nga detyra prej Ministrisë përkatëse me propozim të drejtorit.

Approved For Release 2009/06/15 : CIA-RDP83-00418R001100040009-2

Approved For Release 2009/06/15 : CIA-RDP83-00418R001100040009-2

Vendi i zëv/drejtorit për punët administrative-ekonomike caktohet vetëm në rastet që përfshihen në organikën tip të shkollove të mesme profesionale Në teknikumet, që nuk u takon të kenë zëv/drejtor për punët administratrive-ekonomike, caktohet vendi i ekonomit.

Neni 34.—

Zëv/drejtori për punët administrative-ekonomike ka këto detyra;

a) drejtimin direkt të punës të të gjitha institucioneve ekonomike të shkollës dhe vëzhgimin mbi rregullin dhe gjëndjen sanitare dhe higjenike të lokaleve mësimore, të laboratoreve, të kabineteve, të konviktit, të nxënësve dhe t'ekonomive ndihmëse;

b) drejtimin e ndërtesave dhe meremetimeve të përgjithëshme dhe të rastit,

c) Sigurimin e lokaliteteve mësimore, e laboratorave, e kabineteve, me lëndë djegëse, dritë dhë me gjërat e tjera të domosdoshme për funksionimin e ìyre dhe pajisjen e lokaleve kulturale, mësimore dhe ekonomike me orenditë dhe bazën materjale të nevojshme;

ç) Organizimin e ruajtjes së ndërtesave mësimore, të konviktit, t'inventarit dhe të pajimeve.

Neni 35.

DEGA.

Dega është një njësi mësimore administrative e shkollës që realizon pregatitjen e nxënësve në specialitete të ofërta.

Neni 36.—

Degët varen nga zëv/drejtori për punën mësimore ose nga drejtori sipas specialitetit që kanë.

Neni 37.—

Si kryetar i degës caktohet një nga mësonjësit e lëndëve kryesore të kësaj dege dhe aprovohet nga ministria përkatëse me propozim të drejtorit të shkollës.

Neni 38

Kryetari i degës ka këto detyra;

a) Drejtimin direkt të punës mësimore metodike, të praktikës mësimore dhe në prodhim për nxënësit e degës;

b) Sigurimin e zbatimit të planeve dhe programeve mësimore;

c) Pregatitjen e materialit për orarin e punës mësimore;

ç) Kontrollimin e përparimit të nxënësve në mësime;

d) Ndjekjen e frekuentimit të mësimeve dhe të disiplinës në degë,

dh) Drejtimin e punës edukative me nxënësit.

Neni 39.—

Norma e punës mësimore dhe kategorizimi i kryetarëve të degëve caktohen në bazë të normave për punën mësimore në teknikumet shkollat e mesme profesionale.

KOMISIONET E LËNDËVE MËSIMORE.

Neni 40.—

Komionet e lëndëve mësimore përbëhen nga mësonjësit e të njejtës lëndë ose të disa lëndëve t'ofërta mësimore.

Çdo komision lëndësh organizohet kur në përbërbërjen e tij hyjnë jo më pak se 3-4 mësonjës.

Approved For Release 2009/06/15 : CIA-RDP83-00418R001100040009-2

Approved For Release 2009/06/15 : CIA-RDP83-00418R001100040009-2

Komisionet e lëndëve mësimore punojnë nën drejtimin e zëv/drejtorit për punën mësimore.

Neni 41.

Numëri i komisioneve të lëndëve dhe i mësonjësve që do të marrin pjesë në to caktohet nga drejtori i shkollës në fillim të çdo viti shkollor.

Neni 42.

Drejtimi direkt i punës së çdo komisioni të lëndëve mësimore bëhet prej kryetarit të komisionit të lëndëve mësimore që caktohet prej drejtorit dhe është një nga mësonjësit pjesë-marrës të komisionit

Neni 43.—

Puna e komisioneve të lëndëve mësimore zhvillohet simbas planit t'aprovuar nga zëv/drejtori për punën mësimore.

Neni 44.

Detyrat e komisioneve të lëndëve mësimore janë:

Shqyrtimi i metodave të punës mësimore dhe i orëve të veçanta të mësimit, i çështjes së përpunimit të nxënësve në mësime, i punës së mësonjësve të veçantë, i punës së kabineteve, laboratorëve, ofiçinave mësimore dhe njësive mësimore ndihmëse, shqyrtimi i programeve mësimore, i planëve semestrale kalendarike të mësonjësve, i teksteve dhe i mjeteve mësimore,

Plani i punës së çdo komisioni të lëndëve duhet të hartohet për çdo semestër dhe të përfshijë çështjet mbi punën organizativo-mësimore dhe metodike për ngritjen e kualifikimit të mësonjësve dhe mbi punën jashtë klasës.

Neni 45.—

Norma mbi punën mësimore dhe metodike si edhe kategarizimi i kryetarëve të komisioneve të lëndëve mësimore caktohen në bazë të normave për punën mësimore në teknikumet (shkollat e mesme profesionale).

PERSONELI NDIHMËS MËSIMOR.

Neni 46.

Numëri dhe përbërja e personelit ndihmës mësimor caktohet nga Ministria përkatese me propozim të drejtorit të shkollës në bazë të dispozitave në fuqi.

KËSHILLI PEDAGOGJIK

Neni 47.

Pranë drejtorit të shkollës dhe nën kryesinë e tij organizohet këshilli pedagogjik i teknikumit (shkollës së mesme profesionale) me këtë përbërje:

Zëv/drejtori për punën mësimore, zëv/drejtori për punët administrative-ekonomike, drejtonjësit e edukatës ushtarake, kryetarët e degave, mësonjësit, përfaqësonjësit e organizatave shoqërore të teknikumit (shkollës së mesme profesionale) dhe nën/drejtori i konviktit.

Në përbërjen e këshillit pedagogjik mund të hyjnë edhe udhëheqësit e institucioneve mësimore ndihmëse (bibliotekave, kabineteve etj), mjeku i shkollës si edhe përfaqësonjësit e ndërmarjeve dhe institucioneve për të cilat shkolla pregatit specialistë.

Detyrën e sekretarit të këshillit pedagogjik e kryen njeri prej mësonjësve që zgjidhet për gjithë vitin shkollor nga këshilli pedagogjik, me propozim të drejtorit.

Në raste të veçenta për teknikumet me numër të madh degësh dhe mësonjësish, me aprovimin e Ministrisë s'Arësimit dhe të kulturës si edhe

Approved For Release 2009/06/15 : CIA-RDP83-00418R001100040009-2

Approved For Release 2009/06/15 : CIA-RDP83-00418R001100040009-2

të Ministrisë përkatëse mund të ngrihen edhe këshilla pedagogjike të degëve në bazë të propozimit të bërë nga drejtori i teknikumit.

Neni 48.—

Këshilli pedagogjik mblidhet në afatet e caktuara prej drejtorit të shkollës në bazë të planit kalendarik të mbledhjeve të këshillit pedagogjik por gjithënjë jo më radhë se një herë në muaj.

Neni 49

Këshilli pedagogjik shqyrton: planet vjetore ose semestrale të punës së shkollës, përfundimet e përparimit të nxënësve, gjëndjen dhe përfundimet e mësimeve praktike, gjëndjen e disiplinës dhe të punës politike edukative, planet e punës dhe raportet e degëve dhe të komisioneve të lëndëve mësimore, punën e institucioneve mësimore edukative dhe çështjet e ngritjes së kualifikimit të mësonjësve dhe të punonjësve të tjerë të shkollës.

Neni 50.

Vendimet e këshillit pedagogjik hyjnë në fuqi mbasi të jenë aprovuar nga drejtori i shkollës.

Për çështje të tjera dhe më të hollësishme këshilli pedagogjik duhet të punojë në bazë të udhëzimeve të posaçme për këshillin pedagogjik të nxierra nga Ministrija e Arësimit dhe e Kulturës.

KAPITULLI I VI-të

PASURIA DHE FONDET E TEKNIKUMIT

Neni 51.

Pasuria e teknikumit (shkollës së mesme profesionale) ndërtesat, pajisja, inventari etj. janë pronë socialiste.

Pasuria _____ që figuron në listat e inventarit dhe që gjëndet në bilancin e tij mund të tërhiqen vetëm me lejen e Ministrisë përkatëse.

Neni 52.

Fondet e teknikumit (shkollës së mesme profesionale) përbëhet prej:

a) Fondeve të parashikuara nga Ministria përkatëse për funksionimin e teknikumit (shkollës së mesme profesionale);

b) Fondeve speciale të përbëra nga t'ardhurat e ekonomisë ndihmëse.

Neni 53.—

. . . . . është një institucion i pavarur që vepron si një person juricik dhe që ka planin e tij financjar t'aprovuar prej Ministrisë përkatëse.

Neni 54.

. . . . . ka vulën e vet me stemën shtetërore.

KAPITULLI I VII-të

MËNYRA E APROVIMIT TË RREGULLORES

1. Regulloria e . . . . . aprovohet nga Ministrija e Arësimit dhe Kulturës dhe nga Ministria përkatëse me propozimin e teknikumit . . . . .

2. Ministria e Arësimit dhe Kulturës të nxierrë udhëzim të posaçëm për zbatimin e Statutit tip dhe hartimin nga çdo teknikum të Statutit të ti të mbështetur në Statutin tip.

Approved For Release 2009/06/15 : CIA-RDP83-00418R001100040009-2

Approved For Release 2009/06/15 : CIA-RDP83-00418R001100040009-2

3. Urdhresa e Qeverisë Nr. 49 dt. 10-X-1950 mbi organizimin e arësimit të mesëm profesional si dhe çdo rregullore tjetër e aprovuar gjer më sot nga Ministritë e ndryshme dhe që flet mbi organizimin e brëndëshëm të teknikumeve, mbetet pa fuqi.

4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

SEKRETAR'I PËRGJITHËSHËM I KËSHILLIT TË MINISTRAVE
Muhamer Spahiu

ZV/KRYETAR'I KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË R. P. SH.
Manush Myftiu

KËSHILLI I MINISTRAVE

VENDIM

Nr. 130 Dt. 9-IV-1955

MBI MASAT PËR MBROJTJEN E MONUMENTEVE TË KULTURËS

Këshilli i Ministrave i Republikës Popullore të Shqipërisë, në mbledhjen e datës 9-IV-1955, duke marrë parasysh se udhëheqja dhe kontrolli për mbrojtjen dhe restaurimin e monomenteve historike, arkeologjike, t'arkitekturës dhe t'artit nuk realizohet në mënyrë të kënaqëshme edhe me qëllim që të sigurohet në t'arthmen një mbrojtje më e mirë e tyre në bazë të nenit 14-të ligjës Nr. 609 datë 24-V-1948 mbi mbrojtjen e monumenteve të kulturës dhe ë sendeve të rralla,

V E N D O S I :

I– Udhëheqja dhe kontrolli për mbajtjen e evidencës ruatjen restaurimin dhe përdorimin e monumenteve të kulturës të kryhet nga Istituti i Shkencave i Republikës Popullore të Shqipërisë.

II.— Ruajtja e monumenteve të kulturës që ndodhen në vendet e ndryshme ë Republikës të bëhet nga komitetet ekzekutive të k. p. të qarqeve, rrethete, qyteteve lokaliteteve dhe këshillave popullore të fshatrave përkatëse.

III. — Instituti i Shkencave i Republikës:

a) të krijojë pranë muzeut arkeologjik-etnografik një atelie e cila të merret me mirëmbajten, ruajtjen. dhe restaurimin e monumenteve të kulturës dhe të parashikojë në buxhetin e tij vjetor fonde e materiale të nevojshme që do të përdoren për këtë qëllim për monumentet e kulturës që nuk janë dhënë me qira për shfrytëzimin ekonomik;

b) të formojë një këshillë medodik-shkencor për mbrojtjen e monumentave të kulturës me përfaqësues t'institutit të shkencave, të Ministris s' Arsimit dhe Kulturës, të ndërmarrjes Projekti dhe specialistë të ndryshëm në lëmin e studimit dhe të restaurimit të monumenteve të kulturës duke i ngar kuar këtij këshilli udhëheqjen e punës metodike-shkencore në ruajtjen dhe në studimin e monumenteve të kulturës, në perfeksionimin e metodave shkencore të punimeve të restaurimit dhe në caktimin e klasifikimit shkencor të monumenteve të kulturës:

c) Të përpunojë dhe t'aprovojë rregulloren e këshillit metodiko-shkencor të sipërm;

ç) Të përfundojë brënda vitit 1958 regjistrimin e të gjitha monumenteve të njohura gjer më sot dhe që duhet të figurojnë në listat shtetërore s monumente të kulturës,

Approved For Release 2009/06/15 : CIA-RDP83-00418R001100040009-2

Approved For Release 2009/06/15 : CIA-RDP83-00418R001100040009-2

IV.— Aprovohet rregullorja për rruajtjen e monumenteve të kulturës me përmbajtjen që vijon

I.— DISPOZITA TË PËRGJITHËSHME

1) Të gjithë monumentet e kulturës, që ndodhen në tokën e Republikës Popullore të Shqipërisë dhe që kanë një rëndësi shkëncore, historike ose artistike janë pasuri e pa-prekshme e gjithë popullit dhe vihen nën mbrojtjen e shtetit.

2) Monumentet e kulturës që i nënshtrohen mbrojtjes së shtetit janë:

a) *Monumentet e Arkitekturës*: ndërtesat civile dhe fetare, kala e kulla, gërmadha e mbeturina të ndërtesave arkitekturale, ura monumente varesh të vjetra mauzole, etj, ashtu edhe gjithë veprat e pikturës e skulpturës monumentale, artit të aplikuar dhe të artit të kopshtijeve e parqeve që lidhen me'to'

b) *Monumentet e Artit* veprat e pikturës dhe të skulpturës së kavaletit, veprat e grafikës dhe objektet e arteve dekorative, që ndodhen nëpër Institucionet dhe vendet e ruajtjes shtetërore, ashtu edhe monumentet e skulpturës.

c) *Monumentet e Arkeologjisë*: ndërtimet lakustre (ndër brigjet e liqejve), vënde dhe shpella ku gjenden eshtra kafshësh paleontologjike, tumulat, qytezat e gradishtet, mbeturinat e stacioneve, banimeve dhe qyteteve të lashta, mburoja toke, llogore, gjurma të kanaleve të ujitjes dhe rrugëve, nekropole, pikturat, skulptimet dhe mbishkrimet e lashta, ashtu dhe objekte antike të ndryshme.

ç) *Monumentet historike*: ndërtesat dhe vëndet që lidhen me ngjarje të rëndësishme të historisë së popullit t'onë, me lëvizjen revolucionare dhe në luftën Nac. çl. të tij; me ndërtimin e socializmit, monumente që kanë një rëndësi përkujtimore të lidhura me jetën dhe veprimtarinë e personaliteteve të shquara shtetërore dhe politike, me herojt e popullit dhe me njerzit e shquar të shkencës, artit, teknikës, varet e tyre, monumentet e historisë së teknikës, të artit ushtarak, të ekonomisë dhe jetësës.

3) Monumentet e kulturës që, simbas nenit 2 vihen në mbrojtjen e shtetit përmbahen në lista të posaçme që oprovohen nga Instituti i Shkencave i Republikës Popullore të Shqipërisë.

4) Monumentet e kulturës, që kanë një rëndësi të madhe shkencore historike dhe artistike përshkruhen në një listë të veçantë dhe mbi propozimin e Institutit të shkencave, shpallen nga këshilli i Ministrave si monumente kombëtare.

5) Monumentet e kulturës me karakter kompleks, që kanë një rëndësi të veçantë shkencore historike ose artistike mund të shpallen me vendim të Këshillit të Ministrave monumente të një mbrotjeje të veçantë dhe ruhet dispozitash të veçanta për seicilin.

6) Monumentet e kulturës, të mbledhura nëpër muze dhe nëpër vënde të tjera te ruajtjes, duhet të regjistrohen dhe të ruhen sipas dispozitave të caktuara për muzetë dhe për vëndet e tjera të ruajtjes, sikurse është vendosur nga ana e organeve shtetërore qëndrore nën drejtimin e të cilave ato ndodhen.

7) Udhëheqja dhe kontrolli për mbajtjen e evidencës, ruajtjen, restaurimin dhe përdorimin e monumenteve të kulturës, bëhen nga Instituti Shkencave i Republikës Popullore të Shqipërisë.

Approved For Release 2009/06/15 : CIA-RDP83-00418R001100040009-2

Approved For Release 2009/06/15 : CIA-RDP83-00418R001100040009-2

8) Ruajtja e monumenteve të kulturës u ngarkohet komiteteve ekzekutive të qarqeve, rretheve, qyteteve, lokaliteteve dhe këshillave popullore të fshatrave.

9) Ndryshimi, (modifikimi) lëvizja nga vëndi dhe çdo farë punimi në teritorin e monumenteve të kulturës dhe në "monumentet të një mbrojtjeje të veçantë", ndalohet dhe mund të bëhet vetëm me një autorizim të posaçëm nga:

a) Këshilli i Ministrave, për monumentet kombëtare dhe për "monumentet e një mbrojtjeje të veçontë".

b) Instituti i Shkencave i Republikës Popullore të Shqipërisë për monumentet e tjera.

10) Fondet që merr Instituti i Shkencave për monumentet e kulturës duhet të shpenzohen vetëm për nevojat që kanë të bëjnë me brojtjen, riparimin dhe restaurimin e monumenteve të kulturës.

11) Kur, për raste të jashtëzakonshme, jepet autorizim për modifikimin ose translokimin e monumentit të kulturës, Istituti i Shkencave duhet të organizojë kryerjen e punimeve shkencore të monumenteve në fjalë (gërmimet, fotografimet, matjet, hartimin e skicave e vizatimeve, dorëzimin e disa sendeve të gjetura muzeve, etj) Punimet e rivendosjes, shpenzimet që bëhen me këtë rast, rëndojnë atë institucion që ka marrë autorizimin e trasportimit ose të modifikimit të këtyre monumenteve.

II.— MBROJTJA E MONUMENTEVE T'ARKITEKTURËS

12)Udhëheqja dhe kontrolli për mbajtjen e evidencës, ruajtjen restaurimin dhe përdorimin e monumenteve të arkitukturës, bëhet nga Instituti i Shkencave i Republikës Popullore të Shqipërisë.

13) Të gjitha monumentet e arkitekturës në lidhje me përdorimin e tyre ndahen në tre grupe:

a) Monumentet e arkitekturës që nuk mund të përdoren për qëllime praktike (mure të vjetra, godina të rrënuara. çesme, monumente sepulkrale et.).

b) Monumente që mund të përdoren, por ekskluzivisht nga institute shkencore dhe muze, duke ruajtur fizionominë e tyre artistiske dhe historike, mobilimin e brendëshëm dhe gjendjen e jashtëme (muze fortesa muze kisha e xhami, muze manastire, etj.)

c) Monumente që mund të përdoret për shfrytëzim, po pa pësuar ndonjë dëm përsa i përket ruajtjes së tyre, pa cënime të vlerave historike e artistike, kur këto u jepen organizatave, institucioneve dhe përsonave të ndryshëm

14) Përdorimi i monumenteve të kulturës të shënuara në gërmat b dhe c) të pikës 13 lejohet vetëm në bazë të kushteve të caktuara nga Instituti i Shkencave i Republikës Popullore të Shqipërisë, të përmbajtura në kontrata të posaçme.

15) Ndërmarrjet, institucionet shtetërore, organizatat dhe përsonat që kanë me qira monumente të arkitekturës; që përfshihen në listen e monumenteve të kultures i mbajnë dhe i përdorin këto simbas kushteve të parashikura nga kontrata përkatëse që lidhen nga drejtuesit e institucioneve shtetërore, ndërmarjeve, organizatave dhe përsonave me përfaqësuesit e Institutit të Shkencavet.

16) Drejtuesit e ndërmarrjeve, e institucioneve, shtetnore, të organizatave dhe përsonat që përdorim monumentet e arkitekturës janë përgjegjës,

Approved For Release 2009/06/15 : CIA-RDP83-00418R001100040009-2

Approved For Release 2009/06/15 : CIA-RDP83-00418R001100040009-2

për ruajtjen dhe riparimet e nevojshme sipas udhëzimeve të Institutit të Shkencave për mirëmbajtjen e pjesëve ku ndodhen monumentet dhe për organizimin e ruajtjes përkatëse të këtyre monumenteve.

17) Ndërmarrjeve, institucioneve, organizatave dhe personave qiramarrës që nuk respektojnë kushtet e kontratos duke rrezikuar në këtë mënyrë dëmtimin e monumentit të marrë me qira, me kërkesë të Institutit të Shkencave u hiqet menjiherë e drejta e përdorimit duke u detyruar njëkohësisht që të paguajnë të gjitha dëmet që i janë shkaktuar monumentit.

18) Punimet e restaurimit dhe të riparimit, ashtu edhe punimet e studimeve shkencore që lidhen me sondazhet e monumenteve të arkitekturës ose punimi i tokës dhe gërmimet brënda kufijve të zonës së ruajtur mund të bëhen vetëm në bazë të autorizimit të Institutit të Shkencave.

19) Instituti i Shkencave cakton rreth monumenteve të arkitekturës zona ruajtje sipas madhesisë dhe rëndësisë së tyre.

20) Komitetet ekzekutive të k. p. të rretheve, qyteteve dhe këshillave popullore të fshatrave në territorin e të cilave ndodhen monumente të arkitekturës, kanë për detyrë:

a) Të kujdesen për mbajtjen në gjëndje të mirë dhe për ruajtjen e monumenteve të arkitekturës që janë në përdorim të ndërmarrjeve, institucioneve të ndryshme shtetërore, organizatave ose personave në bazë të kontratos të nënshkruar prej tyre.

b) Të vënë në dijeni Institutin e Shkencavet për marrjen e masave të duhura dhe mbajtjen në gjendje të mirë (riparim dhe restaurin) të monumenteve të arkitekturës, të cilat nuk përdoren nga ana e ndërmarrjeve, institucioneve shtetërore, organizatave dhe personave të ndryshëm.

III. — MBROJTJA E MONUMENTEVE TË ARTIT

21) Kontrolli për mbajtjen në gjëndje të mirë, për ruajtjen dhe restaurimin e monumenteve të pikturës dhe të skulpturës, të grafikës dhe të artit dekorativ, ushtrohet nga Instituti i Shkencave, pavarësisht nga cili institucion, ndërmarrje ose organizate varen këto ashtu edhe nga vendi ku ndodhen (nëpër ndërtesa ose të hapura).

22) Konservimi dhe restaurimi i monumenteve t'artit, pavarësisht nga cili institucion, ndërmarrje ose organizatë varen, mund të bëhet vetëm me autorizimin e Institutit të Shkencave.

23) Instituti i Shkencave ka të drejtë të kontrollojë shit-blerjen e sendeve të ndryshme historike, arkeologjike dhe artistike dhe gëzon të drejtën e precedencës në blerjen e këtyre sendeve, edhe kur këto janë blerë nga institucione ose persona të tjerë pa dijeninë e Institutit të Shkencavet.

IV. — MBROJTJA E MONUMENTEVE ARKEOLOGJIKË

24) Kërkimet dhe gërmimet arkeologjike bëhen vetëm me autorizimin e Institutit të Shkencave.

25) Institucionet dhe organizatat të cilave u jepet autorizimi për të bërë kërkime ose gërmime arkeologjike të ndonjë monumenti, detyrohen, që nga fillimi gjer në mbarim të punimeve, të marrin masat e duhura për ruajtjen e monumentit nga rrënimi ose nga vjedhja.

26) Komitetet ekzekutive kanë për detyrë:

a) Të kujdesen që kërkimet ose gërmimet arkeologjike të bëhen vetëm

Approved For Release 2009/06/15 : CIA-RDP83-00418R001100040009-2

Approved For Release 2009/06/15 : CIA-RDP83-00418R001100040009-2

nga personat që kanë të drejtë të bëjnë këtë gjë në bazë të autorizimit të lëshuar nga Instituti i Shkencave.

b) Të mos lejojnë që monumentet arkeologjike (si p.sh. mbeturinat e qyteteve të lashta, rrenimet dhe gërmadhat e qyteteve të vjetëra, të tumulave, të vorezave, etj.) të përdoren si material ndërtimi, për kullotje, lëvrim ose për çfardo qëllim tjetër.

c) Të ndalojnë menjiherë të gjitha gërmimet dhe veprimet e tjera arbitrare që mund të shkaktojnë rrënimin e monumenteve arkeologjike.

27) Instituti i Shkencavet cakton rreth monumenteve arkeologjike zona ruajtjeje sipas madhësisë dhe rëndësisë së tyre.

28) Zbulimet e ndryshme arkeologjike që bëhen rastësisht në vazhdim të punimeve bujqësore, të bonifikimeve, të çeljeve të kanaleve, të ndërtimeve dhe punimeve të mëdha shtetërore (si miniera, hidroçentrale) dhe çelje rrugësh duhet t'i njoftohen menjiherë Institutit të Shkencave, i cili është i detyruar të dërgojë në vënd brenda një afati prej 7 ditësh përfaqësuesin e vet për studimin e vendit të zbulimit dhe marrjen në dorëzim të materialit të gjetur.

Në rast se monumenti i zbuluar nuk është i luejtëshëm dhe vlefta e tij arkeologjike është e madhe, punimet e filluara duhet të pësojnë në këtë vënd një ndryshim të tillë që të lejojë ruajtjen e monumentit.

29) Monedhat e gjetura deri tani dhe që do të gjënden nëpër thesarët e ndryshme duhet t'i dorëzohen Institutit të Shkencavet, i cili duhet të sigurojë ruajtjen, përshkrimin shkencor dhe shpërndarjen e akzemplarëve të tyre për ekspozim nëpër muze.

V. — MBROJTJA E MONUMENTEVE HISTORIKE

30) Regjistrimi, mirëmbajtja, restaurimi dhe përdorimi i monumenteve historike bëhet nga Instituti i Shkencave i Republikës Popullore të Shqipërisë.

31) Për të gjitha çështjet që i përkasin ruajtjes, mbajtjes në gjëndje të mirë dhe përdorimit të monumenteve historike, zbatohen, sipas rasteve, pikat 13 gjer në 20 të kësaj rregulloreje.

VI. — MBROJTJA E PASURISË SË MUZEVE

32) Muzetë shtetërore janë vendet kryesore të ruajtjes së koleksioneve të monumenteve të luejteshme të kulturës.

Muzetë shtetërore ndahen në:

a) Muze qendrore.

b) Muze lokale.

33) Përgjegjësia e ruajtjes së koleksioneve që ndodhen të mbledhura në muze u ngarkohet organeve që kanë muzet nën drejtimin e tyre direkt.

34) Çdo nxerrje jashtë nga muzetë e koleksioneve artistike dhe arkeologjike ose e koleksioneve shkencore ashtu edhe e objekteve të veçanta të marra prej këtyre koleksioneve, ndalohet. Dhënia e tyre institucioneve të ndryshme shtetërore ose organizatave mund të bëhet në bazë të një autorizimi të posaçëm për çdo rast të veçantë nga ana e organeve qendrore kompetente nga i cili varet muzeu.

35) Instituti i Shkencave, mund të marrë nga muzetë lokale objekte të cilat janë të nevojshme për qëllime studimi ose arësye të tjera shken-

Approved For Release 2009/06/15 : CIA-RDP83-00418R001100040009-2

Approved For Release 2009/06/15 : CIA-RDP83-00418R001100040009-2

core dhe t'i bjerë në muzetë e tij qendrore me afat të përkohëshëm ose përgjithmonë.

36) Transferimi i muzeve nga lokalet ku ndodhen ashtu edhe përdorimi (pjesërisht ose tërësisht i ndërtesave të muzeve jo për qëllime direkte të tyre, ndalohet).

Përjashtime nga ky rregull mund të lejohen vetëm në bazë të një autorizimi të posaçëm të organeve qendrore nga të cilat varen muzetë.

37) Hapja dhe mbyllja e muzeve të ndryshme mund të bëhet vetëm me autorizimin e Këshillit të Ministrave të Republikës Popullore të Shqipërisë.

VII — DISPOZITA TË FUNDIT

38) Autorizohet Instituti i Shkencave të nxjerrë udhëzime përsa i përket rregullit të mbajtjes s'evidencës, regjistrimit dhe mirëmbajtjes së monumenteve të kulturës.

V. — Ky vendim hyn në fuqi menjiherë,

SEKRETAR I FËRGJITHËSHËM I KESHILLIT MINISTRAVE
MUHAMER SPAHIU

ZËV. KRYETAR' I KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË R.P.SH.
MANUSH MYFTIU

URDHËR I MINISTRISË BUJQËSISË

Me qëllim që të zhvillohet krymbi i mëndafshit dhe serikultura në vendin tonë për të cilen si landë e parë ushqimore janë fletët e manit dru i cili shërben edhe për qëllime të tjera industriale, në mbështetje të pikës 12 të rregullave të veçanta për mbrojtjen dhe shfrytëzimin e druve të Vlanidhit dhe të shkurreve dhe druve industriale, botuar në gazetë zyrtare Nr. 12 datë 10-8-952.

URDHËROJ

1. Shpallen si dru industriale manat në gjithë territorrin e Republikës dhe ndalohet prerja dhe çdo llojë dëmtimi i tyre.

2. Mund të lejohet prerja e tyre vetëm në raste të veçanta dhe kurdoherë me leje të posaçme të seksionit të Bujqësisë të Kom. Ekz. të K. P. të rrethit përkatës në bazë të pikës 10 të rregullave të lart-përmendura.

3. Sipas pikës 1 germa «e» të rregullave «mbi mënyrën e marrjes me përgjegjësi penale dhe civile të personave që kryejnë krime ose kundravajtje pyjore», prerja e manave dënohet sipas paragrafit dytë të nenit 130 të Kodit Penal me gjobë nga 1000–20.000 lekë ose me punë korektonjëse ose me burgim gjer 3 vjet.

4, Shefat e bujqësisë të qarqeve dhe rretheve të popullarizojnë këtë urdhër për shpalljen e manave si dru industrial dhe të bëjnë ndjekje ligjore kundra personave që presin pa leje ose në çdo mënyrë dëmtojnë manat, qofshin këta në oborr e kopështe ose në toka.

5. Ky urdhër hynë në fuqi me datën 15 Qershor 1955.

Nr. 195/10 dt. 18-4-1955.

MINISTRI:
Hysni Kapo

Approved For Release 2009/06/15 : CIA-RDP83-00418R001100040009-2

Approved For Release 2009/06/15 : CIA-RDP83-00418R001100040009-2

RREGULLORE E MINISTRISË FINANCAVET MBI SIGURIMIN VULLNETAR TË SENDEVE SHTËPIJAKE

I. OBJEKTI I SIGURIMIT.

Neni 1.—

Arkat e kursimit dhe sigurimeve shtetnore sigurojnë në mënyrë vullnetare sendet shtëpijake, pronë të qytetarëve shtetas shqiptare, të shtetasve të huaj që banojnë në Republikën Popullore të Shqipërisë dhe të përfaqësive të huaja në Republikën Popullore të Shqipërisë.

Gjithashtu arkat e kursimit dhe sigurimeve shtetnore sigurojnë pasurinë e dyqaneve me komision, që pranojnë sende për shitje e ndërmarrjeve të transportit, të pastërtive, të hoteleve, theatrove dhe organizatave e ndërmarjeve të tjera që pranojnë për ruejtje sende të qytetarëve si dhe të puntorëve, që pranojnë për meremetim dhe pregatitje sende me materjale të porositësve.

Neni 2.—

Pranohen për t'u siguruar sendet e poshtë shënuara :

a) Sendet shtëpijake (mobilje, qilima, perde, pasqyra, orë muri e tavoline, enë guzhine, etj).

b) Veshmbathje (rroba të jashtëme dhe të brendëshme, këpucë etj. dhe stofat e pa qepura).

c) Maqinat qepëse dhe të shkrimit, aparatet elektrike për ngrohje dhe veglat e punës.

ç) Instrumentat muzikale, radiot marrëse, veglat sportive dhe të gjuetisë, aparatet fotografike, sendet për udhëtim.

d) Librat, notat, tablloret dhe sendet e tjera artistike.

dh) Pajisjet dhe veglat e kabineteve mjeksore dentare, fizike të inxhinerisë dhe të personave të tjerë.

e) Mjetet e transportit (biçikleta, motoçikleta).

ë) Prodhimet bujqësore (drithëra, bar, kashtë, perime, etj) dhe lëndë djegëse që ndodhen në ndërtesë ose n'afërsitë e saj).

f) Materjalet e ndërtimit (drrasa, trarë, etj) dhe sendet e pregatitura prej druri (dyer, dritare, etj).

Nuk sigurohen dokumentat, aktet, dorëshkrimet, banknotat, letrat me vleftë, gurët e çmuar, stolirat prej ari, argjëndi dhe materjale të tjera të çmuarshme, orët e dorës dhe xhepit, fotografitë dhe lulet dekorative.

II. PËRGJEGJËSIJA E ARKAVE TË KURSIMIT DHE SIG. SHTETNORE

Neni 3

Arkat e kursimit dhe Sigurimeve Shtetnore përgjigjen për dëmet që i shkaktohen pasurisë së siguruar nga këto rreziqe :

a) Zjarri, rrufeja, eksplozioni i gazit, tërmeti, inondatat, shtërngatat, shirat e rrëmbyera, dëbora e madhe, rrëzimi dhe të shkarët e tokës, dhe tufani.

b) Vjedhja dhe zhdukja e pasurisë në kohën e ndodhjes së rrezikut.

Përveç këtyre arkat e kursimit dhe sigurimeve shtetnore përgjigjen për humbjet e shkaktuara nga prishja ose dëmtimi i pasurisë, gjatë veprimeve për shpëtimin e saj në kohën e rrezikut, si prishje nga uji, thyerja, etj.

Approved For Release 2009/06/15 : CIA-RDP83-00418R001100040009-2

Approved For Release 2009/06/15 : CIA-RDP83-00418R001100040009-2

III. SHUMA E SIGURUAR DHE AFATI I KONTRATËS.

Neni 4.—

Sendet e ndryshme mund të sigurohen për çdo shumë, por jo më tepër nga vlefta e tyre, në bazë të çmimeve të tregut të lirë shtetnor duke zbritur amortizimin. Edhe vlefta e prodhimeve bujqësore dhe të lëndës djegëse caktohet në bazë të të njëjtave çmime.

Në mungesë të çmimeve të tregut të lirë Shtetnore, vlefta e sendeve caktohet nga organet e arkave të Kursimit dhe sigurimeve shtetërore në marëveshtje me të siguruarin.

Neni 5.—

Sigurimi i sendeve zakonisht bëhet duke i parë në vend Me gjith'atë lejohet lidhja e kontratës pa i parë sendet në këto raste :

a) Në qytete dhe në kantierët e punës, për nji shumë deri 150.000 lekë për familjarët dhe deri 80.000 lekë për beqarët ;

b) Në fshatra për nji shumë deri 80.000 lekë për familjarët dhe deri 50.000 lekë për beqarët.

Sigurimi për shuma më të mëdha nga këto, bëhet detyrimisht vetëm mbas kontrollit preventiv të sendeve, nga të ngarkuarit e arkave të kursimit dhe sigurimeve shtetnore në prani të pronarit.

Neni 6.—

Kontrata e sigurimit lidhet për nji vit dhe përsëritet në qoftë se nuk denoncohet me shkrim nga i siguruari 30 ditë para skadencës.

Neni 7.

Kur sendet nuk janë siguruar për vleftën e tyre të plotë, ose mbas lidhjes së kontratës janë blerë sende të tjera, i siguruari mund të lidhë nji kontratë të re, që të zavëndësojë të parën. Në këtë rast llogariten primet e paguara për muajt e plotë të pa kaluara të kontratës së parë dhe zbriten nga primi i kontratës së re.

IV. TARIFA E PRIMEVE.

Neni 8.—

Primi i sigurimit caktohet simbas kategorisë së ndërtesave dhe sendeve si dhe vendit ku ato ndodhen.

Për sendet shtëpijake simbas tarifës anekse Nr; 1.

Për pastërti, puntori e dyqane me komision simbas tarifës anekse Nr : 2.

Neni 9

Primi minimal për nji policë eshtë Lekë 50.

Primi rrumbullakohet në njësi të lekut, fraksioni deri Lek 0,50 nuk llogaritet dhe për mbi lek 0,50 llogaritet 1 Lek.

V. LIDHJA E KONTRATËS.

Neni 10.—

Kontratat për sigurimin e pasurisë shtëpijake lidhen nga arkat e kursimit dhe sigurimeve shtetnore në bazë të kërkesës me shkrim në nji formular të veçantë të arkave të kursimit dhe sigurimeve shtetnore (flet —

Approved For Release 2009/06/15 : CIA-RDP83-00418R001100040009-2

Approved For Release 2009/06/15 : CIA-RDP83-00418R001100040009-2

propozimi) që paraqitet nga ana e pronarit. Në fiet propozim pronari dûhet të tregojë vleftën e sendeve të ndarë në grupe dhe ndërtesën ku ato ndodhen.

Neni 11.—

Pronari ka të drejtë të tregojë me shumë të veçantë sendet më të vlefshme (radio, motoçikletë, etj). pa i përfshirë në shumën e grupeve të ndryshme.

Arkat e kursimeve dhe Sigurimeve Shtetnore nuk përgjigjen për dëmet mbi shumat e treguara nga i siguruari në kërkesë, për seicilin grup të sendeve.

Neni 12.—

Sigurimi i sendeve mund të bëhet në mënyrë individuale dhe në mënyrë kolektive.

Neni 13

Sigurimi i sendeve në mënyrë kolektive bëhet në ndërmarje, institute, kooperativa, reparte pune, brigada, degë dhe sektorë të tjerë të prodhimit ku numuri i atyre që kërkojnë të sigurojnë nuk është më i vogël se 20.

Sigurimi kolektiv mund të bëhet edhe në shtëpitë e banimit ku numuri i qira-marrësve nuk është më i vogël se 50.

Kur kryhet sigurimi kolektiv i sendeve, në rast se numuri i të siguruarve arrin në 75 o/o të punonjësve (ose t' atyre që banojnë në një shtëpi) akordohet një zbritje primi në masë 10o/o dhe kur numuri i të siguruarve është mbi 75o/o, një zbritje prej 20o/o.

Neni 14

Primi i kontratës paguhet tërësisht në kohën e dorëzimit të saj të siguruarit.

Neni 15

Sigurimi i sendeve shtëpijake kryhet me lëshimin e kontratës, që i dorëzohet të siguruarit kundrejt arkëtimit të primit.

Në rast sigurimi në mënyrë kolektive, sejcilit të siguruar i lëshohet një kontratë e veçantë,

Neni 16,

Përgjegjësija e arkave të Kursimit dhe Sigurimeve Shtetnore fillon n'orën 24 të ditës në të cilën është paguar primi dhe mbaron n'orën 24 të datës shënuar në kontratë.

Në rast përsëritje të kontratës, përpara skadencës, përgjegjësija vazhdo pa ndërpjerje.

Neni 17.—

Organet e Drejtoris Përgjithëshme të Kursimeve dhe Sigurimeve Shtetnore kanë të drejtë të kontrollojnë gjendjen e pasurisë së siguruar dhe të verifikojnë vlerësimin e saj.

VI. DETYRIMET E TË SIGURUARIT.

Neni 18.—

I siguruari është i detyruar të zbatojë rregullat për mbrojtjen kundra zjarrit. Në qoftë se konstatohet se i shkel këto rregulla, Arkat e Kursimit dhe Sigurimeve Shtetnore mund t'a pezullojnë kontratën dhe mos t'i kthenjë primin e paguar.

Kur bije zjarri, ose ndodh ndonji nga rreziqet e tjera të parapara në

Approved For Release 2009/06/15 : CIA-RDP83-00418R001100040009-2

Approved For Release 2009/06/15 : CIA-RDP83-00418R001100040009-2

këtë rregullore, i siguruari është i detyruar të marrë masa për shpëtimin e sendeve të siguruara dhe për të evituar prishjen e mëtejshme të tyre. Në qoftë se nuk merr të tilla masa Arkat e Kursimit dhe Sigurimeve Shtetnore nuk kanë përgjegjësi për zmadhimin e dëmit.

Neni 19.—

Në rastet e rënies së zjarrit, ose të vërtetimit të ndonji nga rreziqet e tjera që përmenden në nenin 3 të kësaj rregulloreje i siguruari është i detyruar të lajmërojë Arkën e Kursimit dhe Sigurimeve Shtetnore n'afatet si vijon :

1. Të siguruarit në qytetet, mbrenda 24 orëve.
2. Të siguruarit në fshat, mbrenda 5 ditëve.

Lajmërimi i bëhet me shkrim arkës Kursimit dhe Sigurimeve Shtetnore dhe i dorzohet personalisht ose i dërgohet me postë. I siguruari duhet t'i paraqesi të ngarkuarit të arkës që shkon për të bërë vlerësimin e dëmit; listën e sendeve të dëmtuara, duke treguar vlerën e sejcilit objekt në ditën përpara dëmit.

Gjithashtu i siguruari është i detyruar të lajmërojë mbrenda 24 orëve organet e policisë, për vjedhjen dhe zhdukjen e sendeve në kohën e rrezikut.

Neni 20.

I siguruari duhet të lajmërojë mbrenda 15 ditëve arkën e kursimeve dhe sigurimeve shtetnore në rast transferimi totol ose të pjesëshëm të sendeve të siguruara. Në qoftë se ay nuk lajmëron mbrenda këtij afati arkat e Kursimeve dhe Sigurimeve Shtetnore nuk kanë përgjegjësi për dëmtimin e sendeve të transferuara dhe nuk i kthejnë të siguruarit primin e paguar.

Me marrjen e lajmërimit të transferimit të sendeve, arka e Kursimeve dhe Sigurimeve Shtetnore bën shënim mbi kontratë. Në këtë rast nuk rillogaritet primi ; por kur sendet transferohen në një ndërtesë më të dobët p.sh; nga një ndërtesë prej guri në një ndërtesë prej druri shuma e siguruar zvoglohet në të njëjtën përqindje që zmadhohet tarifa e primit.

Për paksimin e shumës së siguruar bëhet shënim mbi kontratë. Në qoftë se i siguruari nuk pranon paksimin e shumës ka të drejtë të lidhë një kontratë të re, me konditat e caktuara në nenin 7 të kësaj rregulloreje.

Neni 21.

Kur i siguruari ndryshon vend banimin e tij, por i lë sendet e siguruara, ose një pjesë të tyre në vendin e më parëshëm duhet t'i paraqesë arkës së Kursimeve dhe Sigurimeve Shtetnore listën e tyre (simbas grupeve) dhe të njoftojë kujt i ka besuar ruajtjen. Në rast se i siguruari nuk respekton këto rregulla, arka e kursimit dhe sigurimeve shtetnore nuk ka përgjegjësi për sendet e lëna.

VII. VËRTETIMI I DËMIT DHE PAGESA E SHPËRBLIMIT

Neni 22.

Arkat e Kursimit dhe Sigurimeve Shtetnore duhet të filloinë vërtetimin e dëmit në qytetet jo më vonë se dy ditë dhe në fshat jo më vonë se 7 ditë nga datë e marrjes së lajmërit nga i siguruari.

Proçes-verbali mbi dëmin nënshkruhet nga i ngarkuari i arkës kursimeve dhe sigurimeve shtetnore. nga i siguruari ose në mungesë të tij nga një

Approved For Release 2009/06/15 : CIA-RDP83-00418R001100040009-2

Approved For Release 2009/06/15 : CIA-RDP83-00418R001100040009-2

antar i familjes me moshë madhore (14 vjeç) dhe nga dy dëshmitarë (në apartamente edhe nga administratori i pallatit).

Neni 23.—

Llogaritja e madhësis së dëmit bëhet në bazë të vleftës efektive të sendeve të prishura ose të dëmtuara simbas sistemit të rrezikut të parë në di'ën e vërtetimit të rrezikut.

Sendet e dëmtuara pjesërisht i mbeten të siguruarit në bazë të vleftësimit të kryer nga i ngarkuari i arkës kursimeve dhe sigurimeve shtetnore në marëveshtje me të.

Neni 24.

Shpërblimi i dëmit duhet t'i paguhet të siguruarit mbrenda 5 ditëve nga data e aprovimit të proçes-verbalit.

Arkat e kursimit dhe sigurimeve shtetnore kanë të drejtë të vonojnë pagesën, në rast dëmtimi nga vjedhja e sendeve, ndodhur në kohën e vërtetimit të rrezikut, deri në marrjen e njoftimit nga organet e policisë mbi rezultatin e kërkimit të sendeve të zhdukura, por jo më se 6 muaj nga dita e paraqitjes së lajmërimit të dëmit nga ana e të siguruarit.

Neni 25.—

Për marrjen e shpërblimit të dëmit i siguruari duhet të paraqesë kontratën e sigurimit ose në rast humbje të saj dublikatën.

Neni 26.

Në rast dëmtimi pjesor të sendeve, kontrata mbetet në fuqi deri në mbarim të afatit, për diferencën midis shumës së siguruar dhe shpërblimit të paguar.

VIII. DËMET QË NUK PAGUHEN NGA ARKAT E KURSIMIT DHE SIGURIMEVE SHTETNORE

Neni 27.—

Arkat e Kursimit dhe të Sigurimeve Shtetnore nuk shpërblejnë dëmet kur këto janë shkaktuar nga faji i të siguruarit ose i antarëve të familjes së tij, në moshën madhore (14 vjeç) si rezultat i pa kujdesisë së theksuar ose me paramendim.

Në qoftë se faji zbulohet mbas pagimit të shpërblimit, shumat e paguara kërkohen që të kthehen.

Pa kujdesija e theksuar dhe veprimi me paramendim përcaktohen nga organet gjyqsore ose hetimore.

Neni 28.—

Arkat e kursimit dhe sigurimeve Shtetnore nuk shpërblejnë dëmet kur konstatojnë se i siguruari me qëllim që të zmadhojnë shumën e tyre fsheh sendet e shënuara ose përfshin në listën sende që nuk gjendeshin në vendin ku ndodhi rreziku, ose paraqit llogari të rreme.

Neni 29.

Arkat e Kursimit dhe Sigurimeve Shtetnore nuk kanë përgjegjësi dhe nuk shpërblejnë dëmet, në qoftë se i siguruari nuk plotëson detyrimet e parashikuara nga nenet 20 dhe 21 të kësaj rregulloreje, mbi transferimin dhe ndryshimin e vend banimit.

Neni 30.—

Arkat e Kursimit dhe Sigurimeve Shtetnore kanë të drejtë të refuzojnë

Approved For Release 2009/06/15 : CIA-RDP83-00418R001100040009-2

Approved For Release 2009/06/15 : CIA-RDP83-00418R001100040009-2

pagimin e dëmëve, në rast se i siguruari nuk lajmëron, duke patur mundësi mbrenda afatit të caktuar për dëmin që i ka ndodhur.

IX. ZGJIDHJA E KONFLIKTEVE.

Neni 31.—

Kërkesat për veprime të pa drejta të arkave të kursimeve dhe sigurimeve shtetnore i paraqiten Seksionit Financiar të Qarkut, mbrenda 15 ditëve nga dita e komunikimit të vendimit mbi dëmin.

NENI 32

Shef' i Seksionit Financiar të Qarkut është i detyruar të shqyrtojë kërkesën dhe të marrë vendim, jo më vonë se 7 ditë nga marrja e kërkesës Vendimi i komun kohet të siguruarit me shkrim mbrenda 24 orëve.

Në shqyrtimin e kërkesës thiret e ndëgjohet edhe i siguruari dhe në rast se ky nuk paraqitet, kërkesa shqyrtohet dhe vendoset në mungesë të tij.

Neni 33.

Kundra vendimit të marrun nga Seksioni Financiar i Qarkut i siguruari ka të drejtë të ankohet mbrenda 15 ditëve nga data e komunikimit të vendimit, pranë Drejtorisë Përgjithëshme të Kursimeve dhe Sigurimeve Shtetnore.

Drejrorija e Përgjithëshme e Kursimeve dhe Sigurimeve Shtetnore shqyrton ' ankimin edhe jep vendimin e sajë mbrënda 10 ditëve, të cilin ja komunikon me shkrim si të siguruarit ashtu dhe Seksioni Financiar përkatës.

Neni 34.

Kundra vendimit të marrun nga Drejtorija e Përgjithëshme e Kursimeve dhe Sigurimeve Shtetnore, i siguruari ka të drejtë të ankohet mbrenda 1 muaji, nga data e komunikimit të vendimit, në gjykatë ose arbitrazhin shtetnor.

Neni 35.

Kontrarat e lidhura për sigurimin e pasurisë private që përfshinë dhe sigurimin e orendive shtëpijake, për pjesën e orendive shtëpijake sigurimi i tyre mbetet në fuqi me konditat e kësaj rregulloreje.

Neni 36

Kjo rregullore hyn në fuqi ditën e botimit të sajë në Gazetën Zyrtare

Tiranë 12-4-1955

MINISTRI FINANCAVET :
Abdyl Këllezi

Approved For Release 2009/06/15 : CIA-RDP83-00418R001100040009-2

Approved For Release 2009/06/15 : CIA-RDP83-00418R001100040009-2

TARIFA Nr. 1.

SIGURIMI I MOBILJEVE DHE SENDEVE SHTËPIJAKE

Kategorija e ndërtesës.	Primi vjetor per 1.000 Lekë.	
	Qytetet: Tiranë, Durrës Shkodër, Korçë, Vlorë.	Qytetet e tjera dhe fshatrat.
1	1	1.
2	2	4
3	6	8

1 KATEGORIJA E NDËRTESAVE

Ndërtesat ndahen në tri kategori simbas materjalit me të cilin janë ndërtuar muret dhe është mbuluar çatija e tyre.

Në kategorinë e I-rë përfshihen ndërtesat me mure guri, tulla, çimento ose me tjetër materjal të pa djegëshëm dhe me çati të mbuluar me çimento, tjegulla, pllaka, guri, llamarinë ose tjetër materjal të pa djegëshëm.

Në kategorinë e II të përfshihen ndërtesat e përzjera (ndërtuar me materjal pjesërisht të djegëshëm dhe pjesërisht të pa djegëshëm) d.m.th, me mure guri, çimento, tulla, qerpiç, etj. dhe breza druri dhe me çati të mbuluar me çimento. tjegulla, ose tjetër materjal të pa djegëshëm, ndërtesat me mure guri, çimento tulle ose tjetër materjal të pa djegëshëm dhe çati të mbuluar me drrasa drurit, karton katramat dhe materjal tjetër të djegëshëm me përjashtim të barit dhe të kashtës.

Në kategorin e III-të përfshihen ndërtesat me mure druri ose gardh lyer me baltë dhe me çati të mbuluar me çdo lloj materjali qoftë, si dhe ndërtesat me mure guri, mbuluar me kashtë ose me barë.

TARIFA Nr. 2.

SIGURIMI I MALLNAVE DHE — PUNTORIVE T' ARTIZANATIT

Kategorija e mallnave	Primi vjetor për 1.000 Lekë.					
	Qytetet: Tiranë, Durrës, Shkodër, Korçë, Vlorë.			Qytetet e tjera dhe fshatrat		
	1	2	3	1	2	3
1	1.5	3	9	2	5	10
2	2	4	10	2.5	6	11
3	6	8	12	7	10	13
4	20	22	25	20	22	25

KATEGORIJA E MALLNAVE DHE E PUNTORIVE T' ARTIZANATIT

Mallrat dhe puntoritë e artizanatit ndahen në kater kategori, të parët

Approved For Release 2009/06/15 : CIA-RDP83-00418R001100040009-2

Approved For Release 2009/06/15 : CIA-RDP83-00418R001100040009-2

simbas landës me të cilën janë përbërë dhe të dytat simbas lëndës që punojnë.

Në kategorinë e I-rë bëjnë pjesë ;

a) Mallrat: hekurishte, metale, lëndë ndërtimi prej materjali të pa dje, gëshëm.

b) Puntoritë: e rrobaqepsave, të këpuctarëve, të lëkurpunuesave, të hekur-punuesave, të poçarëve dhe të berberëve.

Në kategorin e II-të bëjnë pjesë:

a) Mallrat: manifakturë, kinkaleri, qelqurina, veshmbathje, ushqimore. pije dhe lëndë ndërtimi prej druri.

b) Puntoritë: e ripunimit të drurit, e ripunimit të leshit, e punimit të rrogozave të xunkthave, të konservave, restaurante, furra.

Në kategorin e III-të bëjnë pjesë këto mallna: Benzina, vajguri, nafta, qymyri, drutë për djegje, alkooli. shkrepsat dhe sende të tjera të ndezëshme-

Në kotegorin e IV të bëjnë pjesë këto mallna: bari kashta dhe të tjera forazherë, duhani gjethe, kërp dhe lini, të vendosura në grumbuj ose mullarë, mbrenda ose jashtë ndërtesavet.

Për sigurimin e mallnave dhe të puntorive që eventualisht nuk përfshihen në kategoritë e lartë përmendura do t'aplikohet taksi i një llojtë me ato të cilëve u përngjajnë më tepër.

— Kur sigurohen së bashku mallra të kategorive të ndryshme primi llogaritet si vijon:

a) Kur të gjitha mallrat sigurohen me nji shumë të përbashkët apli kohet taksi i kategorisë më të rezikshme.

b) Kur për çdo kategori malli caktohet një shumë e veçantë, aplikohet për sejcilën kategori veças, por kur mallnat e kategorisë më të rrezikshme kapërxejnë 30 për qind të shumës së përgjithëshme paguhet taksi më i lartë për të gjitha.

Kur sigurohen puntoritë, shuma duhet të ndahet në tri pjesë: vegla e maqineri, lëndë të parë dhe produkte të gatëshëm.

MINISTRI
Abdyl Kellezi

Approved For Release 2009/06/15 : CIA-RDP83-00418R001100040009-2

Approved For Release 2009/06/15 : CIA-RDP83-00418R001100040009-2

GAZETA ZYRTARE

E REPUBLIKËS POPULLORE TË SHQIPËRISË

27 Maj | Nr. 6 | Viti 1955

P Ë R M B A J T J A

Pjesa e I-rë

Faqe

1) Dekret Nr. 2026 dt. 5-IV-1955 — Për akordim dekoratash. . 164-176
2) Dekret Nr. 2031 » 11-IV-1955 — Për akordim dekoratash. . 176-184
3) Dekret Nr. 2032 » » » » — Për akordim dekoratash. . 185-194

Pjesa e II-të:

4) Urdhëresë e kom. ekzek. K. P. Q. Tiranë Nr. 1 datë 12-II-1955. — mbi ndërtimet në qytetin e Tiranës. 195-198
5) Lajmërim
6) Lajmërim për ndrim emrash.

Approved For Release 2009/06/15 : CIA-RDP83-00418R001100040009-2

Approved For Release 2009/06/15 : CIA-RDP83-00418R001100040009-2

PJESA E I-rë

D E K R E T

për akordim dekoratash

Në mbështetje të nenit 58, pika 8, të Kushtetutës së Republikës Popullore të Shqipërisë;

PRESIDIUMI I KUVENDIT POPULLOR

D E K O R O N:

I. ME URDHËRIN E PUNËS TË KL I-rë

1) Kolektivin Punonjës të N.M.SH. Qymyr-Gurit Mborje Drenovë.
me këtë motivacion:
«Ka realizuar planin e prodhimit të vitit 1954 103,7%; ka ngritur rendimentin në punë 123% kundrejt planit duke ulur koston 7,7%; ka punuar me vetmohim dhe ka realizuar në mënyrë ritmike planin për çdo tremujor ka punuar me metoda sovjetike 61% e puntorëve duke i kursyer shtetit 238.500 lekë.»

2) Kolektivin Punonjës të N.M.SH. Bakri Rubik,
me këtë motivacion:
«Ka realizuar planin e prodhimit të vitit 1954 128,2%; ka ulur koston 12,6% duke rritur rendimentin në punë 111,5% kundrejt planit; ka punuar me metoda Sovjetike në të cilat i kanë kursyer shteti 1.334 279 lekë; ka bërë 37 propozime për çpikje e racionalizime duke i kursyer shtetit për nji vit 765.000 lekë».

3) Kolektivin Punonjës të N.I.SH. Ushqimore të Korçës
me këtë motivacion:
«Ka realizuar planin e prodhimit të vitit 1954 108,6%; ka rritur rendimentin në punë 104,3% kundrejt planit dhe ka ulur koston 3,38% Ka nxjerrë vazhdimisht kualitet të mirë prodhimi Ka organizuar mirë emulacionin socialist duke punuar gjerësisht me metodat sovjetike duke i kursyer shtetit 211.200 lekë; ka krijuar kondita të mira materjale për puntorët duke organizuar mirë ekonominë ndihmëse».

4) Xhavit Hajdar Qesja 5) Peti Llambi Shamblli
me këtë motivacion:
«Për punë të palodhur e të ndërgjegjëshme në drejtimin e organizatave të partisë dhe në mobilizimin e masave punonjëse për realizimin e planit të shtetit».

II. ME URDHËRIN E PUNËS TË KL. II-të

1) Komitetin ekzekutiv të k.p. të qarkut të Korçës
me këtë motivacion:
«Ka udhëhequr mirë dhe kolegjialisht problemet ekonomike dhe shtetërore të qarkut; ka luftuar me kohë kundër vështirësive dhe pengesave në punë dhe i ka kalue këto; ka përmirësuar metodën e drejtimit dhe si rezultat ka arritur që planin e vitit 1954 t'a realizojë në shumicën e sektorëve».

2) Kolektivin Punonjës të Uzinës «ENVER»

Approved For Release 2009/06/15 : CIA-RDP83-00418R001100040009-2

Approved For Release 2009/06/15 : CIA-RDP83-00418R001100040009-2

me këtë motivacion:

«Ka realizuar planin e prodhimit të vitit 1954 110,5% ; ka rritur rendimentin në punë 117,2% kundrejt planit dhe ka ulur koston 2,32% ka punuar me normë 95% e puntorëve. Ka qenë inisjator i zbatimit të metodave sovjetike, veçanërisht në shfrytëzimin e rezervave të brendëshme».

3) Kolektivin punonjës të N.M.SH. Prodhimit Patos

me këtë motivacion:

«Ka realizuar planin e prodhimit të vitit 1954 105,7%, ka ulur koston e prodhimit 6,5% kundrejt planit; ka organizuar mirë emulacionin socialist dhe punën me metodat sovjetike.»

4) Kolektivin punonjës të N.M.SH. Përpunimit të Naftës Q. Stalin.

me këtë motivacion:

«Ka realizuar planin e prodhimit të vitit 1954 105,4%, ka ulur koston e prodhimit 9,5% dhe ka rritur rendimentin 105,46% kundrejt planit. Ka realizuar në mënyrë ritmike për çdo tremujor planin duke organizuar mirë emulacionin socialist».

5) Kolektivin punonjës të N.T.A SH.-it Tiranë

me këtë motivacion:

«Gjatë vitit 1954 ka realizuar dhe tejkaluar planin e shtetit. Me punën e tij të palodhur është bërë shembull për të gjitha ndërmarrjet e tjera. Ka shfrytëzuar dhe mirëmbajtur automjetet dhe është dalluar në zbatimin e metodës sovjetike 100 mijshe».

6) Kolektivin punonjës të N.T.A.SH.-it Shkodër

me këtë motivacion:

«Gjatë vitit 1954 ka realizuar dhe tejkaluar planin e shtetit. Me punën e tij të palodhur është bërë shembull për të gjitha ndërmarrjet e tjera. Ka shfrytëzuar dhe mirëmbajtur automjetet dhe është dalluar në zbatimin e metodës sovjetike 100 mijshe».

7) Kolektivin punonjës të N.B.SH. Nr. 4 Vlorë

me këtë motivacion:

Gjatë vitit 1954, ësht mobilizuar në punë dhe ka realizuar planin e prodhimit të qumështit 101,5%, të leshit 101,2%, të mishit 110,7%, si dhe planin e dorëzimeve të shtetit në qumësht 105,9% dhe në lesh 104,8% ka realizuar një fitim prej 2.826.000 lekë në vend të 890.000 lekëve të planifikuara».

3) Kolektivin punonjës të S.M.T.-së të Korçës

me këtë motivacion:

« Gjatë vitit 1954 është mobilizuar mirë në punë, duke realizuar planin në unitet hamullor 109,8% ; ka kontribuar në përhapjen dhe kultivimin e panxharit të sheqerit dhe ka ndihmuar kooperativat bujqësore dhe fshatarësin punonjëse të qarkut të Korçës në realizimin e detyrave të ngarkuara nga Partia dhe Qeveria».

9) Kolektivin punonjës të S.M.T.-së të Shkodrës

me këtë motivacion:

«Gjatë vitit 1954 është mobilizuar mirë në punë dhe ka realizuar planin si unitet hamullor 101%, duke kontribuar në arritjen e rendimenteve të larta në grurë e misër, nga ana e Kooperativave bujqësore dhe fshatarësisë punonjëse të qarkut të Shkodrës».

10) Kolektivin punonjës të S.M.T.-së të Kavajës

me këtë motivacion:

«Gjata vitit 1954, është mobilizuar mirë në punë, ka realizuar planin si

Approved For Release 2009/06/15 : CIA-RDP83-00418R001100040009-2

Approved For Release 2009/06/15 : CIA-RDP83-00418R001100040009-2

unitet hamullor 109.8% dhe ka ndihmuar në përhapjen dhe kultivimin e pambukut, duke kontribuar kështu në realizimin e detyrave të caktuara nga Partija dhe Qeverija nga ana e kooperativave bujqësore dhe fshatarësisë punonjëse të rrethit Kavajës»

11) Kolektivin punonjës të N.T.L.A.I.-it Tiranë

me këtë motivacion:

«Është mobilizuar për realizimin e planit të shtetit të cilin e ka realizuar vazhdimisht mbi 100% dhe si vjetor 102%; ka ulur shpenzimet e qarkullimit të mallrave mbi 0.26%; ka përmirësuar reklamimin e mallrave; ka nxjerrë asortimente me kualitet të mirë; ka nxjerrë dhe dërguar në rregull bilancet financiare; ka bërë një punë të mirë për ngritjen tekniko-profesionale të kolektivit punonjës, dhe ka treguar kujdes për ruajtjen e pasurisë sosocialiste».

12) Kolektivin punonjës të N.T.L.A.U.-s Tiranë

me këtë motivacion:

«Është mobilizuar për realizimin e planit të shtetit të cilin e ka realizuar në mënyrë ritmike për ç'do tremujor dhe si vjetor në 101.4%; ka ulur shpenzimet e qarkullimit të mallrave; ka shpallur 16 brigada të shërbimit shembullor dhe një brigadë të kualitet të lartë. Ka organizuar në mënyrë shembullore kulturën tregëtare, u ka shërbyer në mënyrë të kënaqëshme klientave dhe ka bërë përpjekje për ngritjen tekniko-profesionale».

13) Kooperativën e Porcellanit të Tiranës

me këtëtë motivacion:

«Ka punuar pa u lodhur në ndërtimin e kanalit Vjosë – Levan – Fier dhe është treguar i kujdesëshëm për shfrytëzimin e mirë të maqinerisë dhe për mirëmbajtjen e tyre».

64) Asllan Ismail Qeska, me këtë motivacion:

«Si shef plani në kantjerin Vjosë – Levan – Fier ka zbatuar me përpikmëni detyrat dhe më vonë si përgjegjës i sektorit ka organizuar mirë punën, ka zhvilluar emulacionin socialist dhe është kujdesur për ruajtjen e materjalit të shtetit».

Approved For Release 2009/06/15 : CIA-RDP83-00418R001100040009-2

Approved For Release 2009/06/15 : CIA-RDP83-00418R001100040009-2

65) Spiro Jani Boçi, me këtë motivacion:

«Si referent normash ka ponuar për mirëmbajtjen e punës për zhvillimin e garave socialiste dhe për aplikimin e drejtë të noramave».-

66) Spiro Refat Lame, me këtë motivacion:

«Si gjeometër është mobilizuar për realizimin e planit të shtetit në kanalin Vjosë – Levan – Fier, ka organizuar mirë punën me eskavatorët dhe ka qenë i disiplinuar dhe i palodhur në punë».-

67) Rahim Rahman Sinani 68) Rexhep Hysen Rama

me këtë motivacion:

«Si teknikë kanë organizuar mirë punën për zbatimin e veprave të artit në kanalin Vjosë — Levan — Fier dhe kanë qenë të disiplinuar dhe të palodhur në punë».-

68) Ndreçi Vangjel Zhurka, me këtë motivacion:

«Ka realizuar çdo ditë normën e punës, ka mbajtur n' ofiçencë eskavatorin dhe ka nxjerrë punë me kualitet të mirë».

69) Bajram Mahmut Zotaj, me këtë motivacion:

«Punëtor i dalluar dhe i palodhur në punë, ka organizuar mirë punën e transportit dhe është mobilizuar për realizimin e planit të shtetit në kanalin Vjosë–Levan—Fier duke u bërë kështu shembull në punë dhe për punetorët e tjerë».-

70) Pando Jorgo Gjika, me këtë motivacion:

«Si teknik ka kryer mirë detyrat që i janë ngarkuar, ka bërë në rregull organizimin dhe mbajen e punës dhe është kujdesur për zhvillimin e emulacionit socialist në kanalin Vjosë–Levan–Fier.»-

71) Velo Pajo Xhafo, me këtë motivacion:

«Ka qenë kurdoherë i gatëshëm në zbatimin e detyrave që i janë ngarkuar, ka bërë në rregull matjet e punës të eskavatoristave e bolldozeristave dhe është treguar i palodhur dhe i disiplinuar në punë.»-

72) Grigor Jani Mullaj 73) Ruzhdi Malo Mëhilli

me këtë motivacion:

«Si gjeometër kanë organizuar mirë punën, kanë marrë pjesë në emulacionin socialist dhe kanë punuar pa u lodhur fare për realizimin dhe tejkalimin e planit të shtetit në ndërtimin e kanalit Vjosë—Levan—Fier.»-

73) Ali Sulejman Tivari, me këtë motivacion:

«Ka punuar pa u lodhur për realizimin e planit të shtetit në kanalin Vjosë—Levan—Fier duke realizuar çdo ditë normën e punës 170o/o, ka mirëmbajtur eskavatorin dhe ka qenë shembull disipline në punë.»-

75) Adem Nexhip Islami, me këtë motivacion:

«Puntor i palodhur, detyrën si referent administrate e ka kryer mirë, ka ndihmuar për ndërtimin e kanalit Vjosë–Levan–Fier.

II. NË KOMITETIN QENDROR TË P. P. SH.

1) ME URDHËRIN E PUNËS TË KL. II-të

1) Misto Andrea Treska
2) Vandush Qani Vinçani
3) Veiz Bozo Pipa
4) Stavri Dhimitër Mariani
5) Minallaq Llambi Gjinikasi
6) Thoma Mihal Deliana
7) Piro Spiro Bita
8) Vilson Noisi Pecani
9) Nikolla Profi
10) Tasi Andon Mitrushi

me këtë motivacion:

«Për punë të palodhur e të ndërgjegjëshme në kryerjen e detyrës së caktuar për forcimin e orgonizatave të partisë».

Approved For Release 2009/06/15 : CIA-RDP83-00418R001100040009-2

Approved For Release 2009/06/15 : CIA-RDP83-00418R001100040009-2

11) Haxhi Hysen Kroji, me këtë motivacion:
«Është treguar punëtor i palodhur, ka nxjerrë punë të pastër e me kualitet të mirë dhe ka bërë përpjekje për kualifikim në punë».

2) ME URDHËRIN E PUNËS TË Kl. III-të

1) Ngjeli Petraq Toka
2) Ferdi Qerim Karagjozi
3) Sali Sadik Sheshi
4) Sybi Shyqeri Bakiri
5) Qetsor Teki Bino (Kaltani)
6) Nevruz Halil Malindi
7) Raqi Llambi Shamblli
8) Koço Ilo Asllani
9) Gaqo Arqile Totokoçi
10) Halil Kasem Vasjari
11) Hasan Nexhip Banja
12) Vaske Koci Lubonja
13) Petro Mihal Gedeshi
14) Xhoxhi Panajot Robo
15) Koço Thimi Lako
16) Petrit Sotir Nikaj
17) Bajram Abdi Fejzollari
18) Persefoni Pavel Todri
19) Islam Ramadan Jaçellari
20) Burhan Mahmut Çela

me këtë motivacion:
«Për punë të palodhur e të ndërgjegjëshme në kryerjen e detyrës së caktuar për forcimin e organizatave të partisë».

21) Sadik Hamit Myftiu, me këtë motivacion:
«Është treguar punëtor i palodhur, ka nxjerrë punë të pastër e me kualitet të mirë dhe ka bërë përpjekje për kualifikim në punë».

22) Yzedin Aqif Ceno, me këtë motivacion:
«Me punën e tij të palodhur i ka mbajtur automjetet gjithmonë në gjendje të gatëshme. Është treguar i gatëshëm për çdo punë që i është ngarkuar. Me punën e tij i ka kursyer arkës së Partisë me dhjetra mijra lekë».

3) ME MEDALJEN E PUNËS

1) Gjike Theodhor Trajani
2) Aleksandër Pal Xhumari
3) Misto Sotir Trebicka
4) Llaz Miti Cici
5) Gaqo Spiro Themeli
6) Mehdi Abdurrahim Spahiu
7) Muharem Hasan Doçi
8) Vasil Ligor Premti
9) Alipi Koli Dede
10) Mynaver Vesel Shuteriqi
11) Perikli Kozma Cingo
12) Mersin Dine Gotellari

me këtë motivacion:
«Për punë të palodhur e të ndërgjegjëshme në kryerjen e detyrës së caktuar për forcimin e organizatave të partisë».

13) Stamata Vasil Morava
14) Leanoro Veniamin Andoni
15) Hedije Xhevdet Xhango
16) Stela Dhimitër Karapataqi
17) Voica Mihal Kroji
18) Fatime Ali Keçi
19) Polikseni Kristo Mariani
20) Faik Muharrem Meko
21) Hamit Mehmet Veta
22) Dafina Dhimitër Jonku
23) Durime Hysen Denaj
24) Nuri Mehmet Viscka
25) Xhemal Sefer Shijaku

me këtë motivacion:
«Janë treguar punëtor të palodhur, kanë nxjerrë punë të pastër e me kualitet të mirë dhe kanë bërë përpjekje për kualifikim në punë».

26) Mehdi Jano Zeqo
27) Stavri Prokop Zoraqi
28) Dhimitër Gaqo Tasho

Approved For Release 2009/06/15 : CIA-RDP83-00418R001100040009-2

Approved For Release 2009/06/15 : CIA-RDP83-00418R001100040009-2

me këtë motivacion:

«Janë dalluar për mirëmbajtjen e automjetit, kanë bërë përpjekje për t'u kualifikuar dhe i kanë kursyer arkës së partisë mijra lekë».-

III. NË MINISTRINË E MBROJTJES POPULLORE

ME URDHËRIN «YLLI I KUQ»

1) Gazeta «Luftëtari», me këtë motivacion:

«Për punë të çmueshme që ka bërë, për edukimin politik dhe ushtarak të ushtarëve, nënoficerave oficerave dhe, gjeneralave, për rritjen e gadishmërisë luftarake të ushtërisë dhe për forcimin e disiplinës ushtarake me efektivin».

Tiranë, me 25-4-1955
Nr. i dekretit: 2041

PËR PRESIDIUMIN E KUVENDIT POPULLOR
TË REPUBLIKËS POPULLORE TË SHQIPËRISË

SEKRETARI:
Sami Baholli

KRYETARI:
Haxhi Lleshi

Realizimi i normës në përqindje

ME URDHËRIN E PUNËS TË KLASIT III-të

1) Shaqir Shaqir Deliu	145%
2) Thoma Jani Prinei	170%
3) Panajot Janko Janko	180%
4) Selami Hamit Selami	195%

ME MEDALJEN E PUNËS

1) Anesti Ndreçi Zhurka	165%
2) Musa Shaqir Çani	141%
3) Aristidh Mihal Diamanti	165%
4) Filip Jani Zhurga	125%
5) Shaqir Arshim Berhami	137%
6) Foto Stavri Koroveshi	170%
7) Rexhep Bajram Popova	125%
8) Llaqi Kosta Zisi	148%
9) Mehdi Hekuran Kuqi	160%
10) Ramiz Hamza Beqari	130%
11) Avdyl Muharrem Lushka	115%
12) Shaban Estref Alushi	125%
13) Zenel Shaban Oshafi	120%
14) Shahin Emin Kamberi	125%
15) Gjezair Myftar Tereziu	130%
16) Osman Shaban Oshafi	110%
17) Misir Caush Çuli	110%
18) Bajram Hekuran Hekurani	125%
19) Ali Veli Hoxha	115%
20) Asim Demir Arapi	125%
21) Marko Spiro Kala	130%
22) Rapo Hysen Jonuzi	125%

Approved For Release 2009/06/15 : CIA-RDP83-00418R001100040009-2

Approved For Release 2009/06/15 : CIA-RDP83-00418R001100040009-2

D E K R E T

për akordim dekoratash

Në mbështetje të nenit 58, pika 8, të Kushtetutës së Republikës Popullore të Shqipërisë,

PRESIDIUMI I KUVENDIT POPULLOR

DEKORON:

I. ME URDHËRIN E PUNËS TË KL. III-të

1) Komitetin e B.R.P.SH. të rrethit të Mallakastrës,
me këtë motivacion:
«Duke ju përgjegjur thirrjes së Partisë dhe Qeverisë, mobilizoi masën e rinisë për punë vullnetare në kanalin Vjosë-Levan-Fier ku shkuan 305 vullnetarë si dhe 35 të tjerë në Hidrocentralin «ENVER». Të rinjtë e këtij rrethi pa marrë parasysh vështirësitë dhe mungesat në punë, kanë punuar pa u lodhur dhe kanë realizuar dhe tejkaluar normat e punës, duke u bërë kështu shembull edhe për të rinjtë e tjerë»,

ME MEDALJEN E PUNËS

1) Organizatën e B.R.P.SH. të fshatit Bamicë të rrethit Kotë
me këtë motivacion;
«Duke ju përgjegjur thirrjes së Partisë dhe Qeverisë, të rinjtë e kësaj organizate shkuan vullnetarë për të dytën herë për të punuar në kanalin Vjosë-Levan-Fier dhe me punën e tyre të palodhur u bënë shembull edhe për të rinjtë e tjerë».

2) Organizatën e B.R.P.SH. të fshatit Aranitas të rrethit Mallakastrës
me këtë motivacion:
«Duke ju përgjegjur thirrjes së Partisë dhe Qeverisë 30 të rinj të kësaj organizate shkuan vullnetarisht për të punuar në kanalin Vjosë-Levan-Fier dhe me punën e tyre të palodhur u bënë shembëll edhe për të rinjtë e tjerë».

3) Organizatën e B.R.P.SH. të fshatit Buzmath të rrethit Mallakastrës
me këtë motivacion:
«Duke ju përgjegjur thirrjes së Partisë dhe Qeverisë të rinjtë e kësaj organizate punuan vullnetarisht për dy muaj rrjesht në kanalin Vjosë-Levan-Fier dhe me punën e tyre të palodhur u bënë shembull edhe për të rinjtë e tjerë».

4) Hair Hajdar Pashaj, me këtë motivacion:
«Me punën e tij të palodhur ka bërë që të dalin 92 të rinj vullnetarë për të punuar në kanalin Vjosë-Levan-Fier si dhe shumë të tjerë për në hidrocentralin «ENVER».

Tiranë, me 27/4/1955
Nr. i dekretit: 2042

PËR PRESIDIUMIN E KUVENDIT POPULLOR
TË REPUBLIKËS POPULLORE TË SHQIPËRISË

SEKRETARI:
Sami Baholli

KRYETARI:
Haxhi Lleshi

Approved For Release 2009/06/15 : CIA-RDP83-00418R001100040009-2

Approved For Release 2009/06/15 : CIA-RDP83-00418R001100040009-2

D E K R E T

për akordim dekoratash

Në mbështetje të nenit 58, pika 8, të Kushtetutës së Republikës Popullore të Shqipërisë,

Me propozimin e Ministrisë së Mbrojtjes Popullore:

PRESIDIUMI I KUVENDIT POPULLOR

DEKORON:

1) ME URDHËRIN E PUNËS TË KL. III-të

1) Ali Ymer Çela
2) Stathi Andrea Çoku

me këtë motivacion:

«Kanë organizuar punën në mënyrë shëmbullore, kanë punuar me metoda sovjetike, kanë realizuar normën e punes 120%, kanë nxjerrë prodhim me kualitet të mirë dhe kanë bërë përpjekje të vazhdueshme për ngritjen e tyre tekniko-profesionale».

3) Thanas Pano Treska

me këtë motivacion:

«Ka organizuar dhe drejtuar punën në mënyrë shëmbullore, ka punuar me metoda sovjetike dhe ka nxjerrë punë me kualitet të lartë. Ka treguar kujdes për ruajtjen dhe administrimin e pasurisë shtetrore dhë ka bërë përpjekje për ngritjen e tyre tekniko-profesionale».

4) Koço Mihal Mitrovasili

me këtë motivacion:

«Punëtor i dalluar, është mobilizuar për realizimin dhe tejkalimin e planit të shtetit. Ka punuar me metoda sovjetike, ka realizuar dhe tejkaluar normën e punës 120% dhe ka nxjerrë prodhim me kualitet të lartë. Ka bërë përpjekje të vazhdueshme për ruajtjen dhe çfrytëzimin racional të materialeve dhe për ngritjen e tij tekniko-profesionale».

2) ME MEDALJEN E PUNËS

1) Aristidh Spiro Plaka
2) Bedri Sulejman Sopoti
3) Emin Ibaki Meçani
4) Reshat Hasan Zema
5) Sami Hamit Hidi
6) Skënder Vlash Dhora
7) Shaban Hysen Maloku

me këtë motivacion:

«Puntorë të dalluar, kanë punuar me metoda sovjetike, kanë realizuar normën e punës 110% dhe kanë nxjerrë prodhim me kualitet të mirë. Kanë vënë në përdorim materjale të vjetra, kanë treguar kujdes për ruajtjen e pasurisë shtetrore dhe kanë bërë përpjekje për ngritjen e tyre tekniko-profesionale».

8) Adnand Hamit Dalliu
9) Hysen Xhemal Luta
10) Hysen Xhemal Reçi
11) Josif Gaqo Xhamo
12) Jonulla Thanas Stefi
13) Jorgji Theodhor Duma
14) Kristaq Vaskë Karanxho
15) Kristo Spiro Tollka
16) Llambi Ligor Nasi
17) Milica Qipro Laçi
18) Mehmet Osman Spahiu
19) Mehmet Kurtesh Godenca
20) Mustafa Galip Çano
21) Nazmije Ali Mjolli
22) Petrit Iliaz Hoxha
23) Sadik Fadil Lleshi
24) Shyqeri Xhemal Hasani
25) Shefqet Shaban Resmi
26) Shyqeri Muharrem Shkoza
27) Telo Tasi Konomi
28) Thoma Mina Goge

Approved For Release 2009/06/15 : CIA-RDP83-00418R001100040009-2

Approved For Release 2009/06/15 : CIA-RDP83-00418R001100040009-2

me këtë motivacion :

«Kanë punuar pa u lodhur për realizimin dhe tejkalimin e planit të shtetit, kanë punuar me metoda sovjetike, kanë nxjerrë prodhim me kualitet të mirë, kanë evituar skarcitetet në prodhim dhe kanë bërë përpjekje për uljen e kostos».

29) Anastas Thoma Capo
30) Caci Jani Çaundari
31) Dr.itim Sadik Duraj
32) Dhimitër Vangjel Mara
33) Gago Ilo Stillo
34) Hamit Rexhep Ndroqi
35) Haxhi Beqir Kodra
36) Jani Nina Rino
37) Nella Ilo Thanasi
38) Ramazan Halil Qyshka
39) Shaban Abedin Birko
40) Timo Stathi Muço

me këtë motivacion :

«Kanë treguar kujdes për mirëmbajtjen e automjetit, kanë shtuar afatin e përdorimit të gomave mbi kilometrazhin e caktuar, kanë kursyer karburant, lubrifikant dhe kanë qenë kurdoherë të gatëshëm në kryerjen e detyrës ».

41) Abdyl Belul Beluli
42) Aleks Spiro Kallogjeri
43) Avdi Mehmet Doçi
44) Aristidh Leonidha Gjivogli
45) Beshir Dervish Karanxha
46) Bajram Hysen Xhangolli
47) Bajram Demir Rapollari
48) Burhan Isuf Strazimiri
49) Damjan Sotir Bici
50) Elvira Thanas Zaharia
51) Fatbardha Noxhi Grazhdani
52) Fiqrete Riza Buzo
53) Ferit Gani Shehu
54) Ferit Rakip Myftari
55) Ferit Isuf Gjevori
56) Hatixhe Zyber Xhorxhi
57) Hekuran Qemal Bardhyli
58) Haxhi Hasan Kapllani
59) Kiço Sotir Panariti
60) Koço Jorgji Panajoti
61) Liri Besim Mema
62) Mahmut Nuredin Kurti
63) Muharrem Bajram Koçi
64) Marko Ilija Vollçi
65) Namik Ismail Shehu
66) Naun Llambi Bici
67) Naime Kadri Dibra
68) Petro Jorgji Konomi
69) Sadedin Bego Duka
70) Sazan Hasan Misja
71) Stefan Theodhor Prifti
72) Spiro Koço Qaramaj
73) Vangjel Lame Bashari
74) Xhemal Myrteza Karadaku

me këtë motivacion :

«Kanë kryer me kujdes dhe ndërgjegje detyrat që u janë ngarkuar, Kanë ruajtur sekretin ushtarak dhe pasurinë shtetërore dhe kanë bërë përpjekje për ngritjen e tyre politike dhe profesionale».

75) Beqir Teufik Haveri
76) Fatime Ibrahim Zhuri
77) Mazllëm Nazif Zylfo
78) Mihal Leonilla Liti
79) Rufije Bajram Sharofi
80) Zyhra Abaz Breti

me këtë motivacion :

«Kanë punuar pa u lodhur dhe kanë kryer me ndërgjegje detyrat që u janë ngarkuar. Kanë treguar kujdes për shëndetin e të sëmurve, kanë mbajtur rregull në repart dhe përpjekje për ngritjen e tyre tekniko-profesionale».

81) Nikolla Kozma Gjina
82) Remzi Abdulla Basha
83) Sofika Jorgji Jorgji

me këtë motivacion :

«Punonë të dalluar dhe të palodhur në punë, si guzhinjerë kanë treguar kujdes për pregatitjen e gjellëve dhe i kanë nxjerrë me kualitet të

Approved For Release 2009/06/15 : CIA-RDP83-00418R001100040009-2

Approved For Release 2009/06/15 : CIA-RDP83-00418R001100040009-2

mirë. Kanë ruajtur pasurinë shtetrore dhe kanë bërë përpjekje për ngritjen e tyre tekniko profesionale»,

84) Beqir Hasan Nekshiqi
85) Dhimitraq Naum Musha
86) Liri Muharem Natiku

me ketë motivacion :

«Puntorë të dalluar dhe të palodhur në punë, kanë treguar kujdes për të sëmurët dhe u kanë bërë shërbim të mirë. Kanë ruajtur materialin dhe kanë bërë përpjekje pér ngritjen e tyre tekniko-profesionale».

87) Adem Bajram Karaj
88) Asllan Ismail Subashi
89) Avdyl Ibrahim Zeneli
90) Asllan Fejzo Brinja
91) Abdulla Demir Metaj
92) Ali Sulejman Demetja
93) Basir Beqir Abedini
94) Beqir Zyber Ha:a
95) Dilaver Xhafer Tola
96) Dine Isuf Maleshka
97) Elman Ahmet Ajazi
98) Ferik Hekuran Dervishi
99) Fejzulla Abdulla Muça
100) Fidaji Em.n Musaj
101) Fadil Ymer Peqini
102) Gjore Jaho Shuklo
103) Hamit Nuredin Nuredini
104) Halim Xhafer Boriçi
105) Hamit Hysen Toçi
106) Hasim Qemal Dobi
107) Halim Beqir Tafa
108) Izet Mehmet Haxhi
109) Ibrahim Kapllan Nidhi
110) Islam Abdulla Bandi
111) Jonuz Sadik Gjikneli
112) Kristo Mitrush Koço
113) Kurtli Ramadan Kurtolli
114) Kristaq Thanas Bici
115) Loni Llambi Voka
116) Mustafa Resul Hasani
117) Meleqe Sali Noci
118) Meta Anastas Cvilo
119) Muharrem Reshit Foçi
120) Mazllom Abaz Rada
121) Mustafa Shaban Rama
122) Mustafa Muhamet Spahiu
123) Murat Zyber Naraçi
124) Nikolla Qaf Qirici
125) Osman Hysen Zakja
126) Osman Shaban Rada
127) Prek Frano Brozi
128) Petro Theodhor Qirko
129) Petro Sadi Bici
130) Qamil Ejup Muça
131) Qezim Haxhi Baqoshi
132) Qazim Muharrem Dervishi
133) Ramazan Shaban Laska
134) Rexhep Shaban Rerana
135) Rexh Bexhet Gorenxa
136) Ramazan Haxhi Matja
137) Ramadan Hysen Drini
138) Rahim Iljaz Ademi
139) Refat Riza Salillari
140) Sali Hasan Hasani
141) Sefedin Dajlan Brahimi
142) Shaban Ramazan Zolka
143) Sherif Ahmet Ajazi
144) Shaban Dizar Hasa
145) Shahin Rexhep Sinahaj
146) Traje Vasil Profitishti
147) Thanas Thanas Thomaj
148) Vangjel Andon Baci
149) Xhemal Mustafa Tereziu

me këtë motivacion :

« Puntorë të dalluar dhe të pa lodhur në punë. Janë mobilizuar për realizimin dhe tejkalimin e planit të shtetit dhe kanë nxjerrë punë me kualitet të mirë. Kanë bërë përpjekje për shfrytëzimin racional të materialeve dhe për ngriten e tyre tekniko-profesionale.

150) Vasilika Gaqo Prevazi

me këtë mativacion :

«Puntore e dalluar. Si llogaritare ka punuar pa u ladhur për mbarë-i vajtjen e sektorit ku punon, ka kryer mirë dhe me ndërgjegje detyrën që është ngarkuar. Ka nxjerrë punë të paster dhe në kohë dhe ka ruajtur sekretin ushtarak»,

Approved For Release 2009/06/15 : CIA-RDP83-00418R001100040009-2

Approved For Release 2009/06/15 : CIA-RDP83-00418R001100040009-2

151) Riza Rexhep Tahiri
me këtë motivacion:
«Puntor i dalluar dhe i palodhur në punë. ka kryer në mënyrë shembullore detyrën që i është ngarkuar».
152) Muharem Bajram Koçi 153) Marko Ilija Vollçi
me këtë motivacion:
«Pontorë të dalluar dhe të palodhur në punë. Kanë organizuar mirë punën në sektorin që drejtojnë, kanë punuar me metoda sovjetike, janë përpjekur vazhdimisht për uljen e kostos dhe për ngritjen e tyre tekniko-profesionale».

Tiranë, më 27-4-1955
Nr. i dekretit : 2043

PËR PRESIDIUMIN E KUVENDIT POPULLOR
TË REPUBLIKËS POPULLORE TË SHQIPËRISË
SEKRETARI: Sami Baholli
KRYETARI: Haxhi Lleshi

DEKRET
mbi dhënie Shtetësie

Në mbështetje të nenit 3 të dekretit Nr. 1874 datë 7-6-1954 mbi shtetësinë shqiptare

PRESIDIUMI I KUVENDIT POPULLOR
V E N D O S I :

I. — Tu jepet shtetësia shqiptare personave të posht shënuar:
1) Zeqir Selim Zeqiri banues lagja 29 Nandori Rr. Kristoforidhi Nr. 8 Tiranë
2) Hava Sadik Zeqiri » » » » » » » »
3) Esma Kamber Sada » katundi Tuçep rrethi Shupenzë.
4) Qazim Mustafa Qeriqi » Lagja Guerilјeve Rr. Musa Dutja Nr. 24 Shkodër
5) Maliqe Jusuf Qeriqi » » » » » » » »
6) Homide Sejtali Ferhati » katundi Shengjergj rrethi i qerës Korçë.
7) Hysen Rustem Qajaj » LLakatund Vlorë
8) Lutfi Hyse Qajaj » » »
9) Mitko Jonçi Simonovski » » »
10) Murat Rexhit Nikoçaj » » »
11) Hajrije Meto Nikoçaj » » »
12) Hoda Rexhit Nikoçaj » » »
13) Rexhep Hajdar Tahiri » » »
14) Hare Mon Tahiri » » »
15) Shaqe Zef Tanjri » » »
16) Hysen Hajda Tahiri » » »
17) Drane Hysen Tahiri » » »
18) Hami I Asllani » » »
19) Rabe Dine Biraj » katundi Gjinaj Kukes

II. — Ky dekret hyn në fuqi me datë 16-5-1955.

III. — Për zbatimin e këtij dekreti ngarkohet Ministria e punëve të brendëshme.

Tiranë, më 2-5-1955
Nr. i dekretit : 2045

PËR PRESIDIUMIN E KUVENDIT POPULLOR
TË REPUBLIKËS POPULLORE TË SHQIPËRISË
SEKRETARI: Sami Baholli
KRYETARI: Haxhi Lleshi

Approved For Release 2009/06/15 : CIA-RDP83-00418R001100040009-2

Approved For Release 2009/06/15 : CIA-RDP83-00418R001100040009-2

PJESA E II-të

KËSHILLI I MINISTRAVE

VENDIM
Nr. 153 Dt. 2/V/1955

MBI
GRADAT DHE TITUJT SHKENCORË DHE MBI ASPIRANTURËN NË SHKOLLAT E LARTA DHE INSTITUCIONET E KËRKIMEVE SHKENCORE

Këshilli i Ministrave i Republikës Popullore të Shqipërisë, me qëllim që punës kulturale dhe shkencore ti jepet një hov më i math, duke u kualifikuar kuadrot shkencore, në mbledhjen e datës 2 /V/1955,

V E N D O S I :

1. — Në degët e shkencave fizike e matematike, kimike, biologjike, biologjike-mineralogjike, teknike, bujqësore, historike, ekonomike, filozofike e filologjike, gjeografike, juridike, pedagogjike, mjekësore, farmaceutike, veterinare dhe arkitekturë jepen grada shkencore «Kandidat i Shkencave» dhe «doktor i shkencave».

Gradat shkencore të sipërme u jepen punonjësve shkencorë në bazë të kualifikimit në një degë të caktuar të shkencës, në bazë të volumit të dijenive shkencore dhe në bazë të punës së pavarur shkencore që bëjnë dhe të rëndësisë së saj.

2. — Grada shkencore «kandidat i shkencave» që jepet nga komisioni lartë i atestimit i përket punonjësit shkencor që ka bërë aspiraturën gjatë kohës së caktuar ose ka dhënë provimet e nevojshme dhe ka mbrojtur me sukses disertacionin e kandidaturës me temën e zgjedhur prej tij.

Disertacioni duhet të tregojë njohurit e përgjithëshme teorike në një ëndë të caktuar, njohuritë speciale për çështjet që zhvillohen në disertacionin si dhe aftësitë e disertantit për kërkime shkencore të pavarura.

Në raste të veçanta mund të mos bëhet aspirantura nga punonjësi shkencor dhe të mos jepen prej tij provimet e kandidaturës kur ai ka një stazh të gjatë në punë shkencore dhe sa ka shkruar e botuar vepra të një niveli shkencor dhe ideollogjik të lartë. Veprat e botuara ose të pa botuara në këtë rast zejnë vendin e disertacionit.

3. — Grada shkencore «doktor i shkencave» që jepet nga komisioni i lartë i atestimit, i përket punonjësit shkencor që ka gradën shkencore të kandidatit të shkencave dhe ka mbrojtur me sukses disertacionin e doktorit të shkencave me temën e zgjedhur prej tij.

Disertacioni duhet të tregojë punën e pavarur shkencore, si rezultat i së cilës janë zgjidhur ose janë përgjithësuar teorikisht probleme të rëndësishme shkencore ose janë shtruar dhe arsyetuar në mënyrë shkencore probleme të reja të një rëndësie të konsiderueshme shkencore.

Në raste të veçanta, mund të mos mbrohet disertacioni përkatës nga punonjës shkencor që ka shkruar e botuar vepra të çquara shkencore ose ka bërë shpikje dhe zbulime të rëndësishme shkencore.

4. — Për punën shkencore dhe pedagogjike që bëjnë punonjësit e shkencës u jepen titujt shkencor që janë:

a) «asistent në shkollat e larta, «bashkëpuntor i ri shkencor» në institucionet e kërkimeve shkencore;

Approved For Release 2009/06/15 : CIA-RDP83-00418R001100040009-2

Approved For Release 2009/06/15 : CIA-RDP83-00418R001100040009-2

b) «docent» në shkollat e larta, «bashkëpuntor i vjetër shkencor» në institucionet e kërkimeve shkencore;

c) «profesor» si në shkollat e larta ashtu dhe në istitucionet e kërkimeve shkencore.

5. — Titulli shkencor «asistent» në shkollat e larta që jepet me vendim të këshillave shkencore të këtyre shkollave dhe «bashkëpuntor i ri shkencor» në institucionet e kërkimeve shkencore, që jepet me vendim të presidiumit të Institutit të Shkencave, i përket punonjësit shkencor që ka mbaruar shkollën e lartë, ka një kualifikim të mjaftueshëm për punë pedagogjike ose kërkime shkencore dhe nën udhëheqjen e një profesori ose docenti në shkollat e larta, ose bashkëpuntori të vjetër shkencor në institucionet e kërkimeve shkencore, drejton punë praktike ose punë laboratori dhe merr pjesë në referatet për ngritjen e tij shkencore.

6. — Titulli shkencor «docent» në shkollat e larta që jepet nga komisioni i lartë i atestimit dhe «bashkëpuntot i vjetër shkencor» në institucionet e kërkimeve shkencore që jepet nga presidiumi i Institutit të Shkencave i përket punonjësit shkencor që ka mbaruar shkollën e lartë, zhvillon kurse leksionesh të plota të pavarura të një niveli të lartë shkencor, ka një aktivitet metodiko-shkencor i cili shprehet në veprat e tij qofshin këto të botuara ose të pa botuara, në artikuj të ndryshëm shkencore, në adaptime tekstesh, në referate shkencore etj, dhe që në këto punë ka një stazh jo në pak se tre vjet.

7. — Titulli shkencor «profesor» si në shkollat e larta ashtu dhe në institucionet e kërkimeve shkencore që jepet nga komisioni i lartë i atestimit, mbi propozimin e këshillave shkecore të shkollave të larta ose të presidiumit të Institutit të Shkencave, i përket punonjësit shkencor që ka një aktivitet të gjërë pedagogjike-shkencor, ka vepra të tij shkencore të botuara, ka zgjidhur ose zgjidh probleme të rëndësishme për shkencën dhe prodhimin dhe ka më tepër se tre vjet që ka marrë titullin shkencor «docent».

8. — Për dhënien e gradave dhe titujve shkencore, sipas këtij vendimi krijohet pranë Këshillit të Ministrave komisioni i lartë i atestimit nën kryesinë e Ministrit të Arësimit dhe Kulturës, duke pasur nën/kryetarë, sekretar dhe anëtarë që caktohen nga Këshilli i Ministrave. Komisioni i lartë i atestimit kryen veprimtarinë e tij simbas rregullores që formon pjesë përbërëse të këtij vendimi.

9. — Pranë shkollave të larta dhe institucioneve të kërkimeve shkencore të Republikës Popullore të Shqipërisë të organizohet aspirantura si forma kryesore për pregatitjen e kuadrove shkencore dhe pedagogjike të kualifikuara në konformitet me rregulloren, që formon pjesë përbërëse të këtij vendimi,

10. — Ky vendim hyn në fuqi menjiherë.

ZËV. KRYETAR' I KËSHILLIT MINISTRAVE TË R.P.SH.
HYSNI KAPO

SEKRETAR' I PËRGJITHSHËM
KËSHILLIT TË MINISTRAVE
Muhamer Spahiu

Approved For Release 2009/06/15 : CIA-RDP83-00418R001100040009-2

Approved For Release 2009/06/15 : CIA-RDP83-00418R001100040009-2

RREGULLORE
MBI
KOMISIONIN E LARTË TË ATESTIMIT

Neni 1.—

Për dhënien e gradave dhe titujve shkencore pranë Këshillit të Ministrave krijohet komisioni i lartë i atestimit i cili:

a) me propozimin e këshillave shkencore të shkollave të larta ose të presidiumit të Institutit të Shkencave jep gradat shkencore «kandidat i shkencave» dhe «doktor i shkencave» dhe titujt shkencorë «docent» dhe «profesor» duke lëshuar njikohësisht dhe atestatet përkatëse;

b) kontrollon punën e këshillave shkencore të shkollave të larta dhe të institucioneve të kërkimeve shkencore përsa i përket bërjes së propozimeve për dhënien e gradave dhe titujve shkencore;

c) cakton lëndët për të cilat këshillat e shkollave të larta dhe të institucioneve të kërkimeve shkencore u jepet e drejtë të propozojnë disertacionet;

ç) jep diplomë personave që u është aprovuar dhënia e gradës shkencore dhe atestat atyre që u jepet titulli shkencor;

d) jep udhëzime të nevojshme për zbatimin e dispozitave mbi gradat dhe titujt shkencore.

Neni 2.—

Komisioni i lartë i atestimit përbëhet: nga kryetari që është Ministri i Arësimit dhe i Kulturës, zëv/kryetarët, sekretari shkencor dhe anëtarët dhe aprovohet me vendim të Këshillit të Ministrave mbi propozimin e Ministrit të Arësimit dhe Kulturës.

Kryetari i komisionit të lartë të atestimit, zëvëndës kryetarët dhe sekretari shkencor përbëjnë presidiumin e komisionit

Neni 3.—

Puna organizative dhe pregatitore e komisionit të lartë të atestimit kryhet nga sekretari shkencor, në bazë të rregullores së brëndëshme të aprovuar nga kryetari. ndërsa disertacionet që i paraqiten komisionit shqyrtohen në menyrë paraprake nga komisionet e ekspertave, të cilët, në rast nevoje, për një analizë të hollësishme, thërasin referentë specialistë për temën e disertacionit.

Përbërja e komisionit të ekspertave dhe rregullorja e punës së tyre aprovohen nga kryetari i komisionit të lartë të atestimit.

Neni 4.—

Vendimet e komisionit të lartë të atestimit dhe dhënia e gradave dhe titujve shkencorë merren në mbledhjen plenare të komisionit dhe me shumicën e votave të fshehta.

Neni 5.—

Vendimet mund të rishqyrtohen nga vet komisioni i lartë i atestimit mbi kërkesën e motivuar të paraqitur brenda dy muajve nga këshillat shkencore të shkollave të larta, institucionet e kërkimeve shkencore ose personi i interesuar,

Në këtë rast, po të jetë e nevojshme, disertacionet dhe materialet mund të dërgohen për një ekspertizë plotësuese, rezultati i së cilës rishqyrtohet nga komisioni, vendimi i të cilit është i formës së prerë.

Neni 6.—

Vendimet e komisionit të lartë të atestimit për dhënien e gradave dhe

Approved For Release 2009/06/15 : CIA-RDP83-00418R001100040009-2

Approved For Release 2009/06/15 : CIA-RDP83-00418R001100040009-2

titujve shkencorë u komunikohen të interesuarve dhe botohen në gazetën zyrtare.

Neni. 7.—

Presidiumi i komisionit të lartë të atestimit shqyrton çështjet korente të punës së komisionit dhe:

a) shqyrton në mënyrë paraprake kërkesat e motivuara që paraqiten kundra vendimeve të komisionit;

b) shqyrton kërkesat për ti lejuar kandidatit të mos japë provimet e kandidaturës,

Neni 8.—

Pjestarët e komisionit të lartë të atestimit gjatë mbledhjeve të komsionit lirohen nga puna e tyre kryesore.

Neni 9.—

Komisioni i lartë i atestimit ka vulën e tij me stemën shtetërore

Neni 10

Kjo rregullore hyn në fuqi menjiherë.

ZËV. KRYETAR' I KËSHILLIT MINISTRAVE TË R.P.SH.
HYSNI KAPO

SEKRETAR' I PËRGJITHËSHËM I
KËSHILLIT TË MINISTRAVE
Muhamer Spahiu

FËRBËRJA E KOMISIONIT TË LARTË TË ATESTIMIT

Këshilli i Ministrave aprovon përbërjen e mëposhtëme të komisionit të lartë të atestimit:

1)	Bedri Spahiu	Kryetar
2)	Qibrije Ciu	N/Kryetare
3)	Kol Paparisto	»
4)	Drejtori i Instituteve të Larta	Sekretar shkencor
5)	Hasan Duma	Anëtar
6)	Zeqir Lika	»
7)	Stefanaq Pollo	»
8)	Zija Këlliçi	»
9)	Adem Deliu	»
10)	Munir Reso	»
11)	Kolë Popa	»
12)	Sotir Kuneshka	»

ZËV. KRYETAR' I KËSHILLIT MINISTRAVE TË R.P.SH.
HYSNI KAPO

SEKRETARI I PËRGJITHËSHËM I
KËSHILLIT TË MINISTRAVE
Muhamer Spahiu

Approved For Release 2009/06/15 : CIA-RDP83-00418R001100040009-2

Approved For Release 2009/06/15 : CIA-RDP83-00418R001100040009-2

R R E G U L L O R E

MBI

ASPIRANTURËN

I. — DISPOZITA TË PËRGJITHËSHME

Neni 1.—

Aspirantura, që organizohet në shkollat e larta dhe institucionet e kërkimeve shkencore, është forma kryesore për pregatitjen e kuadrove shkencore dhe pedagogjike të kualifikuara.

Neni 2.—

Aspirantura organizohet vetëm në ato shkolla të larta dhe institucione të kërkimeve shkencore, që kanë udhëheqës shkencorë me një kualifikim të lartë dhe disponojnë bazën përkatëse të kërkimeve shkencore.

Neni 3

Aspirantura është dy llojesh:

a) aspirantura duke u çkëputur nga puna kryesore

b) aspirantura pa u çkëputur nga puna kryesore.

Aspirantura pa u çkëputur nga puna kryesore organizohet për përgatitjen e kuadrove shkencore nga radhët e atyre specialistëve që mund të hyjnë në aspiranturë pa u çkëputur nga puna kryesore për shkak se në qëndrat e punës ku punojnë i kanë kushtet e nevojëshme për punë shkencore.

Neni 4.—

Këshilli i Ministrave i Republikës Popullore të Shqipërisë, mbi propozimin e ministrive përkatëse, aprovon numurin e aspiranteve duke caktuar njëkohësisht dhe shkollat e larta dhe katedrat si dhe seksionet e institucioneve të kërkimeve shkencore ku do të përgatiten këta aspirantë.

II. – RREGULLAT PËR PRANIMIN NË ASPIRANTURË

Neni 5.—

Në aspiranturë pranohen personat që kanë arësim të lartë dhe aftësi për punë pedagogjike e kërkime shkencore.

Neni 6.—

Lutjet per pranimin në aspiranturë i paraqiten drejtorit të shkollës së lartë ose kryetarit te institucionit të kërkimeve shkencore së bashku me:

a) diplomën e mbarimit të shkollës së lartë

b) autobiografinë,

c) dokumentin ushtarak,

ç) karakteristikat nga qëndra e punës ku ka punuar kohën e fundit lutjedhënësi.

Neni. 7.—

Ministria përkatëse, nga e cila varet shkolla e lartë ose institucioni i kërkimeve shkencore, vendos mbi pranimin e lutjeve të paraqitura, duke patur parasysh numurin e aprovuar të aspiranteve nga Këshilli i Ministrave simbas nenit 4 të kësaj rregulloreje.

Duhet të pranohen, në rradhë të parë, në aspiranturë personat që

Approved For Release 2009/06/15 : CIA-RDP83-00418R001100040009-2

Approved For Release 2009/06/15 : CIA-RDP83-00418R001100040009-2

kanë diplloma të shkëlqyer ose stazh pune praktike për një specialitet të caktuar.

Neni 8.—

Lutjet për pranimin në aspiranturë dhe vendimi i ministrisë mbi pranimin e tyre, jepen rregullisht prej 1 Korrikut gjer me 15 Shtator.

Neni 9.—

Ata që pranohen në aspiranturë, duke u çkëputur nga puna e tyre kryesore, lirohen nga qendrat e punës së tyre dhe vihen në dispozicion të shkollave të larta ose të institucioneve të kërkimeve shkencore jo më vonë se 15 ditë pas pranimit të tyre në aspiranturë.

III. — PËRGATITJA E MËSIMEVE PREJ ASPIRANTIT

Neni 10.

Koha për përgatitjen e aspirantëve, duke u përfshirë edhe mbrojtja e disertacionit, caktohet në 3 vjet për ata që çkëputen nga puna e tyre kryesore dhe 5 vjet maksimum për ata që nuk çkëputen nga puna e tyre kryesore (3 vjet për dhënien e provimeve dhe 2 vjet për përgatitjen dhe mbrojtjen e disertacionit).

Neni 11

Udhëheqja dhe përgjegjësia për përgatitjen e aspirantëve i ngarkohet përgjegjësit të katedres në shkollat e larta dhe sekretarit shkencor të presidiumit të institucioneve të kërkimeve shkencore.

Çdo aspirant, që në vitin e parë të përgatitjes, vihet pranë një udhëheqësi shkencor, i cili duhet të ketë gradën «kandidat i shkencave» ose pranë personave pa gradë por t'aftë për të realizuar një udhëheqje shkencore ose pranë një kolektivi specialistësh të caktuar nga komisioni i lartë i atestimit.

Zakonisht një udhëheqës shkencor mund të ketë në patronazh jo më shumë se dy aspirantë.

Neni 12.—

Përgatitja e aspiranteve bëhet në bazë të një plani individual 3 vjeçar (për aspirantët që çkëputen nga puna kryesore) dhe 5 vjeçar (për aspirantët që nuk shkëputen nga puna e tyre kryesore. Ky plan hartohet prej përgjegjësit të katedrës në shkollat e larta ose përgjegjësit të seksionit të institucioneve të kërkimeve shkencore dhe pas shqyrtimit të tij në këshillin shkencor aprovohet prej drejtorit të shkollës së lartë ose kryetarit të institucionit të kërkimeve shkencore.

Në planin e aspirantëve që nuk çkëputen nga puna e tyre kryesore parashikohen jo më shumë se 30 orë javore për studime dhe kërkime shkencore. Aspiranti duhet të raportojë periodikisht por jo më pak se dy herë në vit për zbatimin e planit individual, në mbledhjen e katedres ose përpara këshillit shkencor përkatës t'institucionit shkencor.

Neni 13

Përmbajtja kryesore e planit individual të aspirantit është puna e pavarur që duhet të bëjë ky për përgatitjen e tij pedagogjike dhe shkencore.

Aspiranti përgatitet në këto forma:

a) Ndjek mësimet teorike për një nga lëndët socialo-ekonomike, për një gjuhë të huaj dhe për lëndët speciale që i përkasin sektorit shkencor të zgjedhur prej aspirantit duke studjuar materialin shkencor në gjuhën

Approved For Release 2009/06/15 : CIA-RDP83-00418R001100040009-2

Approved For Release 2009/06/15 : CIA-RDP83-00418R001100040009-2

shqipe dhe në gjuhë të huaja si për specialitetin e zgjedhur prej tij asht; dhe për sektorët shkencorë, që kanë lidhje me këtë specialitet.

b) Merr pjesë në veprimtarinë metodike të katedres duke gakuentuar leksionet, konsultimet dhe mësimet praktike në laboratore që udhëhiqen nga pedagogë me eksperiencë,

c) Zhvillohen që prej vitit të parë akademik punë pedagogjike për specielitetin e dhënë.

ç) Zhvillon veprimtari të pavarur në kërkimet shkencore, të lidhura me temën e disertacionit, duke filluar prej vitit të parë të pregatitjes.

d) Bën, pas vitit të parë të përgatitjes, praktikë shkencore në prodhim ose për specialitetin e dhënë kur është aspirant i katedrave ose i seksioneve speciale që nuk kanë stazh prodhimi.

dh) Përgatitet dhe mbron disertacionin.

Neni 14.—

Tema e disertacionit e aspirantit caktohet në vitin e parë të përgatitjes dhe aprovohet prej komisionit të lartë të atestimit të cilit i paraqitet prej këshillit shkencor të shkollës së lartë ose institucionit të kërkimeve shkencore, në marrëveshje me ministrinë përkatëse.

IV. — PROVIMET E ASPIRANTIT

Neni 15.—

Për të gjitha lëndët që studjon aspiranti, simbas planit individual të tij, është i detyruar që në afatin e caktuar në atë plan, të japë provimin përpara komisionit që përbëhet prej drejtorit të shkollës së lartë (ose drejtorit të institucionit shkencor) zev. drejtorit të shkollës së lartë për anë mësimore (ose zev. drejtorit të institucionit shkencor) përgjegjësit të katedres dhe pedagogut të lëndës për të cilën jepet provimi (ose komisionit të specialistëve të lëndës për të cilën jepet provimi),

Neni 16.—

Provimet e kandidaturës përfshijnë këto lëndë:

a) Materializmin dialektik dhe historik.

b) Lëndën kryesore për specialitetin e kandidatit.

c) Lëndën speciale sipas temës së zgjedhur nga kandidati.

ç) Gjuhën ruse dhe një nga gjuhët e perendimit.

Provimet e kandidaturës mbi materializmin dialektik dhe historik dhe mbi gjuhën ruse e perëndimore jepen sipas programeve të posaçme të aprovuara nga Ministria e Arësimit dhe Kulturës ndërsa provimet mbi lëndë speciale jepen sipas programeve të aspiranturës respektive.

Neni 17

Provimi i kandidaturës mbi materializmin dialektik dhe historik si dhe mbi gjuhën ruse e perendimore mund të jepet në çdo shkollë të lartë pranë së cilës është organizuar aspirantura, ndërsa provimet për lëndët speciale jepen në shkollën e lartë ose në institucionet e kërkimeve shkencore pranë të cilave është organizuar aspirantura në atë specialitet që ka zgjedhur kandidati.

Neni 18.—

Provimet e kandidaturës për lëndët e ndryshme mundet të jepen në kohra të ndryshme por në mes dy provimeve nuk duhet të kalojnë më tepër se 9 muaj.

Neni 19.—

Shkolla e lartë ose institucioni i kërkimeve shkencore pranë të cilit

Approved For Release 2009/06/15 : CIA-RDP83-00418R001100040009-2

Approved For Release 2009/06/15 : CIA-RDP83-00418R001100040009-2

kandidati jep provimet, i lëshon këtij një dëshmi, sipas një forme të posaçme që aprovohet nga Ministria e Arësimit dhe Kulturës.

Kopjet e dëshmive ruhen së bashku me protokollet e komisioneve të provimeve në arkivën e shkollës së lartë ose të institucionit të kërkimeve shkencore.

Neni 20

Drejtimin e përgjithëshëm të përgatitjes së kuadrove me anën e aspiranturës e ka Ministria e Arësimit dhe Kulturës.

V. — TË DREJTAT DHE DETYRAT E ASPIRANTEVE

Neni 21

Aspirantet, që nga viti i parë i përgatitjes, bëjnë pjesë në katedrën e shkollës së lartë ose në seksionin e institucionit të kërkimeve shkencore dhe përdorin pajisjet laboratoret, kabinetet dhe bibliotekën një lloj si personeli tjetër.

Neni 22.—

Të gjithë aspirantët që çkëputen nga puna e tyre kryesore marrin bur së prej 4.500 lekësh në muaj.

Neni 23.—

Aspirantët gëzojnë të gjitha lehtësirat që kanë punonjësit e shkencës.

Neni 24

Aspirantët që çkëputen nga puna e tyre kryesore gëzojnë të drejtën e lejes vjetore prej 2 muajsh në verë.

Aspirantët që nuk çkëputen nga puna e tyre kryesore e kanë ditën e punës 6 ore, n'istitutet e larta kanë 3/4 e normës dhe marrin një muaj pushim në vit dhe 3 muaj vitin e fundit.

Aspirantët që nuk çkëputen nga puna kryesore hartojnë planin individual të punës duke llogaritur të punojnë për studime e kërkime shkencore jo më pak se 30 orë në javë.

Neni 25.—

Aspirantëve nuk u lejohet të punojnë në një qendër tjetër pune, përveç qendrës së tyre të punës, pa plotësuar detyrat që cakton neni 13 i kësaj rregulloreje.

Neni 26.

Aspiranti që nuk zbaton planin individual, me urdhër të Ministrit përkatës përjashtohet nga aspiranturа dhe në qoftë se është çkëputur nga puna e tij kryesore lihet në dispozicion të ministrisë, nga e cila varej.

Neni 27.—

Quhet se ka mbaruar aspiranturën personi që ka kryer planin individua dhe ka mbrojtur disertacionin për gradën shkencore «Kandidat i shkencave».

Neni 28.—

Personat që kanë mbaruar aspiranturën emërohen prej Ministrisë përkatëse, sipas një plani të bërë në bashkëpunim me Ministrin e Arësimit dhe Kulturës.

Neni 29

Kjo rregullore hyn menjëherë në fuqi.

ZËV. KRYETAR' I KËSHILLIT MINISTRAVE R.P.SH.

HYSNI KAPO

25X1

Approved For Release 2009/06/15 : CIA-RDP83-00418R001100040009-2